# RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT

## "AUDITIM FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRIE"

## BASHKIA ROSKOVEC

**Tiranë, shtator 2024**

🗐 PËRMBAJTJA

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE....4
1. Përshkrim i shkurtër i projektit të auditimit ....4
2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve....5
3. Konkluzioni i përgjithshëm dhe opinioni i auditimit....6
II. HYRJA....9
1. Objektivat dhe qëllimi i auditimit....9
2. Identifikimi i çështjes. ....9
3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese. ....10
4. Përgjegjësitë e audituesve. ....10
5. Kriteret e vlerësimit ....10
6. Standardet e auditimit. ....12
7. Metodologjia e auditimit. ....12
8. Dokumentimi i auditimit. ....14
III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT....14
1.Informacion i përgjithshëm....14
2. Përshkrimi i auditimit sipas drejtimeve të auditimit....14
2.1Mbi kontrollin e brendshëm financiar publik. ....14
2.2 Mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit. ....26
2.3 Mbi vlerësimin e raportimit financiar për vitin 2023. ....44
2.4 Mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik. ....53
2.4.1 Mbi zbatimin e kontratave të punimeve në investimet publike. ....81
2.5 Mbi organizimin dhe funksionimin e strukturave mbi administrimin e pronës 91
2.6 Të ndryshme të dala gjatë auditimit. ....95
IV. GJETJE DHE REKOMANDIME ....98

## Lista e shkurtimeve

| | |
|---|---|
| KLSH | Kontrolli i Lartë i Shtetit |
| MFE | Ministria e Financave dhe Ekonomisë |
| MFK | Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli |
| NA | Nëpunës Autorizues |
| NZ | Nëpunës Zbatues |
| GMS | Grupi i Menaxhimit Strategjik |
| NJAB | Njësia e Auditimit të Brendshëm |
| AB | Auditi i Brendshëm |
| MAB | Manuali i Auditimit të Brendshëm |
| FZHR | Fondi i Zhvillimit të Rajoneve |
| AQT | Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara |
| UMF | Udhëzim i Ministrisë së Financave |
| VKM | Vendim i Këshillit të Ministrave |
| VKB | Vendim i Këshillit Bashkiak |
| ASHK | Agjencia Shtetërore e Kadastrës |
| NJA | Njësi Administrative |
| SHA | Shoqëri Anonime |
| NJP | Njësia e Prokurimit |
| BOE | Bashkim i Operatorëve Ekonomikë |
| OE | Operator Ekonomik |
| KVO | Komisioni i Vlerësimit të Ofertave |
| ISSAI | Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit |
| INTOSAI | Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit |
| IFAC | Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve |
| IPSAS | Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik |

## I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

### 1. Përshkrim i shkurtër i projektit të auditimit

**a.** Bashkia **Roskovec** është njësi vendore institucion i pavarur, ku pas ndarjes së re territoriale është një bashkim mes qytetit dhe ish-komunave në afërsitë të tij, pra në total ka 4 njësi administrative si vijon: Njësia Administrative Roskovec (qyteti), Njësia Administrative Strum, Njësia Administrative Kuman dhe Njësia Administrative Kurjan.

**Misioni** i Bashkisë Roskovec është të sigurojë qeverisjen në një nivel sa më afër qytetarëve, duke garantuar vetë-qeverisjen në përputhje me kërkesat e Kartës Evropiane të Autonomisë Vendore.

**Synimi kryesor** është plotësimi sa më i mirë i nevojave dhe kërkesave të komuniteteve përkatëse, nëpërmjet arritjes së një niveli sa më të lartë shërbimesh, në dobi të një zhvillimi të balancuar me qëllim përfundimtar standarde të larta të cilësisë së jetesës në territorin nën administrim.

**Buxheti i Bashkisë Roskovec** si të gjithë njësitë e qeverisjes vendore financohet nga të ardhurat e veta të krijuara në mënyrë të pavaruar, nga transferta e pakushtëzuar e akorduar nga buxheti i shtetit për realizimin e funksioneve të veta dhe të përbashkëta, nga transfertat e kushtëzuara të akorduara nga buxheti i shtetit për realizimin e funksioneve të deleguara, nga transferta specifike për realizimin e e funksioneve të reja, nga ndarja e taksave ndërkombëtare, donacione e burime të tjera të parashikuara në ligj.

**b. Rëndësia e institucionit dhe auditimit të tij.**

Auditimi i këtij institucioni çdo vit është detyrim ligjor në bazë të ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e qeverisjes vendore" nenit 50 "Auditi i jashtëm" pikat 1 dhe 2 në të cilat përcaktohet: "*1. Veprimtaria financiare dhe zbatimi i buxhetit vjetor të njësive të vetëqeverisjes vendore u nënshtrohen çdo vit auditimit të jashtëm. 2. Auditimi i jashtëm realizohet nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose auditues të tjerë ligjorë".* Gjithashtu ky auditim merr rëndësi të veçantë për arsye se, Bashkia Roskovec si çdo njësi vendore administron, menaxhon dhe shpenzon fonde publike, pjesë e buxhetit të bashkisë të miratuar nga Këshilli Bashkiak me burim financimi nga të ardhurat e realizuara nga taksapaguesit qytetarë dhe fondet e transferuara nga Buxheti i Shtetit.

**c. Qëllimi i auditimit.**

Qëllimi i këtij auditimi është dhënia e opinionit mbi përputhshmërinë e veprimtarisë ekonomike dhe financiare me aktet ligjore dhe nënligjore, për periudhën 01.01.2023 - 31.12.2023. Për të gjitha problematikat e konstatuara janë dhënë rekomandime për përmirësime me synim ndërmarrjen e masave dhe veprimeve korrigjuese nga Bashkia Roskovec. Në përmbushje të qëllimit të auditimit, janë shqyrtuar çështjet e mëposhtme:

- *mbi menaxhimin financiar, kontrollin dhe auditin e brendshëm.*
- *mbi planifikimin, zbatimin e monitorimin e planit të buxhetit.*
- *mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, si dhe zbatimin e kontratave të punimeve.*
- *Mbi organizimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin e pronës publike.*

**d. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave.**

Metodogjia e përdorur për kryerjen e këtij auditimi është mikse, sasiore dhe cilësore. Auditimi është kryer mbi bazë risku. Grupi i auditimit ka audituar mbi 50% të transaksioneve të likuidimeve nëpërmjet bankës dhe auditimin e blerjeve dhe investimeve për procedurat, ku vlera e investimit apo e blerjes është e konsiderueshme. Metodat e auditimit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit. Në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve, janë përdorur veçmas ose të kombinuara metodat dhe teknikat e mëposhtme verifikimi i transaksioneve, shqyrtimi i raporteve dhe dokumentacionit, intervistat, verifikimi në sistem dhe terren.

**e**. **Nga shqyrtimi i evidencave**, rezultoi se institucioni për periudhën nën auditim paraqet mangësi në disa prej drejtimeve të veprimtarisë. Grupi i auditimit ka konstatuar 25 gjetje dhe ka dhënë 28 rekomandime, nga të cilat: masa organizative me 17 gjetje dhe 20 rekomandime, 4 gjetje-rekomandime shpërblim dëmi në fushën e zbatimit të kontratave të punimeve në vlerën **4,739,122 lekë**, 4 gjetje-rekomandim si efekt negativ në vlerën **124,319 mijë lekë** në fushën e prokurimit të fondeve publike, dhe 3 gjetje dhe 3 rekomandime në fushën e të ardhurave.

**2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve**

**a.Paraqitja e gjetjeve kryesore**. Disa nga problematikat e konstatuara lidhen me*:*

- ***Procedurat e zbatimit të kontratave të punimeve të ndërtimit***

- Në **4 raste** janë konstatuar punime të pakryera me një ***dëm ekonomik në vlerën* 4,739,122 lekë** projektet e investimit me objekt:
- "*Rikonstruksioni i shkollës mesme "Didin Bishani Kurjan*";
- "*Ndërhyrje për sigurinë e rezervuarit të Ngjeqarit*";
- "*Asfaltimi i rrugëve të brendshme në lagjet e Bashkisë Roskovec*";
- *Ndërhyrje emergjente në fshatin Ngjeqar, Njësia Administrative Kurjan (Riparim i shkarjes në lagjen Stan, L=50L; Riparim i shkarjes në lagjen Gogallarët; Punime në rrugën Ngjeqan-Kurtaj; Punime për Përroin e Allambrezit*)".

***Procedurat e prokurimit publik*** për punë publike, mallra dhe shërbime:

Nga auditimi i 5 procedurave me vlerë të fondit limit 156,312 mijë lekë, janë konstatuar me shkelje të akteve ligjore/nënligjore të LPP, të 5 procedurat me vlerë kontrate 124,319 mijë lekë ose 80 % e vlerës së fondit limit. Në 4 nga këto procedura ofertat ekonomike të OE/BOE të shpallur fitues, nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të DT, si dhe rezulton vendosje jo e drejtë e kritereve për kualifikim duke çuar në mungesë konkurrence me pasojë përdorimin të fondeve publike për vlerën 103,762,016 lekë pa TVSh, në kundërshtim me përcaktimet e kuadrit ligjor në fuqi.

- ***Procedurat e planifikimit dhe realizimit të të ardhurave***

- Për mos pagesën e detyrimeve tatimore më datën 31.12.2023 janë debitorë abonentët familjar në vlerën **158,982,417 lekë**.
- Për mos pagesën e detyrimeve tatimore janë debitorë subjektet e biznesit të vogël, biznesit të madh në vlerën **21,076,995 lekë**.
- Për mos pagimin e taksës së infrastrukturës janë debitorë subjektet në vlerën **26,028,331 lekë**.

- ***Për vlerësimin e raportimit financiar***

- Referuar analizës të gjendjes së llogarisë (210) "*Toka, troje, terrene*" nuk paraqet gjendjen reale sepse nga ana e Drejtorisë Ekonomike nuk janë hedhur në kartelat e kontabilitetit asnjë prej vlerave të; a) trojeve të objekteve si godina e re e Bashkisë dhe trualli përreth saj, ndërtesat e shkollave që ka në administrim, ndërtesat e shkollave dhe të zyrave në NjA, etj, b) truallit të godinave të regjistruar në ASHK në pronësi të Bashkisë, c) trojeve të cilat me VKM kanë kaluar në pronësi të Bashkisë Roskovec;
- Referuar analizës të gjendjes së llogarisë (212) "*Ndërtime e Konstruksione*" nuk paraqet gjendjen reale sepse nuk disponohet asnjë lloj dokument pronësie për *30 objekte* me sipërfaqe trualli nën objekt të objekteve prej *23,303* $m^2$ të trashëguara nga nga ish Komunat një numër të konsiderueshëm objektesh të cilat janë në verifikim për regjistrimin e tyre.
- Referuar analizës të gjendjes së llogarisë (213) "*Rrugë, rrjete, vepra ujore*" nuk paraqet pamjen reale pasi në këtë llogari nuk janë kryer ndryshimet përkatëse nëpërmjet marrjes në përdorim dhe krijimit të servitutit të përhershëm në sipërfaqet e tokave shtetërore që preken nga ndërtimi i korridorit të ndërtimit dhe korridori i sistemit të gazsjellësit, të projektit të gazsjellësit trans adriatik (projekti TAP)".

- ***Procedurat e ndjekura për inventarizimin dhe rregjistrimin e aseteve***

Nga auditimi rezultoi se, janë 596 pronave të paluajtshme publike, shtetërore, të transferuara në pronësi ose në përdorim Bashkisë Roskovec, listat përfundimtare të të cilave janë të

miratuara me VKM përkatëse. Nga këto prona janë hipotekuar 20 prona, ndërsa për pjesën tjetër të pronave nuk është bërë përditësimi i të dhënave të inventarit të këtyre pronave.
Nga Bashkia Roskovec nuk janë marrë masat e duhura ligjore për regjistrimin në kontabilitet të të gjithave pronave të cilat janë transferuar sipas VKM të sipërpërmendura.

**b. Paraqitja e rekomandimeve kryesore:** Me qëllim zgjidhjen e problematikave, janë dhënë disa rekomandime si vijon:

- Bashkia Roskovec në lidhje me ***zbatimin e kontratave të punimeve të ndërtimit*** të kërkojë në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, nga sipërmarrësit e punimeve arkëtimin e vlerës prej **4,739,122 lekë** të faturuara dhe të paguara nga AK, të konstatuar dëm ekonomik nga mos kryerja e punimeve.
- Bashkia Roskovec ***në lidhje me të ardhurat*** të marrë masa dhe të ndjekë të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për:

- Arkëtimin e detyrimeve nga abonentët familjar në vlerën **158,982,417 lekë**.
- Arkëtimin e detyrimeve nga subjektet e biznesit të vogël, biznesit të madh në vlerën **21,076,995 lekë**.
- Arkëtimin e detyrimeve për taksën e ndikimit në infrastrukturë, në vlerën **26,028,331 lekë.**

- Bashkia Roskovec në lidhje ***me hartimin e pasqyrave financiare***:

- Të marrë masa për vlerësimin e trojeve nën godina, që ka në inventar, si dhe të kryhet inventarizimi dhe vlerësimi i trojeve, të kaluara me VKM në pronësi të Bashkisë Roskovec. Po kështu për pyjet, kullotat, rrugë, vepra ujore, etj në pronësi të Bashkisë Roskovec, të transferuara me VKM, të bëhen inventarët me përditësimet përkatëse, saktësimi i hartave dhe kufijve të tyre, si dhe të bëhet vlerësimi i tyre.
- Të ngrejë grup pune i cili të verifikoj, vlerësoj, dhe saktësoj të gjitha aktivet e llogarive të klasës 2 dhe të dokumentoj këto aktive sipas kuadrit ligjor për regjistrimin e pasurisë.
- Të ngrejë një grup pune me specialistë të fushës për kryerjen e inventarizimit dhe vlerësimin e aktiveve të llog. *212"Ndërtesa, Konstruksione"* për NJA dhe nëpërmjet Drejtorisë Ekonomike të kryejë zbërthimin e dokumentacionit të trashëguar nga ish-Komunat për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra e veprimet me to në vite për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në bilancin e vitit 2015 e në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.

- Bashkia Roskovec në lidhje ***me procedurat e prokurimeve publike*** të marrë masat e nevojshme, që në procedurat e prokurimit publik, kriteret e veçanta të kualifikimit të hartohen në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës që prokurohet si dhe të merren masa për eliminimin e rasteve të kualifikimit të OE që nuk plotësojnë të gjitha kriteret e vendosura në DT.

## 3. Konkluzioni i përgjithshëm dhe opinioni i auditimit

### Opinioni i auditimit

**<u>I- Opinioni i auditimit financiar:</u>**
Ne kemi audituar pasqyrat financiare përmbledhëse vjetore të konsoliduara të Bashkisë Roskovec për periudhën ushtrimore 01.01.2023-31.12.2023, ku përfshihet pasqyra e pozicionit financiar, performancës financiare, pasqyra e flukseve monetare, ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto etj., në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në to, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të tyre si dhe shënimet dhe relacioni për llogaritë që shoqëronin këto pasqyra. *"Sipas opinionit tonë, pasi kemi marrë evidenca dhe dëshmi të*

*mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, shprehim një opinion të* ***opinion të kundërt***[1] *për llogaritë vjetore të subjektit Bashkia Roskovec, duke arritur në përfundimin se anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale dhe të përhapura, në llogaritë vjetore të vitit 2023", të shprehura në bazën për opinion.*

**Baza për opinionin e kundërt:**

Në dhënien e opinionit, ne kemi marrë në konsideratë faktin se disa llogari, megjithëse nuk janë krijuar në periudhën ushtrimore të viteve objekt auditimi, nuk kanë pasur lëvizje në debi ose në kredi, përgjegjësi kjo e raportuesit për saktësinë dhe vërtetësinë e këtyre llogarive, e konkretisht;

1. Llog. (210) "*Toka, troje, terrene*", nuk paraqet gjendjen reale pasi nga ana e Drejtorisë Ekonomike nuk janë hedh në kartelat e kontabilitetit asnjë prej vlerave të; a) trojeve nën objekt të godinës së re të bashkisë dhe trualli përreth saj, ndërtesat e shkollave që ka në administrim, ndërtesat e shkollave dhe të zyrave në NjA, etj, sipas regjistrit të aktiveve të pasqyruar në llog. 212 "*Ndërtime e konstruksione*". Nuk janë kryer ndryshimet përkatëse pasi nuk rezulton të jetë pasqyruar VKM datë 29.09.2021, për *sipërfaqen tokë bujqësore (arë) në korridorin me gjerësi përgjithësisht 38 (tridhjetë e tetë) metra, në total 27,570 (njëzet e shtatë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë) m2 dhe servitutit me gjerësi përgjithësisht 8 (tetë) metra, në total 8,669 (tetë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e nëntë) m2, me vlerë të përgjithshme kompensimi prej 6,242,275.63 (gjashtë milionë e dyqind e dyzet e dy mijë e dyqind e shtatëdhjetë e pesë pikë gjashtëdhjetë e tre) lekësh;* e cila i ka kaluar Projektit të gazsjellësit TAP.

2. Llog. (212) "*Ndërtime e Konstruksione*" nuk paraqet gjendjen reale sepse nuk disponohet asnjë lloj dokument pronësie për *30 objekte* me sipërfaqe trualli nën objekt të objekteve prej *23,303* $m^2$të trashëguara nga nga ish Komunat një numër të konsiderueshëm objektesh të cilat janë në verifikim për regjistrimin e tyre. Kjo vjen për arsye se një pjesë e objekteve janë të trashëguara dhe të mbartura nga njësitë që u shkrinë (*ish/komunat*) në periudhat raportuese para vitit 2015 të pa shoqëruar me kartela objekti. Në këto kushte duhet që të bëhet saktësimi objekteve, dokumentimi me kartelë objekti, inventarizim fizik i objektit, si dhe rivlerësim me normat për secilin objekt. Pra llog. 212 "Ndërtime e konstruksione" nuk paraqet një pamje reale për pasqyrat financiare të vitit 2023.

3. Llog. (213) "*Rrugë, rrjete, vepra ujore*" nuk paraqet pamjen reale pasi në këtë llogari nuk janë kryer ndryshimet përkatëse sipas VKM datë 29.09.2021, "Përdisa ndryshime dhe shtesa në VKM nr.802, datë 30.9.2015, "Për vënien në dispozicion të shoqërisë Trans Adriatic Pipeline (TAP ag), nëpërmjet marrjes në përdorim dhe krijimit të servitutit të përhershëm në sipërfaqet e tokave shtetërore që preken nga ndërtimi i korridorit të ndërtimit dhe korridori i sistemit të gazsjellësit, të projektit të gazsjellësit trans adriatik (projekti TAP)", për ndryshimet përkatëse në llogarinë 213, për kalimin e *38 metra lineare, në total 14,457* $m^2$ *dhe servitutit me gjerësi përgjithësisht 8 (tetë) metra, në total 2,838 m2 pa kompensim; si dhe sipërfaqen rrugë automobilistike në korridorin me gjerësi përgjithësisht 38 metra linear, në total 5,755 m2 dhe servitutit me gjerësi përgjithësisht 8 metra, në total 1,304* $m^2$.

4. Llog. 468 "Debitorë të ndryshëm" rezulton se nuk janë përfshirë debitorët e tjerë që rrjedhin nga taksa e ndikimit në infrastrukturë në vlerën 6,393,168lekë për 219 persona, dhe në total progresive shuma prej 26,028,331 lekë. Gjithashtu nuk janë përfshirë gjobat e vendosura nga IMT –ja dhe Policia Bashkiake në vlerën 650,000 lekë për 4 subjekte të konstatuara gjatë vitit 2023 ndërkohë që shuma progresive deri në fund të vitit paraqitet në vlerën 1,857,000 lekë së bashku me gjobat e viteve para periudhës ushtrimore e cila nuk është paasqyryar në llogarinë

[1] ***Opinion i kundërt.*** *Audituesi duhet të shprehë një opinion të kundërt: 1. kur audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku,* ***janë materiale, të përhapura****, në llogaritë vjetore apo transaksionet në fjalë; ose 2. kur audituesi nuk është në gjendje për të marrë* ***dëshmi të mjaftueshme*** *dhe të përshtatshme të auditimit ku të bazojë opinionin, dhe efektet e mundshme mbi llogaritë vjetore apo transaksionet të kësaj pamundësie janë materiale të përhapura.*

përkatëse. Pra llog. 468 (debitorë të ndryshëm) nuk paraqet pamjen reale në raportimin financiar të Njësisë Roskovec.

5.Llog. (520) “Disponibilitete në thesar” paraqitet në pasqyrat financiare në fund të vitit 2022 në shumën 82,851,685 lekë ndërsa në fund të vitit 2023 në shumën 121,091,695 lekë, shumë e cila ka kundërparti llog. 466 *(kreditorë në ruajtje)* e cila paraqitet në shumën 62,536,544 dhe llog. 85 *(teprica e periudhës)* e cila paraqitet në shumën 58,555,151 lekë. Në ekstraktin e sistemit të Thesari llog. 520 paraqitet me vlerën 0 lekë edhe pse llog. 466 dhe llog. 85 paraqiten po në vlerë të njëjtë me të dhënat e paraqitura nga Bashkia Roskovec, pra ka një mosrakordim të llog. 520, në të dhënat e PF të Bashkia Roskovec me të dhënat e sistemit të Thesarit.

- Nuk ka hartuar regjistër kontabël të përditësuar të aktiveve që zotëron apo ka në administrim Bashkia Roskovec dhe njësitë në varësi. Nuk janë marrë masat e duhura për ngritjen e komisioneve përkatës për verifikimin dhe vlerësimin e zërit troje, ndërtesa, pyje e kullota për Bashkinë Roskovec dhe njësitë në varësi. Për këto aktive nuk është kryer asnjëherë inventar fizik në lidhje me to, për të cilat nuk mund të gjykohet nëse vlera e pasqyruar në kontabilitet, është fizikisht apo jo e disponueshme dhe e përdorshme nga institucioni.

**II. Opinioni mbi përputhshmërinë.**

Ne audituam përputhshmërinë e veprimtarisë së Bashkisë Roskovec, sa i takon shkallës së zbatueshmërisë së rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave dhe marrëveshjeve që lidhen dhe ndikojnë në përdorimin e fondeve/burimeve, gjatë ushtrimit të aktivitetit përkatës për periudhën 01.01.2023-31.12.2023.

Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe në dokumentacionin e vënë në dispozicion, kemi konstatuar se në veprimtarinë e Bashkisë Roskovec, janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të përshkruara në paragrafin “Baza për Opinionin”, të cilat nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një opinioni të modifikuar për përputhshmërinë.

**Baza për dhënien e opinionit të modifikuar:**

Opinionin e dhënë e mbështesim në anomalitë e konstatuara, si më poshtë:

- Nga auditimi i 5 procedurave të prokurimit publik për periudhën 01.01.2023-31.12.2023 për punë publike, mallra dhe shërbime, në 4 raste u konstatuan mangësi që lidhen me hartimin e kritereve për kualifikim dhe në 5 raste, kualifikimi i OE të shpallur fitues është bërë në kushtet e mospërmbushjes së kritereve të veçanta të kualifikimit të përcaktuara në DT;
- Nga auditimi i zbatimit të kontratave në 4 (katër) objekte, rezultoi dëm ekonomik në vlerën **4,739,122 lekë**pa Tvsh, si rezultat i diferencave në volume pune;
- Detyrime tatimore më datën 31.12.2023 për mos pagesën e taksave dhe tarifave vendore nga abonentët familjar në vlerën **158,982,417 lekë**.
- Detyrime tatimore më datën 31.12.2023 për mos pagesën e taksave dhe tarifave nga subjektet e biznesit të vogël dhe biznesit të madh në vlerën **21,076,995 lekë**.
- Detyrime tatimore më datën 31.12.2023 për mos pagesën e taksës së infrastrukturës në vlerën **26,028,331 lekë**.

**Përgjegjësitë e Drejtuesve të Bashkisë.**

Drejtimi i njësisë vendore, është përgjegjës për përgatitjen dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi të raportimit financiar. Drejtimi është përgjegjës për ngritjen dhe monitorimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, me qëllim shmangien e gabimeve apo mashtrimet e mundshme, për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e miratuara, për kontrollin e procesit të raportimit financiar dhe realizimit të të ardhurave nga taksat e tarifat vendore, planifikimin dhe realizimin e buxhetit dhe të gjithë veprimtarisë që zhvillon Bashkia Roskovec.

**Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH.**

Përgjegjësia e audituesit të KLSH-së është që nëpërmjet auditimit të realizuar të krijojmë bindje, të cilat do të shprehen në opinionin e grupit të auditimit mbi saktësinë, vërtetësinë dhe besueshmërinë e hartimit të pasqyrave financiare dhe raportimit financiar, nëse pasqyrat

financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale në përputhje me kuadrin e rregullator të raportimit financiar. Audituesi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare dhe Fushavetë tjera të auditimit dhe i përshkruan ato në raportin e auditimit. Siguria që jepet nga audituesi është një siguri e arsyeshme e cila është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet, mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë.

**II. HYRJA**

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*", në zbatim të programit të auditimit nr. 609/1 Prot., datë 02.05.2024, miratuar nga Kryetari i KLSH-së, nga data 07.05.2024, deri më 14.06.2024, në institucionin Bashkia Roskovec u krye auditimi "Financiar dhe i Përputhshmërisë".Auditimi mbuloi periudhën prej datës 01.01.2023 deri me datën 31.12.2023.

Auditimi u krye nga grupi i auditimit me përbërje:

1. G........K....... (Përgjegjës grupi)
2. E.........M...... anëtar
3. H.........M...... anëtar
4. K.........H...... anëtar

**Titulli:** Auditim financiar dhe përputhshmërie.

**Marrësi:** Projektraporti i Auditimit i drejtohet subjektit të audituar Bashkisë Roskovec.

**1. Objektivat dhe qëllimi i auditimit**

Auditimi Financiar dhe i Përputhshmërisë në Bashkinë Roskovec kishte si objektiva kryesore:

- Vlerësimin nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet janë në të gjitha aspektet materiale ose jo, në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator mbi bazën e të cilit subjekti që auditohet ushtron veprimtarinë e tij;
- Vlerësimin e zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi, duke vlerësuar risqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare dhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara dhe gabimeve materiale (ISSAI 1315);
- Dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare dhe procedurat e prokurimit duke kryer vlerësimin e risqeve, nivelin e materialitetit dhe identifikimit të gabimeve, bazuar në standardet ISSAI 1700;
- Dhënien e opinionit dhe hartimin e Raportit të Auditimit mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësim, mbështetur mbi evidenca të besueshme, të mjaftueshme dhe përkatëse.

Objektivi i auditimit financiar në Bashkinë Roskovec është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, për periudhën nën auditim, mbi transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike nëse janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, kjo referuar kuadrit ligjor të raportimit financiar në fuqi.

Ndërsa në auditimin e përputhshmërisë synohet dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve, politikave, kodeve të vendosura apo termave, prokurimin e mallrave/shërbimeve dhe investimeve.

**2. Identifikimi i çështjes.**

Raporti Përfundimtari Auditimit, synon të identifikojë përmbushjen e rolit të njësisë vendore dhe përgjegjësive të saj, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve dhe shërbimeve në dobi të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e Bashkisë Roskovec, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave dhe nevojave të tyre.

Çështjet mbi të cilat është shtrirë auditimi:

- Mbi Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin dhe Auditin e Brendshëm.
- Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit, burimi i krijimi të të ardhurave, vlerësimi i mbledhjes së tyre.
- Vlerësimi i raportimit financiar për vitin 2023.
- Mbi planifikimin, realizimin, zhvillimin e procedurave të prokurimeve publike për periudhën 01.01.2023-31.12.2023.
- Mbi organizimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin e pronës publike.

**3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.**

Strukturat drejtuese të Bashkisë Roskovec, janë përgjegjëse për paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiarë në përputhje me ligjin për kontabilitetin. Ato janë përgjegjëse për aktivitetin financiar, në përputhje me kriteret e përputhshmërisë duke përfshirë, por pa u kufizuar në ligjin e buxhetit dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin e prokurimeve së bashku me aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për auditin e brendshëm dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, etj.

**4. Përgjegjësitë e audituesve.**

Përgjegjësia e grupit të auditimit është të shprehë konkluzionin dhe një opinion mbi çështjet që janë nën auditim. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI-t, të cilat kërkojnë që audituesit të respektojnë kërkesat etike, si dhe të planifikojnë dhe kryejnë auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, mbështetur në evidencat e grumbulluara të auditimit.

Përgjegjësia jonë (e audituesve të KLSH-së), është që nëpërmjet auditimit të realizuar të krijohen bindjet, si dhe të shprehet opinioni i grupit të auditimit mbi aspektet që duhet të vlerësojë:

- Nëse shpenzimet janë realizuar në përputhje me ligjin e Buxhetit të Shtetit, me aktet përkatëse ligjore e nënligjore dhe me parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin;
- Nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar në sektorin publik dhe të sjelljes së zyrtarëve të sektorit publik;
- Nëse janë zbatuar kërkesat e përcaktuara në ligjet dhe aktet normative përkatëse, si Ligji organik i buxhetit apo Ligji i prokurimit publik, etj.;
- Nëse janë reflektuar shkeljet e institucionit të audituar, të evidentuara në auditimet e mëparshme;
- Interesin publik ose pritshmërinë publike (p.sh. shkelje të identifikuara nga media, ankesat, etj.).

Fushat specifike të cilat janë objekt i fokusit për zbatimin e ligjit, etj.;

Në përputhje me ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450, objektivi i audituesit është që të aplikojë konceptin e materialitetit në mënyrë korrekte gjatë planifikimit dhe kryerjes së auditimit. Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë evidenca auditimi rreth praktikave administrative e financiare, rreth shumave dhe raportimit të shifrave në Pasqyrat Financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga gabimi material, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Gjatë procesit të vlerësimit të riskut, audituesit vlerësuan nivelin e kontrollit të brendshëm përkatës në Bashkinë Roskovec, në mënyrë që të programoheshin drejt procedurat e auditimit, të cilat janë të përshtatshme për kushtet e subjektit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të subjektit.

**5. Kriteret e vlerësimit**

Grupi i auditimit për të vlerësuar aktivitetin e Bashkisë Roskovec është mbështetur në kuadrin ligjor, nënligjor dhe rregullativ të listuar më poshtë. Ky kuadër ligjor ka shërbyer si bazë për burimin e kritereve që ka hartuar grupi i auditimit kundrejt të cilave janë vlerësuar aktivitetet e Bashkisë Roskovec. Burimet e kritereve të vlerësimit janë:

- Ligji organik i KLSH-së nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit";

- Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore";
- Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar;
- Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar;
- Ligji nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar;
- - Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar;
- Ligji nr. 152-2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar;
- Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar;
- Ligji nr. 9780, datë 06.07.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme", i ndryshuar;
- Ligji nr. 107/2014, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit";
- Ligji nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik";
- VKM nr. 894, datë 04.11.2015 "Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i Njësisë Vendore";
- Ligjin nr. 20/2020, datë 05.03.2020 "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë";
- Ligjin nr. 7850, datë 29.7.1994 "Për kodin civil të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- VKM nr. 510, datë 10.06.2015 "Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiviteteve dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial";
- VKM nr.500 datë 14.08.2001 "Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendor"
- VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik";
- VKM nr.165, datë 02.03.2016 "Për grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore", i ndryshuar;
- VKM nr. 860, datë 10.12.2014 "Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlera vetë zbatueshme për legalizim;
-VKM nr. 170, datë 25.4.2002 "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre", me ndryshime;
- VKM nr. 1064, datë 22.12.2010, "Për disa ndryshime në VKM nr. 391, datë 21.06.2006 "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave";
- VKM nr. 54, datë 5.2.2014 "Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", i ndryshuar
- Udhëzim i MF nr. 24, datë 02.9.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar;
- UMF nr. 5, datë 27.12.2014 "Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura";
- UMF nr. 21, datë 25.10.2016 "Për nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve";
- UMF nr. 22, datë 30.07.2018 "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore";
- UMF nr. 9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit";
- UMF nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të qeverisjes së përgjithshme", i ndryshuar me MFE nr.05 datë 21.02.2022;
- UMF nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar;
- Udhëzim i KM nr. 1, datë 04.06.2014 "Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit";
- Manuali i Auditimit të Brendshëm në sektorin publik i miratuar me urdhrin e Ministrit të MFE nr. 100, datë 16.10.2017.
- Udhëzimin nr.15 datë 30.06.2003 "Për mënyrën e paraqitjes nga njësitë e qeverisjes vendore

të kërkesave për transferimin në pronësi të tyre të pronave të paluajtshme publike

- *Rregullore e brendshme "Mbi procedurat e auditimit në KLSH";*
- *Rregullore e brendshme "Mbi organizimin dhe funksionimin administrativ KLSH-së";*
- *Rregullore e brendshme e organizimit dhe funksionimit të Këshillit Bashkiak dhe aparatit administrativ të bashkisë.*
- *Vendimet e Këshillit Bashkiak dhe shprehja e ligjshmërisë nga Prefekti i Qarkut;*
- *Legjislacioni bazë dhe dytësor, dispozitat e tjera, si dhe kriteret përkatëse që janë përdorur dhe ju jemi referuar për kryerjen e vlerësimeve gjatë auditimit.*

**6. Standardet e auditimit.**

Për kryerjen e Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë në Bashkinë Roskovec grupi i auditimit ka ndjekur edhe standardet ndërkombëtare të auditimit si më poshtë:

- ISSAI 100 "Parimet themelore të auditimit të sektorit publik";
- ISSAI 400 "Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë", që përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë;
- ISSAI 4000 "Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë"; si dhe ISSAI 4200;
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilisteve IFAC.

**7. Metodologjia e auditimit.**

Auditim i njëpasnjëshëm dhe me zgjedhje periudhash. Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me eficencë dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku. Nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur, për përzgjedhjen e kampioneve për ekzaminim, në zërat e shpenzimeve, u morën në konsideratë dy elementë:

- Risku i lidhur me shpenzimin specifik; dhe
- Pesha specifike që një zë shpenzimesh zë ndaj totalit të shpenzimeve të subjektit.

Ndjekja dhe zbatimi i hapave të mësipërm do të sjellin natyrshëm përcaktimin e elementëve kryesorë që do të ndiqen gjatë procesit të zbatimit të projektit të auditimit, nëpërmjet sigurimit të gjurmës së projektit të auditimit. Gjurma e auditimit është dokumentimi i procesit të realizimit të Projektit të Auditimit. Evidentimi i zbatimit të procedurave të auditimit nëpërmjet dokumentimit përfshin të gjitha fazat e kryerjes së Projektit të Auditimit që nga Planifikimi i Auditimit, Puna në Terren, Raportimi i Auditimit, Ndjekja e Rekomandimeve dhe Publikimi i Auditimit. Theksojmë se nga ana jonë do të auditohen pothuajse të gjitha fondet, si më poshtë:

- *Kontrolli aritmetik*

Duke konsideruar faktin se në thelb, kontabiliteti konsiston në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike (që është edhe qëllimi i kontabilitetit), bëhen një seri veprimesh të cilat kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim (*Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve*).

- *Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese*

Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë gabime aritmetike, ato mund të jenë të gabuara, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Nga kontrolli me zgjedhje i pjesëve justifikuese (*Urdhër shpenzimeve*) u konstatua se shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar, sipas kërkesave të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "*Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*", i ndryshuar.

- *Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese*

Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, llogarive, librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminoi përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, por mbi ekzistencën reale të aktiveve në subjekt u konstatuan probleme. Gjithashtu, për të verifikuar kryerjen e saktë të inventarizimit fizik dhe përputhjet e tij me atë kontabël u krye mbikëqyrje fizike e magazinës.

▪ *Kontrolli i vlerësimeve*

Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

▪ *Konfirmimi nga të tretët*

Transaksionet e përzgjedhura për t'ju nënshtruar testeve të detajeve, u kryqëzuan me informacionin e gjeneruar nga Thesari dhe rakordimit periodike me ente dhe institucione të tjera shtetërore.

▪ *Kontrolli sipas një treguesi*

Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna "jashtë normales", të cilat përbëjnë tregues të parregullsive kontabël. Mund të përmendim nëse ka: mungesë të pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave, etj.

▪ *Intervista*

U kryen intervista me specialistët e Bashkisë Roskovec me qëllim për të kuptuar dhe vlerësuar më mirë problematikat e konstatuara.

▪ *Raporte dhe Informacione*

U shqyrtuan raporte, informacione dhe dokumentacion lidhur me çështjet nën auditim

▪ *Praktikat e ndjekura në kryerjen e auditimit*

Mbështetur në ISSAI 1315, objektivi i audituesit është identifikimi dhe vlerësimi i risqeve e anomalive materiale në pasqyrat financiare si edhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara të gabimeve materiale.

Në këtë kontekst merr rëndësi vlerësimi i materialitetit në përputhje me ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450, i cili përcakton nivelin e gabimit që audituesi konsideron të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e pasqyrave financiare. Nisur nga gjykimi profesional i audituesit dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, grupi i auditimit përcaktoi materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar, ku si bazë për llogaritjen e tij janë marrë shpenzimet për pagat (600), shpenzimet operative (602) dhe investimet (231). Pas përcaktimit të nivelit të materialitetit, grupi i auditimit ka kryer vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në institucion sa i takon: (a) hartimit; (b) implementimit; dhe (c) funksionimit të 5 komponentëve të kontrollit të brendshëm. Vlerësimi i kontrollit të brendshëm është bazuar në kryerjen e testeve të kontrolleve. Gjatë kryerjes së testeve të kontrolleve është arritur në përfundimin që sistemet e kontrollit të brendshëm paraqesin risk të moderuar deri të lartë.

Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit, konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti. Kemi ndërmarrë procedurat për vlerësimin e riskut (analiza), me qëllim sigurimin e nivelit të kërkuar të njohjes së riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit të subjektit. Informacion të vlefshëm administruam dhe nga procedurat e ndjekura nga vetë subjekti për vlerësimin e riskut, duke iu nënshtruar skepticizmit profesional nga ana e audituesve. Gjatë vlerësimeve u mbështetëm në modelin e riskut që aplikon KLSH-ja[2].

Nisur sa më sipër, jemi përpjekur të ruajmë nivelin e pranuar të riskut të auditimit prej 5%, duke shtuar nivelin e procedurave analitike (ISSAI 1520) dhe testeve thelbësore të kryera.

---

[2] Risku i Auditimit = Risku i qenësishëm * Risku i kontrollit * Risku i Zbulimit

Në këtë kontekst, procedurat e ndjekura nga grupi i auditimit konsistojnë në analizat e marrëdhënieve ndërmjet informacionit financiar dhe jo financiar; inspektimeve që konsistojnë në regjistrimin e dokumenteve në regjistra/ditarë/partitarë ose ne trajtë elektronike por edhe në inspektime fizike; në observime, të cilat kanë të bëjnë me analizën e proceseve ose procedurave të kryera nga të tjerë, me qëllim sigurimin e informacionit rreth performancës së proceseve/procedurave, por kjo mbetet e limituar deri në kohën kur ka ndodhur observimi; dhe së fundmi, kërkimi/hetimi që konsiston në kërkimin e informacionit te personat kompetentë dhe të mirë informuar brenda dhe/ose jashtë njësisë shpenzuese.

**8. Dokumentimi i auditimit.**

Mbështetur në kërkesat e Manualeve të Auditimit si edhe në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit ISSAI 1230 "Dokumentimi i auditimit", nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat ligjore dhe rregullatore të zbatueshme. Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra gjatë auditimit, si dhe çështje të tjera tërëndësishme që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre sipas gjykimit dhe skepticizmit profesional që audituesit ushtruan në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe ka shërbyer si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

## III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

### 1.Informacion i përgjithshëm

Bashkia Roskovec kufizohet në veri dhe perëndim me Bashkinë Lushnjë, në jug me Bashkinë Mallakastër, në lindje me Bashkinë Dimal, ndërsa në perëndim me Bashkinë Patos. Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Roskovecit. Sipas Censusit të vitit 2011, Bashkia Roskovec ka 21.742 banorë ndërsa në Regjistrin Civil popullsia e regjistruar është 31.548 banorë. Bashkia ka një sipërfaqe prej 118.01 $km^2$. Në bazë të popullsisë së numëruar nga censusi, densiteti i popullsisë së bashkisë është 184 banorë për kilometër katror ndërsa në bazë të regjistrit civil densiteti rezulton 263.33 banorë/ $km^2$.

Bashkia e Roskovecit shtrihet pjesërisht mbi zonën naftëmbajtëse Patos-Marinzë, e cila njihet si burimi më i madh i naftës në Europën kontinentale. Pjesë e bashkisë janë Njësitë Administrative Roskovec, Strum, Kuman dhe Kurjan, e cila përfshin edhe fshatin Marinzë, që njihet veçanërisht si zonë naftëmbajtëse. Të ardhurat kryesore të banorëve vijnë nga ky sektori i naftës, në të cilin janë punësuar shumë prej banorëve të zonës. Gjithashtu, njësitë e tregtimit dhe shërbimeve janë një tjetër sektor ku janë punësuar shumë prej banorëve të qytetit të Roskovecit. Sa i takon zonave rurale, të ardhurat fitohen kryesisht nga prodhimet bujqësore dhe agrumet.

### 2. Përshkrimi i auditimit sipas drejtimeve të auditimit

### 2.1 Mbi kontrollin e brendshëm financiar publik.

### 1. Mbi Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin

Drejtimet kryesore të auditimit të MFK-së janë:

- Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK;
- Mjedisi i Kontrollit, Menaxhimi i Riskut, Veprimtaritë e Kontrollit, Informimi/ Komunikimi, si dhe Monitorimi;
- Saktësia e deklaratës vjetore dhe raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësinë publike që mbulon.

Në drejtim të vlerësimit të implementimit të komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm në Bashkinë Roskovec, nga grupi i auditimit janë kryer verifikimet për implementimin dhe plotësimin e kërkesave në lidhje me funksionimin, përgjegjshmërinë menaxheriale, realizimit të objektivave të institucionit për të gjithë komponentët si: *"Mjedisi i Kontrollit", "Menaxhimi i Riskut", "Aktivitetet e Kontrollit", "Informimi dhe Komunikimi"* si dhe *"Monitorimi",* sipas përcaktimit të nenit 19 të Ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*" i ndryshuar, ku titullari i njësisë në sektorin publik krijon dhe vlerëson sistemet e MFK-së nëpërmjet këtyre komponentëve të lidhur me njëri tjetrin. Thelbi i MFK-së ka të bëjë me menaxhimin dhe kontrollin e të ardhurave, shpenzimeve, aktiveve, detyrimeve, procedurave të tenderimit dhe kontraktimit, si dhe mënyrës së funksionimit të njësisë.

Në zbatim të auditimit, u kërkua dokumentacioni i mëposhtëm:

1. Baza rregullatore mbi të cilën ushtron funksionet e saj Bashkia e Roskovec: Rregullorja e brendshme e miratuar, Rregullorja për sinjalizimin, planet mujore dhe vjetore të punës. etj
2. Strukturën organizative dhe organigramën e institucionit me ndryshimet për vitet objekt auditimi; dhe nëse ka pasur ndryshime në strukturë, a është reflektuar edhe në rregullore;
3. Shkresat e përcaktimit të NA dhe NZ në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", ligjin "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH", si dhe ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore";
4. Shkresat për krijimin e grupeve të menaxhimit strategjik [GMS];
5. Trajnimet e stafit si dhe planifikimet për trajnime të tyre në një vit;
6. Regjistrin e riskut;
7. Raportet e monitorimit ku përfshihen edhe Deklarata e cilësisë dhe Pyetësori i vetëvlerësimit;
8. Plotësimi i pyetësorëve të KLSH për bashkinë e Roskovec, dërguar me E-mail @bashkiaroskovec.gov.al;
9. Nga auditimi i dokumentacionit të vene në dispozicion nga Bashkia e Roskovec, në përgjigje të kërkesave të përshkruara më lart lidhur me MFK-në, grupi i auditimit rezulton me këto konstatime:

- Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK.

Në drejtim të vlerësimit të implementimit të komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm në Bashkinë Roskovec, nga grupi i auditimit janë kryer verifikimet për implementimin dhe plotësimin e kërkesave në lidhje me funksionimin, përgjegjshmërinë menaxheriale, realizimit të objektivave të institucionit për të gjithë komponentët si: *"Mjedisi i kontrollit", "Menaxhimi i riskut", "Aktivitetet e kontrollit", "Informimi dhe komunikimi"* si dhe *"Monitorimi",* në referim të nenit 19 të Ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*" i ndryshuar me ligjin nr. 110/2015 "*Për disa shtesa dhe ndryshime*", ku titullari i njësisë në sektorin publik krijojnë dhe vlerësojnë sistemet e MFK-së nëpërmjet këtyre komponentëve të lidhur me njëri- tjetrin. Thelbi i MFK-së ka të bëjë me menaxhimin dhe kontrollin e të ardhurave, shpenzimeve, aktiveve, detyrimeve, procedurave të tenderimit dhe kontraktimit si dhe mënyrës së funksionimit të njësisë.

Në lidhje me vlerësimin e komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit rezultoi se:

**I. Komponenti "Mjedisi i Kontrollit":**

**Në lidhje me parimin 1 "***Angazhimin për integritet dhe vlerat etike".*

- Mjedisi i kontrollit është një element i menaxhimit financiar dhe kontrollit, i cili siguron vendosjen e objektivave në përmbushjen e misionit të institucionit. Mjedisi i kontrollit përmban: a) integritetin personal dhe etikën profesionale të nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të njësisë publike; b) politikat menaxheriale dhe stilin e punës; c) strukturën organizative, garantimin e ndarjes së detyrës, hierarkinë dhe rregulla të qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit; ç) politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore; d) aftësitë profesionale të punonjësve.

- Nga shqyrtimi i Strukturës dhe Organigramës së Bashkisë Roskovec në Rregulloren e saj, u konstatua se në disa raste ka mbivendosje dhe mbingarkesë kompetencash.
- Në nenin 4 të Rregullores, ku përshkruhet përbërja e strukturës së Drejtorisë së Planifikimit të Territorit, Kontrollit të Projekteve, Shërbimeve Publike, Transportit, Administrimit të Ujërave, Diasporës, Migracionit dhe Integrimit Europian, si dhe përgjegjësitë dhe detyrat e këtaj drejtorie së bashku me punonjësit e saj, vihet re mos përmendja e tyre si dhe përshkrimi në strukture sa me evidente të detyrave dhe kompetencave të kësaj drejtorie, duke qenë se pjesë e saj janë dhe specialistë të integrimit europian dhe specialistë për çështjet e e diasporës, migracionit dhe integrimit europian. Këto dy pozicione jo vetëm që kanë përgjegjësi e detya të ngjashme me njëra tjetrën, por duhet të përshtaten me profilin dhe përshkrimin e punës së kësaj Drejtorie. Këto dy pozicione do të ishin më përshtatshme në Drejtorinë Juridike dhe sektorët e saj.
- Në Drejtorinë e sipërcituar parashikohet pozicioni i punës specialist për, pronat dhe asetet, ujitjen dhe kullimin, i cili parashikon disa detyra dhe përgjegjësi mbi pronat, pyjet, përgërryerjet, ujitjen, vaditjen dhe rindërtimin e sistemeve të tyre në rast dëmtimi të tyre. Në Drejtorinë e Asistencës ndaj Fermerit, Mjedisit, Shërbimit Pyjor, Mbrojtjes Konsumatore dhe Shërbimit Veterinar, Sektori për Bujqësinë, Asistencën e Fermerit dhe Administrimin e Ujërave, është parashikuar specialisti Administrimit të Ujërave, i cili konkretisht mbikëqyr dhe kontrollon punën e Specialistit për Ujitjen, pjesë e strukturës së Drejtorisë së Planifikimit të Territorit dhe struktura e drejtorisë se Aseteve. Për të mos ngarkuar strukturën e Drejtorisë së Planifikimit të Territorit, si dhe për të lehtësuar e thjeshtëzuar punën në shërbimin ndaj qytetarëve, do të duhej që pozicioni i Specialistit të Ujitjes të vendosej në Sektorin e Administrimit të Ujërave në Drejtorinë e Asistencës së Fermerit Mjedisit, Shërbimit Pyjor, Mbrojtjes Konsumatore dhe Shërbimit Veterinar. Këto dy drejtori mbajnë në emërtesën e tyre funksionin e Administrimit të Ujërave, duke ndërlikuar ushtrimin e detyrave dhe përgjegjësive të përcaktuar në Rregulloren e institucionit si dhe Sektor te Administrimit e Menaxhimit të Pronave.
- Për vitin 2023, Bashkia Roskovec ka miratuar Strukturën dhe Organigramën e saj me Urdhrin e Kryetarit nr. 11 datë 16.01.2023 dhe ndryshimeve sipas Vendimit nr. 105, datë 31.08.2023, ku përcaktohet numri i përgjithshëm i punonjësve të bashkisë prej 199 punonjësish, nga të cilët kanë në fakt janë 181 punonjës pra me vakanca 18 punonjës 9 në pozicionet e shërbimit civil dhe 9 punonjës me kontratë nga këta rezultojnë 68, punonjës të Bashkisë Roskovec dhe në strukturën mbështetës 131 punonjës .
Sipas specifikave dhe strukturës rezulton se në bashkinë Roskovec janë 47 nëpunës Civil dhe 134 me kod pune.

**Të dhënat për pozicionet e punës në Bashkinë Roskovec për vitin 2023**

| Numri i përgjithshëm i pozicioneve të punës | Numri i pozicioneve me Kod Pune | | | Numri i pozicioneve në Shërbim Civil | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | Plan | Fakt | Vakant | Plan | Fakt | Vakant |
| 199 | 143 | 134 | 9 | 56 | 47 | 9 |

- Për vitin 2023, Bashkia Roskovecka ushtruar veprimtarinë e saj nëpërmjet Rregullores së Brendshme të institucionit me Vendimi nr. 40, datë 21.04.2021 të ndryshuar në vitin 2024. Bashkia nuk ka pasur një Kod Etike të hartuar dhe miratuar si një dokument të veçantë me vitin 2023, por dispozitat që rregullojnë etikën dhe disiplinën e administratës së institucionit janë integruar në rregulloren e institucionit. Në bazë të pyetësorit dërguar njësive të menaxhimit, nuk ka një urdhër nga titullari i institucionit për njohjen dhe trajnimin e stafit me rregulloren dhe bazën ligjore në fuqi. Komunikimi për rregulloren e brendshme dhe dispozitat përkatëse për etikën dhe disiplinën është kryer nëpërmjet postës elektronike". Megjithëse në vitin 2024 sipas Vendimit nr. 55, datë 22.02.2024 ka miratuar "Kodin e Etikës".
- Bashkia Roskovec ka hartuar dhe krijuar rregulloren "Për hetimin administrativ të sinjalizimit dhe konfidencialitetin me sipas rasteve dhe rregullores "Për hetimin administrativ dhe kërkesën e sinjalizuesit për mbrojtjen nga hakmarrja", si dhe është krijuar Njësia e Sinjalizimit të Brendshëm që ka funksionuar sipas sistemit elektronik. Për ndëshkimin e rasteve ndiqen

procedurat e masave disiplinore të parashikuara në legjislacionin për shërbimin civil dhe kodin e punës.
- Sipas Rregullores së institucionit, ankesat nga qytetarët mund të depozitohen zyrtarisht pranë institucionit (në sektorin e marrëdhënieve me publikun). Rregullorja përcakton se përgjigjet lidhur me ankesat e paraqitura siglohen nga specialisti, drejtuesi i njësisë së menaxhimit dhe drejtori i përgjithshëm e me pas firmosen nga Kryetari i Bashkisë. Përveç dorëzimit të ankesave në Sektorin e Marrëdhënieve me Publikun, Rregullorja e Institucionit në nenin 15 të saj parashikon se qytetarët kanë të drejtë të takojnë personalisht Kryetarin e Bashkisë për problemet e tyre, në ditët dhe orët e përcaktuar specifikisht në rregullore.
**Në lidhje me parimin nr. 2** "Titullari demonstron pavarësi dhe përgjegjshmëri në ushtrimin e përgjegjësisë për mbikëqyrje".
- Për periudhën vitin 2023, janë hartuar raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit për çdo 4-muaj, duke u paraqitur MFE.
- Këshilli Bashkiak me kompetencat e tij ushtron përgjegjësitë e mbikëqyrjes dhe kontrollit të veprimtarisë së bashkisë.
Në lidhje me parimin 3 "Titullari/NJA krijon strukturat organizative, linjat e raportimit, autoritetet dhe përgjegjësitë"
- Bashkia Roskovec nuk ka një plan strategjik për veprimtarinë vjetore ose të viteve në vijim.
- Nuk është hartuar dhe miratuar në dokument të veçantë deklarata e misionit.
- Bashkia Roskovec nuk ka një plan strategjik për veprimtarinë vjetore ose të viteve në vijim.
- Nuk është hartuar dhe miratuar në dokument të veçantë deklarata e misionit.
Për çdo drejtori janë përcaktuar objekti, qëllimi, detyrat dhe përgjegjësitë sipas hierarkisë në nivel drejtori, përgjegjës sektori dhe specialist.
**Në lidhje me parimin nr. 4** "Njësia publike demonstron angazhimin në realizimin e kompetencave".
Punësimi në Bashkinë e Roskovec bëhet në zbatim të Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar dhe Ligjit nr. 7961 /1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë' i ndryshuar, VKM nr. 243/2015 i ndryshuar me VKM nr. 746/2018 Kreu I, pika 1,2. Kjo procedurë rregullohet nga Strukturat e Bashkisë së Roskovec:
- Drejtoria e Burimeve Njerëzore është përgjegjëse për zbatimin e hapave të procedurës së punësimit sipas nenit 10 pika 1 e Ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar dhe VKM nr. 243/2015 i ndryshuar Kreu II;
- Komiteti i Përhershëm i Pranimit [KPP] në zbatim të përcaktimeve në Kreun III të VKM nr. 243/2015 i ndryshuar ;
- Kryetari i Bashkisë në zbatim të nenit 64 pikat "e", "ë", "f' e "g" të Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore".
- Strukturat përgjegjëse të Bashkisë së Roskovec hartojnë në fillim të çdo viti Planin vjetor të pranimit në shërbimin civil duke zbatuar Ligjin nr. 152/2015 "Për nëpunësin civil" neni 18, VKM nr. 108/2014 "Për plani vjetor të pranimit në shërbimin civil", VKB "Mbi miratimin e numrit maksimal të punonjësve dhe nivelit të pagave të tyre" si dhe Vendimeve të Kryetarit "Për miratimin e strukturave organizative të Bashkisë Roskovec" për çdo vit ushtrimor.
- Punonjësit e Bashkisë Roskovec trajnohen në bazë të kalendarit të trajnimeve vjetore të ASPA, për ata punonjës që të cilët janë punësuar sipas dispozitave të Ligjit për Nëpunësin Civil. Bashkia Roskovec nuk ka një plan trajnimesh të brendshme, për rrjedhojë as një buxhet trajnimesh për punonjësit e shërbimit civil apo punonjësit marrëdhënia e punës e të cilëve rregullohet me anë të Kodit të Punës. Mungesa e një plani të brendshëm trajnimesh bie në kundërshtim me Kreun III, paragrafin 3.1 të Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollin.
- Për vitin 2023 janë larguar 31 punonjës, ndërsa janë rekrutuar 41 punonjës. Të dhëna tabelore si më poshtë:

| Nr | Emer Atesi Mbiemer | Data e Largimit | Arsyeja e Largimit |
|---|---|---|---|
| 1 | M. Ç. | 11.01.2023 | me deshiren e saj |
| 2 | R. Z. | 01.02.2023 | me dëshirën e tij |
| 3 | N. S. | 24.02.2023 | me dëshirën e tij |
| 4 | S. Ç. | 7.04.2023 | me dëshirën e saj |
| 5 | A. V. | 28.04.2023 | me dëshirën e tij |
| 6 | K. D. | 23.05.2023 | me dëshirën e saj |
| 7 | G. G. | 31.05.2023 | dalje ne pension |
| 8 | B. H. | 31.05.2023 | dalje ne pension |
| 9 | S. P. | 16.06.2023 | me deshiren e saj |
| 10 | G. D. | 13.06.2023 | me deshiren e tij |
| 11 | E. H | 21.06.2023 | me deshiren e tij |
| 12 | P. H. | 30.06.2023 | braktisje e punes |
| 13 | B. B. | 12.07.2023 | me deshiren e saj |
| 14 | E. H. | 19.07.2023 | me deshiren e tij |
| 15 | S. H. | 19.07.2023 | me deshiren e saj |
| 16 | A. A. | 24.07.2023 | me deshiren e saj |
| 17 | K. M. | 25.07.2023 | braktisje e punes |
| 18 | D. F. | 28.07.2023 | me deshiren e saj |
| 19 | Z. Sh. | 28.08.2023 | me deshiren e saj |
| 20 | A. A. | 01.09.2023 | me deshiren e saj |
| 21 | K. T. | 15.09.2023 | me deshiren e saj |
| 22 | E. L. | 03.10.2023 | me deshiren e tijj |
| 23 | K. L. | 02.10.2023 | me deshiren e tij |
| 24 | Sh. P. | 25.10.2023 | me deshiren e tij |
| 25 | L. M. | 27.10.2023 | me deshiren e saj |
| 26 | B. L. | 1.11.2023 | zgjidhje kontrate |
| 27 | D. H. | 1.11.2023 | me deshiren e tij |
| 28 | K. S. | 13.11.2023 | me deshiren e tij |
| 29 | E. Ç. | 15.11.2023 | me deshiren e tij |
| 30 | D. K. | 17.11.2023 | me deshiren e tij |
| 31 | E. M. | 22.12.2023 | zgjidhje kontrate |

## Punonjës të punësuar në vitin 2023 - 41 punonjës

| Nr | Emër Atësi Mbiemër | Profesioni | Data e Fillimit |
|---|---|---|---|
| 1 | V. V. | "Polic Bashkiak" | 05.01.2023 |
| 2 | E. R. | "Edukatore në K. ...... " | 09.01.2023 |
| 3 | F. H. | "Edukatore në Velmish" | 09.01.2023 |
| 4 | E. Ç. | "Inspektor i IMT-së" | 25.01.2023 |
| 5 | E. Y. | "Përgjegjëse dhe Edukatore fëmijësh" | 31.01.2023 |
| 6 | E. K. | "Edukatore fëmijësh " në çerdhe | 31.01.2023 |
| 7 | F. Ç. | "Edukatore fëmijësh " në çerdhe | 31.01.2023 |
| 8 | O. GJ. | "Edukatore fëmijësh " në çerdhe | 31.01.2023 |
| 9 | D. H. | "Sanitare" në çerdhe | 31.01.2023 |
| 10 | M. Ç. | "Kuzhiniere në çerdhe" | 31.01.2023 |
| 11 | F. P. | "Punonjës ujitje i përkohshëm" | 31.01.2023 |
| 12 | F. R. | "Specialist Tatim-Taksave" NJ.A. K. ...... | 13.02.2023 |
| 13 | K. S. | "Polic Bashkiak" | 16.02.2023 |
| 14 | S. Ç | "Specialist prokurimeve publike" | 28.02.2023 |
| 15 | K. G. | "Specialist IT" | 28.02.2023 |
| 16 | N. Y. | "Specialist për prokurimet publike" | 28.02.2023 |
| 17 | A. C. | "Specialiste per ndjekjen e investimeve" | 16.03.2023 |
| 18 | N. A. | "Luftues/Shpetues" | 10.03.2023 |
| 19 | E. L. | Edukatore ne ........ | 23.03.2023 |
| 20 | A. G. | "Punonjës Administrativ" | 04.04.2023 |
| 21 | A. T. | "Luftues/Shpetues" | 12.06.2023 |
| 22 | E. K. | "Luftues/Shpetues" | 15.06.2023 |
| 23 | B. A. | "Specialist Bujqesie" | 6.07.2023 |
| 24 | S. F. | "Specialiste prokurimeve" | 13.07.2023 |
| 25 | E. T. | "Specialiste Shërbimit Social K. ...... " | 13.07.2023 |
| 26 | R. B. | "Punonjese e zyres me nje ndalese" | 19.07.2023 |
| 27 | B. H. | Specialist Kontabiliteti | 31.07.2023 |
| 28 | E. M. | Punonjes ujitjeje i perkohshem | 31.07.2023 |
| 29 | O. M. | Edukatore ne Çerdhe | 14.08.2023 |
| 30 | M. H. | Edukatore ne Çerdhe | 14.08.2023 |
| 31 | K. Xh. | Specialist transporti | 31.08.2023 |
| 32 | E. T. | Punjes per stacionet e pompimit | 13.09.2023 |
| 33 | A. H. | Specialist Inxhinier | 22.09.2023 |
| 34 | L. K. | Manovrator | 03.10.2023 |
| 35 | G. D. | Manovrator | 11.10.2023 |
| 36 | P. Gj. | Edukatore koptin nr 1 | 20.10.2023 |
| 37 | A. S. | Edukatore koptin Lulet e Jetes (zevendesuese) | 23.10.2023 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| 38 | R. K. | Specialist Arkitekt | 26.10.2023 |
| 39 | F. G. | Roje pyjesh | 6.11.2023 |
| 40 | R. C. | Specialiste e Sherbimit Social Nja.S...... | 20.11.2023 |
| 41 | A. H. | Edukatore ne Kopshtin Rexhep Kothere Velmish (zevendesuese) | 20.11.2023 |

- Për Bashkinë Roskovec, Koordinator të Riskut është z. M. G.
- Nëpunësi Zbatues për zbatimin e programit buxhetor është z. S. Ç., e cila mban pozicionin si Drejtor i Drejtorisë Ekonomike dhe Financave.
- *Krijimi i grupeve të menaxhimit strategjik (GMS).*

Në zbatim të nenit 24 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor", i ndryshuar; ligji nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar; ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017"Për financat e vetëqeverisjes vendore", ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar dhe Udhëzimin e MFE nr. 23, datë 30.07.2018 "Për procedurat standarde për përgatitjen e PBA të njësive të qeverisjes vendore", është ngritur GMS ku është miratuar draft-projekti PBA 2023-2025, projekt-buxheti për vitin 2023, si dhe deklarata e cilësisë së sistemit të kontrollit të brendshëm dhe raporte për funksionimin e kontrollit të brendshëm. Lidhur me përbërjen e GMS, në përgjithësi ajo është sipas përcaktimit të bërë në pikën 30 të Udhëzimit nr. 23, datë 30.07.2016 "Për proceduratstandarde për përgatitjen e PBA të njësive të qeverisjes vendore", ku drejtuesi i grupit është Kryetari i Bashkisë, si dhe ka përfaqësues nga të gjitha drejtoritë dhe sektorët e bashkisë.

Nga verifikimi i veprimtarisë së Grupit të Menaxhimit Strategjik(GMS) rezultoi se:
- Bashkia Roskovec nuk ka miratuar plan pune vjetor lidhur me funksionimin e "Grupit për Menaxhimin Strategjik" në kundërshtim me Udhëzimin nr. 15, datë 20.07.2016 për Koordinatorin MFK dhe koordinatorin e riskut në njësinë publike, pika 2.3.
- Procesverbalet e mbledhjeve të GMS përgjatë vitit 2023 janë të paprotokolluara, si dhe u konstatua mungesa e firmave të disa anëtarëve të GMS, duke ardhur kështu në kundërshtim me nenin 18 *"Normave tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë"*.
- Nuk ka mbajtur regjistër risku me të dhënat e konstatuar, problematikat e ndjekura si dhe delegimin e tyre sipas sektorëve te saj.

**II.Komponenti "Menaxhimi i Riskut"**

**Në lidhje me parimin 6**: Njësia Publike specifikon objektivat si bazë për identifikimin dhe vlerësimin e risqeve në lidhje me realizimin e tyre.

-Nga Bashkia Roskovec përcaktohen objektiva sasiore (vlerë monetare) vetëm në hartimin e PBA-ve dhe buxheteve vjetore. Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion, konstatohet se nuk është hartuar plani i përgjithshëm strategjik të zhvillimit afatmesëm të Bashkisë Roskovec, sipas përcaktimit të bërë në nenin 32 të Ligjit nr. 68/2017 "Për financat e njësive të vetëqeverisjes vendore".

**Në lidhje me parimin 7:** "Njësia Publike identifikon dhe analizon risqet për arritjen e objektivave".
- Bashkia Roskovec ka hartuar dhe ka miratuar regjistrin e riskut.
- Në Bashkinë Roskovec nuk është hartuar dhe miratuar strategjia e menaxhimit të riskut, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 15, datë 20.07.2016 pika 3.2.3, si dhe në kundërshtim me në kundërshtim me nenin 21, pika 2 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin".
- Përcaktimi i NA dhe NZ është bërë në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", ligjin *"Për menaxhimin e sistemit buxhetor të RSH"*, si dhe ligjit nr. 90 datë 27.09.2012 *"Për organizimin e administratës shtetërore"* si dhe janë njoftuar Njësia Qendrore e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit në Ministrinë e Financës Nëpunësi Autorizues dhe Zbatues plotësojnë kriteret e kërkuara nga ligji si: (kriteri i varësisë NA-NZ, kriteri i arsimimit dhe kriteri i nivelit menaxherial).

**III.Komponenti: " Aktivitetet e Kontrollit"**

**Në lidhje me parimin 10: "**Njësia publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete kontrolli".

- Në Rregulloren e Brendshme në mënyrë të përgjithshme dhe për çdo strukturë, krahas detyrave, janë të identifikuara edhe proceset e punës.
- Urdhër shpenzimet nënshkruhen nga nëpunësi Autorizues dhe Nëpunësi Zbatues.
- Bashkia Roskovec nuk ka hartuar "Planin e veprimit e kontrollit për kontrollin e brendshëm" në kundërshtim me paragrafin 3.3, Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin.
- Kontrolli i dokumentacionit dhe pranimi i tij para njohjes së shpenzimit në kontabilitet kryhet nga Drejtori i Drejtorisë Ekonomike dhe Financiare (NZ). Kontabilizimi i transaksioneve financiare kryhet nga Drejtori i Drejtorisë Ekonomike, hartimi dhe regjistrimi i pagesës kryhet nga specialistët e Sektorit të Financës, ndërsa Autorizimi i pagesës nga NA.
- Për prokurimet nga NA kanë dalë urdhrat e krijimit dhe funksionimit, komisionit të përllogaritjes së fondit limit dhe specifikimeve teknike,njësia e prokurimit,komisioni i vlerësimit të ofertave, komisioni i blerjeve të vogla, komisioni i marrjes në dorëzim të mallrave/punimeve/shërbimeve.
- Për çdo vit buxhetor hartohet regjistri i planit dhe realizimit të prokurimeve
- Në Rregulloren e Brendshme për dokumentacionin e financës nuk parashikohet dhe specifikohet ndonjë rregull i veçantë, por veprohet në bazë të legjislacionit për arkivat.
- Për menaxhimin e aktiveve veprohet në bazë të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, në bazë të cilit është mbajtur regjistri i aktiveve, i cili përditësohet çdo vit për ndryshimet e pësuar si për shtesat dhe pakësimet. Aktivet afatgjata dalin në përdorim në bazë urdhër-dorëzimeve nga personi i autorizuar dhe për to janë hapur kartelat e zyrave dhe kartelat personale të konfirmuar nga përgjegjësi.
- Të ardhurat arkëtohen nëpërmjet bankave të nivelit të dytë në llogarinë e Thesarit për Bashkinë Roskovec.
- Bashkia Roskovec në bashkëpunim me Degën e Thesarit, kryen kontrollin e disponibiliteteve monetare, kontrolli i angazhimeve, menaxhimi i investimeve sipas planit kontraktual tëpagesave dhe gjendjen limit të arkës, ku përçdo transaksion merret konfirmimi i Degës së Thesarit për gjendjen e disponilibiteteve, dhe bëhet çelja e fondeve me shkresë nga bashkia.
- Titullarja e Bashkisë Roskovec nuk ka miratuar gjurmën e auditimit. Kjo bie në kundërshtim me nenin 16 pika 2 të Ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin".

**Në lidhje me parimin 11:** "Njësia publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete të kontrollit të përgjithshme të kontrollit të teknologjisë".

- Bashkia Roskovec nuk ka proçedura të përshtatshme për të siguruar IT të ndryshme në sektorë të ndryshëm si dhe nuk ka plan investimesh për programet e IT. Jo çdo sistem ka procedurën e vet të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara.
- Bashkia Roskovec nuk ka një sistem elektronik "Back-up" për të dhënat e institucionit.
- Në rregulloren e brendshme përcaktohen detyrat e specialistit të IT. Aktualisht Bashkia Roskovec nuk ka një punonjës IT që të mbulojë këtë fushë në institucion.
- Nuk ka manuale të përdorimit të sistemit të IT.

**Në lidhje me parimin 12:** "Njësia publike vendos aktivitetet e kontrollit përmes politikave dhe proçedurave".

- Në rregulloren e brendshme janë përcaktuar dhe ndarë detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorëve dhe Përgjegjësve të Sektorëve, ku vihen re mbivendosje/mbingarkesë të funksioneve.
- Me vlerësimin, përzgjedhjen, kostimin dhe monitorimin e investimeve merret Drejtoria Ekonomike dhe Financave, duke iu referuar dispozitave ligjore në fuqi dhe rregullores së brendshme.
- Ekzistojnë procedura kontrolli të integritetit të të dhënave financiare, pasi nga përgjegjësit e kontabilitetit kryhen kontrolle dhe rregullime në lidhje me veprimet e kryera nga specialistët

përkatës të kontabilizimeve e mbajtjene ditareve, hartimin e PF, rakordimet me thesarin e bankat e nivelit të dytë, hartimine listë-pagesave, urdhër-shpenzimeve eveprime të tjera, pastaj kontrollohen nga Drejtori. PF konfirmohen nga NA dhe NZ. Këto procedura janë të përfshira në detyrat dhe përgjegjësit në të gjitha nivelet e Drejtorisë Ekonomike dhe Financave.

**IV. Komponenti: "Informimi dhe Komunikimi"**

**Në lidhje me parimin 13:**

Bashkia Roskovec disponon faqen e saj të web-it @.bashkiaroskovec.gov.al

Në këtë faqe pasqyrohet aktiviteti i saj si rregullorja e brendshme, broshura, planet e performancës, projekte të brendshme dhe të huaja, bashkëpunime brenda dhe jashtë vendit, aktivitete, struktura organike, vendimet e këshillit bashkiak, buxheti vjetor, publikime të ndryshme e shumë të dhëna të tjera nga veprimtaria e bashkisë. Të gjithë drejtuesit e programeve kanë informacion mbi miratimet e buxheteve, alokimet dhe rialokimet që ndodhin gjatë vitit buxhetor si dhe realizimet në fakt të shpenzimeve. Nuk janë përditësuar raportet periodike apo publikimet vjetore për përformancën e bashkisë në lidhje me shërbimet e ofruara publikut, planifikimin dhe realizimin e prokurimeve, raporte të auditimit, institucionet e varësisë, nuk përditësohet informacioni mbi ndryshimet në strukturën e bashkisë, paketat fiskale.

- Çdo drejtori ka e-mail zyrtar dhe është e përcaktuar apo menaxhohet nga Drejtori i Drejtorisë.
- Komunikimi me publikun, ankesat dhe kërkesat për informacion menaxhohen nga organet e parashikuara në Rregulloren e brendshme.

**Në lidhje me parimin 14:** Njësia publike përdor komunikimin e brendshëm verbal, shkresor dhe atë elektronik, i cili rregullohet në nenin 35 të rregullores së brendshme.

**V. Komponenti: "Monitorimi dhe Raportimi"**

**Në lidhje me parimin 16:** "Njësia publike përzgjedh, zhvillon dhe kryen vlerësime të vazhdueshme".

- Proçedurat periodike të raportimit që rregullojnë zbatimin dhe monitorimin e objektivave në këtë institucion konsistojnë në planet mujore dhe vjetore të punës, analizat për aktivitetin bashkisë. Raportimet e drejtuesve të sektorëve dhe drejtorive bëhen në me shkresa dhe në mënyrë verbale drejtuar eprorëve.
- Monitorimi i progresit lidhur me arritjen objektivave dhe analiza e shkaqeve për dështimet e mundshme nga ana e drejtuesve të programeve buxhetore e lidhin me monitorimin e zbatimit të buxhetit, dokument i cili duhet hartohet çdo 4 muaj, dhe është dorëzuar brenda afateve në MFE.
- Procesi i vlerësimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm realizohet nëpërmjet procesit të vetëvlerësimit të menaxherëve e strukturave, hartimit e deklaratës mbi cilësinë e kontrollit të brendshëm, si dhe me anë të njësisë të auditimit të brendshëm, e cila vepron sipas një plani vjetor dhe strategjik të miratuar nga titullari i institucionit.

Në monitorim të dërgim Raportit të Monitorimit sipas 4 mujoreve rezulton se janë dërguar shkresat me nr. 1456 prot., datë 29.02.2023, shkresa me nr. 3513 prot., datë 30.05.2023 dhe shkresa me nr. 3708 prot., datë 22.09.2023 si dhe analizën financiare me nr. 661 prot., datë 01.02.2024.

- Bashkia Roskovec lidhur me pyetësorin e vetë vlerësimit të sistemit të kontrollit të brendshëm dhe deklaratën e cilësisë, ka raportuar në MFE për vlerësimin e sistemeve për vitin 2023 me shkresën përcjellëse më datë 23.05.2024. Raporti i Cilësisë së Sistemeve të Kontrolli të Brendshëm paraqet në mënyrë të përmbledhur problematikat në 5 komponenentët e MFK dhe është deri diku në përputhje me problematikat e evidentuara në këtë raport. Të pesta elementet e MFK janë trajtuar në raport, së bashku me çfarë është menduar të zgjidhet dhe organet përgegjëse për problematikat e caktuara. Nuk është konstatuar nga ana e institucionit paligjshmëria e pjesëmarrjes së Drejtorit të Ekonomisë dhe Financës në Njësinë e Prokurimit.

**Në lidhje me parimin 17:** "Njësia publike vlerëson dhe komunikon mangësitë".

- Sipas kontakteve me menaxhimin dhe pyetsorëve nuk ka raportime apo ankesa për çështje të kontrollit të brendshëm.

**2. Mbi vlerësimin e veprimtarisë së njësisë së auditit të brendshëm.**

**Përshkrimi i situatës mbi krijimin dhe përbërjen e strukturës së Njësisë së Auditit të Brendshëm.**

Në bazë të VKM nr .83, datë 03.02.2016 "Për miratimin e kritereve të krijimit të Njësive të Auditit të Brendshëm në Sektorin Publik", është krijuar NJAB, e cila është e organizuar në nivelin e Sektorit të Auditit të Brendshëm duke përmbushur detyrimin ligjor të pavarësisë, i parashikuar nga Standardi Atributit nr. 1100 i Institutit Ndërkombëtar të Auditëve të Brendshëm. Ky sektor përgjatë periudhës 2023, është organizuar dhe ka funksionuar në zbatim të VKB nr. 98, datë 23.12.2022 "Për miratimin e buxhetit, numrin maksimal të punonjësve të bashkive ose dhe të ndërmarrjeve vartëse të bashkisë për vitin 2023" të miratuar nga Prefekti i Qarkut Fier me shkresën nr. 02/1 prot., datë 06.01.2023,duke pasur në strukturën e Auditit të Brendshëm tre punonjës. Përgjegjësi i kësaj njësie është z. G. H.

*Struktura e njësisë AB për periudhën2023*

| Nr | 2023 | Funksioni | Arsimimi | Vjetërsi ne pune | Vjetërsi në auditim/vite | Certifikimi |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | G. H. | Përgjegjës | i lartë | 34 | 15 | i certifikuar |
| 2 | E. Ç. | Specialiste | i lartë | 4 | 4 | i certifikuar |
| 3 | Xh. S. | Specialiste | i lartë | 1 | 1 | i pa certifikuar |

Pra nuk ka përshtatshmëri të pozicionit të punës, specialistja e auditimit të brendshëm znj. Xh. S., pa u pajisur me certifikatë të auditimit të brendshëm nga Njësia e Harmoizimit të Auditit të Brendshëm Tiranë, në kundërshtim me nenin 11 (pika "ç") të Ligji nr. 114/2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik (ndryshuar me ligj nr. 12, datë 2.02.2023 "Për disa ndryshime e shtesa në ligjin 114, datë 22.10.2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik") ku shprehimisht citohet: "Auditues i brendshëm në sektorin publik"; *ç) nëpunësi civil ose punonjësi që punësohet në njësinë e auditimit të brendshëm dhe që nuk zotëron certifikatën si "Auditues i brendshëm", gjatë 3 viteve të para punon nën mbikëqyrjen e drejtuesit të njësisë së Auditimit të Brendshëm ose të një audituesi të brendshëm të certifikuar dhe me eksperiencë. Brenda kësaj periudhe, ky punonjës i nënshtrohet detyrimisht procedurës së certifikimit si "Auditues i brendshëm në sektorin publik". Në rast se brenda këtij afati nëpunësi civil ose punonjësi nuk certifikohet si "Auditues i brendshëm në sektorin publik", i ndërpriten marrëdhëniet e punës, të cilat konsiderohen se janë ndërprerë për shkak të këtij ligji, si dhe "Rregullore për procedurat e certifikimit të audituesve të brëndshëm ne sektorin publik",* Miratuar me Urdhër nr. 37, datë 16.03.2016 "Për miratimin e rregullores për trajnimin e vijueshëm profesional për audituesit e brendshëm në sektorin publik"

**<u>Përshkrimi i situatës mbi aktivitetin e NJAB për vitin 2023.</u>**

Përgjatë periudhës Janar-Dhjetor 2023, nga sektori i auditit të brendshëm pranë Bashkisë Roskovec, janë planifikuar 7 auditime dhe janë kryer 6 kryer auditime.

| Nr | PERIUDHA | TË DHËNA SIPAS RAPORTIMIT | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | Auditime të planifikuara | Auditime të realizuar | | |
| | | | Përputh | Financ | Ralizuar |
| 1 | Viti 2023 | 7 | 0 | 6 | 6 |

- Plani Strategjik 2023-2026 dhe plani vjetor i auditimeve për vitin 2023, është përcjellë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit të Audtimit të Brendshëm, me shkresën nr. 5722/1 prot., datë 12.10.2023.
- Për aktivitetin e veprimtarisë së Strukturës së Auditimit të Brendshëm për vitin 2023 është raportuar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit të Audtimit të Brendshëm, me shkresën nr. 1050 prot., datë 06.02.2024.
- Karta e auditimit të brendshëm është përgatitur dhe miratuar nga Titullari i Bashkisë Roskovec me urdhrin nr. 268 prot., datë 06.01.2023.

- Nga auditimi i raportimit për vitin 2022, rezulton se janë dhënë 31 rekomandime, të cilat janë pranuar 20 dhe 8 prej tyre janë në proçes dhe 3 nuk janë zbatuar të cilat janë planifikuar në vitin 2023 "Zbatushmëria e rekomandimeve të vitit 2022".
- Nga auditimi i raportimit për vitin 2023, rezulton se janë planifikuar 7 auditime dhe janë zbatuar 6 prej tyre janë dhënë 25 rekomandime, nga këto 5 janë organizative, dhe 20 zbatushmerie ligjore të cilat *nuk janë* verifikuar zbatimi i tyre , megjithëse është planifikuar por nuk është zbatuat në vitin2024.
Në mënyrë të përmbledhur paraqiten në tabelë si më poshtë:

**Tabela nr.5**
**REKOMANDIMET NGA AUDITIMET E KRYERA NË VITIN 2023**

| Nr | Subjekti Audituar | Rek. të dhëna në vitin 2023 | STATUSI I REKOMANDIMEVE | | | | REKOMANDIMET SIPAS LLOJIT | | | | | AUDITUES |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Rekomandim idhënë | Rekomandim i pranuar | Rekomandim i zbatuar | Në proces zbatimi | Rekomandi | Rekomandi me të | Rekomandi me të | Rekomandi me për | Rekomandi me të tjera | |
| 1 | **Në Drejtorit e Sektorët e Bashkisë Roskovec Zbatimi i Rekomandime të Lëna nga auditimet e mëparshme viti 2022** | **31** | | | 20 | 8 | | | | | **3** | **G. H E Ç Xh. S** |
| 2 | **Në Drejtorin e Ekonomisë dhe Financës Auditim auditim i detyrimeve të prapambetura** | **7** | | | 5 | 1 | **1** | | | | | **G. H E Ç Xh. S** |
| 3 | **Në Drejtorinë e kultures dhe Njesise intregimit Europjan** | **3** | | | | 3 | | | | | | **G. H E Ç Xh. S** |
| 4 | **Në Drejtoria e Publike . per investimet .** | **4** | | | | 4 | | | | | | **G. H E Ç Xh. S** |
| 5 | **Në Drejtoria e Arsimit dhe shendetsise në Bashkin Roskovec** | **5** | | | | 5 | | | | | | **G. H E Ç Xh. S** |
| 6 | **Në Drejtori e Prokurimeve Zbatushmëria e Ivestimeve ( Sektori Prokurimeve)** | **6** | | | | 6 | | | | | | **G. H E Ç Xh. S** |
| 7 | **Në Drejtorine e Burimeve Njerzore** | **0** | | | | | | | | | | **G. H E Ç Xh. S** |
| | **shuma** | **56** | | **28** | 5 | 19 | **1** | 0 | **0** | | 3 | |

**Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion u konstatua se:**
- Nuk është ngritur Komiteti i Auditimit të Brendshëm, në kundërshtim me nenin 13 të Ligjit nr. 114/2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik"
- Karta e Auditimit të Brendshëm është hartuar në përputhje me formatin e paraqitur në Manualin e Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdhrin nr. 4, datë 10.01.2020 të Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë "Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në manualin e auditimit të brendshëm, miratuar me urdhrin nr. 100, datë 25.10.2016";
- Plani strategjik është përgatitur dhe dërguar në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm për vitet 2023-2025, dhe është hartuar në përputhje me standardet e përcaktuar në MAB, Kapitulli III, pika 3.1.6 dhe aneksin me modelin përkatës në fundin e kapitullit III.
- Plani vjetor i auditimeve për vitin 2023 është përgatitur në mënyrë të rregullt, në përputhje me paragrafin 3.2 të Kapitullit III të MAB, si dhe me modelet përkatëse në po këtë kapitull.
- Për vitin 2023, konstatohet se janë mbuluar me auditim 6 subjekte si dhe është realizuar dhe mjaftuar me një auditim tematik në Drejtoritë dhe Sektorët e Bashkisë Roskovec, për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve nga vitit ushtrimor paraardhës. Nuk janë kryer verifikimet mbi zbatimin e rekomandimeve ne vitin 2023 deri në periudhën e auditimit në Bashkinë Roskovec".

| Nr | Subjektet e Audituara | Realizimii angazhimeve të auditimit | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Auditime të realizuara sipas llojit të tyre | | | | | | | | Statusi i Angazhimit | |
| | | Gjithsej Planif. | Shërbime të Sigurisë nga të cilat: | | | | | Shërbime Këshillimi | Angazhime me kërkesë të titullarit | | |
| | | | A. të përputhshmërisë | A. të performancës | A. financiare | A. tek.Informacionit | A. të kombinuara | | | Angazhime të përfunduara | Angazhime në proces |
| 1 | Në Drejtorit e Sektorët e Bashkisë Roskovec Zbatimi i Rekomandime të Lëna nga auditimet e mëparshme viti 2022 | 1 | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1 | |
| 2 | Në Drejtorin e Ekonomisë dhe Financës Auditim auditim i detyrimeve të prapambetura | 1 | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1 | |
| 3 | Në Drejtorinë e Planifikimit ei Mbrojtjes se Territorit | 1 | 1 | | | | | | | 1 | |
| 4 | Në Drejtoria e Sherbimeve Publike dhe Mirëmbajtjes rruge, varreza,gjelberim ( Prokurimet). | 1 | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1 | |
| 5 | Në Drejtoria e Tatim Taksave dhe Menaxhimit të Aseteve në Bashkin Roskovec | 1 | 1 | | 0 | | | | | 1 | |
| 6 | Në Drejtori e Prokurimeve Zbatushmëria e Ivestimeve ( Sektori Prokurimeve) | 1 | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1 | |
| 7 | Në Drejtorine e Burimeve Njerzore | 1 | | | | | | | | | |
| | shuma | 7 | 6 | 0 | 0 | | | | | 6 | |

- Struktura e projekt-raporteve dhe raporteve përfundimtare pjesë e dosjeve të auditimit të zhvilluar në vitin 2023, nuk është hartuar plotësisht në përputhje me urdhërin nr, 4 datë 10.10.2020 të MFE. Në dosjet e auditimit të realizuar përgjatë vitit 2023, nuk janë bërë pjesë e Raportit Përfundimtar të Angazhimit, rubrikat e parashikuara si pjesë e përmbledhjes ekzekutive:

1) Rezultatet e auditimit.

2) Opinioni mbi vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm.

- Nga verifikimi i Raporteve Përfundimtare të Angazhimit pjesë e dosjeve të auditimit u konstatua mungesa e rubrikës "Opinion i Përgjithshëm" në kundërshtim me përcaktimet e Urdhrit nr. 4, datë 10.10.2020 të MFE.

- Dosjet e auditimit të brendshëm të njësive publike nuk arkivohen në arkivin e njësisë vendore në kundërshtim me nenin 19, pika 1 e "Normave tekniko profesionale të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë".

- Njësia e Auditit të Brendshëm nuk ka çelur manualisht dhe elektronikisht dosjet e përhershme mbi njësitë e menaxhimit, duke rënë në kundërshtim me Manualin e Auditimit të Brendshëm, Kreu 6, paragrafin 6.3.

- Nuk është bërë pjesë e dosjes së auditimit njoftimi që duhet të kryejë grupi i auditimit për titullarin e njësisë publike, në rastet kur subjekti i audituar nuk njofton për planin e masave në kundërshtim me përcaktimet e MAB, pika 4.1.12.

- Në dosjet e auditimit të realizuar nga Njësia e Auditimit nuk është dokumentuar plani i veprimit, i cili duhet të realizohet nga subjekti i audituar në vazhdën e rekomandimeve të lëna nga grupi i auditimit. Edhe pse vërtetohet se grupi i auditimit të brendshëm ka lënë për detyrë hartimin e një plani veprimi për zbatimin e rekomandimeve, nga verifikimi fizik i disa prej dosjeve të përzgjedhura u konstatua mungesa e planeve të veprimit nga ana e subjekteve të audituara. Duke qenë se plani i veprimit nga ana e subjektit të audituar është fillimi i procesit të ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve nga ana e NJAB, duhet të ishte bërë një punë më këmbëngulëse nga kjo njësi për ecurinë e këtij procesi. Në dosjet e auditimit nuk janë

konstatuar shkresa rikujtuese nga ana e përgjegjësit të njësisë së auditimit drejtuar njësive të menaxhimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna. Këto mosveprime bien në kundërshtim me Kreun IV paragrafi 4.1.13.1 të Manualit për Auditimin e Brendshëm.

***Konkluzione***

*- Bashkia Roskovec nuk ka parashikuar në strukturën e saj, Komitetin e Auditimit të Brendshëm.*

*- Struktura e projekt-raporteve dhe raporteve përfundimtare pjesë e dosjeve të auditimit të zhvilluar në vitin 2023, nuk është hartuar plotësisht në përputhje me urdhërin nr. 4 datë 10.10.2020 të MFE. Në dosjet e auditimit të realizuar përgjatë vitit 2023, nuk janë bërë pjesë e raportit përfundimtar të angazhimit, rubrikat e parashikuara si pjesë e përmbledhjes ekzekutive:*

*1) Rezultatet e auditimit*

*2) Opinioni mbi vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm.*

*- Nga verifikimi i raporteve përfundimtare të angazhimit pjesë e dosjeve të auditimit u konstatua mungesa e rubrikës "Opinion i Përgjithshëm" në kundërshtim me përcaktimet e Urdhrit nr, 4 datë 10.10.2020 të MFE.*

*- Dosjet e auditimit të brendshëm të njësive publike nuk arkivohen në arkivin e njësisë vendore në kundërshtim me ligjin nr. 9154, datë 6.11.2003 dhe nenin 19 pika 1 e "Normave tekniko profesionale të shërbimit arkivor në RSh".*

*- NjAB nuk ka çelur manualisht dhe elektronikisht dosjet e përhershme mbi njësitë e menaxhimit, duke rënë në kundërshtim me paragrafin 6.3, Kreun 6 të Manualit të Brendshëm të Auditimit.*

*- Nuk është bërë pjesë e dosjes së auditimit njoftimi që duhet të kryejë grupi i auditimit për titullarin e njësisë publike, në rastet kur subjekti i audituar nuk njofton për planin e masave.*

*- Në dosjet e auditimit të realizuar nga Njësia e Auditimit nuk është dokumentuar plani i veprimit, i cili duhet të realizohet nga subjekti i audituar në vazhdën e rekomandimeve të lëna nga grupi i auditimit. Edhe pse vërtetohet se grupi i auditimit të brendshëm ka lënë për detyrë hartimin e një plani veprimi për zbatimin e rekomandimeve, nga verifikimi fizik i disa prej dosjeve të përzgjedhura u konstatua mungesa e planeve të veprimit nga ana e subjekteve të audituara. Duke qenë se plani i veprimit nga ana e subjektit të audituar është fillimi i procesit të ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve nga ana e NJAB, duhet të ishte bërë një punë më këmbëngulëse nga kjo njësi për ecurinë e këtij procesi. Në dosjet e auditimit nuk janë konstatuar shkresa rikujtuese nga ana e përgjegjësit të njësisë së auditimit drejtuar njësive të menaxhimit për zbatimin e rekomandimeve të lenë, konstatohet se auditi i brendshëm në rekomandimet janë vetëm konstatime pa ndjekje të procedurave ligjore .*

*Mbështetur në kuadrin rregullator të cituar më sipër, llojin e mangësive të konstatuara, mbajnë përgjegjësi:* znj. M. B., me detyrë Kryetar i Bashkisë Roskovec, z. G. H., me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Auditimit të Brendshëm, zj. E. Ç., me detyrë specialist në Auditimin e Brendshëm, zj. Xh. S., me detyrë specialist në Auditimin e Brendshëm.

Nga auditimi u konstatua se në pikën 11 të Rregullores, ku përshkruhet përbërja e strukturës së Drejtorisë së Planifikimit të Territorit, Kontrollit të Projekteve, Shërbimeve Publike, Transportit, Administrimit të Ujërave, Diasporës, Migracionit dhe Integrimit Europian, si dhe përgjegjësitë dhe detyrat e kësaj drejtorie së bashku me punonjësit e saj, vihet re një mbi ngarkesë e detyrave dhe kompetencave të kësaj drejtorie, duke qenë se pjesë e saj janë dhe specialistë të integrimit europian dhe specialistë për çështjet e e diasporës, migracionit dhe integrimit europian. Këto dy pozicione jo vetëm që kanë përgjegjësi e detya të ngjashme me njëra tjetrën, por nuk përshtaten me profilin dhe përshkrimin e punës së kësaj Drejtorie. Këto dy pozicione do të ishin më përshtatshme në Drejtorinë Juridike dhe sektorët e saj. Në Drejtorinë e sipërcituar parashikohet pozicioni i punës Specialist për Ujitjen dhe Kullimin, i

cili parashikon disa detyra dhe përgjegjësi mbi ujitjen, vaditjen dhe rindërtimin e sistemeve të tyre në rast dëmtimi të tyre. Në Drejtorinë e Asistencës ndaj Fermerit, Mjedisit, Shërbimit Pyjor, Mbrojtjes Konsumatore dhe Shërbimit Veterinar, Sektori për Bujqësinë, Asistencën e Fermerit dhe Administrimin e Ujrave, është parashikuar specialisti Administrimit të Ujrave, i cili konkretisht mbikqyr dhe kontrollon punën e Specialistit për Ujitjen, pjesë e strukturës së Drejtorisë së Planifikimit të Territorit. Për të mos ngarkuar strukturën e Drejtorisë së Planifikimit të Territorit, si dhe për të lehtësuar e thjeshtëzuar punën në shërbimin ndaj qytetarëve, do të duhej që pozicioni i Specialistit të Ujitjes të vendosej në Sektorin e Administrimit të Ujrave në Drejtorinë e Asistencës së Fermerit Mjedisit, Shërbimit Pyjor, Mbrojtjes Konsumatore dhe Shërbimit Veterinar. Këto dy drejtori mbajnë në emërtesën e tyre funksionin e Administrimit të Ujrave, duke ndërlikuar ushtrimin e detyrave dhe përgjegjësive të përcaktuar në Rregulloren e institucionit. Bashkia Roskovec nuk ka një plan strategjik për veprimtarinë vjetore ose të viteve në vijim.Nuk është hartuar dhe miratuar në dokument të veçantë deklarata e misionit.Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Bashkia Roskovec, ka hartuar një plan të brendshëm trajnimesh për punonjësit e këtij institucioni, por nuk dokumenton pjesmarjen e tyre dhe urdherat perkatse. Bashkia Roskovec ka miratuar plan pune vjetor lidhur me funksionimin e Grupit për Menaxhimin Strategjik". Procesverbalet e mbledhjeve të GMS përgjatë vitit 2023 janë të paprotokolluara, si dhe u konstatua mungesa e firmave të disa anëtarëve të GMS. Bashkia Roskovec nuk ka hartuar planin e përgjithshëm strategjik të zhvillimit afatmesëm për institucionin.Në Bashkinë Roskovec nuk është hartuar dhe miratuar strategjia e menaxhimit të riskut. Bashkia Roskovec ka hartuar "Planin e Veprimit për Kontrollin e Brendshëm". Bashkia nuk ka proçedura të përshtatshme për të siguruar IT të ndryshme në sektorë të ndryshëm si dhe nuk ka plan investimesh për programet e IT. Jo çdo sistem ka proçedurën e vet të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara, si dhe nuk ka një sistem elektronik "Back-up" për të dhënat e institucionit. Në rregulloren e brendshme përcaktohen detyrat e specialistit të IT.

***Përsa më sipër mbajnë përgjegjësi:*** z. M. B., kryetar i Bashkisë Roskovec, z. S. Ç., me detyrë përgjegjës i sektorit të financës/ Koordinator i Riskut, znj. V. Z. me detyrë ish-Drejtor i Burimeve Njerëzore, z. M. G. me detyre Kordinator i Riskut.

**2.2 Mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit.**

**1. Programimi PBA dhe programimi i buxhetit vjetor.**
Nga auditimi i procedurave për hartimin e PBA-së 2023-2025 konstatohet se, për realizimin e fazave të përgatitjes ka dalë Urdhri i Titullarit të Institucionit pa numër protokolli, datë 20.02.2022, "Për krijimin e grupit të menaxhimit strategjik dhe ekipet e menaxhimit të programeve për hartimin e PBA-së 2023-2025".
Referuar udhëzimit nr. 8, datë 28.02.2022, "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2023-2025" Këshilli Bashkiak ka miratuar me vendimin nr. 13, datë 28.02.2022, "Për miratimin e raportit të vlerësimit dhe parashikimit afatmesëm të të ardhurave 2023-2025".
Me VKB nr. 22, datë 29.03.2022, janë miratuar tavanet përfundimtare të shpenzimeve të PBA-së 2023-2025.
Nga GMS-ja është përgatitur relacioni i programit buxhetor afatmesëm vendor 2023-2025.
Me shkresën nr. 5554 prot., datë 01.06.2022 është dërguar tek Ministria e Financave dhe Ekonomisë projekt dokumenti i PBA 2023-2025.
Me VKB nr. 44, datë 29.06.2022, është miratuar dokumenti i parë i PBA 2023-2025 për Bashkinë Roskovec dhe 2 njësitë shpenzuese.
Me shkresën nr. 12043 prot., datë 20.06.2022, nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë janë dërguar mendimet mbi projekt-dokumentin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025.

Me VKB nr. 72, datë 30.09.2022, është miratuar dokumenti i rishikuar PBA 2023-2025 për Bashkinë Roskovec dhe 2 njësitë shpenzuese.
Nga GMS-ja është përgatitur relacioni përfundimtar i programit buxhetor afatmesëm vendor 2023-2025.
Me VKB nr. 99, datë 23.12.2022, është miratuar dokumenti përfundimtar i PBA 2023-2025 për Bashkinë Roskovec dhe 2 njësitë shpenzuese.
Në **pasqyrën nr. 1** Të dhënat për PBA dhe projekt buxhetin dhe për vitin 2023 sipas tabelës në vijim:

| | Emërtimi | Buxheti Faktik 2022 | Faza e I PBA 2023 | Faza e II PBA 2023 | Projekt Buxhet 2023 |
|---|---|---|---|---|---|
| 600 | Paga | 169,389.851 | 181,957.0 | 181,957.0 | 196,608.982 |
| 601 | Sigurime Shoqërore | 27,337.947 | 28,925.0 | 28,925.0 | 31,980.570 |
| 602 | Mallra dhe Shërbime të Tjera | 71,824.398 | 80,539.0 | 80,539.0 | 65,840.668 |
| 603 | Subvencion | | 4,500.0 | 4,500.0 | |
| 604 | Transfertë e Brendshme | | 6,410.0 | 6,410.0 | 11,100.000 |
| 605 | Transferta Korente të Huaja | | | | |
| 606 | Trans per Buxh. Fam. & Individ | 7,459.568 | 3,500.0 | 3,500.0 | 12,800.000 |
| 609 | F.Rezerve+kontigj. | | | | 1,500.000 |
| **I** | **Shpenzime Korrente** | **276,011.764** | **305,831.00** | **305,831.00** | **319,830.220** |
| 230 | Kapitale të Patrupëzuara | | | | 1,306.518 |
| 231 | Kapitale të Trupëzuara | 231,347.375 | **250,604.0** | 266,165 | 291,360.571 |
| | **Shp. Kapitale me financim te brendshem** | **231,347.375** | **250,604.0** | 266,165 | **292,667.089** |
| 230 | Kapitale të Patrupëzuara | | | | |
| | **Shpenzime Kapitale me financim te huaj** | | | | |
| **II** | **Shpenzime Kapitale** | | | | |
| **III** | **Shpenzime nga Të ardhurat jashte limiti** | | | | |
| **I+II +III Totali I Shpenzimeve** | | **507,359.19** | **556,435.0** | **571,996** | **612,497.309** |

**Burimi:** Bashkia Roskovec

Për vitin 2023, buxheti bazë/fillestar vjetor (në bazë të vlerësimit të të ardhurave dhe të transfertave të pakushtëzuara, të përcaktuara në ligjin e buxhetit vjetor), është miratuar me VKB nr. 98, datë 23.12.2022, konfirmuar nga Institucioni i prefektit Qarkut Fier me shkresën nr. 02/1 prot., datë 06.01.2023. Në këtë VKB, të ardhurat nga burimet e veta të planifikuara për vitin 2023 kanë vlerën **414,712 mijë lekë**, transferta e pakushtëzuar ka vlerën **132,830 mijë lekë**, transferta specifike ka vlerën **64,954mijë lekë**.
- Buxheti i vitit 2023 është miratuar i balancuar dhe pa defiçite.

Sipas buxhetit vjetor të miratuar nga Këshilli Bashkiak Roskovec me Vendimin nr. 98, datë 23.12.2022, të ardhurat së bashku me transfertat e pakushtëzuar, sektoriale janë në vlerë **612,497 mijë** lekë dhe shpenzimet fillestare të miratuara janë në shumën **612,497 mijë lekë.**

**Planifikimiishpenzimevekapitalepër vitin 2023 është bërë si vijon:**

Gjatë vitit 2023 janë parashikuar shpenzime kapitale në vlerën 292,667 mijë lekë të cilat do të financohen nga të ardhurat e veta dhe transfertë e pakushtëzuar.
- Investime në vazhdim gjatë vitit 2023 është planifikuar të likuidohen në vlerën 261,523 mijë lekë. Investime të reja të planifikuara gjatë vitit 2023 janë në vlerën 71,124 mijë lekë nga të cilat është planifikuar të likuidohet gjatë vitit 2023, 31,144 mijë lekë dhe gjatë vitit 2024, 39,979, mijë lekë

Në **aneksin nr. 2/2-1**të raportit të auditimit paraqitet lista e investimeve kapitale të reja parashikuar në buxhetin vjetor të vitit 2023 nga të ardhurat e veta dhe granti**.**

**2.Çelja e fondeve buxhetore të vitit sipas miratimit me Vendim të Këshillit të Bashkisë, ndryshimet gjatë vitit, analiza e tyre sipas artikujve, arsyet e këtyre ndryshimeve.**

Në programet buxhetore është bërë shpërndarja e fondeve të vënë në dispozicion nga Pushteti Qendror të grandeve nëpërmjet transfertës së pakushtëzuar, transfertës specifike dhe fondeve të krijuar nga burimet e veta, për kryerjen e funksioneve të veta, ato të deleguara dhe të përbashkëta si dhe shpërndarjen e fondeve të grandeve.
Ndarja e plan buxhetit dhe detajimi i tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli është kryer në respektim të disiplinës buxhetore sipas strukturës dhe burimeve të financimit.

Gjatë vitit si rezultat i çeljeve të reja në llogarinë e njësisë vendore në thesar, vlerat përkatëse të buxhetit vjetor kanë pësuar ndryshime në kuptimin e vlerës totale, pasi janë çelur fondet për funksionet e deleguara, grandeve qeveritare, ndihma ekonomike, gjendja civile, shpërblime lindje, etj., të cilat nuk kanë qenë të pasqyruara në çeljen fillestare të vitit.
Gjatë vitit janë kryer ndryshime në buxhet (shtesa/pakësime). Këto lëvizje në rastet e lëvizjeve brenda të njëjtit artikull dhe brenda programit janë kryer me urdhër të Titullarit, ndërsa lëvizjet nga programi në program dhe nga një artikull në tjetrin janë kryer me VKB.
- Në hartimin e projekt buxhetit vjetor, është marrë në konsideratë realizimi i artikujve buxhetorë për vitin buxhetor paraardhës.
- Planifikimi dhe detajimi i buxhetit në nivel artikulli dhe nënartikulli, është bërë sipas nevojave të paraqitura dhe kërkesave për fonde buxhetore, duke u bazuar në kërkesat e udhëzimeve përkatëse "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit".
- Akordimi fillestar i buxhetit dhe ndryshimet që kanë pësuar zërat e tij gjatë vitit, janë të rakorduar me Degën e Thesarit Fier dhe janë të raportuara periodikisht pranë Degës së Thesarit. Situacionet e shpenzimeve janë të plotësuara sipas klasifikimit buxhetor për të gjithë periudhën e audituar. Fondet e akorduara në planet buxhetore dhe ndryshimet e bëra në periudha të ndryshme, janë evidentuar dhe janë ndjekur në dinamikë, në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nënartikulli sipas shërbimeve dhe më vete për çdo njësi vartëse e sipas periudhave të planifikuara.
- Analiza e shpenzimeve buxhetore për artikuj dhe nënartikuj është bërë periodikisht mbi bazën e situacioneve mujore të konfirmuara nga Dega e Thesarit.
Janë kryer ndryshime të vazhdueshme në buxhetin vjetor, veprime që tregon se planifikimi i buxhetit duhet të bëhet më i argumentuar, në mënyrë që gjatë vitit ndryshimet të jenë sa më të vogla.
Gjatë vitit 2023 janë miratuar disa VKB të tjera të cilat kanë bërë që të ndryshojnë vlerat e buxhetit bazë. Këto ndryshime paraqiten si vijon:
- Me VKB nr. 6, datë 27.01.2023 "Për një shtesë në buxhetin e vitit 2023", është marrë vendim për miratimin e buxhetit shtesë për alokimin e fondeve të trashëguara nga viti 2022, duke planifikuar të ardhura dhe shpenzime shtesë në vlerën 22,140,105lekë.
- Me VKB nr. 6, datë 27.01.2023 "Për një ndryshim në buxhetin e vitit 2023", është marrë vendim për miratimin e fondit prej 3,500,000 lekë për shtesë në kontributin e Bashkisë Roskovec për financimin e riparimit të banesave për vitin 2023.
- Me VKB nr. 13, datë 03.02.2023 "Për miratim të përdorimit te fondit të emergjencave civile për vitin 2023" është marrë vendim për miratimin e përdorimit të fondit të emergjencave civile në shumën 974,420 lekë për riparimin e shkarjes në rrugën e fshatit Vlosh NJA Kurjan.
- Me VKB nr. 38, datë 30.03.2023 "Për miratim fonde shtesë në buxhetin e bashkisë Roskovec për vitin 2023", është marrë vendim për miratimin e përdorimit të fondit të buxhetit shtesë nga të ardhurat nga donatorët në shumën 4,723,517 lekë nga e cila 4,149,995 lekë për shpenzime operative dhe të mirëmbajtjes ndërsa 573,522 lekë për investime për objektin "Riparim i KUZ të lagjes së Romëve Roskovec".
- Me VKB nr. 66 datë 29.06.2023 "Për miratim fonde shtesë në buxhetin e bashkisë Roskovec për vitin 2023", është marrë për miratimin e përdorimit të fondit të buxhetit shtesë nga granti specifik për rritjen e pagave  në shumën 2,294,318 lekë nga e cila: 1,245,518 lekë për rritjen e pagave për funksionin e arsimit parashkollor (edukatorët),192,000 lekë për rritjen e pagave për funksionin e arsimit parashkollor (punonjës mbështetës), 192,000 lekë për rritjen e pagave për funksionin e arsimit para universitar, 144,000 lekë për rritjen e pagave për funksionin e ujitjes dhe kullimit dhe 520,800 lekë për rritjen e pagave për funksionin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit.
- Me VKB nr. 67, datë 29.06.2023 "Për miratim fonde shtesë në buxhetin e bashkisë Roskovec për vitin 2023" miratimin e fondit 6,318,510 lekë për shpenzime për mirëmbajtje "Për riparim të pjesshëm të shkollave nën administrim të Bashkisë Roskovec", me financim për vitin 2023

prej 1,200,000 lekë të përballohet nga fondi rezervë dhe 5,118,510 lekë financim për vitin 2024 nga fondi i shpenzimeve operative dhe mirëmbajtjes.
- Me VKB nr. 77, datë 28.07.2023 "Për miratim ndryshimesh në buxhetin e Bashkisë Roskovec për vitin 2023", miratimin e fondit prej 2,999,971 lekë për objektin: "Riparime të pjesshme të godinës së vjetër të bashkisë" nga e cila 1,919,251 lekë punime ndërtimi dhe 1,080,720 lekë për mobilimin e muzeut. Financimi për vitin 2023 të jetë 1,000,000 lekë i cili të përballohet nga fondi i zërit "Kontribute për projekte me bashkëfinancim me donatorë vendas", të përcaktuar në buxhetin e vitit 2023.
- Me VKB nr. 78, datë 28.07.2023 "Për miratim fonde shtesë dhe rishpërndarje fondesh ndërmjet programesh në buxhetin e Bashkisë Roskovec për vitin 2023", miratimin e përdorimit të fondit të buxhetit shtesë nga granti i pakushtëzuar për rritjen e pagave për administratën për vitin 2023 në shumën 14,956,272 lekë.
- Me Vendim të titullarit të institucionit me nr. 131, datë 26.10.2023 "Rishpërndarjen e fondeve buxhetore në planin e shpenzime për paga dhe sigurimet shoqërore si dhe shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes për vitin 2023 brenda të njëjtit program buxhetor për BashkinëRoskovec", miratimin e fondit prej 6,100,000 lekë për zërin art. 602 duke pakësuar art. 600 dhe 601.
- Me Vendim të titullarit të institucionit nr. 145, datë 05.12.2023 "Rishpërndarjen e fondeve buxhetore në planin e shpenzime për paga dhe sigurime shoqërore për vitin 2023 brenda të njëjtit program buxhetor për "Ndërmarrjen e pastrim, gjelbërim dhe mirëmbajtje varreza", miratimin e fondit prej 1,100,000 lekë për art. 600, duke pakësuar për art. 602.
Në aneksin nr. 2/2-2 të raportit të auditimit paraqiten të dhënat përmbledhëse për planifikimin e buxhetit dhe ndryshimet për vitin 2023 sipas VKB përkatës.
Në aneksin nr. 2/2-3 të raportit të auditimit paraqitet tabela e ndryshimeve të buxhetit sipas artikujve periudha 2023.

**3.Auditim mbi saktësinë e realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fondeve të çelura, sipas burimeve të financimit e krahasuar me aktrakordimin me thesarin, analiza e mosrealizimit të shpenzimeve.**
Për zbatimin e buxhetit është rakorduar çdo muaj me Degën e Thesarit Fier si për shpenzimet e kryera ashtu edhe për të ardhurat, duke mbajtur akt-rakordimet përkatëse. Janë ruajtur kufijtë e miratuar të shpenzimeve në total dhe për çdo artikull e nënartikulli sipas klasifikimit ekonomik. Pasqyra e realizimit të treguesve të buxhetit për vitin 2023, referuar situacionit të shpenzimeve dhe akt-rakordimit të të ardhurave me thesarin (të ardhurat e veta vendore + transferta e pakushtëzuar + transfertë sektoriale) paraqitet në aneksin nr. 2/2-4 të raportit të auditimit.
Në aneksin nr. 2/2-5 të raportit të auditimit paraqiten të dhëna në formë tabele për planifikimin e buxhetit bazë dhe ndryshimet jepen në tabelën në vijim duke përfshirë fondet e kushtëzuara
Planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve për vitin 2023 vetëm me të ardhurat e veta vendore + transferta e pakushtëzuar, Bashkia Roskovec së bashku me njësitë vartëse (analizë e cila mat saktë performancën e planifikimit dhe realizimit të buxhetit, pasi nuk përfshihen fondet që vijnë nga grantet).
**Për vitin 2023**, planifikimi i buxhetit i rishikuar për zërin e shpenzimeve me të ardhurat e veta vendore transfertën e pa kushtëzuar dhe specifiken, ka vlerën 656,675 mijë lekë, ndërsa realizimi në vlerën 451,001 mijë lekë, ose në masën 69%. Zëri shpenzime page dhe sigurime shoqërore është planifikuar në vlerën 241,660mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 234,244 mijë lekë, ose në masën 97%,
Zëri shpenzime operative (602) është planifikuar në vlerën 96,886 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 70,573 mijë lekë, ose në masën 73%.
Zëri transferta korente të brendshme është planifikuar në vlerën 4,059 mijë lek dhe është realizuar në vlerën 0 lekë.

Zëri transferta buxhete familjare është planifikuar në vlerën 11,825 mijë lek dhe është realizuar në vlerën 300 mijë lekë, ose në masën 3%.
Zëri shpenzime kapitale (artikulli 230 dhe 231)është planifikuar në vlerën 301,704 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 145,883 mijë lekë, ose në  masën 48 %.
Nga auditimi u konstatohet se realizimi i shpenzimeve buxhetore me të ardhurat e veta të Bashkisë Roskovec së bashku me transfertat e pa kushtëzuara dhe specifike, për vitin 2023 kanë diferenca të dukshme me vlerën e planifikuar.
Për vitin 2023 planifikimi i shpenzimeve ka vlerën 656,675 mijë lekë, ndërsa realizimi në vlerën 451,001 mijë lekë, ose në masën 69%,
Niveli i realizmit të investimeve të planifikuara, i cili është zëri më kryesor i buxhetit në lidhje me ndikimin që ka në ofrimin e të mirave publike ndaj komunitetit, për vitin 2023 investimet janë planifikuar në vlerën 301,704 mijë lekë, realizuar 145,883 mijë lekë, ose në masën 48%.
Ky mos realizim vjen si rezultat i mospasjes së fondeve në llogarinë e thesarit në momentin e lidhjes së kontratës. Bashkia Roskovec në fillim të vitit buxhetor duhet të planifikojë angazhime buxhetore realiste.
Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Neni 46 –"Rishikimi i zbatimit të buxhetit vendor", të ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", ku citohet: "*Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore analizon zbatimin e buxhetit jo me vonë se data 30 qershor e çdo viti dhe, në rast se është e nevojshme, harton e propozon në këshillin e njësisë së vetëqeverisjes vendore ndryshimet në buxhet. Procedurat e shqyrtimit, miratimit dhe zbatimit të ndryshimeve u nënshtrohen të njëjtave rregulla të përcaktuara në nenet 5 dhe 40 të këtij ligji".*
Mos analizimi dhe mos korrigjimi i buxhetit brenda muajit qershor 2023, ngarkon me përgjegjësi Kryetaren e Bashkisë znj. M. B., si dhe z. S. Ç. me detyrë Drejtor i Shërbimeve Financiare dhe Buxhetit, në cilësinë e nëpunësit zbatues.
**Në aneksin nr. 2/2-6 të raportit të auditimit paraqitet** pasqyra e realizimit të treguesve të buxhetit për vitin 2023, referuar akt-rakordimet me thesarin.
**Niveli i mbulimit të shpenzimeve me të ardhurat e veta**
**Për vitin 2023**. Njësia vendore nuk planifikon të ardhura për mbulimin e shpenzimeve për ndihmën ekonomike dhe PAK në vlerën 193,843 mijë lekë (e cila zë 23% të buxhetit faktik vjetor), por vetëm administron këtë proces në lidhje me plotësimin e kritereve nga përfituesit dhe hartimin e listave. Duke marrë parasysh këtë fakt, duke zbritur nga shpenzimet totale vlerën e ndihmës ekonomike dhe PAK, konstatohet se shpenzimet faktike totale për vitin 2023 janë në vlerën 674,248,047lekë. Bazuar në këtë vlerë, mbulimi i shpenzimeve me të ardhurat e veta të njësisë vendore për vitin 2023 (pa transfertat e pa kushtëzuara) ka vlerën 250,316,420 lekë, ose në masën 37 % të shpenzimeve totale të realizuara.
Të dhënat e mësipërme për vitin 2023, tregojnë për nivele të ulëta të mbulimit të shpenzimeve me të ardhurat e veta, të cilat kanë si shkak nivelin e ulët të mbledhjes së të ardhurave.
Planifikimi i të ardhurave nga burimet e veta për vitin 2023 ka vlerën 414,000 mijë lekë, ndërsa realizimi ka vlerën 251,491 mijë lekë, ose në masën 60%.
**Miratimi dhe përdorimi i fondit rezervë, kontigjencës, emergjencë.**
Bazuar në ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" dhe nenit 6 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", për të përballuar shpenzime të paparashikuara në buxhetin e njësive të qeverisjes vendore, krijohet Fondi Rezervë.
Për të përballuar efektet e mosrealizimit të të ardhurave, nevojën e kryerjes së financimeve të reja dhe shtimin e financimeve mbi fondet e miratuara, të programeve ekzistuese krijohet Fondi i Kontigjencës.
Të dy këto fonde miratohen në masën deri ne 3 (tre) % të vlerës së përgjithshme të fondeve të miratuara, duke përjashtuar transfertat e kushtëzuara.

Fondet e Emergjencës planifikohen për të përballuar situata emergjente. Në zbatim të nenit 16 të ligjit nr. 8756, datë 26.03.2001 "Për emergjencat civile " të ndryshuar, të nenit 29 të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të pikës III/3 të VKM nr. 329, datë 16.05.2012, "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore" ¬ Parashikimi i fondeve të emergjencave civile dhe fondit rezervë është mbështetur në përvojën e viteve të mëparshme, ndërsa fondi i kontigjence parashikohet për herë të parë filluar nga viti 2017 dhe në vijim. Ndryshe nga sa më sipër, fondi i emergjencave civile planifikohet në shume totale minimalisht 4 % të totalit të buxhetit të bashkisë, filluar nga viti 2020. Nga Bashkia Roskovec në buxhetin e vitit 2023 është parashikuar fondi i emergjencës civile në vlerën 1,500 mijë lekë.
Me VKB nr. 98, datë 23.12.2022 është miratuar për vitin 2023 fondi rezervë, i kontigjencës, si dhe fondi i emergjencës në total lekë,si vijon:
- fondi rezervë nga granti në vlerën 0 mijë lekë;
- fondi rezervë nga të ardhurat në vlerën 1,500 mijë lekë;

**<u>Raportet e monitorimit për zbatimin e buxhetit</u>**

Raporti i monitorimit të zbatimit të buxhetit vjetor të vitit 2023 është dërguar në Ministrinë e Financave me shkresën nr. 1456 prot., datë 29.02.2023. Raportimi i periudhës Janar-Dhjetor 2023.
Total Plan Buxheti i rishikuar ( Bashkia Roskovec) 934,008 mijë lekë, fakti 730,750 mijë lekë, realizimi 78 %.
Ndërmarrja e shërbimit dhe të mirëmbajtjes total plan buxheti i rishikuar 84,133 mijë lekë, Fakti 73,563 mijë lekë, realizimi 89 %.
Ndërmarrja e pastrim, gjelbërimit dhe mirëmbajtje varrezave në total plan buxheti i rishikuar 69,114 mijë lekë, fakti 63,776 mijë lekë, realizimi 92 %.
Raporti i monitorimit të zbatimit të buxhetit të periudhës janar - gusht 2023 është dërguar në Ministrinë e Financave me shkresën tonë nr. 5708 prot., datë 22.09.2023.
Raportimi i periudhës është: Total Plan Buxheti i rishikuar (Bashkia Roskovec) 514,047 mijë lekë, fakti 390,660 mijë lekë, realizimi 76 %.
Ndërmarrja e shërbimit dhe të mirëmbajtjes total plan buxheti i rishikuar 61,379 mijë lekë, fakti 49,542 mijë lekë, realizimi 80 %.
Ndërmarrja e pastrim, gjelbërimit dhe mirëmbajtje varrezave total plan buxheti i rishikuar 47,466 mijë lekë, fakti 40,473 mijë lekë , realizimi 85 %.

Raporti i monitorimit të zbatimit të buxhetit të periudhës janar - prill 2023 është dërguar në Ministrinë e Financave me shkresën nr. 3513 prot., datë 30.05.2023.
Raportimi i periudhës është: Total Plan Buxheti i rishikuar ( Bashkia Roskovec) 279,662 mijë lekë, fakti 189,216 mijë lekë, realizimi 67 %.
Ndërmarrja e shërbimit dhe të mirëmbajtjes total plan buxheti i rishikuar 61,379 mijë lekë, Fakti 49,542 mijë lekë, realizimi 80 %.
Ndërmarrja e pastrim, gjelbërimit dhe mirëmbajtje varrezave total plan buxheti i rishikuar 47,466 mijë lekë , fakti 40,473 mijë lekë, realizimi 85 %.

**4. Programimi i nevojave dhe përgatitja e regjistrit të prokurimeve, çelja e fondeve dhe realizimi i tyre.**

Bashkia Roskovec në përputhje me VKM nr. 285, datë 15.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" neni 3, ka hartuar regjistrimin e parashikimeve të procedurave të prokurimit publik.
Në auditimin e kryer në Bashkinë Roskovec referuar regjistrit të parashikimit për procedurat të cilat do të parashikohen të kryhen gjatë vitit 2023 për blerje mallra,shërbime dhe investime janë parashikuar 106 procedura prokurimi me fond limit 256,954,867 lekë duke përfshirë edhe

procedurat me blerje nën 100,000 lekë. Referuar regjistrit të realizimit janë zhvilluar 62 procedura prokurimi pa përfshirë procedurat me blerje nën 100,000 lekë.
Referuar regjistrit të realizmit, Bashkia Roskovec nuk ka zhvilluar 16 procedura prokurimi të cilat janë parashikuar të zhvilloheshin në vitin 2023 referuar VKB nr. 98, datë 23.12.2022 "Për miratimin e buxhetit".
**Në aneksin nr. 2/2-7 të Raportit Përfundimtar të auditimit** paraqiten objektet për të cilat nuk është realizuar procedura e prokurimit gjatë vitit 2023.
Sipas pasqyrës nr. 8 nga sektori i prokurimeve na është përcjell informacioni për moskryerjen e procedurave të parashikuara në buxhetin e vitit 2023 miratuar me VKB nr. 98, datë 23.12.2022.
**"Fuqizimi i stacionit të pompimit të ujitjes nga lumi Seman , zona Suk-Arapaj, Bashkia Roskovec"** – Kjo procedurë nuk u arrit të realizohej përshkak se fondi i emergjencave civile nuk ishte i mjaftueshëm.
Për procedurat e mëposhtme nuk është paraqitur kërkesë nga drejtoritë/sektorët përkatës për kryerjen e këtyre procedurave.

- "Blerje materiale industriale për Bashkinë Roskovec".
- "Transport për shërbimin në familje për punonjësit dhe përfituesit".
- "Hartimi i PDV-ve+Studim territori për projekte të ndryshme".
- "Shpenzim për mirëmbajtjen e rrugëve, veprave ujore, rrjeteve hidraulike për Ndërmarrjen e Shërbimeve të Mirëmbajtjes".
- "Blerje materiale ngrohje dhe ndriçim".
- "Vizibilitet dhe publikime".
- "Blerje kënd lojërash"
- "Furnizime dhe materiale te tjera zyre dhe te përgjithshme".
- "Shpenzime për mediat".

**Në aneksin nr. 2/2-8 të Raportit të Përfundimtar Auditimit paraqitet** lista e investimeve kapitale të realizuara gjatë vitit 2023 të parashikuara në buxhetin vjetor të vitit 2023 nga të ardhurat e veta dhe granti**.**

**5. Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të pa likuiduara, vendimeve gjyqësore, vendimeve të shpronësimit dhe niveli i realizmit të të ardhurave (faturat e pa likuiduara të shoqërohen me listë analitike të detajuar me nr. fature, datë krijimi etj., sipas raportimit në MFE)**

**Detyrimet e prapambetura viti 2023**

Bashkia Roskovec në datën 01.01.2023 ka pasur si çelje të vitit ushtrimor detyrime të prapambetura progresive me burim financimi të ardhurat e veta vlerën 65,119,199 lekë. Nga kjo vlerë në planin e buxhetit vjetor 2023 është planifikuar për likuidim gjatë vitit 2023 vlera 65,119,199 lekë. Gjatë vitit 2023 për detyrimet e prapambetura është likuiduar vlera 64,108,584 lekë. Detyrime të reja të krijuara janë në vlerën 80,691,728 lekë, totali progresiv i detyrimeve të prapambetura nga të ardhurat dhe granti janë në vlerën 81,702,343 lekë.
Duke marrë në konsideratë vlerën e lartë të detyrimeve të prapambetura nga të ardhurat e veta Bashkia Roskovec nuk duhet të marri angazhime të reja buxhetore, fillimisht duhet të shlyejë detyrimet nga kontrata e mëparshme. Për ketë duhet të rishikohet edhe buxhetit i vitit të ardhshëm duke pakësuar disa nga investimet e parashikuara për mos të patur përkeqësim të situatës së detyrimeve të prapambetura.
Veprimet e mësipërme nuk janë në përputhje me ligjin nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" neni 55 "Probleme financiare"
Marrja e angazhimeve buxhetore pa pasur fonde në dispozicion dhe krijimi i detyrimeve të prapambetura është në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të MFE nr. 9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", pika 153-162, Rubrika - Marrja e angazhimit dhe kryerja e shpenzimeve publike, detyrimet kontraktuale midis palëve, nenin 52 të ligjit nr.

9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, UMF nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, pikat 82-91.
Për mos marrjen e masave për likuidimin e detyrimeve të prapambetura dhe krijimin e detyrimeve të reja për periudhën 01.01.2023 -31.12.2023, ngarkohet me përgjegjësi kryetari i Bashkisë Roskovec znj. M. B., në cilësinë e nëpunësit autorizues dhe z. S. Ç., me detyrë drejtore i Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit, në cilësinë e nëpunësit zbatues.
*Në aneksin nr. 2/2-10 të raportit të auditimit paraqiten të dhëna për detyrimet e prapambetura më 31.12.2023.*

**Efektet financiare në buxhet, si rezultat i zbatimit të vendimeve gjyqësore.**

**Mbi pagesat e vendimet gjyqësore për çështje të tjera të ndryshme**

| Numri i vendimeve gjyqësore si çelje më 01.01.2023 | Vlera e vendimeve gjyqësore si çelje më 01.01.2023 | Numri i vendimeve gjyqësore të ardhura në financë gjatë vitit 2023 | Vlera e vendimeve gjyqësore të ardhura në finance gjate vitit 2023 | Pagesa në lekë të kryera gjatë vitit 2023 | Detyrimi në lekë më 31.12.2023 |
|---|---|---|---|---|---|
| **0** | **0** | **2** | **592,613** | **592,613** | **0** |

***Burimi:** Bashkia Roskovec*

Bashkia Roskovec për zbatimin e vendimeve gjyqësore për vitin 2023 ka shpenzuar vlerën 592,613 lekë, e cila i përket vendimeve gjyqësore me objekt dëmshpërblim i përket vendimeve për çështje të tjera gjyqësore.
Vlera totale **592,613 lekë** e shpenzuar për periudhën 01.01.2023- 31.12.2023 nga Bashkia Roskovec, për zbatimin e vendimeve gjyqësore, **konsiderohet efekt financiar negativ në buxhet.**
Vendimet gjyqësore nuk janë analizuar nga Kryetari i Bashkisë dhe nuk është kërkuar prej tij nxjerrja e përgjegjësive administrative për këto vendime. Analizimi i arsyeve të humbjeve të vendimeve gjyqësore dhe nxjerrja e përgjegjësive administrative për to, do të ndikonte pozitivisht në korrigjimin e praktikave të gabuara të ndjekura nga njësia vendore në proceset e largimit të punonjësve nga puna dhe për çështje të tjera gjyqësore, evidentimin e procedurave të bëra gabim, në kundërshtim me kuadrin rregullator në fuqi, e si rezultat shmangien e tyre në të ardhmen dhe uljen e shpenzimeve financiare negative në buxhet.
Mos kryerja e kësaj analize nga Titullari është në kundërshtim me pikën nr. 60, të UMFE nr. 9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar.
**Në aneksin nr. 2/2-11 të Raportit të Përfundimtar Auditimit** paraqiten në mënyrë analitike lista e vendimeve gjyqësore të ardhura në financë dhe likuidimet e kryera prej saj për mbi pagesat e vendimet gjyqësore për çështje të tjera të ndryshme
**Në aneksin nr. 2/2-12 të Raportit të Përfundimtar Auditimit** paraqiten në mënyrë analitike faturat e pa likuiduara në datën 31.12.2023 për investimet (nga të ardhurat e veta).Bashkia Roskovec ka pasur si çelje detyrime të prapambetura 43 fatura tatimore me vlerë 52,447,190 lekë. Gjatë vitit 2023 janë pranuar 40 fatura tatimore me vlerë 163,625,037 lekë janë shlyer 57 fatura tatimore me vlerë 153,841,421 lekë nga këto 3 fatura janë likuiduar pjesërisht. Total i detyrimeve të prapambetura nga të ardhurat e veta për investime është në vlerën 62,230,806 lekë. Vlera prej 62,230,806 lekë i përket faturave tatimore sipas viteve si mëposhtë:
1.Vitet 2018-2020, dy fatura tatimore me vlerë 403,800 lekë.
2.Viti 2021, shtatë fatura tatimore me vlerë 8,255,524 lekë.
3.Viti 2022, katër fatura tatimore me vlerë 10,693,335 lekë.
4.Viti 2023, gjashtëmbëdhjetë fatura tatimore me vlerë 39,811,619 lekë.
**Në aneksin nr. 2/2-13 të Raportit të Përfundimtar Auditimit** paraqiten në mënyrë analitike faturat e pa likuiduara në datën 31.12.2023 për mallrat dhe shërbimet (nga të ardhurat e veta). Bashkia Roskovec ka pasur si çelje detyrime të prapambetura me vlerë 8,612,128 lekë. Gjatë viti 2023 janë likujduar detyrime të prapambetura në vlerë 8,132,531 lekë dhe vlera e mbetur është 479,597 lekë.
Gjatë vitit 2023 janë krijuar detyrime të reja të prapambetura në vlerën 18,748,452 lekë.

**Vështirësia Financiare e Bashkisë Roskovec.**
Vlera e raportuar nga Bashkia Roskovec në MFE për detyrimet e prapambetura në datën 31.12.2023 është **81,702,045lekë**, konfirmuar me shkresën nr. 1458 prot., datë 29.02.2024 dërguar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë; Drejtorisë së përgjithshme të Buxhetit dhe Borxhit Publik dhe Drejtorisë së Financave Vendore. Stoku i detyrimit të mbetur rakordon me vlerën e detyrimeve në sistemin e thesarit si vijon:
**Në aneksin nr. 2/2-9 Raportit të Përfundimtar Auditimit** paraqitet stoku i detyrimit të mbetur.
Raporti i këtyre treguesve, pra raporti i stokut të detyrimeve të prapambetura me shpenzimeve totale të miratuara, ka vlerën 18,12 %, shifër që e klasifikon Bashkinë Roskovec në njësi të qeverisjes vendore me probleme financiare.
**Investimet Kapitale të financuara nga Buxheti i Shtetit**
Nga auditimi i evidencave të marra nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit,në lidhje me investimet publike të financuara nga buxheti i shtetit rezultoi se. Nga Ministritë e Linjës për vitin 2021-2022, rezulton se janë financuar 9 projekte me vlerë të mbetur kontrate 213,492,865 lekë në datë 01.01.2023. Gjatë vitit 2023 për këto kontrata është likuiduar shuma 149,827,253 lekë. Në datë 31.12.2023 rezultojnë aktive 8 kontrata me vlerë për tu likuiduar 63,665,612 lekë të cilat do të financohen nga fondet e pakushtëzuara.
**Në aneksin nr. 2/2-14 të Raportit të Përfundimtar Auditimit** paraqitet lista e investimeve kapitale të financuara gjatë vitit 2021-2022 nga Buxheti i Shtetit
Nga auditimi i evidencave të marra nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit për vitin 2023, në lidhje me investimet publike, rezultoi se, nga Ministritë e Linjës për vitin 2023, rezulton se janë financuar 6 projekte me vlerë kontrate 99,070,204 lekë nga të cilat do të financohen me fonde të kushtëzuara në vlerën 87,769,264 lekë dhe nga të ardhurat e veta në vlerën 11,300,940 lekë.
Projektet që janë financuar gjatë vitit 2023 gjenden në aneksin 2/2-14 të raportit të auditimit. Gjatë vitit 2023 kanë përfunduar 2 projekte me vlerë financimi 6,456,442 lekë.
Në proces janë aktualisht 4 projekte për të cilaka mbetur për tu financuar shuma 19,842,138 lekë fonde të kushtëzuara dhe 10,046,934 lekë nga të ardhurat e veta.
**Në aneksin nr. 2/2-15 të Raportit të Përfundimtar Auditimit** paraqitet lista e investimeve kapitale të financuara gjatë vitit 2023 nga Buxheti i Shtetit

**Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: znj. M.m B.,** Kryetare e Bashkisë Roskovec në cilësinë e nëpunësit autorizues dhe **z. S. Ç.** me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit në cilësinë e nëpunësit zbatues.

**6. Burimi i krijimit të të ardhurave, planifikimi dhe realizimi i tyre.**

**Strukturat për administrimin dhe mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore**

**Për vitin 2023** numri i përgjithshëm i punonjësve është miratuar me VKB nr. 98, datë 23.12.2022, "Për miratimin e strukturës të administratës së Bashkisë Roskovec për vitin 2023", ku përfshihet edhe struktura e sektorit të tatim- taksave, e cila përbëhet nga 8 punonjës me përbërje 1 drejtor, 2 përgjegjësa dhe 5 specialistë.
Struktura e sektorit të tatim-taksave për vitin 2023 është paraqitur në **Pasqyrën nr 1** në anekset e raportit të auditimit.

- **<u>Parashikimi dhe realizimi i taksave dhe tarifave vendore sipas llojeve</u>**

Me VKB nr. 90, datë 01.12.2022, është miratuar Paketa Fiskale për vitin 2023 e cila do të aplikohet në territorin e Bashkisë Roskovec për vitin 2023.
Referuar planit vjetor të miratuar dhe akt rakordimeve me Degën e Thesarit Fier parashikimi

dhe realizimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore të Bashkisë Roskovec për vitin 2023 paraqitet në mënyrë analitike si më poshtë:

**Parashikimi dhe realizimi i të ardhurave, për vitin 2023:**

Në **pasqyrën nr. 2** më poshtë janë paraqitur të përmbledhura planifikimet dhe arkëtimet e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2023:

| Nr | Emërtimi | Viti 2023 | | |
|---|---|---|---|---|
| | | Plan | Fakt | % |
| | **Të ardhura tatimore** | **237,191,334** | **209,283,159** | **88** |
| A | **Taksa mbi Pasuritë e Paluajtshme** | **152,441,334** | **146,704,263** | 96 |
| 1 | Taksë Ndërtese | 124,110,985 | 121,415,637 | 98 |
| 2 | Taksë mbi tokën bujqësore | 25,852,496 | 22,754,903 | 88 |
| 3 | Taksë trualli | 2,477,853 | 2,533,723 | 102 |
| B | Taksa e ndikimit në infrastrukturë | 5,500,000 | 3,662,094 | 67 |
| C | **Të ardhura nga Taksat e Ndara** | **84,750,000** | **62,578,896** | 73 |
| 1 | Tatim i Thjeshtuar mbi Fitimin | 150,000 | 35,561 | 24 |
| 2 | Taksa mbi të drejtat e kalimit të pronësisë | 100,000 | - | - |
| 3 | Tatim mbi të ardhurat personale | 5,000,000 | 8,645,042 | 173 |
| 4 | Taksa vjetore e automjeteve të përdorura | 9,000,000 | 10,595,649 | 117 |
| 5 | Taksa e Rentës Minerare | 65,000,000 | 39,640,550 | 60 |
| II | **Të Ardhura jo Tatimore** | **177,520,799** | **42,134,985** | **23** |
| A | **Tarifa Vendore** | **39,287,880** | **26,236,688** | **66** |
| 1 | Tarifë Pastrimi | 20,080,850 | 15,675,707 | 78 |
| 2 | Tarifë Gjelberimi | 4,186,100 | 2,472,367 | 59 |
| 3 | Tarifë Ndriçimi | 4,186,100 | 2,570,697 | 61 |
| 4 | Tarifë Kontrolli Veterinar | - | - | - |
| 5 | Tarifë për dhënie e liçencave, lejeve dhe autorizimeve | 1,000,000 | 207,190 | 21 |
| 6 | Taksë Tabele+ Reklama | 558,830 | 622,000 | 111 |
| 7 | Tarifë Parkimi | 300,000 | 280,200 | 93 |
| 8 | Tarifë për licencat e prodhimit dhe tregtimit të naftës | 4,000,000 | - | - |
| 9 | Tarifë nga kopshti+Cerdhet | 1,700,000 | 1,756,392 | 103 |
| 10 | Tarifa për zënien dhe përdorimin e hapësirës publike | 3,276,000 | 2,739,135 | 83 |
| B | **Të ardhura nga dhënia me qera e aseteve** | **3,330,919** | **3,125,895** | **93** |
| 1 | Tarifë për qera toke | 2,447,335 | 2,114,355 | 86 |
| 2 | Tarifë për qera ndërtese | 454,800 | 542,640 | 119 |
| 3 | Tarifë për qera trualli | - | - | - |
| 4 | Të ardhura nga shitja e aseteve të prekshme/ të paprekshme | 428,784 | 468,900 | 110 |
| C | **Të Ardhura të Tjera** | **117,284,000** | **10,194,088** | 9 |
| 1 | Tarifa për linjat ajrore dhe nëntokësore | 3,798,000 | - | - |
| 2 | Tarifa për shërbimin e ujitjes dhe kullimit | 5,000,000 | 3,904,640 | 78 |
| 3 | Tarifë e përkohshme | 10,480,000 | 2,647,137 | 25 |
| 4 | Sekuestrime dhe zhdëmtime | 45,000,000 | 200,825 | 0.4 |
| 5 | Kundravajtjet Administrative (Gjobat) | 2,000,000 | 1,101,032 | 55 |
| 6 | Tarifa të kontrollit të zhvillimit të territorit | 2,545,000 | 999,292 | 39 |
| 7 | Tarifa për shërbimet shtesë nga zjarrëfiksja | 120,000 | 90,000 | 75 |
| 8 | Tarifa të tjera | 48,341,000 | 1,251,162 | 2 |
| D | **Sponsorizime** | **17,618,000** | **2,578,314** | **14** |
| | **Totali** | **414,712,133** | **251,491,288** | **60** |

**Burimi:** Bashkia Roskovec

Për vitin 2023 planifikimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore është në vlerën **414,712,133 lekë** dhe realizimi në vlerën **251,491,288 lekë** ose në masën **60 %** me një diferencë mosrealizimi ndërmjet planifikimit dhe realizimit në vlerën **163,220,845 lekë.**

Referuar të dhënave të sipërpërmendura me tejkalim paraqiten zërat fiskal si më poshtë:

a. "Regjistrimi i automjeti të përdorura" është planifikuar në vlerën 9,000,000 lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 10,595,649 lekë ose realizuar në masën 117%.

b. "Taksa mbi të ardhurat personale 2%"është planifikuar në vlerën5,000,000 lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 8,645,042 lekë ose realizuar në masën 173%.

Si dhe disa prej zërave fiskal nuk janë realizuar në krahasim me planin e përgjithshëm të të ardhurave si më poshtë:

a. "Tarifë pastrimi" është planifikuar në vlerën 20,080,850 lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 15,675,707 lekë ose realizuar në masën 78%.

b. "Tarifë ndriçimi" është planifikuar në vlerën 4,186,100 lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 2,570,697 lekë ose realizuar në masën 61 %.

c. “Tarifë gjelbërimi” është planifikuar në vlerën 4,186,100 lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 2,570,697 lekë ose realizuar në masën 61%.
d. “Taksë toke bujqësore ” është planifikuar në vlerën 25,852,496 lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 22,754,903 lekë ose realizuar në masën 88%.
e. “Sekuestrime dhe zhdëmtime” është planifikuar në vlerën 45,000,000 lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 200,825 lekë ose realizuar në masën 0.4%.
f. “Tarifa të tjera” është planifikuar në vlerën 48,341,000 lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 1,251,162 lekë ose realizuar në masën 2%.
g. “Taksë ndikimi në infrastrukturë” është planifikuar në vlerën 5,500,000 lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 3,662,094 lekë ose realizuar në masën 67%.
h. “Taksa e Rentës Minerare” është planifikuar në vlerën 65,000,000 lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 39,640,550 lekë ose realizuar në masën 60%.

Nga analiza e trajtuar më sipër për sa i përket planifikimit dhe realizimit të të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore konstatohet se, për disa zëra realizimi paraqitet në vlera të ulta dhe për disa zëra realizimi paraqitet me tejkalim mbi planin gjë e cila tregon se planifikimi i të ardhurave nuk është real, ka rezerva në planifikim ose fryrje të pritshmërisë së arkëtimeve e cila kryesisht vjen për shkak të mos njohjes së situatës, moskryerjes së rregullt të procedurave apo përfshirja e arkëtimeve si pasojë e detyrimeve nga vitet e mëparshme gjë e cila ndikon negativisht në realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore duke mos pasqyruar saktë burimin e të ardhurave.

Nga DTTV nuk është kryer një analizë e detajuar në planifikimin e të ardhurave për arsye se nuk janë përfshirë, parashikuar edhe të ardhurat që do të vijnë nga arkëtimet si pasojë e detyrimeve nga vitet e mëparshme.

Gjithashtu në evidencat dhe raportimet mbi planifikimin dhe realizimin e të ardhurave nga kjo drejtori nuk është kryer një ndarje konkrete nga arkëtimet e realizuar nga taksat dhe tarifat vendore për secilin vit dhe detyrimeve të prapambetura të arkëtuara përgjatë vitit 2023 me qëllim pasqyrimin real të të ardhurave.

Në këtë konteks është e rëndësishme të theksohet për vëmendjen e menaxhimit të lartë të Bashkisë Roskovec që në procesin e planifikimit, menaxhimi nuk ka marrë në konsideratë mosrealizimet apo tejkalimet e mëparshme në mënyrë që planifikimi në të ardhmen të kryhet mbi baza sa më reale për të mos shkaktuar defiçit në të ardhurat e arkëtuara dhe për pasojë mosrealizim të shpenzimeve, investimeve, mirëmbajtjeve etj., në dëm të interesave të publikut. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 64, Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, neni 5, neni 42, pikat 1-2 dhe pika 4, neni 54, nënpika “c”, Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Udhëzimin e MFE nr. 9, datë 20.03.2018, “Procedurat standarde për menaxhimin e të ardhurave” Kreu IV, pika 200, dhe Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar Kreu II, pika 2, gërma “a” dhe “b”, Kreu III, pika 32.

➢ **Agjentët tatimorë dhe rakordimet me ta:**

Bashkia Roskovec ka disa agjentë tatimorë të cilat operojnë për mbledhjen e taksave të ndara për llogari të Bashkisë Roskovec.

Referuar dokumentacionit të paraqitur nga sektori i tatim-taksave për vitin 2023:

Akt-Rakordimet me Drejtorinë Rajonale Tatimore Fier janë mbajtur për periudhën janar-dhjetor 2023, akt-rakordimet janë të firmosura nga personat përgjegjës nga Bashkia Roskovec dhe Drejtoria Rajonale Tatimore Fier.

- Për rentën minerare, e cila rrjedh nga eksportet është bërë rakordimi periodik tremujor me

Drejtorin e Doganave dhe mbahet korrespondencë me Ministrinë e Financave.
- Për rentën e cila rrjedh nga shitjet brenda vendit, nuk mbahet korrespondenca me Ministrinë e Financave dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit.
DRSHTRR Fier në lidhje me taksën vjetore të mjeteve të përdorura derdhen automatikisht në fund të çdo muaji për llogari të Bashkisë Roskovec dhe konfirmohen nga Dega e Thesarit Fier.
Të ardhurat e vjela nga agjentët tatimorë për vitin 2023 paraqiten si më poshtë:
Në **pasqyrën nr. 3** më poshtë janë paraqitur të përmbledhura planifikimet dhe arkëtimet nga agjentët tatimorë për vitin 2023.

| Nr. | Emërtimi | Plani 2023 | Realizimi 2023 | % realizimit |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Tatimi i Thjeshtë i Fitimit (Agjenti DRT Fier) | 150,000 | 35,561 | 24 |
| 2 | Tatimi mbi të Ardhurat Personale TAP (Agjenti DRT Fier) | 5,000,000 | 8,645,042 | 173 |
| 3 | Taksa e rregjistrimit të automjeteve (Agjenti DSHTR) | 9,000,000 | 10,595,649 | 118 |
| 4 | Taksa e kalimit të drejtës së pronësisë (Agjenti ASHK) | 100,000 | 0 | 0 |
| 5 | Taksa e Rentës Minerale (Dogana) | 65,000,000 | 39,640,550 | 61 |
| **Totali** | | **79,250,000** | **58,916,802** | **74** |

**Burimi:** Bashkia Roskovec

- **Detyrimet e familjarëve:**

Sektori i tatim-taksave nuk ka hartuar regjistrin e familjarëve sipas Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, neni 4, pika 7, ku përcaktohet që: "Pranë çdo bashkie dhe komune krijohet regjistri i taksave vendore dhe tatimpaguesve vendorë. Forma dhe kodifikimi i këtij regjistri përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave, në përputhje me këtë ligj
Nga auditimi u konstatua se Bashkia Roskovec nuk ka lidhur akt-marrëveshje shoqërinë "Ujësjellës Kanalizime Fier" Sh.A, taksat dhe tarifat vendore sipas paketës fiskale abonentët e Bashkisë Roskovec i bëjnë pagesat në bankë ose në zyrën e Postës Shqiptare.
Në **pasqyrën nr. 4** janë paraqitur të përmbledhura detyrimet e familjarëve sipas njësive administrative për taksat dhe tarifat vendore të vitit ushtrimor 2022 si vijon:

| **Detyrimet deri në datë 31.12.2022** | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Nr** | **Njësitë Administrative** | **Taksa e Tokës Bujqësore** | **Taksa e ndërtesës +Tarifa Vendore** | **Tarifa e mirëmbajtjes të sistemit kullues** | **Tarifë vaditje** | **Totali** |
| **1** | Qyteti Roskovec | 11,718,786 | 16,162,026 | 1,081,813 | | 28,962,625 |
| **2** | Njësia Kuman | 19,832,270 | 12,697,542 | 1,483,406 | | 34,013,218 |
| **3** | Njësia Kurjan | 16,950,759 | 5,738,112 | - | | 22,688,871 |
| **4** | Njësia Strum | 39,656,719 | 17,430,258 | 3,494,325 | | 60,581,302 |
| **5** | | | | | 2,286,870 | 2,286,870 |
| **Totali** | | **88,158,534** | **52,027,938** | **6,059,544** | **2,286,870** | **148,532,886** |

**Punoi:** *Grupi i Auditimi*
Në **pasqyrën nr. 5** janë paraqitur të përmbledhura detyrimet e familjarëve sipas njësive administrative për taksat dhe tarifat vendore të vitit ushtrimor 2023 si vijon:

| **Detyrimet deri në datë 31.12.2023** | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Nr** | **Njësitë Administrative** | **Taksa e Tokës Bujqësore** | **Taksa e ndërtesës +Tarifa Vendore** | **Tarifa e mirëmbajtjes të sistemit kullues** | **Tarifë vaditje** | **Totali** |
| **1** | Qyteti Roskovec | 12,470,976 | 17,841,476 | 1,351,606 | | 31,664,058 |
| **2** | Njësia Kuman | 22,022,771 | 14,819,609 | 1,491,807 | | 38,334,187 |
| **3** | Njësia Kurjan | 16,033,599 | 5,742,186 | - | | 21,775,785 |
| **4** | Njësia Strum | 39,992,804 | 20,530,392 | 3,880,170 | | 64,403,366 |
| **5** | | | | | 2,805,020 | 2,805,020 |
| **Totali** | | **90,520,151** | **58,933,663** | **6,723,583** | **2,805,020** | **158,982,417** |

**Punoi:** *Grupi i Auditimi*

Abonentët familjarë për taksat dhe tarifat vendore në njësitë administrative dhe në qytetin e Roskovecit paraqiten në fund të vitit 2022 në shumën 148,532,886 lekë. Gjatë vitit 2023 pagesa për detyrimet nga vitet e mëparshme për taksat dhe tarifat vendore janë në vlerën 24,663,752 lekë.Gjatë vitit 2023 janë krijuar detyrime të reja në vlerën 35,113,283 leke. Totali progresiv

në fund të vitit 2023 është në vlerën 158,982,417 lekë nga taksat dhe tarifat vendore për abonentët familjarë.

**Në aneksin nr. 2/2/6-2 të Raportit të Përfundimtar Auditimit** janë paraqitur të përmbledhura detyrimet e familjarëve sipas NjA për taksën e ndërtesës dhe tarifat vendore të vitit ushtrimor 2023.

Abonentët familjarë debitorë për taksën e ndërtesës dhe tarifat vendore në njësitë administrative dhe në qytetin e Roskovecit paraqiten në fund të vitit 2022 për vlerën 52,027,938 lekë. Gjatë vitit 2023 pagesa për detyrime nga taksën e ndërtesës dhe tarifat vendore të viteve të mëparshme kanë qenë në vlerën 9,519,682 lekë. Detyrimi për vitet e mëparshme është në shumën 42,508,256, gjatë vitit 2023 janë krijuar detyrime të reja në vlerën 16,425,407 lekë. Totali progresiv në fund të vitit 2023 është në vlerën 58,933,663 lekë nga taksa e ndërtesës dhe tarifat vendore për abonentët familjarë.

**Në aneksin nr. 2/2/6-3 të Raportit të Përfundimtar Auditimit j**anë paraqitur të përmbledhura detyrimet e familjarëve sipas njësive administrative për tarifën e mirëmbajtjes së kanaleve kulluese të vitit ushtrimor 2023.

Abonentët familjarë debitorë për tarifën e mirëmbajtjes së kanaleve kulluese në njësitë administrative dhe në qytetin e Roskovecit paraqiten në fund të vitit 2022 për vlerën 6,059,544 lekë. Gjatë vitit 2023 pagesa për detyrime nga tarifën e mirëmbajtjes së kanaleve kulluese të viteve të mëparshme kanë qënë në vlerën 4,495,556 lekë. Gjatë vitit 2023 janë krijuar detyrime të reja në vlerën 2,228,027 lekë. Totali progresiv në fund të vitit 2023 është në vlerën 6,723,583 lekë nga tarifat për mirëmbajtjen e kanaleve kulluese për abonentët familjarë.

Në **pasqyrën nr. 8** janë paraqitur të përmbledhura detyrimet e familjarëve sipas njësive administrative për taksat dhe tarifat vendore të vitit ushtrimor 2023 si vijon:

| Nr | Emërtimi | Deri më datën 31.12.2022 | Shtesa 2023 | Totali Progresiv | Numri i familjeve debitore |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Taksa e tokës bujqësore | 75,306,552 | 15,213,599 | 90,520,151 | 4,064 |
| 2 | Taksa e ndërtesës +Tarifa Vendore | 42,508,256 | 16,425,407 | 58,933,663 | 4,822 |
| 3 | Tarifa e mirëmbajtjes të sistemit kullues | 4,495,556 | 2,228,027 | 6,723,583 | 2,820 |
| 4 | Tarifë vaditje | 1,558,770 | 1,246,250 | 2,805,020 | 420 |
| | **Totali** | **123,869,134** | **35,113,283** | **158,982,417** | |

**Punoi:** Grupi i Auditimi

- **Njoftimet e bëra për familjarët, masat e mara dhe masat shtrënguese**

Shërbimi për familjet ofrohet në zyrën me një ndalesë për qytetin dhe në Njësitë Administrative nga specialisti i ngarkuar për taksat dhe tarifat vendore.

Paketa Fiskale e bashkisë publikohet në faqen zyrtare të saj, ku të gjithë personat e interesuar mund të marrin informacion të gjerë në lidhje me taksat dhe tarifat vendore, nivelin e tyre, afatet e pagesave, përjashtimet përkatëse etj.

Shpërndarja e faturave dhe njoftimi i familjeve për detyrimet vendore, kryesisht është bërë nga specialistët e taksave si në mënyrë verbale ashtu dhe shkresore.

Për shërbimet që qytetarët kërkojnë të kryejnë në bashki, zakonisht kërkohet dokumentimi i shlyerjes së detyrimeve, nëpërmjet librezës së taksave vendore, me synim ndërgjegjësimin e tyre për pagesën e taksave dhe tarifave vendore në mënyrë vullnetare. Sa më sipër është e vetmja masë shtrënguese e aplikuar për vjeljen e detyrimeve të papaguara nga popullata.

Nga auditimi i të dhënave, rezulton se më datën 31.12.2023 për mos pagesën e detyrimeve tatimore për vitet e mëparshme kemi vlerë detyrimi **123,869,134 lekë**. Kjo vlerë në vitin 2022 ka qenë 148,532,886 lekë dhe në krahasim me vitin 2023 është ulur me **24,663,752 lekë ose 16.6%.** Gjatë vitit 2023 konstatohen/kemi pasur shtesa nga debitorët për tatim-taksat në vlerën 35,113,283 lekë.

Për vitin 2023 vlera debitore progresive është në shumën **158,982,417 lekë e cila përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Roskovec**, nga mos arkëtimi i taksës dhe tarifave nga debitorët familjar deri në datën 31.12.2023. Këto veprime dhe mosveprime janë në kundërshtim me ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e

Shqipërisë", i ndryshuar, Kreut XI-*"Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara",* të neneve 88 deri 104, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore", të ndryshuar.

- **Taksa e tokës:**

Bashkia Roskovec për vitin 2023 ka parashikuar të mbledhi të ardhura nga taksa për tokën bujqësore në vlerën 25,852,496 lekë realizimi i kësaj takse për vitin 2023 është në vlerën 22,754,903 lekë.
Nga informacioni që na është përcjellës nga sektori i tatim taksave kemi informacion për sipërfaqen totale që ju është ndarë 5,380 familjeve konkretisht 8,937,3 ha.
Sipas të dhënave që disponon Drejtoria e të Ardhurave Vendore nga Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural sipërfaqja e tokës e ndarë është 8,937.3 ha e ndarë sipas kategorive të tokës.
**Në aneksin nr. 2/2/6-4 të Raportit të Përfundimtar Auditimit** paraqitet informacioni mbi ndarjes e tokës bujqësore në Bashkinë Roskovec
**Në aneksin nr. 2/2/6-5 të Raportit të Përfundimtar Auditimit** paraqitet informacion për debitorët e taksës bujqësore.
Abonentët familjarë debitorë për taksën e tokës bujqësore në njësitë administrative dhe në qytetin e Roskovecit paraqiten në fund të vitit 2022 për 88,158,534 lekë. Gjatë vitit 2023 pagesa për detyrime për taksën e tokës bujqësore të viteve të mëparshme kanë qënë në vlerën 12,851,982 lekë. Gjatë vitit 2023 janë krijuar detyrime të reja në vlerën 15,213,599 lekë. Totali progresiv në fund të vitit 2023 është në vlerën 90,520,150 lekë nga tarifat për taksën e tokës bujqësore për abonentët familjarë.

- **Bizneset, regjistrimi dhe mbajtja e të dhënave:**

Administrimi i taksave dhe tarifave vendore për subjektet fizik/juridik ku përfshihen regjistrat, pagesat e kryera, detyrimet e pa likuiduara etj., në Bashkinë Roskovec kryhet në programin Excel. Sektori i tatim-taksave kryhen regjistrim manual të të dhënave në regjistrat fizik dhe regjistrat elektronik. Çdo informacion që grumbullon nga njësitë administrative, ndërmarrjet e varësisë dhe nga vetë strukturat e Bashkisë Roskovec i administron në "Excel" në mungesë të një sistemi të mirëfilltë për administrimin e taksave dhe tarifave vendore.
Të dhënat janë regjistra në formë tabelore dhe sipas rasteve me aplikim të formulave për llogaritjen e shumave dhe përqindjeve.
Mungesa e një sistemi të mirëfilltë për menaxhimin e taksave dhe tarifave vendore ka efekt të drejtpërdrejtë në saktësinë e informacionit që përpunojnë punonjësit e DTTV për të cilat mund të ketë gabime në llogaritjen e detyrimeve apo kamatë vonesave. Regjistrimi, përpunimi dhe ruajtja e të dhënave vetëm në programin excel paraqet një risk të lartë edhe ndaj defekteve të ndryshme teknike me pasojë humbjen e të dhënave të DTTV.
Nga verifikimi i regjistrave fizik për bizneset u vërtetua se nuk ishin kryer shkarkimet e detyrimeve në regjistrat sipas njësive të varësisë edhe pas pagesave të subjekteve biznes të taksave dhe tarifave.
Gjithashtu administrimi i taksave dhe tarifave vendore është edhe detyrim i Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, neni 4, pika 7, ku përcaktohet që: "Pranë çdo bashkie dhe komune krijohet regjistri i taksave vendore dhe tatimpaguesve vendorë. Forma dhe kodifikimi i këtij regjistri përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave, në përputhje me këtë ligj dhe me Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar".
Referuar të dhënave të marra nga DTV Bashkia Roskovec, situata e lëvizjes së subjekteve paraqitet si më poshtë:
Në **pasqyrën nr. 11** Rregjistri i biznesit Bashkia Roskovec

| Nr | Lloji Biznesit | Viti | Gjendja Në fillim | Regjistrime Reja | Mbyllur Aktivit | Gjendja në fund të Vitit |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Biznesi Vogël | 2023 | 410 | 28 | 24 | 414 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **2** | **Biznesi Madh** | **2023** | **73** | **1** | **0** | **74** |
| **(1+2)** | **Gjithsej** | **2023** | **483** | **29** | **24** | **488** |

**Burimi:**Bashkia Roskovec

➢ **Menaxhimi i borxhit nga taksat e tarifat vendore.**

Nga auditimi i të dhënave, rezulton se më datën 31.12.2023 për mos pagesën e detyrimeve tatimore janë debitorë subjektet e biznesit të vogël, biznesit të madh dhe subjekte shtetërore në vlerën **21,076,994 lekë, vlerë e cila konsiderohet e ardhur e munguara për buxhetin e Bashkisë Roskovec.**

Referuar të dhënave të vënë në dispozicion grupit të auditimit të KLSH, konstatohet se, gjendja e debitorëve paraqitet **në aneksin nr. 2/2/6-6 të Raportit Përfundimtar të Auditimit**.

Sa me sipër dalim në konkluzionin se nga strukturat tatimore të bashkisë Roskovec, për subjektet, ku megjithëse janë debitorë në vite dhe vlera të konsiderueshme, pasi janë njoftuar për pagesën e detyrimeve si dhe janë zbatuar një pjesë e procedurave për to, nuk është kërkuar kallëzim penalbazuar në nenin 181, "*Mos pagimi i taksave dhe tatimeve*", të Kodit Penal të RSH, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 me ndryshime, ku përcaktohet se:

"*Mospagimi i taksave dhe tatimeve brenda afatit të caktuar, me gjithë mundësinë e pagimit të tyre, nga personi ndaj të cilit janë marrë më parë masa administrative për këtë qëllim, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet.*"

Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 139/2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*", i ndryshuar neni 9 "*Të drejtat dhe përgjegjësitë*" pika 1.3., ku përcaktohet se:

"*1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë këto të drejta dhe përgjegjësi: 1.3. Të drejtën dhe përgjegjësinë e mbledhjes së të ardhurave dhe bërjes së shpenzimeve, sipas së cilës: a) krijojnë, mbledhin të ardhura dhe bëjnë shpenzime për përmbushjen e funksioneve të tyre; b)vendosin taksa vendore e tarifa për shërbimet, si dhe nivelin e tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi; c) hartojnë, miratojnë dhe zbatojnë buxhetin e tyre; ç) mbajnë llogaritë, në përputhje me legjislacionin në fuqi, dhe ofrojnë informacione ose raporte financiare për hartimin dhe zbatimin e buxhetit për qeverisjen qendrore ose shtetasit.*"

Neni 35, "*Të ardhurat që rrjedhin nga burimet e veta vendore*", me ligjin nr. 68/2017 "*Për financat e vetëqeverisjes vendore*" i ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10, si dhe me ligjin nr. 9632, datë 30.10.20106 "*Për sistemin e taksave vendore*", Kreu II, Kreu IV, Kreu V, Kreu VII, etj.

➢ **<u>Të ardhurat dhe vlerat debitore nga taksa e ndikimit në infrastrukturë:</u>**

Nga auditimi i dokumentacionit që disponon Drejtoria e të Ardhurave, Bashkia Roskovec në lidhje me legalizimet e ndërtimeve pa leje dhe listave që disponon për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, konstatohet se nga ASHK Fier janë dërguar zyrtarisht me shkresë lista e qytetarëve shoqëruar me leje legalizimi.

Konkretisht për periudhën nga 01.01.2023 deri më 31.12.2023, sipas listave të vëna në dispozicion me leje legalizimi dhe kryqëzimi i tyre me personat që kanë bërë të mundur likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturës, rezulton se detyrimi për këtë taksë është në vlerën **9,821169 lekë** për 332 persona, ka paguar detyrimet 163 persona me vlerë **3,370,036 lekë** dhe kanë mbetur për likuidim deri datë 31.12.2023 gjithsej **219** persona me vlerë **6,393,168 lekë,** e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Roskovec.

Debitorë nga vitet e mëparshme për taksën e infrastrukturës janë në vlerën 19,635,163 lekë

Në **pasqyrën nr. 13** paraqiten të dhëna përtaksën e infrastrukturës për vitin 2023:

| **Taksa e ndikimit në infrastrukturë** | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Viti** | **Persona** | **Vlera e taksës së ndikimit në infrastrukturë** | **Vlera e arkëtuar** | **Vlera e detyrimit** |
| Deri më datë 31.12.2022 | 922 | 22,107,685 | 7,568,890 | 19,635,163 |
| 2023 | 332 | 9,821,169 | 3,370,036 | 6,393,168 |
| **Totali/Progresim** | **1,254** | **36,928,834** | **10,938,926** | **26,028,331** |

**Burimi:** Bashkia Roskovec

Nga dokumentacioni i paraqitur konstatohet se nga Bashkia Roskovec për përiudhën ushtrimore janë njoftuar subjektet debitorë por nuk i është drejtuar ASHK Dega Fier, për bllokimin e pasurisë dhe mos kryerjen veprimeve hipotekore. Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me VKM nr. 860, datë 10.12.2014 "Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes

dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim" i ndryshuar, pika 5 dhe ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, neni 27.

- **<u>Asetet e dhëna me qira:</u>**

Dhënia e aseteve të Bashkisë me qira bëhet bazuar në kuadrin ligjor si më poshtë:
- Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, nenet 826-840;
- Ligjin nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore;
- VKM nr. 54, datë 05.02.2014 "Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", e ndryshuar;
- VKM nr. 391 datë 21.06.2006, ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave".

Bashkia Roskovec në zbatim të përcaktimeve ligjore në fuqi për administrimin e aseteve në pronësi apo në përdorim, dhe krijimit të të ardhurave prej dhënies me qira të tyre administron 12 kontrata për dhënien me qira të tokave bujqësore të cilat janë lidhur përpara vitit 2023. Këto kontrata janë lidhur bazuar në legjislacionin përkatës në vijimësi me subjekte të ndryshëm fizik/ juridik që kanë shprehur interes, për afate kohore nga 3 vjet deri në 99 vjet.
Tarifa e dhënies së tokës bujqësore është vendosur konform VKM nr. 373, datë 20.06.2018,
Në një vit buxhetor, të ardhurat që pret të arkëtojë Bashkia Roskovec nga qiraja e tokës bujqësore janë gjithsej 2,472,152 lekë. Nga auditimi i kontratave për dhënien me qira të tokës bujqësore, u konstatua se në fund të vitit 2023 është debitor 1 subjekt në vlerën 21,000 lekë e cila **përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Roskovec.**
Për arkëtimin e vlerës debitore të krijuar nga mospagesa e qirasë, nuk administrohet dokumentacion mbi masat e marra, pra zgjidhjen e kontratës në zbatim të kapitullit "zgjidhja e kontratës" në kontratën e lidhur ndërmjet palëve, si dhe padi gjyqësore me qëllim ngarkimin e shërbimit përmbarimor, për ekzekutimin me forcë të detyrimit.
**Në aneksin nr. 2/2/6-7 të Raportit Përfundimtar të Auditimit** paraqiten kontratat e lidhura nga Bashkia Roskovec për dhënien me qira të tokave bujqësore.
**Në aneksin nr. 2/2/6-8 të Raportit Përfundimtar të Auditimit** paraqiten kontratat për dhënien me qira të ndërtesave/objekteve apo enfiteozë
Bashkia Roskovec në zbatim të përcaktimeve ligjore në fuqi për administrimin e aseteve në pronësi apo në përdorim, dhe krijimit të të ardhurave prej dhënies me qira të tyre administron 7 kontrata për dhënien me qira të ndërtesave/objekteve të cilat janë lidhur gjatë viteve 2020-2023. Këto kontrata janë lidhur bazuar në legjislacionin përkatës në vijimësi me subjekte të ndryshëm fizik/ juridik që kanë shprehur interes, për afate kohore nga 1 vit deri në 30 vjet.
Për periudhën nga data 01.01.2023 deri më 31.12.2023, në total është nënshkruar 1 kontratë për dhënien me qira të ndërtesave/objekteve të cilat administrohen nga Bashkia Roskovec.
Nga auditimi i pagesave të kontratave të qirave të ndërtesave/objekteve rezulton se 3 qiramarrës i nuk kanë paguar detyrimin sipas kontratës **në vlerën 193,620** lekë për vitin 2023 e cila **përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Roskovec.**

- **<u>Pajisja me autorizime e subjekteve që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre:</u>**

Sipas dokumentacionit të venë në dispozicion nga Drejtoria e Shërbimeve dhe e Licencave, në lidhje me subjektet e tregtimit të karburanteve që ushtrojnë aktivitet në territorin e Bashkisë Roskovec dhe në Njësitë Administrative, ushtrojnë aktivitetin 10 subjekte të tregtojnë me pakicë hidrokarbure dhe nënprodukte të tyre.
**Në aneksin nr. 2/2/6-9 të Raportit të Përfundimtar Auditimit** paraqiten kontratat e subjekteve që tregtojnë hidrokarbure.
Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se nga Bashkia Roskovec për vitin ushtrimor 2023 kanë ushtruar aktivitetin 10 subjekte të cilat tregtojnë me pakicë hidrokarbure dhe nënprodukte të tyre. Nga auditimi i kësaj kategorie të bizneseve, në lidhje me pajisjen me

lejet përkatëse të tregtimit dhe pagesat e tyre, u konstatua se 1 subjekt ka pezulluar aktivitetin. Janë pajisur me autorizim sipas përcaktimeve të VKM nr. 344, datë 19.04.2017, 3 subjekt konkretisht "B. P." Shpk me Nipt: L..........R dhe ka paguar detyrimet në vlerë 1,000,000 lekë, "E. " Shpk me Nipt K.......S dhe ka paguar detyrimet në vlerë 800,000 lekë, "Xh." Shpk me Nipt: K.........S dhe ka paguar detyrimet në vlerë 800,000 lekë si dhe nuk janë pajisur me autorizim 7 subjekte. Sa më sipër rezulton së Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore ka vepruar në kundërshtim me Kreun II pika 11 e VKB nr. 90 datë 02.12.2022 "Mbi miratimin e paketës fiskale për vitin 2023" si dhe VKM nr. 970, datë 02.12.2015 "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj" i ndryshuar kapitulli II, pika 1; gërma "b", dhe pika 9, ndryshuar me VKM nr. 344, datë 19.04.2017, kapitulli II, pika 1; gërma "b" dhe pika 9 dhe 15.

**Nga auditimi i dosjeve fizike të subjekteve u konstatua se situata paraqitet si mëposhtë:**

**1.** Subjekti **"Ç." Shpk,** me Nipt: J.........B, ka ushtruar aktivitet si pikë shpërndarje karburantesh, vajrash dhe pjesë këmbimi automjetesh, tregtim gazi me pakicë, etj., si dhe është pajisur me licencë 1 vjeçare nga data 24.04.2018-23.04.2019, pajisja me licencën e radhës është 24.04.2019-23.04.2020 dhe është pajisur sërish me licencë 3-vjeçare për periudhën 05.05.2020-04.05.2023. Pas mbarimit të autorizimit subjekti "Ç." shpk ka paraqitur kërkesën për licencim dhe ka dorëzuar dokumentacionin me shkresë nr. 6217 prot., datë 19.10.2023. Bashkia Roskovec ka kthyer përgjigje negative me shkresën nr. 6217/1 prot., datë 20.11.2023, për pajisje me licencë, për mosplotësim dokumentacioni.

2. Subjekti "**B. O." Shpk**, me Nipt: L....A, ushtron aktivitet tregtim me shumicë e pakicë i hidrokarbureve e nënprodukteve të saj, lëngut të gazit, etj. Subjekti "B.O." Shpk në datë 01.12.2023 ka aplikuar për rinovimin e licencës për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të tij. Bashkia Roskovec ka kthyer përgjigje negative me shkresën nr. 7769/1 prot., datë 27.12.2023, për pajisje me licencë, për mosplotësim dokumentacioni.

3. Subjekti "**E.." Shpk**, me Nipt: K..........S, ushtron aktivitet tregtim karburant, lubrifikant me pakicë dhe ka marrë autorizim për një periudhë 5-vjeçare për tregtim me pakicë të karburanteve, është pajisur me licencë 1-vjeçare nga data 23.09.2019-22.09.2020 dhe licencë 4-vjeçare nga data 07.12.2020-07.12.2024. Pagesa për licencën nga subjekti është kryer e plotë

4. Subjekti **"L. 2." Shpk**, me Nipt: L........K, ka ushtruar aktivitet tregtim me pakicë i karburanteve të ndryshme, vajrave lubrifikant për mjete të tonazheve dhe llojeve të ndryshme, etj. Bashkia Roskovec ka kthyer përgjigje negative me shkresën nr. 3152, datë 24.05.2021, nr. 6450/1 prot., datë 26.10.2021 dhe nr. 6450/2 prot., datë 25.10.2021 për pajisje me licencë, për mosplotësim dokumentacioni. Bashkia Roskovec ka rinjoftuar subjektin "L...2..." Shpk me shkresën nr. 6240 prot., datë 16.10.2023 për të dorëzuar dokumentacionin për pajisjen me licencë për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj.

5. Subjekti **"A.O." Shpk,** me Nipt: L........M, sipas verifikimit nga QKB subjekti rezulton me status të pezulluar prej datës 15.07.2022.

6. Subjekti **"E.-T." Shpk**, me Nipt: K........J, ushtron aktivitet tregtim me pakicë të karburanteve, etj. Subjekti nuk është i pajisur me autorizim nga Bashkia për tregtim te hidrokarbureve. Bashkia Roskovec me shkresën nr. 6240 prot., datë 16.10.2023 ka njoftuar subjektin "E..-T" Shpk për për tu pajisur me licencë për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj. Formulari i aplikimit nga subjekti është paraqitur me shkresën nr. 6870, prot., datë 01.11.2023. Bashkia Roskovec ka kthyer përgjigje negative me shkresën nr. 6870/1 prot., datë 23.11.2023, për pajisje me licencë, për mosplotësim dokumentacioni. Subjekti është rinjoftuar përsëri nga Bashkia Roskovec për paraqitjen e dokumentacionin i cili mungon në dosje për licencimin e subjektit.

7. Subjekti **"Xh." Shpk**, me Nipt: K.......E, ushtron aktivitet tregtim me pakicë i karburanteve dhe gazit të lëngshëm, etj. Është pajisur me licencë 1 vjeçare nga data 28.06.2019-27.06.2020, pajisja me licencën e radhës është për një periudhë 4-vjeçare nga 18.12.2020-18.12.2024, dhe

për periudhën 28 Qershor – 17 Dhjetor të vitit 2020 ka ushtruar aktivitet pa licencë. Pagesa për detyrimin për licencën 1,000,000 lekë është kryer në datë 18.12.2020.
8. Subjekti **"A.-O." Shpk**, me Nipt: K....A ushtron aktivitet tregtim karburanti dhe është pajisur me licencë 5-vjeçare nga data 06.05.2015-06.05.2020, pas kësaj subjekti ushtron aktivitet pa licencë. Subjekti "A.-O." Shpk ka paraqitur formular aplikimi me shkresën nr. 7484 prot., datë 20.11.2023. Bashkia Roskovec ka kthyer përgjigje negative me shkresën nr. 7484/1 prot., datë 07.12.2023, për pajisje me licencë, për mosplotësim dokumentacioni.
9. Subjekti "B. P." Shpk, me Nipt: L........R, ushtron aktivitet tregtim me pakicë i naftës bruto, gazit natyror, gazit të lëngshëm, i nënprodukteve të përparuara të naftës si benzina, etj., dhe është pajisur me licencë 5-vjeçare nga data 18.12.2020-18.12.2025. Pagesa për detyrimin për licencën 1,000,000 lekë është kryer në datë 18.12.2020.
10. Subjekti **"Xh.-1." Shpk**, me Nipt: L........V, ushtron aktivitet tregtim me pakicë i karburanteve dhe gazit të lëngshëm, etj. Është pajisur me licencë 5 vjeçare nga data 04.11.2016-04.11.2021. Subjekti "Xh.-1." Shpk ka aplikuar në datë 03.06.2022 për rinovimin e licencës për tregtim me pakicë të naftës bruto, gazit natyror, gazit të lëngshëm, dhe nënprodukteve të përparuara të naftës si benzina,. Bashkia Roskovec ka kthyer përgjigje negative me shkresën nr. 5622/1 prot., datë 01.07.2022, për pajisje me licencë, për mosplotësim dokumentacioni. Bashkia Roskovec ka rinjoftuar subjektin "Xh.-1." Shpk me shkresën nr. 6239 prot., datë 16.10.2023 për të dorëzuar dokumentacionin për pajisjen me licencë për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj.
Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore:
1) VKM nr. 170, datë 25.4.2002 "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre", i ndryshuar, kapitulli II dhe kapitulli III, pika 4.
2) VKM nr. 970, datë 02.12.2015 "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj" i ndryshuar kapitulli II, pika 1; germa "b", dhe pika 9, ndryshuar me VKM nr. 344, datë 19.04.2017, kapitulli II, pika 1; germa "b" dhe pika 9 dhe 15 ku citohet: 15.1 "Në përputhje me legjislacionin në fuqi, organi që ka për detyrë të japë licencën informon, menjëherë, inspektoratin shtetëror përgjegjës dhe bashkëpunon me të për marrjen e masave të bllokimit të veprimtarisë së subjekteve që ushtrojnë, pa licencë, aktivitetin e tregtimit me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse, për përdorim nga konsumatorët fundorë Veprimet dhe mosveprimet ngarkojnë me përgjegjësi komisioni për dhënien e licensave për tregëtimin e naftës bruto dhe nënproduktet e saj".

➢ **Mbi pagesën e detyrimeve vendore nga subjektet që janë shpallur fitues në procedurat e prokurimit në Bashkinë Roskovec.**

Lidhur me subjektet që janë shpallur fitues nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duke fituar të drejtën të kryejnë punime në territorin e Bashkisë Roskovec, u audituа dokumentacionin mbi pagesën e detyrimeve të këtyre subjekteve për taksat dhe tarifat vendore për periudhën e ushtrimit të aktivitetit në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar. Për periudhën nën auditim janë lidhur 9 kontrata me operatorë ekonomikë që kanë fituar të drejtën për të kryer punime të ndryshme në territorin e Bashkisë Roskovec. Nga Drejtoria e të Ardhurave Vendore janë njoftuar detyrimet për njoftim vlerësimet tatimore.

➢ **Gjobat e Policisë Bashkiake dhe IMTV**

Për periudhën objekt auditimi nga Inspektorati Mbrojtjes Territorit Bashkia Roskovec *është njoftuar zyra juridike për vazhdimin e procedurave për arkëtimin e gjobave të vendosura.* Nga Inspektorati Mbrojtjes Territorit (IMT) Bashkia Roskovec për periudhën objekt auditimi janë vendosur 7 (shtatë) gjoba në vlerën **950,000lekë** nga të cilat është arkëtuar vlera **300,000lekë,**

janë referuar në gjykatë 4 (katër) raste të ndërtimeve pa leje të konstatuara në vlerën **650,000 lekë të cilat i janë referuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë për tu shpallur në titull ekzekutiv.** Debitorët progresivë nga gjobat e IMTV dhe Policisë Bashkiake në datë 31.12.2023 janë në shumën **1,857,000 lekë**.
Sa më sipër rezulton se për të gjitha praktikat IMT-ja, Drejtoria Juridike ka ndjekur të gjitha rrugët ligjore, me qëllimin arkëtimin e detyrimeve.
**Në aneksin nr. 2/2/6-10 të Raportit Përfundimtar të Auditimit** paraqiten gjobat e IMTV dhe Policisë Bashkiake.

**<u>Mbi llogaritjen e Taksës së ndikimit në infrastrukturë.</u>**
Për periudhën nën auditim, 01.01.2023 – 31.12.2023, nga Bashkia Roskovec janë miratuar katër leje ndërtimi për të cilën është vjelë Taksa e Ndikimit në Infrastrukturë. Referuar VKB nr. 90, datë 01.12.2022 *"Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2023"*, vlera e Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë, e shprehur në përqindje, është 4%.

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:**
**1. znj. M. B.** me detyrë Kryetare e Bashkisë Roskovec.
**2. znj. A. R.** me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Biznesit, Drejtoria e të Ardhurave Vendore për periudhën (01.01.2023-31.08.2023).
**3. z. M. P.** me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Tatim-Taksave, Drejtoria e të Ardhurave Vendore.
**4. znj. O. G.** me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Biznesit, Drejtoria e të Ardhurave Vendore për periudhën (31.08.2023-31.12.2023).

### 2.3 Mbi vlerësimin e raportimit financiar për vitin 2023.

**-** *<u>Nxjerrja e pasqyrave financiare për vitin 2023</u>*.
**Për vitin 2023**, Pasqyrat financiare janë të nënshkruar nga NA dhe NZ si dhe janë të dërguara në Degën e Thesarit Fier për vitin ushtrimor 2023 me shkresë përcjellëse nr. 2251 prot., datë 28.03.2024. Në cilësinë e Nëpunësit Autorizues është Kryetaria e Bashkisë Roskovec zj. M. B. dhe në cilësinë e Nëpunësit Zbatues është Drejtori Drejtorisë Ekonomike z. S. Ç.

**-** *<u>Hartimi i pasqyrave financiare</u>***:**
Për vitin 2023 në përputhje me kërkesat e Udhëzimit të MF nr. 5, datë 21.02.2022, "Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të qeverisjes së përgjithshme", janë përgatitur pasqyrat financiare të përbëra si më poshtë:
□ Formati nr. 1. Pasqyra e pozicionit financiar.
□ Formati nr. 2. Pasqyra e performancës financiare (Klasifikimi sipas natyrës ekonomike).
□ Formati nr. 3. Pasqyra e flukseve monetare (Cash Floŵ).
□ Formati nr. 4. Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto.
□ Formati nr. 5. Pyetësor dhe shënimet shpjeguese.
□ Formati nr. 6. Investimet dhe burimet e financimit.
□ Formati nr. 7/a. Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (kosto historike).
□ Formati nr. 7/b. Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (vlera neto).
□ Formati nr. 8. Numri i punonjësve dhe fondi i pagave.

**-** *<u>Mënyra e mbajtjes së kontabilitetit dhe dokumentacionit bazë e justifikues si dhe sigurimi i informacionit kontabël, përgatitjen e llogarive për vlerësimin e gjendjes pasurore, financiare dhe rezultatit</u>*.
Për tu siguruar nëse, regjistrimet kontabël janë kryer në përputhshmëri ligjore dheme saktësi u kryen testime në regjistrimet në ditarët kontabël në lidhje me:

- Mbështetjen në dokumente justifikuese, të verifikuara përsa i përket vlefshmërisë për t'u pranuar në kontabilitet (vlerësimi kontabël);
- Mos ndryshueshmëria e regjistrimeve tashmë të kryera dhe e mbartësve të tyre;
- Tërësinë e regjistrimeve në mënyrë kronologjike dhe sistematike deri në mbyllje të të ushtrimit vjetor.
- Nëse informacioni kontabël mundëson, në të gjithë ciklin e tij, kontrollin rrjedhës dhe të mëvonshëm nëpërmjet:
- Shqyrtimit të vlefshmërisë së një regjistrimi fillestar duke e krahasuar me dokumentin bazë justifikues;
- Kontrollit të vlefshmërisë të një regjistrimi të kryer me anë të një dokumenti duke e krahasuar këtë dokument me dokumentet bazë justifikuese mbi të cilat është përgatitur;
- Verifikimit të pajtueshmërisë së shumave të nxjerra nga regjistrimet kronologjike me regjistrimet në llogari (barazimi i lëvizjeve të ditarëve me ato të librit të llogarive) dhe verifikimit të pajtueshmërive të tjera aritmetike.

**-** *Pohimet e testeve të kryera rreth mbajtjes së kontabilitetit të Aparatit Bashkisë* **.**
Si rezultat i testeve të kryera pohojmë se:
- Kontabiliteti është mbajtur i plotë për të gjitha veprimet kontabël të rezultuara nga kryerja e veprimeve ekonomike, mbi bazën e dokumentacionit bazë dhe justifikues.
- Në këtë bashki, kontabiliteti është organizuar dhe mbahet në mënyrë informatike në program "Excel"dhe jo me program të veçantë**.**
- Janë zbatuar drejt parimet e përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit, sipas përcaktimeve të dispozitave ligjore për kontabilitetin.
- Azhurnimet e veprimeve ekonomike janë në mënyrë kronologjike dhe kontabilizimet e tyre janë kryer në ditarët e bankës, të arkës, magazinës, të pagave dhe janë mbajtur partitarët për llogaritë kreditore e debitore. Nuk është mbajtur libri i madh apo libri centrilizator për evidentimin e veprimeve kontabël të kryera, duke kaluar nga ditarët në fletë-kontabilizimet apo kartelat kontabël deri në bilancin vërtetues rezultuar nga prerja e artikujve kontabël.
Këto libra kontabël janë bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë kronologjike dhe sistematike të efekteve të veprimeve të kryera, të marra nga dokumentet vërtetuese.
- Në tërësi organizimi i mbajtjes së kontabilitetit ka mundësuar nxjerrjen e gjendjeve të llogarive sipas klasave, nisur nga dokumentet bazë justifikuese, të cilat janë të dhëna bazë të hyra në kontabilitet.
- Plotësimi i dokumenteve bazë e justifikues është bërë në mënyrë të plotë, pasi përshkruajnë me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban te dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato te vlerës, personat qe kane urdhëruar dhe ekzekutuar veprime të dhënat të nevojshme qe i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Kështu: Dokumentet vërtetues si urdhër-shpenzimi, fletë hyrje-daljet, mandat arkëtimet e pagesat, janë të hartuara me të gjitha elementet që kërkon formati i miratuar. Këto dokumente shoqërohen nga dokumente autorizues si me urdhrat apo vendimet e organeve drejtuese, kontratat, dokumentet kryesore të procedurave të prokurimit, akt-marrëveshjet etj. Bashkëlidhur këtij dokumentacioni janë dokumentet vërtetues të shpenzimit si faturat, listëpagesat, situacionet e shpenzimeve, procesverbalet, shkresat etj.
- Informacioni kontabël është përgatitur mbi bazën e një kontabiliteti të quajtur të angazhimeve (*ose në bazë të të drejtave të konstatuara*), duke dhënë elementet e nevojshme për të vlerësuar gjendjen pasurore, gjendjen financiare dhe rezultatet e njësisë ekonomike.

**-** *Baza e dhënies së opinionit së Raportimit Financiar. Pohimet mbi saktësinë e paraqitjes së zërave të pasqyrave financiare***.**
Për dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare, u analizuan treguesit e pasqyrave financiare të bashkisë për aktivitetin ekonomiko- financiar nga data 01.01.2023 deri më datën 31.12.2023.

Pasqyrat financiare janë përgatitur nga Drejtoria e Financës. Gjatë fazës së ekzekutimit në terren, u kryen teste të detajeve dhe teste thelbësore, nga ku u konstatua se janë mbartur saktë tepricat e llogarive dhe se tepricat në çelje për vitin 2023, rakordojnë me tepricat në mbyllje të vitit 2022.
Nga verifikimi gjendjes së llogarive të bilancit të vitit ushtrimor 2023 rezulton se, llogaritë e Aktivit dhe të Pasivit kuadrojnë me formatet anekse pjese e PF, si dhe llogaritë sintetike kuadrojnë me ato analitike;
Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion u analizuan të dhënat e disa prej llogarive kontabël konkretisht si më poshtë:

- *Inventarizimi i aktiveve për vitin 2023 Bashkia Roskovec*
Inventarizimi i aktiveve është një element i rëndësishëm kontrolli në kuadrin e menaxhimit të aktiveve të njësisë i cili kryhet për të vërtetuar saktësinë, cilësinë e gjendjes fizike të aktiveve në një kohë të caktuar si dhe përdorimin në mënyrën e duhur dhe me eficiencë të tyre. Çdo njësi publike duhet të kontrollojë të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementëve dhe dokumentacionit mbështetës.
Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion u konstatua se;
Dokumentacioni kontabël i veprimatarisë financiare, klasifikimi, përpunimi, ruajtja dhe mbajtja e kontabilitetit kryhet nëpërmjet programit "Excel". Nëpëmjet këtij formati Bashkia Roskovec, Ndërmarrja e Pastrimit dhe Gjelbërimit dhe Mirëmbajtje e Varrezave, Ndërmarrja Shërbimeve të Mirëmbajtjes si njësi shpenzuese në varësi të bashkisë, mbajnë, përpunojnë dhe ruajnë të dhënat kontabël po në të njëjtin format pra në mënyrë manuale, duke paraqitur mosbesueshmëri dhe risk për përmbajtjen e tyre.

Nga auditimi rezultoi që mbajtja e kontabilitetit dhe funksionimi i llogarive sintetike me llogaritë analitike, në Bashkinë Roskovec, mbahet në mënyrë manuale, që e bën me risk të lartë për sa i përket sigurisë në saktësinë e informacionit që marrim nga ky sistem kontabiliteti pasi përdoret programi eksel për ruajtjen dhe përpunimin e të dhënave kontabël të Njësisë dhe njësive të vartësisë. Drejtoria Ekonomike në Bashkia Roskovec dhe sektorët e financës në njësitë vartëse, regjistrimet e veprimeve kontabël, kryhen me program exel dhe jo me "Bartës informatik", të cilët janë programe informatike të pamanipulueshme dhe të printueshme në çdo kohë. Veprimet e kryera në këtë mënyrë ndikojnë në mosbesueshmërinë dhe riskun që bartin në vetvete këto programe duke qenë të ndryshueshme në çdo kohë, të cilat gjithashtu ndikojnë në pasaktësi të veprimeve kontabël e rrjedhimisht në rezultate jo korrekten në kundërshtim me ligjin nr. 25/2018, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", nenin 3, pikat 14 e 15 ku citohen se;*"Dokument kontabël" është dokumenti bazë, dokumenti plotësues dhe regjistrat (librat) kontabël, që përgatiten në letër të shkruar ose në bartës informatikë..."Bartës informatik" është çdo dokument kontabël i autorizuar nga organet përkatëse, i shkruar në mjete kompjuterike, sipas programeve informatike të pamanipulueshme dhe të printueshme në çdo kohë."*
Nenin 11 ku citohet se; "*Qëllimi i pasqyrave financiare. 1. Pasqyrat financiare hartohen në mënyrë të qartë, në përputhje me këtë ligj dhe standardet e aplikueshme të raportimit financiar, si dhe paraqesin me vërtetësi dhe besueshmëri pozicionin financiar, performancën financiare, ndryshimet në kapital/aktivet neto dhe flukset e mjeteve monetare të njësive ekonomike. 2. Pasqyrat financiare në këtë ligj u referohen pasqyrave financiare individuale dhe pasqyrave financiare të konsoliduara."*
Kjo gjë çon dhe në mos kuadrim të drejtë dhe të saktë si dhe vonesa në kohë për gjetjen, korrektimin dhe sistemimin e gabimeve matematikore. Mungesa e programimit kompjuterik në hedhjen e të dhënave në shërbimin kontabël, ndikon në ngadalësimin e marrjes dhe përpunimit të informacioneve financiare, si dhe në cilësinë dhe saktësinë e evidencave kontabël

dhe të pasqyrave financiare *për të cilat mban përgjegjësi z. S. Ç. në cilësinë e nëpunësit zbatues.*

*(Gjendja e llogarive të bilancit në fund të vitit 2023, paraqitet në aneksin nr. 2.3, bashkëlidhur Raportit Përfundimtartë Auditimit).*

Në lidhje me verifikimin e disa vlerave të pasqyruara në llogaritë e pasqyrave të pozicionit financiar të vitit ushtrimor 2023, të saktësisë dhe besueshmërisë së tyre, u audituan referencat e llogarive të aktivit dhe të pasivit, si në vijim.

Nga auditimi i të dhënave kontabël të paraqitura në pasqyrat financiare për vitin 2023 rezulton se Llogaria 520 (Disponibilitete në thesar) paraqitet në pasqyrat financiare në fund të vitit 2022 në shumën 82,851,685 lekë ndërsa në fund të vitit 2023 në shumën 121,091,695 lekë, shumë e cila ka kundërparti llog. 466 *(kreditorë në ruajtje)* e cila paraqitet në shumën 62,536,544 dhe llog. 85 *(teprica e periudhës)* e cila paraqitet në shumën 58,555,151 lekë. Në ekstraktin e sistemit të Thesari llog. 520 paraqitet me vlerën 0 lekë edhe pse llog. 466 dhe llog. 85 paraqiten po në vlerë të njëjtë me të dhënat e paraqitura nga Bashkia Roskovec, pra ka një mosrakordim të llog. 520, në të dhënat e PF të Bashkia Roskovec me të dhënat e sistemit të Thesarit. Kjo problematikë është konstatuar edhe në auditimet e mëparëshme dhe përsëri rezulton se nuk është sistemuar llogaria nga Drejtoria Ekonomike e Bashkisë Roskovec dhe Degës së Thesarit Fier veprim i cili nuk është në respektim të kërkesave të Kap. III, pikat 30, 50 të UMF nr. 8, datë 9.03.2018 "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme".*Kap. III, pikat 30 *Çdo njësi e qeverisjes së përgjithshme kryen verifikimin fizik të aktiveve dhe elementeve të tjera, konform kritereve të përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore, si dhe saktëson vërtetësinë e llogarive të të drejtave e të detyrimeve ndaj të tretëve. Mbi këtë bazë, në kontabilitet, bëhen veprimet për sistemimin e diferencave të gjendjes fizike me gjendjen kontabël për llogari të vitit kontabël që mbyllet",* dhe pika 50. *"Tepricat e llogarisë 520, "Disponibilitete në thesar" dhe të llogarisë 466, "Kreditorë për mjete në ruajtje" duhet të vërtetohen me akt rakordim me thesarin, një kopje e të cilit i bashkëngjitet llogarisë vjetore. Në akt rakordim, tepricat duhet të paraqiten të strukturuara sipas natyrës së të ardhurave të trashëguara (të ardhurat e papërdorura, si të çelura ashtu edhe ato të paçelura, mjetet në ruajtje, sponsorizimet dhe pjesën e grantit që trashëgohet)"*

*-Aktivet Afatgjata Materiale*

Llog 210 *"Toka, troje terrene"*e cila pasqyron gjendjen e llogarisë për Bashkinë Roskovec dhe për 3 njësitë administrative, në fund të 2022 rezulton në vlerën 112,776,000 lekë, në 2023 rezulton po në vlerën 112,776,000 lekë pra nuk ka as shtesa e as pakësime në këtë llogari, konkretisht si më poshtë;

| Lëvizjet e llogarisë | Vlera në lekë |
|---|---|
| Gjendja në 31.12.2022 (D) | 112,776,000 |
| Gjendja në 01.01.2023 | 112,776,000 |
| Shtesa gjatë vitit 2020 (D) | 0 |
| Hapësira rekreative për fëmijët | 0 |
| Pakësim gjatë vitit 2023 (K) | 0 |
| Gjendja në 31.12.2023 (D) | 112,776,000 |

*Burimi: Drejtoria Ekonomike, Bashkia Roskovec.*

Nga auditimi mbi dokumentacionin e vendosur në dispozicion nga Sektori i Regjistrimit të Pronave (SRP) të krahasuara me kartelat në kontabilitet të Drejtorisë Ekonomike për truallin nën objekt të objekteve të administruara në **llog.(210)** "Toka, troje terrene" u konstatua se; Bashkia Roskovec, sipas DRP ka në administrim gjithsej *38 objekte* ndërtesa dhe konstruksione të ndryshme me sipërfaqe trualli nën këto objekte prej *74,995 m*$^2$, nga të cilat dokument të pronësisë (çertifikatë, apo vërtetim hipotekor) disponohen vetëm për *8 objekt*e me sipërfaqe trualli nën këto objekt të objekteve prej *28,703 m*$^2$, kurse për *30 objekte* me sipërfaqe

trualli nën objekt të objekteve prej *23,303 m²* nuk disponohet asnjë lloj dokument pronësie. Nga këto, Drejtoria Ekonomike ka të administruara në kontabilitet *zero m²* të truallit nën objekt të objekteve. Në këto kushte për mospërputhjet në administrimin për çdo truall të *"Toka, troje, terrene"* nga Bashkia Roskovec duhet që patjetër të kryejë sistemimin e llogarisë 210 *"Toka, Troje, Terrene"* duke bërë që në këtë llogari të paraqitet, vlera e trojeve të ndërtesave të pasqyruar në llogarinë 212 "*Ndërtime e konstruksione*", vlera e trojeve të cilat me VKM të posaçme kanë kaluar në pronësi të Bashkisë Roskovec, vlera e truallit dhe ndërtesave të regjistruara në ASHK Fier si dhe inventarizimi i trojeve me komision përkatës. Në këtë llogari nuk është pasqyruar VKM datë 29.09.2021, "Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr.802, datë 30.9.2015, "Për vënien në dispozicion të shoqërisë Trans Adriatic Pipeline ag (TAP ag), nëpërmjet marrjes në përdorim dhe krijimit të servitutit të përhershëm në sipërfaqet e tokave shtetërore që preken nga ndërtimi i korridorit të ndërtimit dhe korridori i sistemit të gazsjellësit, të projektit të gazsjellësit trans adriatik (projekti TAP)", për ndryshimet përkatëse në llogarinë 210, pasi me këtë akt ligjor ka kaluar për llogari të këtij projekti konkretisht: *-Sipërfaqja tokë bujqësore (arë) në korridorin me gjerësi përgjithësisht 38 (tridhjetë e tetë) metra, në total 27,570 (njëzet e shtatë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë) m2 dhe servitutit me gjerësi përgjithësisht 8 (tetë) metra, në total 8,669 (tetë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e nëntë) m2, me vlerë të përgjithshme kompensimi prej 6,242,275.63 (gjashtë milionë e dyqind e dyzet e dy mijë e dyqind e shtatëdhjetë e pesë pikë gjashtëdhjetë e tre) lekësh;* vlerë e cila duhet të pasqyrohej në PF.

Më poshtë po paraqesim tabelën e detajuar:

| Nr | Emërtimi | Gjithsej | | Të pa Regjistruara | | Të Regjistruara | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | **Nr. objekt** | **Sipërfaqe Trualli** | **Nr. objekt** | **Sipërfaqe Trualli** | **Nr. objekt** | **Sipërfaqe Trualli** |
| **I** | **BashkiaRoskovec** | **10** | **18,337** | **8** | **9,565** | **2** | **8,768** |
| **II** | **Njësitë administrative** | **28** | **56,658** | **22** | **13,738** | **6** | **19,935** |
| 1 | Njësia Administrative Strum | 8 | 26,224 | 8 | 3,239 | - | - |
| 2 | Njësia Administrative Kuman | 8 | 24,024 | 6 | 5,749 | 2 | 18,275 |
| 3 | Njësia Administrative Kurjan | 12 | 6,410 | 8 | 4,750 | 4 | 1,660 |
| | **Shuma gjithsej** | **38** | **74,995** | **30** | **23,303** | **8** | **28,703** |

*Shënim: Të dhëna të marra nga Drejtoria Ekonomike, Sektori i Pronave, Bashkia Roskovec.*

Nga auditimi mbi saktësinë e **Llog 210** "Toka, troje terrene" rezulton se kjo llogari nuk paraqet një pamje reale për pasqyrat financiare të vitit 2023.

Kontabilizimi i Aktiveve Afatgjata Materiale në llog. (210)" *Toka, troje terrene*" dhe paraqitja e gjendjes së kësaj llogarie në PF është e paplotë, pasi mungojnë analizat për të.

Nga verifikimi dhe analiza e Llog. 210 "*Toka, troje, terrene*", konstatohet se kjo llogari nuk paraqet gjendjen reale nga ana e Drejtorisë Ekonomike pasi, nuk janë hedh në kartelat e kontabilitetit asnjë prej vlerave të; a) trojeve nën objekt të objekteve si godina e re e bashkisë dhe trualli përreth saj, ndërtesat e shkollave që ka në administrim, ndërtesat e shkollave dhe të zyrave në NjA, etj, sipas regjistrit të aktiveve të pasqyruar në llogarinë 212 "*Ndërtime e konstruksione*".

b) truallit të godinave të regjistruar në ASHK në pronësi të Bashkisë,

c) trojeve të cilat me VKM kanë kaluar në pronësi të Bashkisë Roskovec, si dhe nuk është kryer inventarizimi dhe vlerësimi i tyre, për të cilën duhej bërë sistemimi dhe kalimi në administrim në llogarinë përkatëse. Nga Bashkia Roskovec është evidentuar vlera e investimit për godinën e re të ndërtuar por nuk janë reflektuar ndryshimet se sa është vlera përkatëse e truallit në këtë llogari sipas VKM të datës 16 janar, në të cilin detyrohet si njësi të cilës i kalon prona me vlerë 24,435,412 lekë e përbërë nga ndërtesë dhe truall, e ndryshuar me VKM nr. 705, datë 30.10.2019, është ndryshuar duke shkuar në shumën 30,775,074 lekë.

**-Llog 211** *"Pyje, Kullota, Plantacione"*, e cila pasqyron gjendjen e llogarisë për Bashkinë Roskovec dhe për 3 NjA në fund të 2022 paraqitet në vlerën 269,666,100 lekë, ndërsa në vitin 2023 paraqitet në vlerën 271,319,700 ku në të cilën është pasqyruar dhe sipërfaqja e pyjeve

dhe kullotave të kaluara me VKM nr. 433, datë 08.06.2016 "*Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/Bashkive*", pika 24, shtojca me nr.22, e ndryshuar me VKM nr. 684, datë 02.09.2020, pika 1, gërma "gj" e cila përmban, listën e inventarit të pyjeve dhe kullotave që transferohen në pronësi të Bashkisë Roskovec, me numrin rendor 1 (një) deri 24 (njëzetë e katër). Lista përkatëse rezulton të jetë në 208,21 Ha të cilat *edhe pse janë evidentuar në Pasqyrat Financiare të Bashkisë Roskovec të vitit 2023 për këto aktive nuk ka dokumentacion pronësor dhe nuk është kryer verifikim fizik për vitin 2023.*

**-Llog. 212** *"Ndërtime e konstruksione"*,e cila pasqyron gjendjen e llogarisë për Bashkinë Roskovec dhe për 3 NJA, në fund të vitit 2022 rezulton për vlerën 831,027,163 lekë dhe fund të vitit 2023 për vlerën 895,676,409 lekë ose me rritjen në vlerën neto 64,649,246 lekë në vlerë neto.

| Lëvizjet e llogarisë | Vlera në lekë |
|---|---|
| Gjendja në 01.01.2023 | 831,027,163 |
| Shtesa gjatë vitit 2023 (D) | 64,649,246 |
| Pakësime gjatë vitit 2023 (K) | |
| **Gjendja në 31.12.2023(D)** | **895,676,409** |

*Burimi: Drejtoria Ekonomike, Bashkia Roskovec.*

Shuma prej 64,649,246 lekë i përket 15 objekte të marra në dorëzim gjatë vitit 2023 të investimeve të mëparëshme dhe objektet e kryera gjatë vitit 2023, duke zbritur amoritizimin e akumuluar.

**- Llog. 213** *"Rrugë, rrjete, vepra ujore"*,e cila pasqyron gjendjen e llogarisë për Bashkinë Roskovec, në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerën 1,471,337,015 lekë, ndërsa në vitin 2023 gjendja paraqitet në vlerën 1,354,701,781 lekë. Kjo rritje vjen si rezultat i disa investimeve të bëra gjatë vitit ushtrimor dhe viteve përpara periudhës raportuese në rrugët e qytetit, fshatrave, etj, të cilat janë marrë në dorëzim dhe janë përfunduar gjatë vitit ushtrimor, konkretisht të dhënat dhe lëvizjet jepen si më poshtë;

| Lëvizjet e llogarisë | Vlera në lekë |
|---|---|
| Gjendja në 01.01.2023 | 1,471,337,015 |
| Shtesa gjatë vitit 2023 (D) | |
| Pakësime gjatë vitit 2023 (K) | 116,635,234 |
| **Gjendja në 31.12.2023(D)** | **1,354,701,781** |

*Referuar pasqyrës 7/a në këtë llogari gjatë vitit 2023 me ndryshime.*

Nga verifikimet e bëra rezulton se; në këtë llogari nuk janë kryer ndryshimet përkatëse pasi nuk është pasqyruar VKM datë 29.09.2021, "Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr.802, datë 30.9.2015, "Për vënien në dispozicion të shoqërisë trans adriatic pipeline ag (tap ag), nëpërmjet marrjes në përdorim dhe krijimit të servitutit të përhershëm në sipërfaqet e tokave shtetërore që preken nga ndërtimi i korridorit të ndërtimit dhe korridori i sistemit të gazsjellësit, të projektit të gazsjellësit trans adriatik (projekti TAP)", për ndryshimet përkatëse në llogarinë 213, pasi me këtë akt ligjor ka kaluar për llogari të këtij projekti konkretisht për:

- ***sipërfaqen ujore kanal*** *në korridorin me gjerësi përgjithësisht 38 (tridhjetë e tetë) metra, në total 14,457 (katërmbëdhjetë mijë e katërqind e pesëdhjetë e shtatë) m2 dhe servitutit me gjerësi përgjithësisht 8 (tetë) metra, në total 2,838 (dy mijë e tetëqind e tridhjetë e tetë) pa kompensim;*
- ***sipërfaqen rrugë automobilistike*** *në korridorin me gjerësi përgjithësisht 38 (tridhjetë e tetë) metra, në total 5,755 (pesë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e pesë) m2 dhe servitutit me gjerësi përgjithësisht 8 (tetë) metra, në total 1,304 (një mijë e treqind e katër) m2 pa kompensim.*

Ka të evidentuara në kontabilitet në llog.(212) nga ish Komunat një numër të konsiderueshëm objektesh të cilat janë në verifikim për regjistrimin e tyre. Kjo vjen për arsye se një pjesë e objekteve janë të trashëguara dhe të mbartura nga njësitë që u shkrinë (*ish/komunat*) në periudhat raportuese para vitit 2015 të pa shoqëruar me kartela objekti. Në këto kushte duke qënë se ka mospërputhje në administrimin për çdo objekt të "*Ndërtesave e Konstruksioneve*"

nga Bashkia Roskovec nga Sektori i Regjistrimit të Pronave, duhet që të bëhet hedhja në kontabilitet e objekteve dhe sipërfaqeve të regjistruara saktësimi objekteve, dokumentimi me kartelë objekti, inventarizim fizik i objektit, si dhe rivlerësim me normat për secilin objekt. Për sa më sipër *Llog. 212 "Ndërtime e konstruksione"* nuk paraqet një pamje reale për pasqyrat financiare të vitit 2023. Nga titullari i Bashkisë Roskovec, Sektori i Pronave dhe Drejtoria Ekonomike nuk janë marrë masat e duhura për përmbushjen e kuadrit rregullator ligjor të regjistrimit të pronave dhe evidentimit të saktë në llogaritë përkatëse me vlerën e drejtë të tyre. *Veprimet e mësipërme nuk janë në përputhje me kuadrin rregullator ligjor të kontabilitetit dhe raportimit financiar, konkretisht me* VKM nr. 19, datë 16.01.2019, pika 8, në të cilën citohet: *"Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Fier, brenda 30 ditëve, nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Roskovec, të fillojë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit në hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe të bëjnë kalimin e pronësisë, për pasuritë e shpronësuara, në favor të shtetit, përfaqësuar nga Bashkia Roskovec".*
Gjithashtu nuk janë pasqyruar ndryshimet sipas VKM, datë 29.09.2021, pika 8, në të cilën citohet:*"Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, drejtoritë vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, sipas përkatësive për bashkitë ku kalon projekti i Gazsjellësit Trans Adriatik (projekti TAP), si dhe njësitë e qeverisjes vendore, ku kalon projekti i Gazsjellësit Trans Adriatik (projekti TAP), për zbatimin*, për *sipërfaqjen tokë bujqësore (arë) në korridorin me gjerësi përgjithësisht 38 (tridhjetë e tetë) metra, në total 27,570 (njëzet e shtatë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë) m2 dhe servitutit me gjerësi përgjithësisht 8 (tetë) metra, në total 8,669 (tetë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e nëntë) m2, me vlerë të përgjithshme kompensimi prej 6,242,275.63 (gjashtë milionë e dyqind e dyzet e dy mijë e dyqind e shtatëdhjetë e pesë pikë gjashtëdhjetë e tre) lekësh;* e cila i ka kaluar Projektit të gazsjellësit TAP.

-*Llogari të Arkëtueshme* Llogaria 468 "*Debitorë të ndryshëm*".
Nga auditimi i pasqyrave financiare në lidhje me llogaritë 468 dhe 401-408, rezulton se; Llogaria 468 në fund të vitit 2022 paraqitet në shumën 176,090,570 lekë, ndërsa për vitin 2023 në shumën prej 188,006,444 lekë. Gjatë vitit 2023 shtesa prej 11,915,874 lekë vjen si rezultat i rritjes së debitorëve për taksa e tarifa vendore të Bashkisë Roskovec dhe njësive vartëse. Nga ana e Bashkisë Roskovec rezulton se nuk janë marrë masat e duhura për uljen e detyrimeve debitore dhe rritjen e performancës në arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore. *sipas llogaritjeve të bëra nga grupi i auditimit shuma e debitorëve është në vlerën 209,296,575 lekë, pra rezulton me një diferencë të pa reflektuar në raportimin financiar të njësisë në vlerën 21,290,131 lekë.*
Nga analiza e llog. 468 "Debitorë të ndryshëm" rezulton se nuk janë përfshirë debitorët e tjerë që rrjedhin nga taksa e ndikimit në infrastrukturë në vlerën **6,393,168** lekë për 219 persona, dhe në total progresive shuma prej 26,028,331 lekë. Gjithashtu nuk janë përfshirë gjobat e vendosura nga IMT–ja dhe Policia Bashkiake në vlerën 650,000 lekë, për 4 subjekte të konstatuara gjatë vitit 2023 ndërkohë që shuma progresive deri në fund të vitit paraqitet në vlerën 1,857,000 lekë së bashku me gjobat e viteve para periudhës ushtrimore e cila nuk është paasqyryar në llogarinë përkatëse. *Nga sa më sipër rezulton se llogaria 468 (debitorë të ndryshëm) nuk paraqet pamjen reale në raportimin financiar të Njësisë Roskovec për të cilën mban përgjegjësi Drejtori i Drejtorisë Ekonomike z. S. Ç.*, veprime këto në kundërshtim meudhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" kreu III pika 32, Kreu II pika 2/a, b, pika 22, me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, kreu II, neni 12, pika 3/g/gj, Rregullore e brendshme e*

*funksionimit të Bashkia Roskovec, miratuar me vendimin pa nr. prot, datë 25.02.2019, Kreu VI, neni 36, pika 2.3.*

- *Llogaritë 401-408* "*Furnitorë e llogari të lidhura me to*" në fillim të vitit 2023 rezulton për vlerën 588,748 lekë dhe në fund të vitit 2023 është në vlerën 771,403 lekë ose me një rritje në vlerën 182,655 lekë.

- *Paga, shpërblime e të tjera personeli (llog. 600) dhe sigurimet shoqërore (llog 601).*
-Nga auditimi i listë-pagesave u konstatua se listë-pagesat hartoheshin sipas standardeve të kontabilitetit, ku plotësoheshin pagat me të gjithë elementet dhe shtesa të ndryshme të përfituara deri tek shuma bruto. Po kështu pasqyroheshin llojet e ndalesave, raportet e përkohshëm, lejet e zakonshme e deri tek paga neto. Përmbledhëset janë të kuadruara me listë pagesat dhe me urdhër pagesat respektive, të nënshkruara nga specialisti i pagave, nëpunësi zbatues dhe nëpunësi autorizues.
- Nga verifikimi me zgjedhje i ushtruar në disa nga listë pagesat e muajve janar, maj, dhjetor të vitit 2023 rezultoi se pagat, shtesat dhe ndalesat janë përllogaritur drejt sipas tabelës së pagave. Gjithashtu listë pagesat janë të shoqëruara dhe me listë prezencat përkatëse. Përmbledhëset janë të kuadruara me listë pagesat dhe me urdhër pagesat respektive, të nënshkruara nga punonjësi i financës dhe nëpunësi i autorizuar i bashkisë.
- Për të gjithë periudhën e audituar, janë përllogaritur, ndaluar dhe xhiruar detyrimet për kontributin e sigurimeve shoqërore dhe tatimin mbi të ardhur, si dhe janë bërë sipas kohëzgjatjes orare të punës.

***- Inventari Fizik.***
Në zbatim të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*" i ndryshuar me ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015; *Ligjit nr. 25/2018, datë 10.05.2018, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, pika (1), neni* (15) "*Inventari aktiveve e detyrimeve*"; UMF nr.30, datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*", Kreu (IV) "*Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve, inventarizimi i aktiveve*" pika (81) në njësinë publike vendore Bashkia Roskovec u verifikuan procedurat e ndjekura për kryerjen e inventarizimit fizik të pasurisë të administruara në llogaritë; "*Aktive afat shkurtëra*"; "*Gjendje inventar qarkullues*"; "*Materiale*"; "*Inventar i imët*"; "*Aktive afatgjata jo materiale*" dhe "*Aktive afatgjata materiale*" për vitin 2023. Komisionet e inventarizimit në fillim të procesit kanë në dispozicion listën e aktiveve për tu inventarizuar e hartuar nga nëpunësi zbatues mbi bazën e të dhënave të pasqyruara nga regjistrat kontabël për secilën llogari kontabile të njësisë publike vendore.

Nga auditimi mbi dokumentacionin e vendosur në dispozicion për periudhën raportuese 2023 u konstatua se, për realizimin e procesit të inventarizimit fizik të "*aktiveve afatgjata dhe afatshkurtra*" (materiale e jomateriale) dhe "*inventar qarkullues*" të pasurisë, aseteve dhe vlerave materiale në përdorim të njësisë publike vendore Bashkia Roskovec, Titullari ka nxjerr urdhrin e brendshëm nr. 206, administruar me shkresën nr. 6539, datë 25.10.2023, "*Për inventarizimin e aktiveve të njësisë për vitin 2023*", me komisionet përkatëse. Komisionet do të bëjnë verifikimin e ekzistencës dhe vlerësimit të aktiveve, detyrimeve dhe të kapitaleve të veta të institucionit, Njësistë Administrative Kuman, Krujan dhe Strum, kopështet, shkollat, pallati i kulturës si dhe Qendra Rinore, për vitin 2023.
Janë printuar kartelat me aktivet për secilin punonjës të Bashkia Roskovec, nga Drejtoria Ekonomike të cilat pasi është kryer verifikimi janë nënshkruar nga komisioni dhe punonjësi me përgjejgësi materiale. Nga verifikimi me zgjedhje nuk rezultojnë problematika për kryerjen e procesit të iventarizimit si për Bashkinë ashtu edhe për njësitë e varësisë. Përveç sa përmendet sa më sipër rezultoi se;
Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për kryerjen e procedurave të

inventarizimit për vitin 2023 rezulton se; nga Bashkia Roskovec nëpunësi zbatues i njësisë publike, i caktuar nga titullari i njësisë publike, nuk ka hartuar regjistër kontabël të përditësuar të aktiveve që zotëron apo ka në administrim Bashkia Roskovec dhe njësitë në varësi, i cili në varësi të llojit të përmbajë kërkesat minimale si datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia etj.

- Nuk është kryer verifikim fizik për zërat e bilancit Tokë, truall, pyje, kullota, ndërtime, rrugë, rrjete, vepra ujore dhe mos paraqitje e dokumentuar e vlerave të tyre në Pasqyrat Financiare të Bashkia Roskovec.

Nga auditimi i pasqyrave financiare dhe procedurave të inventarizimit të aktiveve për vitin 2023 në lidhje me zërin e llog. 210 (Toka, troje, terrene) e cila paraqitet në shumën 112,776,000 lekë, në llog. 211 (pyje, kullota, plantacione) e cila paraqitet në shumën 271,319,700 lekë, në llog.213 (rrugë, rrjete, vepra ujore) e cila paraqitet në shumën 1,354,701,781 lekë, rezulton se; Nga Nëpunësi i Autorizuar në cilësinë e titullarit të njësisë publike dhe nga Drejtori Ekonomik në cilësinë e Nëpunësit Zbatues nuk janë marrë masat e duhura për ngritjen e komisioneve përkatës për verifikimin dhe vlerësimin e zërit troje, ndërtesa, pyje e kullota për Bashkia Roskovec dhe njësitë në varësi. Për këto aktive nuk është kryer asnjëherë inventar fizik, për të cilat nuk mund të gjykohet nëse vlera e pasqyruar në kontabilitet, është fizikisht apo jo e disponueshme dhe e përdorshme nga institucioni çka do të thotë se nuk mund të verifikohet dhe vlerësohet dokumentacioni mbështetës i tyre. E njëjta situatë konstatohet edhe në Njësitë Administrative në varësi të Bashkia Roskovec pasi nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezultoi se nuk është kryer inventarizim për zërat e mësipërm të bilancit.

Këto veprime nuk janë në përputhje me Ligjin nr. 25/2018, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", pikat 26-33 në të cilin ndër të tjera citohet: *"Formati i regjistrit të aktiveve hartohet në vartësi të llojit të tyre afatgjatë apo afatshkurtër si dhe grupit përkatës brenda llojit. Kërkesat minimale që duhet të përmbajë regjistri i aktiveve në vartësi të llojit, përfshijnë: datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia";*

Ligjin nr. 25/2018, *"Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare"*, neni 11 dhe nenin 15, me ligjin nr.10296, datë 08/07/2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, neni 9 dhe 12, UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, kreu IV, pika 74, e cila citon se *"Çdo njësi publike duhet të kontrollojë të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dokumentacionit mbështetës."*

*Veprim për të cilin mban përgjegjësi N/A zj. M. B. dhe z. S. Ç. në cilësinë e nëpunësit zbatues.*

***Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:***

1) Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar,
2) Ligjin nr. 25/2018, datë 10.05.2018, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare",
3) Ligjin nr. 68, datë 227.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore",
4) VKM nr. 19, datë 16.01.2019 "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Për rikualifikimin urban dhe zhvillimin e bllokut nr. 2, Qendra e Qytetit Roskovec", i ndryshuar,

5) VKM nr. 433, datë 08.06.2016, "Për transferimin në pronësi të bashkive, të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-Komunave", i ndryshuar,
6) Standardet Kombëtare të Kontabilitetit Publik,
7) UMF nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme".
8) Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar.

***Për veprimet e mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:***
*1) Zj. M. B., me detyrë zv/Kryetare e Bashkisë Roskovec, në cilësinë e nëpunësit autorizues*
*2) Z. S. Ç., me detyrë Drejtor Ekonomik në cilësinë e nëpunësit zbatues*
*3) Z. E. K., me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Rregjistrimit të Pronave*

**2.4 Mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik.**

*1. Programimi i nevojave, përgatitja e regjistrit të prokurimeve*.
Nga auditimi ka rezultuar se, janë hartuar regjistrat e parashikimeve dhe realizimeve për periudhën 01.01.2023 – 31.12.2023. Mbas miratimit në sistem të regjistrit nga APP, me shkresa përcjellëse janë dërguar në Degën e Thesarit, regjistri i parashikimit të prokurimeve për vitet objekt auditimi mbështetur në VKB përkatëse "Mbi miratimin e buxhetit vjetor të Bashkisë Roskovec". Gjithashtu në të gjitha rastet e shtesave dhe pikësimeve është dërguar regjistri përkatës. Në këto regjistra janë pasqyruar shtesat dhe ndryshimet e bëra sipas VKB –ve përkatëse, në përputhje me VKM nr. 285 datë 19.05.2021 "*Regjistri i parashikimeve të procedurave të prokurimit publik*", është bërë brenda afateve të përcaktuara.
Mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur nga Bashkia Roskovec *(regjistrat e parashikimit dhe realizmit)*, për periudhën 01.01.2023 – 31.12.2023, të dhënat mbi procedurat e zhvilluara paraqiten në pasqyrën si më poshtë:
**Për vitin 2023**: Bashkia Roskovec ka zhvilluar gjithsej **17** procedura prokurimi me vlera të larta, me vlerë të fondit limit:207,197,349 lekë Tvsh, vlerë të kontratës**:**139,616,988 lekë Tvsh, diferencë midis tyre prej: **67,580,351** lekë pa Tvsh.
- "E Hapur e thjeshtuar", **9** procedura, me fondin limit në total prej: 26,916,386 lekë pa Tvsh, kontrata të lidhura pa Tvsh në total prej:23,364,409lekë Tvsh, duke kursyer shumën prej**: 3,551,977** lekë pa Tvsh.
- "Tender i Hapur", **3** procedura, me fondin limit në total prej:118,714,848 lekë pa Tvsh, kontrata të lidhura pa Tvsh në total prej: 75,814,579 lekë pa Tvsh, duke kursyer shumën: **42,900,269** lekë pa Tvsh.
- Me negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, 1 procedurë, me fondin limit në total prej**:** 2,108,500 lekë pa Tvsh, kontrata të lidhura pa Tvsh në total prej**:** 2,108,000lekë pa Tvsh, duke kursyer shumën prej**: 500** lekë pa Tvsh.
- Marrëveshje kuadër me një operator të vetëm, **4** procedura, me fondin limit në total prej:59,457,615 lekë pa Tvsh, kontrata të lidhura pa Tvsh në total prej**:**38,330,010lekë Tvsh, duke kursyer shumën prej**:**21,127,605 lekë pa Tvsh.
- "Blerje me vlerë të vogël", **44** procedura, me fondin limit në total prej:20,082,147 lekë pa Tvsh, kontrata të lidhura në total prej:16,611,980 lekë pa Tvsh, duke kursyer shumën prej: **3,470,167** lekë pa Tvsh;

| **Viti 2023** | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **Lloji i procedurës** | **Nr.** | **Fondi limit pa Tvsh** | **Kontrata pa Tvsh** | **Fondi total i kursyer pa Tvsh** | **% që zë fondi i kursyer ndaj fondit limit** |
| *Procedurë e hapur;* | 3 | 118,714,848 | 75,814,579 | 42,900,269 | **36%** |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| *Procedurë e hapur e thjeshtuar;* | 9 | 26,916,386 | 23,364,409 | 3,551,977 | **13%** |
| *Procedurë me negocim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës* | 1 | 2,108,500 | 2,108,000 | 500 | **0.02%** |
| *Marrëveshje kuadër me një operator* | 4 | 59,457,615 | 38,330,010 | 21,127,605 | **36%** |
| *Prokurim me vlerë të vogël.* | 44 | 20,082,147 | 16,611,980 | 3,470,167 | **17%** |
| ***SHUMA*** | **61** | **207,197,349** | **156,228,978** | **71,050,518** | **31%** |

## Pasqyra e investimeve të prokuruara për periudhën 01.01.2023 – 31.12.2023

| N | Objekt i prokuruar | Fondi limit pa TVSH | Operatori fitues | Kontrata me OE fitues | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Nr/ datë | Vlera me Tvsh në lekë |
| 1 | Përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitetet e varfëra dhe të pa favorizuara | 20,332,647 | S. | 6176/13.10.2023 | 21,600,000 |
| 2 | Rikonstruksioni i shkollës “Naun Doko” ambjenteve sportive dhe atyre të jashtme, Marinëz | 19,359,198 | 2Z.K. | 5504/14.09.2023 | 17,739,600 |
| 3 | Ndërhyrje për sigurinë e rezervuarit të Ngjeqarit | 76,728,812 | B. | 5112/30.08.2023 | 51,637,895 |
| 4 | Asfaltimi i rrugëve të brendshme në lagjet e Bashkisë Roskovec | 28,435,140 | E. -A. | 1837/23.03.2023 | 27,856,260 |
| 5 | Blerje materiale për investimet e Ndërmarrjes së Shërbimeve të Mirmbajtjes | 11,456,219 | G.1 | 2030/28.03.2023 | 13,463,952 |
| 6 | Blerje e një mjeti transporti për Administrartën e Bashkisë | 3,860,615 | C. | 1594/07.03.2024 | 3,900,000 |
| 7 | Pajisje mobileri për shkollat e arsimit bazë (Shkolla 9-Vjeçare “5 Dëshmorët” Suk 1)” | 2,602,777 | E. | 6688/26.10.2023 | 2,068,200 |
| 8. | Riparim i pjesshëm i shkollave nën administrimin e Bashkisë Roskovec | 5,265,425 | 2Z. K. | 5079/30.08.2023 | 5,837,520 |
| 9. | Ndërtim çatie shkolla Alush Grepcka | 4,253,220 | Z. | 47466/03.08.2023 | 4,388,242 |
| 10 | Rikonstruksion i shkarjes në rrugën Lamaj, fshati Mbrez | 4 166,598 | S. | 4746/03.08.2023 | 4,388,242 |
| 11 | Riparime të pjesshme të godinës së vjetër të Bashkisë Roskovec. | 2,449,596 | S. | 7002/06.11.2023 | 2,520,000 |
| | **SHUMA** | **178,910,247** | | | **155,596,029** |

## Pasqyra prokurimit të audituara për periudhën 01.01.2023 – 31.12.2023

| N | Objekt i prokuruar | Fondi limit pa TVSH | Operatori fitues | Kontrata me OE fitues | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Nr/ datë | Vlera me Tvsh në lekë |
| 1 | Përmirësimi i banesave egzistuese për komunitete të varfëra dhe të pafavorizuara | 20,332,647 | S. | 6176/13.10.2023 | 21,600,000 |
| 2 | Rikonstruksioni i shkollës “Naun Doko” ambjenteve sportive dhe atyre të jashtëme, Marinëz | 19,359,198 | 2Z. K. | 5504/14.09.2023 | 17,739,600 |
| 3 | Ndërhyrje për sigurinë e rezervuarit të Ngjeqarit | 76,728,812 | B. | 5112/30.08.2023 | 51,637,895 |
| 4 | Asfaltimi i rrugëve të brendëshme në lagjet e bashkisë Roskovec | 28,435,140 | E.-A. | 1837/23.03.2023 | 27,856,260 |
| 5 | Blerje materiale për investimet e Ndërmarrjes së Shërbimeve të Mirëmbajtjesë | 11,456,219 | G.1 | 2030/28.03.2023 | 13,463,952 |
| | **SHUMA** | **156,312,016** | | **31,992,088** | **155,399,911** |

**1.** Procedura e prokurimit me objekt: **“Blerje materiale për investimet e Ndërmarrjes së Shërbimeve të Mirëmbajtjes”, Bashkia Roskovec,** me nënobjekte si më poshtë:

*1. Blerje materiale për “ Rikonstruksioni i fushës së futbollit fshati Jagodin”.*
*2. Blerje materiale për “Rikonstruksion i fushës së futbollit fshati Suk”.*
*3. Blerje materiale për “Rikonstruksionin i fushës së futbollit fshati Kuman”.*
*4. Blerje materiale për “Rikonstruksionin i fushës së futbollit fshati Vlosh”.*
*5. Blerje materiale për “Ndërtim KUZ lagjia Lapenjt, L=410ml, Roskovec”.*
*6. Blerje materiale për“Ndërtim KUZ pararel rrugës nacionale, Kuman”.*
*7. Blerje materiale për “Zgjerim i rrugës së varrezave lagjia Kurtaj, fshati Ngjeqar”.*
*8. Blerje materiale për “Riparimin i shkarjes në rrugën “Ramiz Dalipi”, fshati Luar”.*

*9. Blerje materiale për "Taracim+sheshim dhe ndërtim muri betoni në varrezat e lagjes "Kashtë e Bardhë".*
*10. Blerje materiale për "Sistemim, zgjerim trotuari Suk1"/*
*11. "Blerje materiale për"Sistemim ambjente brënda pallateve (kopshtinr.1)".*
*12. Blerje materiale për "Sistemim ambjente brënda pallateve (Granit)".*

| **a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Blerje materiale për investimet e Ndërmarrjes së Shërbimeve të Mirmbajtjesë", *Bashkia Roskovec* viti 2023. REF-58534-02-09-2023** | | |
|---|---|---|
| **1. Urdhër Prokurimi** Nr. 87 e nr. 1389 prot., datë 05.04.2023<br>**4. Lloji i Procedurës së Prokurimit:**"E Hapur" | **2. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit** Nr. 87, datë 05.04.2023<br>1. S.P.(Ing)<br>2. S.Ç. (Arkitekt)<br>3. Z.Sh.((Ekonomist) | **3. Komisioni Vlerësimit Ofertave**-Urdhër nr. 937 prot., datë 04.05.2023<br>1. M.L.(Kryetar)-Jurist<br>2. E.T. (Ekonomist)<br>3. Z.C. (Ekonomist) |
| **5. Fondi Limit 11,456,219** lekë | **6. Oferta fituese**: OE "G.1" Shpk vlera e ofertës 11,219,960 lekë | **7. Diferenca me fondin limit** 236,259 lekë |
| **8. Data e hapjes së ofertave:** 04.05.2023 | **9. Burimi Financimit:** Buxheti i Shtetit (referuar VKM nr. 493 datë 21.07.2022) | **10. Operatorët Ekonomikë** 1. OE "G.1" Shpk |
| **11. Ankimime AK: Nuk KA** | **12. Përgjigje ankesës nga AK,** | **13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP.** |
| **b. Kontrata nr. 1389/4 prot., prev 01.06.2023** | | |
| **14. Lidhja e kontratës 01.06.2023** | **15. Vlera e kontratës** | **208,606,804** |

**Afatet e lëvrimit:** Lëvrimi i mallit do të bëhet sipas nevojave dhe kërkesave të Autoritetit kontraktor nga data e nënshkrimit të kontratës, Brenda 12 (dymbëdhjetë) muaj, sipas Marrëveshjes Kuadër.
- Projekti preventive është hartuar nga Drejtoria e Zhvillimit dhe Planifikimit të Territorrit të Bashkisë Roskovec (Ing. E. H., Ing. E. H., Ing. E. K., E. H.) dhe është miratuar nga Titullari i Bashkisë Roskovec, Znj. M.B.

Me urdhërin nr. 38 prot., datë 05.01.2023 "Për ngritjen e komisionit të llogaritjes së fondit limit dhe specifikimeve teknike (KLLFLST)" me përbërje:
1. S. K., Specialiste për Strehim Social dhe Çështjet Ligjore.
2. E. H., Drejtor në Ndërmarrjen e Shërbimeve dhe Mirëmbajtjes.
3. A. D., Përgjegjës në Sektorin e Zbatueshmërisë së Investimeve.

Me procesverbalin nr. 121/2 prot., datë 30.01.2023 nga KLLFLS, është formuluar/nënshkruar relacioni drejtuar Titullarit të Autoritetit Kontraktor.
Në dosje nuk gjenden; "Formularët e deklarimit të konfliktit të interest" të nënshkruar nga KLLFLST me nr. 121/3 prot., datë 30.01.2023.

**Hartimi i dokumenteve të tenderit:**
Me urdhërin e prokurimit nr. 07, nr. 707 prot., datë 03.02.2023 është ngarkuar Njësia e Prokurimit me përbërje:
1. S.P. Ing. (Personi përgjegjës)
2. S. Ç. Ekonomist
3. Z. Sh. Juriste.

Në dosje gjenden; "Formularët e deklarimit të konfliktit të interest" të nënshkruar nga Njësia e Prokurimit me nr. 707/2 prot., datë 03.02.2023.
Njësia e Prokurimit me nr. 707/3 prot., datë 10.02.2023 ka hartuar Procesverbali për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim.
Njoftimi për zhvillimin e procedurës së prokurimit APP me nr. 707/3 prot., datë 10.02.2023, botuar në Buletinin nr. 17 datë 20 shkurt 2023, faqe 27/510.

Në lidhje me financimin e kësaj kontratë për procedurën e prokurimit blerje materiale për investimet e Ndërmarrjes së Shërbimeve të Mirëmbajtjes, është konstatuar që është zhvilluar procedura e prokurimit dhe është lidhur kontrata edhe pse fondi nuk është në dispozicion të AK Bashkia Roskovec. Konkretisht, në DT është kërkuar: Në seksionin 2.10 pika 1, të DT, AK ka përcaktuar: "Fondi limit/vlera e pritshme ekontratës:**11,456,219** *(njëmbëdhjetë milionë e katërqindë e pesëdhjetë e gjashtë mijë e dyqindë e nëntëmbëdhjetë)* **lekë pa Tvsh;**
Financimi i ndar si më poshtë:

- Për vitin 2023 – nga buxheti i Bashkisë Roskovec = 7,483,187 lekë pa Tvsh.
- Për vitin 2024 – nga buxheti i Bashkisë Roskovec = 3,976,032 lekë pa Tvsh.

Në lidhje me financimin e kësaj kontratë, nga AK Bashkia Roskovec nuk janë zbatuar parashikimet pikës 1 të nenit 21 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" ku citohet: *"Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirë planifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi. dh*e pikës 2 të nenit 85,të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar ku përcaktohet: *"Lidhja e kontratës do të bëhet në përputhje me afatet e përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, dhe vetëm pasi fondi do të jetë në dispozicion (në llogarinë përkatëse) të autoritetit/entit kontraktor".*
Zhvillimi i procedurës së prokurimit dhe lidhja e kontratës pa pasur në dispozicion fondin e nevojshëm për realizimin e punimeve, janë veprime të cilat direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE në procedurë e ngarkojnë me përgjegjësi Titullari i Autoritetit Kontraktor znj. M. B. dhe znj. S. P., z. S. Ç. dhe znj. Z. Sh. në cilësinë e anëtarëve të Njësisë së Prokurimeve.

**- Zhvillimi i procedurës.**
Me urdhërin e veçantë nr. 937 prot., datë 13.02.2023 "Për ngritjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave" me përbërje:
1. M. L., Kryetar
2. E.T., Anëtar.
3. Z. Ç., Anëtar.
Në dosje gjenden; "Formularët e deklarimit të konfliktit të interest" të nënshkruar nga Komisionin i Vlerësimit të Ofertave me nr. 1429/1 prot., datë 06.03.2023.
Nga shqyrtimi i dokumentacionit të OE/BOE pjesëmarrës, paraqitur në SPE për këtë procedurë KVO është hartuar procesverbalin me nr. 1 e nr. 1348 prot., datë 01.03.2023, ku konstatohet që kanë marrë pjesë:
**1.** OE "G.1" Shpk (me Nipt: L.....U) vlerë ekonomike të ofertës **11,219,960** *(njëmbëdhjetë milion e dyqind e nëntëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë)* **lekë pa Tvsh.**
KVO me procecverbali nr. 3 e nr. 1525 prot., datë 08.03.2023, klasifikimi i ofertave ka kërkuar më datë 03.03.2023 dokumentacionin e OE "G.1" Shpk, të paraqitura më datë 07.03.2023 dhe është konstatuar që rezultojnë të rregullta sipas deklarimeve.
Me nr. 1558 prot., datë 09.03.2023, nga KVO është publikuar "Formulari i njoftimit të fituesit (paraprak)", botuar në Buletinin nr. 24 datë 13 Mars 2023 në faqet 215 – 216/793.
Me nr. 707 prot., datë 13.03.2023, nga KVO është publikuar "Formulari i njoftimit të fituesit (paraprak)", botuar në Buletinin nr. 26 datë 20 Mars 2023 në faqet 187 – 188/448.
Me nr. 1588 prot., datë 09.03.2023, nga KVO është publikuar "Formulari i njoftimit të fituesit 1", botuar në Buletinin nr. 24 datë 13 Mars 2023 në faqet 289-290/728.
Me nr. 1700 prot., datë 16.03.2023, nga KVO është publikuar "Formulari i njoftimit të fituesit 1", botuar në Buletinin nr. 28, datë 27 Mars 2023 në faqet 289-290/728.
Me nr. 1762 prot., datë 20.03.2023, nga KVO është formuluar/nënshkruar "Raporti përmbledhës" miratuar nga Titullari i AK me vendimin nr. 1762/1 prot., datë 20.03.2023.
Marrëveshja kuadër ku përcaktohen të gjitha kushtet me nr. 2030 prot., datë 28.03.2023, është lidhur mes Autoritetit Kontraktor, Bashkia Roskovec, të përfaqësuar nga Titullari i Autoriteti Kontraktor znj. M. B. me OE "G.1" Shpk, të përfaqësuar nga administratori z. I. D. me objekt: "Blerje materiale për investimet e Ndërmarrjes së Shërbimeve të Mirëmbajtjes", Bashkia Roskovec, në përputhje me marrëveshjen ka përcaktuar kushtet përfshirë çmimet për njësi dhe rregullat për dërgimin e mallrave/shërbimeve/punëve për objektin e marrëveshjes.

Nga auditimi i dokumentacionit **OE "G.1" Shpk**, rezulton se nuk ka plotësuar të gjitha kriteret e DT duke u kualifikuar dhe shpallur fitues pa të drejtë nga ana e KVO-së dhe Titullarit të AK dhe konkretisht:
**OE "G.1" Shpk:** referuar Web-in zyrtar të "Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit", ka realizuar punime në territorin e bashkive: **Shijak; Roskovec; Lushnje, Patos, Rrogozhinë, Divjakë, Fier e Berat.**
Ka paraqitur vërtetimin e datës 14.11.2020, nga Bashkia Patos ku vërtetohet që ka shlyer detyrimet për taksat/tarifat vendore për vitin 2022.
Nuk ka paraqitur vërtetimin për taksat dhe tarifat vendore në territorin e bashkive **Shijak; Roskovec; Lushnje, Rrogozhinë, Divjakë, Fier e Berat,** sa më sipërështë në kundërshtim me paragrafin e fundit (3) të pikës 2.2 **Kapaciteti ekonomiko financiar në DT ku citohet:**
*"Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga pushteti vendor për vitin 2022 në zbatim të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", (i ndryshuar). (Në rastet e BOE, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB).*
***Shënim:*** *Për të përmbushur këtë kriter në fazën e ofertimit është e mjaftueshme paraqitja e deklaratës, sipas shtojcës nr. 8, ndërsa OE i klasifikuar i pari, në përputhje me nenin 26.6 të VKM nr. 285, datë 19.5.2021, duhet të dorëzojë dokumentacionin si më poshtë:*
*Vërtetimi për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore përfshirë edhe detyrimet vendore për vitin 2022 të lëshuara nga ana e kërkesat e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për systemin e taksave vendore" i ndryshuar.*
Referuar Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit më datë 06.03.2023 të administratorit të OE "G.1" Shpk, ka në pronësi:
**Kamion vetëshkarkues** me kapacitet mbajtës dhe transportues mbi 12 ton – copë 1.
**Tërheqës Man** Targa e mjetit A....X; Leje Qarkullimi F......2; Shasi Ë......2.
**Gjysëmrimorkio SCHMITZ** Targat e mjetit A.......6, Leje Qarkullimi F.....2; Shasi W....9.
**Autobetoniere** copë 1 Tip Merlo Modeli DBM3500XS nr. 3....7 Shasisë së mjetit; Blerë me faturë tatimore më datë 26.01.2021 të OE "B. B" Shpk është autobetoniere kantieri dhe i mungojnë dokumentacioni i kërkuar në DT për mjetet me rrota: *a) dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit b) leja e qarkullimit; c) çertifikatën e kontrollit teknik; d) siguracionin e mjetit (i vlefshëm); e) certifikatën për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme).*
Për sa trajtuar më sipër OE "G.1" Shpk, nuk plotëson të gjitha kriteret e veçanta të vendosura në DT dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO por duhet të ishte skualifikuar. KVO dhe Titullari i Autoritetit Kontraktor nuk duhet të shpallte fitues OE "G.1" Shpk, por anullimin e procedures së prokurimit publik, për arsye se asnjë nga OE nuk plotëson të gjitha kriteret e vendosura në DT.
Mos disponimi, apo mosparaqitja e dokumenteve, përbën shkak të ligjshëm për skualifikimin e OE "G.1" Shpk, dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO dhe nuk duhet të ishte shpallur fitues. Gjithashtu nga titullari nuk duhet të ishte miratuar shpallja fitues e OE "G.1" Shpk. Sa më sipër KVO nuk ka vepruar në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, "Për prokurimin publik" i ndryshuar, neni 3, "Parimet të përgjithshme", neni 98 "Anulimi i një procedure prokurimi" si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 82 "Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave" pika 2, neni 67 "Klasifikimi i ofertave" pika 2, neni 83 "Njoftimi i fituesit".
Mos anulimi i procedurës dhe shpallja fitues e OE "G.1" Shpk, pasi nuk është në kushtet e plotësimit të gjitha kritereve të DT, veprime në kundërshtim të dispozitave të LPP, ku KVO duhet të anulonte procedurën dhe zhvillonte procedurë tjetër me kushte më favorizuese, sjellin si efekt përdorimin pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomicitet të fondit për vlerën **11,219,960 lekë pa Tvsh.**

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:** znj. M. B. Kryetare e Bashkisë Roskovec në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor, znj. S.P., z. S.Ç. e znj. Z. Sh.në cilësinë e anëtarëve të Njësisë së Prokurimit dhe z. M. L., znj. E.T. e z. Z. Ç. në cilësinë e anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

**2.** Procedura e prokurimit me objekt: **"Asfaltimi i rrugëve të brendshme në lagjet e bashkisë Roskovec",** Bashkia Roskovec, me nënobjekte si më poshtë:
1. "Rikonstruksion i rrugës"Argjinaturës", Agacaj, 440ml, b=4m asfalt";
2. "Rikonstruksion i rrugës "Rukallarëve", fshati Suk 2,200 ml, b=4m asfalt";
3. "Rehabilitim i ish-bllokut të SMT-së, Roskovec, Rruga nr . 9 (Riza Agaçi,140 ml)";
4."Rehabilitim i ish-bllokut të SMT-së , Roskovec, Rruga (Arqile Kaceli,140 ml)"
5. "Rikonstruksion i rrugicave "Dyli Ç......" L=51ml, b=4m dhe "Refat Ç......", L= 44ml, b= 4m, Roskovec";
6. "Rikonstruksion i rrugicave së Cjepëve, fshati Suk 1 ,485 ml , b=4 m asfalt , bankine-2x0.5m)"'
7. "Rikonstruksion i rrugës "Spahiu" fshati Strum ,L=300ml b=4m asfalt";
8. "Rikonstruksion i rrugës "Hazizajve" fshati Strum,270ml, b=4m asfalt";
9. "Rikonstruksion i rrugës "Lagja Dortaj" fshati Vlosh, 840ml";
10."Rikonstruksion i rrugës "Buzallarët",550ml+rrugës "Doksaneve",150ml fshati Kurjan";
11. "Rruga "Bakallarët"L=250ml ( b=3.5 m + 0.5m bankine)".

| **a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimitme objekt: "**Asfaltimii rrugëve të brenshme në lagjet e Bashkisë Roskovec" BashkiaRoskovec. REF-**58449-02-08-2023** | | |
|---|---|---|
| **1. Urdhër Prokurimi**<br>Nr. 05, nr. 615 prot., datë 31.01.2023<br>2. Lloji i Procedurës –<br>"E hapur" | **3. Urdhëri** nr. 121 prot., datë 10.01.2023 KLLFLST<br>1. A. A.<br>2. E. H.<br>3. A. D.<br>3/1. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit<br>Urdhër nr. 05, datë 31.08.2023 Njësia e Prokurimit<br>1. D. H., Jurist (Personi përgjegjës)<br>2. S. P.ing. (Personi përgjegjës)<br>3. S. Ç. Ekonomist<br>4. E. K.. Ing.<br>5. E. H. Ing. | **4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave**<br>Urdhër nr. 883 prot., datë 10.02.2023<br>1. M. L. Kryetar<br>2. E. T.<br>3. Z. C. |
| **5. Fondi Limit (pa Tvsh)**<br>28,435,140lekë. | **6. Oferta fituese** (pa Tvsh) OE "E.A." Shpk **23,213,550** lekë | **7. Diferenca me fondin limit** 5,221,590 (pa Tvsh) |
| **8. Data e hapjes së tenderit**<br>Datë 01.03.2023 | **9. Burimi Financimit**<br>Buxheti i shtetit + Të ardhurat e bashkisë | **10. Operatoret Ekonomike**<br>a) Pjesëmarrës në tender 2 OE/BOE<br>b) Skualifikuar 0 OE/BOE,<br>c) Kualifikuar 2 OE/BOE |
| **11. Ankimime për DT**; APP | **12. Përgjigje Ankesës** | **13. Përgjigje Ankesës** |
| **b. Kontrata nr. 1837 prot., datë 23.03.2023** | | |
| **Datë 23.03.2023** | **Vlera e kontratës** | **27,865,260 lekë me Tvsh** |

**Projekt Preventivi** është hartuar nga Drejtoria e Zhvillimit dhe Planifikimit të Territorrit të Bashkisë Roskovec (Ing. E. H., Ing. E.H., Ing. E. K., E. H.) dhe është miratuar nga Titullari i Bashkisë Roskovec, znj. M. B.
Me urdhrin nr. 121 prot., datë 10.01.2023 "Për ngritjen e komisionit të llogaritjes së fondit limit dhe specifikimeve teknike (KLLFLST)" me përbërje:
1. A. A., Specialiste për Kontabilitetin.
2. E. H., Drejtor në Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimin e Territorit.
3.A. D., Përgjegjës në Sektorin e Zbatueshmërisë së Investimeve.
Me nr. 121/1 prot., datë 25.01.2023 është marrë në dorëzim projektpreventivi i objektit të sipërcituara nga KLLFLS.
Me procesverbalin nr. 121/2 prot., datë 30.01.2023 nga KLLFLS, është formuluar/nënshkruar relacioni drejtuar Titullarit të Autoritetit Kontraktor.

Në dosje nuk gjenden; “Formularët e deklarimit të konfliktit të interest” të nënshkruar nga KLLFLST me nr. 121/3 prot., datë 30.01.2023.

**Hartimi i dokumenteve të tenderit:**

Me urdhrin e prokurimit nr. 05, nr. 615 prot., datë 31.01.2023 është ngarkuar Njësia e Prokurimit me përbërje:

1. D....H...., Jurist (Personi përgjegjës)
2. S.....P...Ing. (Personi përgjegjës)
3. S.......Ç..... Ekonomist
4. E.... K......, Inxhinier
5. E......H..... Inxhinier

Në dosje nuk gjenden; “Formularët e deklarimit të konfliktit të interest” të nënshkruar nga Njësia e Prokurimit me nr. 615/2 prot., datë 08.02.2023.

Njësia e Prokurimit me nr. 615/1 prot., datë 08.02.2023 ka hartuar Procesverbali për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim.

Njoftimi për zhvillimin e procedurës së prokurimit APP me nr. 615/3 prot., datë 08.02.2023, botuar në Buletinin nr. 60 datë 03 korrik 2023, faqe 25/603.

**Ndryshime në DT:** Me vendimin nr. 30 e nr. 951 prot., datë 14.02.2023 është pezulluar e prokurimit në zbatim të sygjerimeve nga asistenca e APP.

Në dosje gjendet procesverbali me nr. 951/1 prot., datë 14.02.2023 i NjP për modifikimin e kritereve të kualifikimit për procedurës së prokurimit.

Njësia e Prokurimit me nr. 951/2 prot., datë 14.02.2023 ka hartuar vendimin për modifikimin e kritereve të kualifikimit për procedurës të sipërcituar.

Me nr. 951/33 prot., datë 14.02.2023, është hartuar Shtojca e DT dhe me nr. 951/4 prot., datë 14.02.2023 është formuluar njoftimi për ndryshimin e DT.

Në lidhje me financimin e kësaj kontratë për procedurën e prokurimit Asfaltimi i rrugëve të brendshme në lagjet e bashkisë Roskovec, është konstatuar që është zhvilluar procedura e prokurimit dhe është lidhur kontrata edhe pse fondi nuk është në dispozicion të AK Bashkia Roskovec. Konkretisht, **n**ë DT është kërkuar:Në seksionin 2.10 pika 1, të DT, AK ka përcaktuar: “Fondi limit/vlera e pritshme ekontratës:**28,435,140** *(njëzetë e tetë milionë e katërqindë e tridhjetë e pesë mijë e njëqind e dyzetë)* **lekë pa Tvsh;**

Financimi i ndar si më poshtë:

- Për vitin 2023 – nga buxheti i Bashkisë Roskovec = 7 083 333 lekë pa Tvsh.
- Për vitin 2024 – nga buxheti i Bashkisë Roskovec = 21 351 807 lekë pa Tvsh.

Në lidhje me financimin e kësaj kontratë, nga AK Bashkia Roskovec nuk janë zbatuar parashikimet e pikës 1 të nenit 21 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” ku citohet: *“Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirë planifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi. dh*e pikës 2 të nenit 85,të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar ku përcaktohet: *“Lidhja e kontratës do të bëhet në përputhje me afatet e përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, dhe vetëm pasi fondi do të jetë në dispozicion (në llogarinë përkatëse) të autoritetit/entit kontraktor”.*

Zhvillimi i procedurës së prokurimit dhe lidhja e kontratës pa pasur në dispozicion fondin e nevojshëm për realizimin e punimeve, janë veprime të cilat direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE/BOE në procedurë e ngarkojnë me përgjegjësi Titullari i Autoritetit Kontraktor znj. M. B. dhe znj. D. H., znj. S. P., z. S. Ç., z. E. K. dhe z. E. H. në cilësinë e anëtarëve të Njësisë së Prokurimeve.

**- Zhvillimi i procedurës.**

Me urdhërin e veçantë nr. 883 prot., datë 10.02.2023 “Për ngritjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave” me përbërje:

1.M. L., Kryetar
2. E. T., Anëtar.
3. Z. C., Anëtar.
Në dosje gjenden; "Formularët e deklarimit të konfliktit të interesit" të nënshkruar nga Komisionin i Vlerësimit të Ofertave me nr. 1348/1/1 prot., datë 01.03.2023.
Nga shqyrtimi i dokumentacionit të OE/BOE pjesëmarrës, paraqitur në SPE për këtë procedurë KVO është hartuar procesverbalin me nr. 1 e nr. 1348 prot., datë 01.03.2023, ku konstatohet që kanë marrë pjesë:
**1. OE "L. K." Shpk**, (me Nipt: K...H) vlerë ekonomike të ofertës **23,213,550** *(njëzetë e tre milion e dyqind e trembëdhjetë mijë e peseqind e pesëdhjetë)* **lekë pa Tvsh**
**2. OE "B." Shpk**, (me Nipt: J.....B) vlerë ekonomike të ofertës **27,853,040** *(njëzetë e shtatë milion e tetëqind e pesëdhjetë e tre mijë e dyzetë)* **lekë pa Tvsh.**
KVO me procecverbali nr. 2 e nr. 1415 prot., datë 03.03.2023, (Për klasifikimi e ofertave)ka shqyrtuar i dokumentacionin e OE/BOE pjesëmarrës, paraqitur në SPE për këtë procedure dhe ka rezultuar që:
**Nuk ka OE/BOE të skualifikuar.**
KVO me procecverbali nr. 3 e nr. 1525 prot., datë 08.03.2023, klasifikimi i ofertave ka kërkuar më datë 03.03.2023 dokumentacionin e OE "L. K." Shpk të paraqitura më datë 07.03.2023 dhe është konstatuar që rezultojnë të rregullta sipas deklarimeve.
Me nr. 1558 prot., datë 09.03.2023, nga KVO është publikuar "Formulari i njoftimit të fituesit (paraprak)", botuar në Buletinin nr. 24 datë 13 Mars 2023 në faqet 215 – 216/793.
Me nr. 1700 prot., datë 16.03.2023, nga KVO është publikuar "Formulari i njoftimit të fituesit 1", botuar në Buletinin nr.28 datë 27 Mars 2023 në faqet 289-290/728.
Me nr. 1762 prot., datë 20.03.2023, nga KVO është formuluar/nënshkruar "Raporti përmbledhës" miratuar nga Titullari i AK me vendimin nr. 1762/1 prot., datë 20.03.2023.
Marrëveshja kuadër ku përcaktohen të gjitha kushtet me nr. 1837 prot., datë 23.03.2023, është lidhur mes Autoritetit Kontraktor, Bashkia Roskovec, të përfaqësuar nga Titullari i Autoriteti Kontraktor znj. M. B. me OE "L.K." Shpk, të përfaqësuar nga administratori znj D. M. me objekt: "Asfaltimi i rrugëve të brendshme në lagjet e Bashkisë Roskovec", Bashkia Roskovec, në përputhje me projekt-zbatimin e objektit, specifikimet teknike dhe çdo dokument të tenderit, si pjesë integrale e kontratës. Vlera e kontratës është **23,213,550 (***katërmbëdhjetë milion e shtatëqindë e tetëdhjetë e tre mije)* **lekë pa Tvsh** (27,865,260 lekë me Tvsh).
**Me nr. 1916 prot., datë 24.03.2023, nga Titullari i AK i është dërguar OE** "L. K." Shpk ftesa për ofertë për nënobjektet e "Asfaltimi i rrugëve të brendëshme në lagjet e Bashkisë Roskovec", në zbatim të marrëveshjes kuadër nr. 1837 prot, datë 23.03.2023 është kërkuar konkretisht:
1. Me nr. 1916/1 prot., datë 24.03.2023, nga OE "L. K." Shpk, ofertë ekonomike për kryerjen e punimeve me objekt: "Rikonstruksion i rrugës "Buzallarët", 550ml+rrugës "Doksaneve",150ml fshati Kurjan";
2.Me nr. 1916/2 prot., datë 24.03.2023, nga OE "L. K." Shpk, ofertë ekonomike për kryerjen e punimeve me objekt: "Rikonstruksion i rrugës Argjinaturës", Agacaj, 440ml, b=4m asfalt";
3. Me nr. 1916/3 prot., datë 24.03.2023, nga OE "L. K." Shpk, ofertë ekonomike për kryerjen e punimeve me objekt: "Rikonstruksion i rrugës "Rukallarëve", fshati Suk 2,200 ml, b=4m asfalt";
4. Me nr. 1916/4 prot., datë 24.03.2023, nga OE "L. K." Shpk, ofertë ekonomike për kryerjen e punimeve me objekt: "Rehabilitim i ish-bllokut të SMT-së, Roskovec, Rruga nr. 9 (Riza Agaçi, 140 ml)";
5. Me nr. 1916/5 prot., datë 24.03.2023, nga OE "L. K." Shpk, ofertë ekonomike për kryerjen e punimeve me objekt: "Rehabilitim i ish-bllokut të SMT-së, Roskovec, Rruga (Arqile Kaceli,140 ml)";

6. Me nr. 1916/6 prot., datë 24.03.2023, nga OE "L. K." Shpk, ofertë ekonomike për kryerjen e punimeve me objekt: "Rikonstruksion i rrugicave "Dyli Ç......" L=51ml, b=4m dhe "Refat Ç......", L= 44ml, b= 4m, Roskovec";
7. Me nr. 1916/7 prot., datë 24.03.2023, nga OE "L. K." Shpk, ofertë ekonomike për kryerjen e punimeve me objekt: "Rikonstruksion i rrugicave së Cjepëve, fshati Suk 1 ,485 ml , b=4 m asfalt, bankine- 2x0.5m)";
8. Me nr. 1916/8 prot., datë 24.03.2023, nga OE "L. K." Shpk, ofertë ekonomike për kryerjen e punimeve me objekt: "Rikonstruksion i rrugës "Hazizajve" fshati Strum,270ml, b=4m asfalt";
9. Me nr. 1916/9 prot., datë 24.03.2023, nga OE "L. K." Shpk, ofertë ekonomike për kryerjen e punimeve me objekt: "Rikonstruksion i rrugës "Lagja Dortaj" fshati Vlosh, 840ml";
10. Me nr. 1916/10 prot., datë 24.03.2023, nga OE "L. K." Shpk, ofertë ekonomike për kryerjen e punimeve me objekt: "Rikonstruksion i rrugës "Spahiu" fshati Strum, L=300ml b=4m asfalt";
11. Me nr. 1916/11 prot., datë 24.03.2023, nga OE "L. K." Shpk, ofertë ekonomike për kryerjen e punimeve me objekt: "Rruga "Bakallarët" L=250ml (b=3.5 m + 0.5m bankine)".
Bashkangjitur ofertave gjenden; Plani i vendosjes, preventivi i punimeve, formulari i ofertës, grafiku i punimeve për secilin nga objektet e sipërcituara.
Në dosjen e prokurimit gjendet ftesat për ofertë dërguara nga OE "L. K." Shpk:
1. Me nr. 2035 prot., datë 28.03.2023 për objektin: "Rikonstruksion i rrugës"Argjinaturës", Agacaj, 440ml, b=4m asfalt", me vlerë ekonomike të ofertës **3.044,800lekë pa Tvsh**;
2. Me nr. 2036 prot., datë 28.03.2023 për objektin: "Rikonstruksion i rrugës "Rukallarëve", fshati Suk 2,200 ml, b=4m asfalt", me vlerë ekonomike të ofertës **1,384,000 lekë pa Tvsh**;
3. Me nr. 2037 prot., datë 28.03.2023 për objektin: "Rehabilitim i ish-bllokut të SMT-së, Roskovec, Rruga nr . 9 (Riza Agaçi,140 ml)", me vlerë ekonomike të ofertës **968,800 lekë pa Tvsh**;
4. Me nr. 2040 prot., datë 28.03.2023 për objektin: "Rehabilitim i ish-bllokut të SMT-së , Roskovec, Rruga (Arqile Kaceli,140 ml)", me vlerë ekonomike të ofertës **553,600 lekë pa Tvsh**
5. Me nr. 2041 prot., datë 28.03.2023 për objektin: "Rikonstruksion i rrugicave "Dyli Ç......" L=51ml, b=4m dhe "Refat Ç......", L= 44ml, b= 4m, Roskovec", me vlerë ekonomike të ofertës **657,400 lekë pa Tvsh**;
6. Me nr. 2042 prot., datë 28.03.2023 për objektin: "Rikonstruksion i rrugicave së Cjepëve, fshati Suk 1 ,485 ml , b=4 m asfalt , bankine- 2x0.5m)", me vlerë ekonomike të ofertës **3,356,200 lekë pa Tvsh**
7. Me nr. 2043 prot., datë 28.03.2023 për objektin: "Rikonstruksion i rrugës "Spahiu" fshati Strum ,L=300ml b=4m asfalt", me vlerë ekonomike të ofertës **2,076,000 lekë pa Tvsh**;
8. Me nr. 2044 prot., datë 28.03.2023 për objektin: "Rikonstruksion i rrugës "Hazizajve" fshati Strum,270ml, b=4m asfalt", me vlerë ekonomike të ofertës **1,868,400 lekë pa Tvsh**;
9. Me nr. 2045 prot., datë 28.03.2023 për objektin: "Rikonstruksion i rrugës "Lagja Dortaj" fshati Vlosh, 840ml", me vlerë ekonomike të ofertës **4,170,000 lekë pa Tvsh**;
10. Me nr. 2047 prot., datë 28.03.2023 për objektin: "Rikonstruksion i rrugës "Buzallarët",550ml+rrugës "Doksaneve",150ml fshati Kurjan", me vlerë ekonomike të ofertës **3,839,500 lekë pa Tvsh**;
11. Me nr. 2048 prot., datë 28.03.2023 për objektin: "Rruga "Bakallarët"L=250ml ( b=3.5 m + 0.5m bankine)", me vlerë ekonomike të ofertës **1,294,850**
**Në zbatim të Marrëveshjes Kuadër nr.** 1837 prot., datë 23.03.2023, është lidhur mes Autoritetit Kontraktor, Bashkia Roskovec, të përfaqësuar nga Titullari i Autoriteti Kontraktor znj. M. B. me OE "L. K." Shpk, të përfaqësuar nga administratori znj. D. M. me objekt: "Asfaltimi i rrugëve të brendshme në lagjet e Bashkisë Roskovec", Bashkia Roskovec, janë lidhur kontratat me OE "L. K." Shpk.

**1. Kontrata me nr. 2695 prot**., datë 24.04.2023 me objekt: "Rikonstruksion i rrugicave së Cjepëve, fshati Suk 1 ,485 ml , b=4 m asfalt , bankine- 2x0.5m)", bashkangjitur "Formulari i sigurimit të kontratës" lëshuar më datë 04.04.2023 nga OE "A." Sha, për nënobjektin e sipërcituar.
**2. Kontrata me nr. 2696 prot**., datë 24.04.2023 me objekt:"Rikonstruksion i rrugës "Buzallarët", 550ml+rrugës "Doksaneve",150ml fshati Kurjan", bashkangjitur "Formulari i sigurimit të kontratës" lëshuar më datë 04.04.2023 nga OE "A." Sha, për nënobjektin e sipërcituar.
**3. Kontrata me nr. 2697 prot**., datë 24.04.2023 me objekt: "Rikonstruksion i rrugës "Argjinaturës", Agacaj, 440ml, b=4m asfalt", bashkangjitur "Formulari i sigurimit të kontratës" lëshuar më datë 04.04.2023 nga OE "A." Sha, për nënobjektin e sipërcituar.
**4.** Kontrata me nr. 2698 prot., datë 24.04.2023 me objekt: "Rehabilitim i ish-bllokut të SMT-së , Roskovec, Rruga (Arqile Kaceli,140 ml)", bashkangjitur "Formulari i sigurimit të kontratës" lëshuar më datë 04.04.2023 nga OE "A." Sha, për nënobjektin e sipërcituar.
**5. Kontrata me nr. 2699 prot**., datë 24.04.2023 me objekt: "Rruga "Bakallarët"L=250ml ( b=3.5 m + 0.5m bankine)", bashkangjitur "Formulari i sigurimit të kontratës" lëshuar më datë 04.04.2023 nga OE "A." Sha, për nënobjektin e sipërcituar.
**6**. Kontrata me nr. 2700 prot., datë 24.04.2023 me objekt: "Rikonstruksion i rrugës "Spahiu" fshati Strum ,L=300ml b=4m asfalt", bashkangjitur "Formulari i sigurimit të kontratës" lëshuar më datë 04.04.2023 nga OE "A." Sha, për nënobjektin e sipërcituar.
**7. Kontrata me nr. 2701 prot**., datë 24.04.2023 me objekt: "Rehabilitim i ish-bllokut të SMT-së, Roskovec, Rruga nr . 9 (Riza Agaçi,140 ml)", bashkangjitur "Formulari i sigurimit të kontratës" lëshuar më datë 04.04.2023 nga OE "A." Sha, për nënobjektin e sipërcituar.
**8.** Kontrata me nr. 2702 prot., datë 24.04.2023 me objekt: "Rikonstruksion i rrugës "Rukallarëve", fshati Suk 2,200 ml, b=4m asfalt", bashkangjitur "Formulari i sigurimit të kontratës" lëshuar më datë 04.04.2023 nga OE "A." Sha, për nënobjektin e sipërcituar.
**9.** Kontrata me nr. 2703 prot., datë 24.04.2023 me objekt: "Rikonstruksion i rrugës "Lagja Dortaj" fshati Vlosh, 840ml", bashkangjitur "Formulari i sigurimit të kontratës" lëshuar më datë 04.04.2023 nga OE "A." Sha, për nënobjektin e sipërcituar.
**10.** Kontrata me nr. 2704 prot., datë 24.04.2023 me objekt: "Rikonstruksion i rrugës "Hazizajve" fshati Strum, 270ml, b=4m asfalt", bashkangjitur "Formulari i sigurimit të kontratës" lëshuar më datë 04.04.2023 nga OE "A." Sha, për nënobjektin e sipërcituar.
**11.** Kontrata me nr. 2705 prot., datë 24.04.2023 me objekt: "Rikonstruksion i rrugicave "Dyli Ç......" L=51ml, b=4m dhe "Refat Ç......", L= 44ml, b= 4m, Roskovec", bashkangjitur "Formulari i sigurimit të kontratës" lëshuar më datë 04.04.2023 nga OE "A." Sha, për nënobjektin e sipërcituar.
Me urdhërin e Titullarit të AK për 11(njëmbëdhjetë) kontratat e sipërcituar "Për caktimin e personave përgjegjës për zbatimin e kontratës" janë caktuar:
1. Z. A. D. me detyrë "Përgjegjës i Sektorit të Zbatueshmërisë së Investimeve".
2. Znj. S. K. me detyrë "Përgjegjës i Sektorit të Çështjeve Juridike". Bashkangjitur me nr. 2705/2 prot., datë 01.05.2023 "Plani i zbatimit të kontratës".

Nga auditimi i dokumentacionit të BOE "L. K." Shpk rezulton se nuk ka plotësuar të gjitha kriteret e DT duke u kualifikuar dhe shpallur fitues pa të drejtë nga ana e KVO-së dhe Titullarit të AK dhe konkretisht:
Lidhur me **OE "L. K." Shpk** (ish OE "E. A." Shpk**)**, rezulton se nuk ka plotësuar të gjitha kriteret e DT duke u kualifikuar dhe shpallur fitues pa të drejtë nga ana e KVO-së dheTitullarit të AK dhe konkretisht:
**OE "L. K." Shpk:** referuar web-in zyrtar të "Open Procuerment Albania", ka realizuar punime në territorin e bashkive: **Tiranë; Maliq; Bulqizë, Dibër.**
**Nuk ka paraqitur vërtetim për taksat dhe tarifat vendore në Bashkinë Maliq.**

Në dosje e DT nuk gjenden vërtetime për pagimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Maliq, sa më sipër është në kundërshtim me paragrafin e fundit në kriteret e veçanta të kualifikimit në DT ku citohet:"*OE, bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, paraqesin si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe nenit 26 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021.*
*Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.*
*Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim".*
Referuar Deklaratës qe OE pjesëmarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë 01.03.2023 nga AK Bashkia Roskovec, me objekt: "Asfaltim i rrugëve të brendshme në lagjet e Bashkisë Roskovec", me fond limit 28,435,140 *(njëzetë e tetë milionë e katërqindë e tridhjetë e pesë mijë e njëqindë e dyzetë)* lekë pa Tvsh. Administratori i OE "L. K." znj. D.M. në deklaratën e datës 01.03.2023 ka paraqitur:
**z. B. M.**, me profesion Inxhinier Gjeolog i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e drejtuesit teknik/Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë me kod të profesioni në listëpagesat e paraqitura 2114.12, që i korrespondon profesionit- Inxhinier mekanik për lokomotiva. Përgjegjës për dëmet në mjedis/Ekspert Zjarrfikës në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtim
**z. B. S.** në pozicionin Manovrator i mjeteve të rënda; me kod të profesioni në listëpagesat e paraqitura 7212.09; që i korrespondon profesionit **Saldator.**
**Për mjetet e paraqitura në Deklaratë:**
**- Kontrata e qerasë** e lidhur me I. K, me nr. 1324 rep., nr. 1020 kol**.,** datë 19.07.2021 me afat kohor nga 18.02.2021 deri 18.02.2024, për mjetin: Autobitumatrice me targa A..A; Leje Qarkullimi D..9 e Nr. Z....5 Shasie. Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur për këtë mjet konstatohet që është kamiocinë Iveco me kapacitet mbajtës (3500-2635) 965 kg, Me certifikatë nr. 44, datë 30.04.2020 "Për transport mallrash për të tretë dhe me qera brenda vendit" lëshuar nga Bashkia Bulqizë. ***(Mungon Autobrumatrice)***
**- Kontrata e qerasë e** lidhur me L. B., me nr. 10143 rep., nr. 6759 kol., datë 16.10.2021 me afat kohor nga 16.10.2021 deri 16.10.2026, për mjetet:
**Kamionçinë nën 3.5 ton** Targa A....R; Leje qarkullimi T.....5; Shasi V...6; Nuk ka leje transporti**;**
**Kamionçinë nën 3.5 ton** Targa A...E; Leje qarkullimi F....2; Shasi F...A; Nuk ka leje transporti;
**- Kontrata e qerasë e** lidhur me A.A., me nr. 1730 rep., nr. 1211 kol., datë 21.02.2023 me afat kohor nga 21.02.2023 deri 21.02.2023, për mjetin: Kamionçinë nen 3.5 ton Targa A...8; Leje qarkullimi K...4; Shasi W....9. Nuk ka leje transporti;
**- Kontrata e qerasë** e lidhur me L.K., me nr. 8996 rep., nr. 5933 kol., datë 16.09.2022 me afat kohor nga 16.09.2022 deri 16.09.2022, për mjetin: Kamionçinë nen 3.5 ton. Targa A...E; Leje qarkullimi T...1; Shasi W...4 Nuk ka leje transporti;
**- Kontrata e qerasë e** lidhur me OE "K.D." Shpk, me nr. 4376 rep., nr. 3056 kol., datë 19.05.2021 me afat kohor nga 19.05.2021 deri 19.05.2024, për mjetin: Greider Targa A..3; Leje qarkullimi D...8; Shasi 4...P: është në rregull.
**- Kontrata e qerasë** e lidhur me E.O., me nr. 2835 rep., nr. 650 kol., datë 04.12.2019 me afat kohor nga 04.12.2019 deri 04.12.2024, për mjetin: Autobot Targa A..F; Leje qarkullimi T....8; Shasi Y....8 është në rregull.
Për sa trajtuar më sipër OE "L.K." Shpk, nuk plotëson të gjitha kriteret e veçanta të vendosura në DT dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO por duhet të ishte skualifikuar. KVO dhe Titullari i Autoritetit Kontraktor të shpallte fitues OE "L.K." Shpk, por anullimin e procedures së prokurimit publik, për arsye se OE nuk plotëson të gjitha kriteret e vendosura në DT.

Mos disponimi, apo mosparaqitja e dokumenteve, përbën shkak të ligjshëm për skualifikimin e OE "L. K." Shpk, dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO dhe nuk duhet të ishte shpallur fitues. Gjithashtu nga titullari nuk duhet të ishte miratuar shpallja fitues e OE "L. K." Shpk. Sa më sipër KVO nuk ka vepruar në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, "Për prokurimin publik" i ndryshuar, neni 3, "Parimet të përgjithshme", neni 98 "Anulimi i një procedure prokurimi" si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 82 "Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave" pika 2, neni 67 "Klasifikimi i ofertave" pika 2, neni 83 "Njoftimi i fituesit".

**Si konkluzion,** konstatohet seprocedura paraqitet me probleme në lidhje me financimin e kontratës si dhe në shpalljen fitues të OE "L. K." Shpk, pasi nuk është në kushtet e plotësimit të gjitha kritereve të DT, veprime në kundërshtim të dispozitave të LPP, ku KVO nuk duhet ta kishte shpallur fitues, por duhet të shpallte OE "B." Shpk (nëse plotësonte kriteret e vendosura në DT), ose të anulonte procedurën dhe zhvillonte procedurë tjetër me kushte më favorizuese, duke sjellë për pasojë përdorimin pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomicitet të fondit për vlerën **23,213,550 (***njëmbëdhjetë milion e dyqind e nëntëmbëdhjetëmijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë)* **lekë pa Tvsh.**

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:** znj. M. B. Kryetare e Bashkisë Roskovec në cilësinë e titullarit të autoritetit kontraktor, znj. D.H., z. S.Ç., znj. S.P., z. E.K., z. E. H. në cilësinë e anëtarëve të Njësisë së Prokurimit dhe z. M. L., znj. E.T., z. Z. Ç. në cilësinë e anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

**3.** Procedura e prokurimit me objekt: **"Ndërhyrje për sigurinë e rezervuarit të Ngjeqarit",** Bashkia Roskovec.

| **a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Ndërhyrje për sigurinë e rezervuarit të Ngjeqarit"**, Bashkia Roskovec. REF-**73449-06-23-2023** | | |
|---|---|---|
| **1. Urdhër Prokurimi**<br>Nr. 63, nr. 3601 prot., datë 02.06.2023<br>**2. Lloji i Procedurës –**<br>"E hapur" | **3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit**<br>Urdhër nr. 63, datë 31.08.2023 Njësia e Prokurimit<br>1. D. H., Jurist (Personi përgjegjës)<br>2. S.Ç. Ekonomist<br>3. S.P. Ing. (Personi përgjegjës)<br>4. E. K. Ing.<br>5. A. D. Ing. | **4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave**<br>Urdhër nr. 3970 prot., datë 19.06.2023<br>1. E.M. Kryetar<br>2. V.Z.<br>3. O.G. |
| **5. Fondi Limit (pa Tvsh)**<br>76,728,812 lekë. | **6. Oferta fituese** (pa Tvsh)<br>43,031,579 lekë | **7. Diferenca me fondin limit**<br>33,697,233 (pa Tvsh) |
| **8. Data e hapjes së tenderit**<br>Datë 12.07.2023 | **9. Burimi Financimit**<br>Buxheti i shtetit | 10. Operatoret Ekonomike<br>a) Pjesëmarrës në tender 14 OE/BOE<br>b) S'kualifikuar 3 OE/BOE,<br>c) Kualifikuar 11 OE/BOE |
| **11. Ankimime për DT;** | **12. Përgjigje Ankesës** | **13. Përgjigje Ankesës** |
| **b. Kontrata nr. 5112 prot., datë 30.08.2023** | | |
| **14. Lidhja e kontratës 30.08.2023** | **15. Vlera e kontratës** | **51,637,895 lekë me Tvsh** |

**Projekt preventivi:** Në dosjen e prokurimit gjenden:

a. Kontrata e dhurimit me nr. 876 prot., datë 09.02.2023, lidhur mes Autoritetit Kontraktor, Bashkia Roskovec, të përfaqësuar nga Titullari i Autoriteti Kontraktor znj. M. B. dhe me OE "S." Shpk, përfaqësuar nga administratori z. V. A. për dhurimin e projektit me objekt: "Ndërhyrje për sigurinë e rezervuarit të Ngjeqarit", Bashkia Roskovec.

b. Kontrata e dhurimit me nr. 875 prot., datë 09.02.2023, lidhur mes Autoritetit Kontraktor, Bashkia Roskovec, të përfaqësuar nga Titullari i Autoriteti Kontraktor znj. M. B. dhe me OE "A." Shpk, përfaqësuar nga administratori z. B.H. për dhurimin e projektit me objekt: "Përmirësimi i shkarjeve në rrugën Gjonaj – Fetanaj - Pocest, Njësia Administrative Kurjan" Bashkia Roskovec.

Me procesverbalin nr. 876/1 prot., datë 09.02.2023 janë marrë në dorëzim (pesë kopje) të projekteve të sipërcituara nga E. H. e E. H., Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit.

**Hartimi i dokumenteve të tenderit:**

Me urdhrin e prokurimit nr. 63 e nr. 3601 prot., datë 02.02.2023 është ngarkuar Njësia e Prokurimit me përbërje:

1. D. H. Jurist (Personi përgjegjës)
2. S. Ç. Ekonomist
3. S. P. Ing. (Personi përgjegjës)
4. E. K. Inxhinier
5. A. D. Inxhinier

Në dosje nuk gjenden; "Formularët e deklarimit të konfliktit të interest" të nënshkruar nga Komisionin i Vlerësimit të Ofertave me nr. 3601/2 prot., datë 23.06.2023.

Njësia e Prokurimit me nr. 3601/1 prot., datë 23.06.2023 ka hartuar Procesverbali për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim.

Njoftimi për zhvillimin e procedurës së prokurimit APP me nr. 3601/3 prot., datë 23.06.2023, botuar në Buletinin nr. 60 ,datë 03 korrik 2023, faqe 17/462.

**Ndryshime në DT:**

Me vendimin nr. 4360 prot., datë 10.07.2023 është pezulluar e prokurimit në zbatim të sygjerimeve nga asistenca e APP.

Në dosje gjendet vendimi me nr. 4361 prot., datë 10.07.2023 i NjP për modifikimin e kritereve të kualifikimit për procedurës së prokurimit.

Njësia e Prokurimit me nr. 4361/2 prot., datë 10.07.2023 ka hartuar Procesverbali për modifikimin e kritereve të kualifikimit për procedurës të sipërcituar.

Me nr. 4361/3 prot., datë 10.07.2023, është hartuar Shtojca e DT dhe me nr. 4361/4 prot., datë 10.07.2023 është formuluar njoftimi për ndryshimin e DT.

Në seksionin 2.10 pika 1, të DT, AK ka përcaktuar: "Fondi limit/vlera e pritshme ekontratës: **76,728,812***(njëmbëdhjetë milionë e katërqindë e pesëdhjetë e gjashtëmijë e dyqindë e nëntëmbëdhjetë)* **lekë pa Tvsh.**

Financimi i ndarë si më poshtë:

- për vitin 2023 – nga buxheti i shtetit = 38,985,304 lekë pa Tvsh.
- për vitin 2024 – nga buxheti i shtetit = 37,743,508 lekë pa Tvsh.

Në lidhje me financimin e kësaj kontratë, nga AK Bashkia Roskovec nuk janë zbatuar parashikimet pikës 1 të nenit 21 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" ku citohet: *"Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor <u>ka detyrimin të mirë planifikojë</u> në cilësi <u>dhe në kohë fondet publike</u> e nevojat e tij <u>dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në</u> përputhje me legjislacionin në fuqi. dh*e pikës 2 të nenit 85,të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar ku përcaktohet: *"Lidhja e kontratës do të bëhet në përputhje me afatet e përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, dhe vetëm pasi fondi do të jetë në dispozicion (në llogarinë përkatëse) të autoritetit/entit kontraktor".*

**Në pikën 2.3.11 të Kapacitetit teknik në DT është kërkuar:***Rastet e detyrimeve të mëparshme kundrejt Bashkisë Roskovec si: taksa, gjoba, debi të ndryshme, kontratat e mëparshme të pambyllura të lidhura me AK Bashkia Roskovec duhet të jen realizuara minimumi në masën 70% të investimit si dhe moszbatim në kohë dhe sipas kushteve përkatëse të kontratave të mëparshme, të dokumentuara me njoftime, procesverbale etj, do të përbëjnë kusht për skualifikim të OE përkatës.*

Kriteri nukpërmbushin parashikimet e dispozitave të legjislacionit tëzbatueshëm për prokurimin publik, pikës 1, të nenit 77, të Ligjit nr. 162/2020, "Për prokuriminpublik", dhe nenet 39 e 85 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Përrregullat e prokurimit publik", i ndryshuar, që çdo kriter i veçantë duhet të jetë në përputhje menatyrën dhe përmasën e kontratës.(nenet

124 e 125 tëLigjit nr. 162/2020, dhe neni 107 e 108 e VKM nr, 285 për kontratat e mëparshme të pambyllura të lidhura me AK Bashkia Roskovec.)
Zhvillimi i procedurës së prokurimit dhe lidhja e kontratës pa pasur në dispozicion fondin e nevojshëm për realizimin e punimeve, janë veprime të cilat direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE në procedurë e ngarkojnë me përgjegjësi Titullari i Autoritetit Kontraktor znj. M. B. dhe znj. D. H., z. S. Ç. dhe znj. S. P., z. E. K., z. A. D. në cilësinë e anëtarëve të Njësisë së Prokurimeve.

**- Zhvillimi i procedurës.**
Me urdhërin e veçantë nr. nr. 3970 prot., datë 19.06.2023 "për ngritjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave" me përbërje:
1. E. M., Kryetar
2. V. Z., Anëtar.
3. O. G., Anëtar.
Në dosje gjenden; "Formularët e deklarimit të konfliktit të interest" të nënshkruar nga Komisionin i Vlerësimit të Ofertave me nr. 4511/1 prot., datë 20.07.2023.
Nga shqyrtimi i dokumentacionit të OE/BOE pjesëmarrës, paraqitur në SPE për këtë procedurë KVO është hartuar procesverbalin me nr. 1 e nr. 4511 prot., datë 20.07.2023, ku konstatohet që kanë marrë pjesë 14 (katërmbëdhjetë) OE/BOE.
Nga shqyrtimi i dokumentacionit të OE/BOE pjesëmarrës, paraqitur në SPE për këtë procedurë KVO ka hartuar procesverbalin nr. 2 (Për klasifikimi e ofertave) e nr. 4732 prot., datë 02.08.2023, ku konstatohet që kanë marrë pjesë:
**1. OE "A. S." Shpk**, (me Nipt: J....Ë) vlerë ekonomike të ofertës **70,992,159** *(shtatëdhjetë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e dy mijë e njëqind e pesëdhjetë e nëntë)* **lekë pa Tvsh**
**2. BOE "A.&E." Shpk & "L. K." Shpk**, (me Nipt-e respektive: L......A & K...H) vlerë ekonomike të ofertës **51,341,075** *(pesëdhjetë e një milion e treqind e dyzetë e një mijë e shtatëdhjetë e pesë)***lekë pa Tvsh.**
**3. BOE "A.-Co" Shpk & "2Z. K." Shpk**, (me Nipt-e respektive: K.......C & J......K) vlerë ekonomike të ofertës **56,601,468** *(pesëdhjetë e gjashtë milion e gjashtëqind e një mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e tetë)* **lekë pa Tvsh.**
**4. BOE "B. II" Shpk & "B." Shpk & "V. G." Shpk**, (me Nipt-e respektive: L......O & J....R & L......E) vlerë ekonomike të ofertës **57,325,410** *(pesëdhjetë e shtatë milion e treqind e njëzetë e pesë mijë e katërqind e dhjetë)* **lekë pa Tvsh.**
**5. OE "B. - I." Shpk,** (me Nipt K........A) vlerë ekonomike të ofertës **60,393,585** *(gjatëdhjetë milion e treqind e nëntëdhjetë e tre mijë e pesëqind e tetëdhjetë e pesë)* **lekë pa Tvsh**
**6. BOE "B." Shpk & "A.C." Shpk**, (me Nipt-e respektive: J......V & K.......Ë) vlerë ekonomike të ofertës **61,869,271** *(gjashtëdhjetë e një milion e tetëqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e dyqind e shtatëdhjetë e një)* **lekë pa Tvsh.**
**7. BOE "B." Shpk & "Ll." Shpk**, (me Nipt-e respektive: J......B & K.....K) vlerë ekonomike të ofertës **43,031,579** *(dyzetë e tre milion e tridhjetë e një mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e nëntë)***lekë pa Tvsh.**
Për periudhën e auditimit nga data 01.01.2023 deri më 31.12.2023 AK Bashkia Roskovec ka realizuar gjithësej 42 procedura prokurimi blerje me vlera të vogla, me fond limit në shumën 20,082,147 lekë pa Tvsh, me vlerë kontrate në shumën 16,611,980 lekë pa Tvsh.
Nga verifikimi i regjistrit të realizimeve dhe dosjeve të marra për shqyrtim, u audituan me zgjedhje 17 procedura me fond limit në shumën 9,725,076 lekë dhe vlerë kontrate në shumën 7,828,092 lekë, ose 48%, bashkëlidhur aneksi nr. 1, për procedurat e marra për auditim.
Nga auditimi i dokumentacionit dhe të dhënave të vëna në dispozicion u konstatua se:
Në 4 procedura prokurimi rezulton të jenë shmangur zhvillimi i procedurave standard të prokurimit (tender), duke copëzuar fondet dhe duke kryer me procedura blerje me vlera të vogla, konkretisht:
-Në 2 procedura në shumën totale të fondit limit në vlerën 1,416,666 lekë pa Tvsh, dhe vlerë kontrate në shumën 1,088,318 lekë, procedura të cilat duhet të kryheshin tenderim pasi kanë të njëjtën objekt prokurimi konkretisht:
1. Procedura me objekt "Blerje materiale për prodhim tubo betoni, për Ndërmarrjen e Shërbimeve të Mirëmbajtjesë" zhvilluar në 29.12.2024 me fond limit 583,333 lekë pa Tvsh dhe vlerë kontrate 298,818 lekë pa Tvsh dhe
2. procedura me objekt "Blerje materiale për rrugë e trotuare gjate vitit, për Ndërmarrjen e Shërbimeve të Mirëmbajtjesë" zhvilluar në muajin tetor me fond limit 833,333 lekë pa Tvsh dhe vlerë kontrate 789,500 lekë pa Tvsh.
-Në 2 procedura në shumën totale të fondit limit në vlerën 1,475,841 lekë pa Tvsh, dhe vlerë kontrate në shumën 1,215,000 lekë, procedura të cilat duhet të kryheshin tenderim pasi kanë të njëjtën objekt prokurimi konkretisht:
1. Procedura me objekt "Rikonstruksion i çezmave publike fshati Luar, Ngjeqar, Mbers" zhvilluar në 29.12.2024 me fond limit 663,824 lekë pa Tvsh dhe vlerë kontrate 465,000 lekë pa Tvsh dhe
2. procedura me objekt "Riparim i shkarjes, fshati Vlosh ml 25" zhvilluar në muajin tetor me fond limit 812,017ekë pa Tvsh dhe vlerë kontrate 750,000 lekë pa Tvsh.
***- Nga sa më sipër rezulton se të dhënat e regjistrit të parashikimeve të hartuara nga personat përgjegjës dhe miratuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor, nuk janë siguruar në mënyrë të tillë që, të analizoheshin sipas nevojave të paraqitura, me qëllim shmangien e copëzimit të fondeve për grup mallrat e ngjashme dhe kryerjen e tyre me procedura të rregullta konkurruese sipas kufijve monetarë. Pra nëse do të përllogariteshin drejtë nga personat përgjegjës të prokurimeve të dhënat e administruara, procedurat e blerjeve me vlera të vogla ku natyra dhe sasia e planifikuar kanë të njëjtin funksion apo të ngjashëm këto procedura do të kryheshin me procedura normale tenderimi,*** veprime këto në kundërshtim meVKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, nenin 11, pika 5 në të cilën citohet se "*Asnjë kontratë publike nuk mund të ndahet për shmangien e kufirit monetar apo të procedurave, të parashikuara nga LPP-ja."* neni 12, "Metoda të zbatueshme në përllogaritjen e vlerës së kontratës, pika 3 në të cilën citohet se "*Përzgjedhja e metodës që përdoret për përllogaritjen e vlerës së prokurimit nuk bëhet me qëllim për ta përjashtuar atë nga fus e zbatimit të LPP-së dhe këtyre rregullave, apo për të copëzuar kontratën me qëllim shmangien e procedurave sipas kufijve monetarë."*; nenin 56, pika 2 paragrati i II-të, në të cilin citohet se "*2. Autoriteti/enti kontraktor planifikon natyrën, sasitë dhe llojet e kontratave, që do të prokurohen me këtë procedurë prokurimi. Për përcaktimin e kufirit monetar për këtë procedurë llogariten grup - mallrash apo shërbimesh të ngjashme, të cilat zakonisht*

*prokurohen njëherësh dhe, në asnjë rast, nuk duhet të ndahen për përdorimin e kësaj procedure.”*; Pika 11 në të cilën citohet se “*Në asnjë rast, autoriteti/enti kontraktor në momentin e planifikimit të nevojave të tij, nuk duhet të përdorë procedurën e prokurimit me vlerë të vogël, si mundësi për të pjesëtuar vlerën e kontratës për shmangien nga procedurat e prokurimit.”;* Udhëzimin nr. 05, datë 25.06.2021 “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, pika 3 në të cilën citohet ndër të tjera se “*Kjo lloj procedure do të përdoret për blerjen e një grupi mallrash, kryerjen e shërbimeve apo punëve të ngjajshme, që kanë të njëjtin funksion kryesor apo kanë të njëjtin emërtim në planin e shpenzimeve. Përdorimi i kësaj procedure nuk duhet parë si mundësi për shmangien e procedurave konkurruese të prokurimit. Në asnjë rast, autoritetet kontraktore ose entet kontraktore nuk duhet të prokurojnë veçmas mallra, shërbime apo punë që përfshihen në një grup për shkak të ngjajshmërisë së tyre, apo për shkak të funksionit kryesor.”*; Nenin 74 “Personi përgjegjës për prokurimin dhe njësia e prokurimit”, pika 3 ku ndër të tjera citohet se:*a) Sigurimin e të dhënave të nevojshme nga strukturat përkatëse në institucion dhe përgatitjen e regjistrit të parashikimit dhe regjistrit të realizimit të procedurave të prokurimit publik;b) Përzgjedhjen e llojit të procedurës së prokurimit (dhe justifikimin, kur është rasti) kur kjo nuk bëhet nga struktura të tjera të posaçme;*

*Veprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi titullarin e Autoritetit Kontraktor zj. M. B., personat përgjegjës të prokurimeve zj. D.H. e zj. S.P.*

### 2.4.1 Mbi zbatimin e kontratave të punimeve në investimet publike.

Për auditimin e zbatimit të kontratave të punimeve u analizuan regjistri i realizimit të investimeve që i përket periudhës së auditimit të përputhshmërisë 01.01.2023 deri me datën 31.12.2023 dhe kontrata të realizuara që periudha e garancisë së punimeve është brenda periudhës së audituar.
Për periudhën e auditimit në Bashkinë Roskovec u audituan **4** (katër) dosje/objekte të prokuruar (Tabela në vijim), në vlerën totale të kontratave **143,149,792.90 lekë me Tvsh,** mbi zbatimin e kontratave për punë publike.

**Tabela: Objekte të prokuruara për punë publike.**

| Nr | Objekti | Kontraktori Sipërmarrës | Vlera e kontratës me TVSH |
|---|---|---|---|
| 1 | Rikonstruksioni i shkollës mesme “Didin Bishani Kurjan”, Bashkia Roskovec. | OE “S.” Shpk | 23,244,666 |
| 2 | Ndërhyrje për sigurinë e rezervuarit të Ngjeqarit | BOE “B.” Shpk & “Ll.” Shpk | 51,637,895 |
| 3 | Asfaltimi i rrugëve të brendëshme në lagjet e bashkisë Roskovec | OE “L. K.” Shpk | 27,865,260 |
| 4 | Ndërhyrje emergjente në fshatin Ngjeqar, Njësia Administrative Kurjan (Riparim i shkarjes në lagjen Stan, L=50L; Riparim i shkarjes në lagjen Gogallarët;Punime në rrugën Ngjeqan-Kurtaj;Punime për Përroin e Allambrezit ). | BOE “2Z. K.” Shpk & “A.&E.” shpk & “A.-Co” Shpk | 40,401,971.90 |
| | **Shuma në lekë me TVSH** | | **143,149,792.90** |

**Nga auditimi mbi zbatimin e kontratave për punë publike, u konstatua si vijon:**

**1.Mbi auditimin e zbatimittë punimeve në objektin: “Rikonstruksioni i shkollës mesme “Didin Bishani Kurjan”, Bashkia Roskovec**me këto të dhëna**:**

| **b. Zbatimi i Kontratës së Punimeve: “Rikonstruksioni i shkollës mesme “Didin Bishani Kurjan”, Bashkia Roskovec.** | | |
|---|---|---|
| **14.Lidhja e kontratës**<br>Nr. 1743 prot., datë 17.03.2023 | **15.Vlera e kontratës (me tvsh)** 23,244,666 lekë. **OE fitues** “S.” Shpk | **16. Likuiduar lekë**<br>**lekë** |
| **17- Situacioni Përfundimtar datë** 05.11.2019<br>**-Vlera me tvsh 23,244,539lekë** | **18.Afati i kontratës në dite**<br>Parashikuar (6 muaj)<br>Fillimi punimeve: 23.03.2023 | **19. Zgjatja e kontratës** |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **-Vlera pa tvsh 19,370,449 lekë** | Përfundimi punimeve :11.09.2023 | | | |
| **20**. **Mbikëqyrësi i punimeve**<br>BOE "A." Shpk<br>"L. - I." Shpk | Licenca Nr:<br>MK 1997/4<br>MK 0985/7 | Kontrata nr. 1542 prot., datë 09.03.2023 | Vlera e Kontratës (me Tvsh)<br>348,000 lekë | Likujduar (me Tvsh)<br>leke |
| **21**. **Kolaudatori i punimeve**<br>Ing. V. A.<br>"S. " Shpk | Licenca Nr:<br>MK 0944/9 | Kontrata nr. 7474 prot.,datë 20.11.2023 | Vlera e Kontratës (me Tvsh)<br>34,800lekë | Likujduar (me Tvsh)<br>lekë |
| **22.Akt Kolaudimi**<br>Datë 30.11.2023. | **23.Akt i marrjes në dorëzim** datë 12.12.2023 | | | |

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **1,124,502lekë pa Tvsh**.
Nga auditimi i realizimit të punimeve në objekt, u konstatua se ka patur diferenca në volume dhe çmime në zërat e punës "Punime fasade me polisterol t=5cm+rrjetë +suva"; "F.V. Përcjellës shirit zingato Zn 30x3mm"; "F.V. Pusetë PVC 40x40cm";" F.V. Fiksuese zingato shirit – shirit 30x3mm";" F.V. Elektroda tokëzimi profil Zn bakerzuara l=1.5m komplet.";" F.V. Tabela druri për koshat e kompletuar për palestër";" F.V. Tabela druri për koshat e kompletuar me shtyllë për fushën e jashtme" dhe "F.V. Kangjella alumini për 2 ballkonet cilësia", për pasojë vlera e këtyre diferencave janë përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.Situacionimi i volumeve jo në përputhje me projektpreventivin dhe faktin, janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimi", i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12., Udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" e konkretisht Kreu II, Pika 3, Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr. 1743 prot., datë 17.03. 2023, Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me1542 prot., datë 09.03.2023, Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve, sipas aktit me nr. 7474 prot., datë 25.09.2023, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **1,124,502 lekë pa Tvsh**.

**Në mënyrë të përmbledhur nga auditimi i dosjes teknike dhe i zbatimit të punimeve për kontratën me objekt: "**Rikonstruksioni i shkollës mesme "Didin Bishani Kurjan", Bashkia Roskovec,**", u konstatua:**
Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se punimet, sipas njoftimeve përkatëse kanë nisur më nisur me datë 20.03.2023. dhe kanë përfunduar me datë 11.09.2023 brenda afatit të parashikuar në kontratë
Është bërë akti i dorëzimit të sheshit të ndërtimit në datën 20.03.2023, sipas të cilit "*...nga verifikimi në vend i sheshit, u konstatua se sheshi është i lire dhe sipërmarrësi i punimeve merr në dorëzim sheshin e punimeve për realizimin e kontratës...*".
Punimet kanë përfunduar më datë 11.09.2023 sipas afateve të parashikuar në amendamentin e kontratës. Garancia e punimeve është 12 muaj.
-Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume pune ndërtimi në vlerën **1,124,502lekë pa Tvsh**.

***Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:***
1. Z. B. H. dhe N. P, me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes;
2. Z. V. A., me detyrë kolaudator i kontratës së sipërmarrjes;

**2. Mbi auditimin e zbatimittë punimeve në objektin: "Ndërhyrje për sigurinë e rezervuarit të Ngjeqarit", Bashkia Roskovec,** me këto të dhëna:

| b. Zbatimi i Kontratës së Punimeve: "Ndërhyrje për sigurinë e rezervuarit të Ngjeqarit", Bashkia Roskovec | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **14.Lidhja e kontratës**<br>Nr. 5112 prot., datë 30.08.2023 | **15.Vlera e kontratës (me tvsh)** 51,637,895 lekë<br>**OE fitues** BOE "B." Shpk & "Ll." Shpk | | **16. Likuiduar lekë**<br>**lekë** | |
| **17- Situacioni Përfundimtar datë** 05.11.2019<br>**-Vlera me tvsh 51,637,579 lekë**<br>**-Vlera pa tvsh 43,031,579 lekë** | **18.Afati i kontratës në dite**<br>Parashikuar (6 muaj) 0, Zbatuar 6 muaj.<br>Fillimi punimeve: 13.09.2023<br>Perfundimi punimeve : 2712.03.2024 | | **19. Zgjatja e kontratës** | |
| **20. Mbikëqyrësi i punimeve**<br>"S." Shpk | Licenca Nr:<br>MK 0944/10 | Kontrata nr. 5304 prot., datë 107.09.2023 | Vlera e Kontratës (me Tvsh)<br>1 636 267 lekë | Likujduar (me Tvsh) |
| **21. Kolaudatori i punimeve**<br>Ing. V. Dh. | Licenca Nr:<br>MK 0096/4 | Kontrata nr. 2532 prot., datë 05.04.2024 | Vlera e Kontratës (me Tvsh)<br>48 468lekë | Likujduar (me Tvsh) |
| **22.Akt Kolaudimi**<br>Datë 17.04.2024 | **23.Akt i marrjes në dorëzim**<br>datë 24.04.2024 | | | |

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **536,391 lekë pa Tvsh**.

Nga auditimi i realizimit të punimeve në objekt, u konstatua se ka patur diferenca në volume dhe çmime në zërat e punës: "Lyerje e tubacionit me një dorë minio e dy duar bojë antiruxho"; "Gabiona me rrjetë teli i zinguar e gurë kave 1x1x1m"; dhe "Gabiona me rrjetë teli i zinguar e gurë kave 1x1x1.5m", për pasojë vlera e këtyre diferencave janë përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve. Situacionimi i volumeve jo në përputhje me projektpreventivin dhe faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimi", i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" e konkretisht Kreu II, Pika 3, Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr. 5112 prot, datë 30.08.2023, Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. nr. 5304 prot, datë 07.09.2023, Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve, sipas aktit me nr. 2532 prot., datë 05.04.2024, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **536,391 lekë pa Tvsh**.

**Në mënyrë të përmbledhur nga auditimi i dosjes teknike dhe i zbatimit të punimeve për kontratën me objekt: "Ndërhyrje për sigurinë e rezervuarit të Ngjeqarit", Bashkia Roskovec u konstatua:**
Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se punimet, sipas njoftimeve përkatëse kanë nisur më nisur me datë 13.09.2023. dhe kanë përfunduar me datë 12.03.2024 brenda afatit të parashikuar në kontratë
Është bërë akti i dorëzimit të sheshit të ndërtimit në datën 13.09.2023, sipas të cilit "...*nga verifikimi në vend i sheshit, u konstatua se sheshi është i lire dhe sipërmarrësi i punimeve merr në dorëzim sheshin e punimeve për realizimin e kontratës*...".
Punimet kanë përfunduar më datë 11.09.2023 sipas afateve të parashikuar në amendamentin e kontratës. Garancia e punimeve është 12 muaj.
-Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume pune ndërtimi në vlerën **536,391 lekë pa Tvsh**.

**3. Mbi auditimin e zbatimittë punimeve në objektin: “Asfaltimi i rrugëve të brendëshme në lagjet e bashkisë Roskovec”, Bashkia Roskovec, me nënobjekte si më poshtë:**
1. “Rikonstruksion i rrugës”Argjinaturës”, Agacaj, 440ml, b=4m asfalt”; -
2. “Rikonstruksion i rrugës “Rukallarëve”, fshati Suk 2,200 ml, b=4m asfalt”;
3. “Rikonstruksion i rrugicave së Cjepëve, fshati Suk 1 ,485 ml , b=4 m asfalt , bankine-2x0.5m)”
4. “Rikonstruksion i rrugës “Spahiu” fshati Strum, L=300ml b=4m asfalt”;
5. “Rikonstruksion i rrugës “Hazizajve” fshati Strum,270ml, b=4m asfalt”;
Për auditimin e kësaj procedure u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:
Marrëveshja kuadër ku përcaktohen të gjitha kushtet me nr. 1837 prot., datë 23.03.2023, është lidhur mes Autoritetit Kontraktor, Bashkia Roskovec, të përfaqësuar nga Titullari i Autoriteti Kontraktor znj. M. B. me OE “L. K.” Shpk, të përfaqësuar nga administratori znj D. M. me objekt: “Asfaltimi i rrugëve të brendshme në lagjet e Bashkisë Roskovec”, Bashkia Roskovec, në përputhje me projekt-zbatimin e objektit, specifikimet teknike dhe çdo dokument të tenderit, si pjesë integrale e kontratës. Vlera e kontratës është **23,213,550 (***katërmbëdhjetë milion e shtatëqind e tetëdhjetë e tre mijë)* **lekë pa Tvsh** (27,865,260 lekë me Tvsh).
Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **2,084,900lekë pa Tvsh**.

Diferenca në volume për punime të deklaruara të kryera në objektin: “Asfaltimi i rrugëve të brendshme në lagjet e bashkisë Roskovec”, Bashkia Roskovec”,me nën objekte si më poshtë: Bashkia Roskovec, nga zbatuesi i punimeve OE “L.K.” Shpk, për zërat e punimeve: 1. 3.212/a’ “Shtresë stabilizant”
Nga auditimi i realizimit të punimeve në objekt, u konstatua se:
-Ka patur diferenca në volume dhe çmime në zërat e punës “Shtresë stabilizant”, në nënobjektet:

**6.1**. Objekti i nënkontratës:**“Rikonstruksioni i rrugës Argjinaturës, Agacaj 440 ml, b = 4 m asfalt”.**

<table>
<tr><td colspan="5">b/1 Zbatimi i Marrëveshjes kuadër të punimeve: “Asfaltimi i rrugëve të brendshme në lagjet e Bashkisë Roskovec”, nënobjekti: “Rikonstruksioni i rrugës Argjinaturës, Agacaj 440 ml, b = 4 m asfalt”</td></tr>
<tr><td>14.Lidhja e kontratës<br>Nr. 2342 prot., datë 06.04.2023</td><td colspan="2">15.Vlera e kontratës (me tvsh) 3,653,700<br>OE fitues “L. K.” Shpk</td><td colspan="2">16. Likuiduar lekë</td></tr>
<tr><td>17- Situacioni Përfundimtar<br>-Vlera me tvsh 2,958,300 lekë<br>-Vlera pa tvsh 2,465,250 lekë</td><td colspan="2">18.Afati i kontratës në dite<br>Parashikuar (1 muaj), zbatuar 1 muaj.<br>Fillimi punimeve: 19.04.2023<br>Përfundimi punimeve 18.05.2023</td><td colspan="2">19. Zgjatja e kontratës</td></tr>
<tr><td>20. Mbikëqyrësi i punimeve<br>OE “A.” Shpk</td><td>Licenca Nr:<br>MK 1997/4</td><td>Kontrata nr 1394 prot., datë 03.03.2023.</td><td>Vlera e Kontratës (me Tvsh) 38,800 lekë</td><td>Likujduar (me Tvsh)<br>0.0 leke</td></tr>
<tr><td>21. Kolaudatori i punimeve<br>Ing. V. A.<br>OE “S. ” Shpk</td><td>Licenca Nr:<br>MK 0994/4</td><td>Kontrata nr. prot., 8191 datë 22.12.2023</td><td>Vlera e Kontratës (me Tvsh) 38,880 lekë</td><td>Likujduar (me Tvsh) lekë</td></tr>
<tr><td>22.Akt Kolaudimi<br>Datë 29.01.2024</td><td colspan="2">23.Akt i marrjes në dorëzim<br>Nuk është marr në dorëzim</td><td colspan="2"></td></tr>
</table>

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **356,750 lekë pa Tvsh**.

Situacionimi i volumeve jo në përputhje me projekt-preventivin dhe faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me:
- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimi", i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12.
- Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" e konkretisht Kreu II, Pika 3.
- Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr.2342 prot., datë 06.04.2023.
- Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me 1394 prot., datë 023.03.2023
- Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve, sipas aktit me nr. 8191 prot., datë 22.12.2023.

Në mënyrë të përmbledhur nga auditimi i dosjes teknike dhe i zbatimit të punimeve për kontratën me objekt: **"Rikonstruksioni i rrugës Argjinaturës, Agacaj 440 ml, b = 4 m asfalt", u konstatua:**
Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se punimet, sipas njoftimeve përkatëse kanë nisur më nisur me datë 19.04.2023. dhe kanë përfunduar me datë 18.05.2023 brenda afatit të parashikuar në kontratë
Është bërë akti i dorëzimit të sheshit të ndërtimit në datën 19.04.2023, sipas të cilit "*...nga verifikimi në vend i sheshit, u konstatua se sheshi është i lire dhe sipërmarrësi i punimeve merr në dorëzim sheshin e punimeve për realizimin e kontratës...*".
Punimet kanë përfunduar më datë 18.05.2023 sipas afateve të parashikuar në amendamentin e kontratës. Garancia e punimeve është 12 muaj.
-Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume pune ndërtimi në vlerën **356,750 lekë pa Tvsh**.

**6.2.** Objekti i nënkontratës:**"Rikonstruksioni i rrugës Rukallarët, fshati Suk 2 200 ml, b = 4 m asfalt".**

<table>
<tr><td colspan="5">b/2 Zbatimi i Marrëveshjes së punimeve: "Asfaltimi i rrugëve të brendshme në lagjet e Bashkisë Roskovec", nënobjekti:"Rikonstruksioni i rrugës Rukallarët, fshati Suk 2,200 ml, b = 4 m asfalt".</td></tr>
<tr><td>14.Lidhja e kontratës<br>Nr.2343 prot., datë 06.04.2023</td><td colspan="2">15.Vlera e kontratës (me tvsh) 1 660 800<br>OE fitues " L. K." Shpk</td><td colspan="2">16. Likuiduar lekë</td></tr>
<tr><td>17- Situacioni Përfundimtar<br>-Vlera me tvsh 1,359,780 lekë<br>-Vlera pa tvsh 1,133,150lekë</td><td colspan="2">18.Afati i kontratës në dite<br>Parashikuar (1 muaj), Zbatuar 1 muaj.<br>Fillimi punimeve: 19.04.2023<br>Përfundimi punimeve: 18.05.2023</td><td colspan="2">19. Zgjatja e kontratës</td></tr>
<tr><td>20. Mbikëqyrësi i punimeve<br>OE "A." Shpk</td><td>Licenca Nr:<br>MK 1997/4</td><td>Kontrata nr. 1394 prot., datë 03.03.2023.</td><td>Vlera e Kontratës (me Tvsh) 38,880 lekë</td><td>Likujduar (me Tvsh) 0.0 leke</td></tr>
<tr><td>21. Kolaudatori i punimeve<br>Ing. V. A.<br>OE "S." Shpk</td><td>Licenca Nr:<br>MK 0994/4</td><td>Kontrata nr. 8191 prot., datë 22.12.2023</td><td>Vlera e Kontratës (me Tvsh) 38,880 lekë</td><td>Likujduar (me Tvsh) lekë</td></tr>
<tr><td>22.Akt Kolaudimi<br>Datë 29.01.2024</td><td colspan="2">23.Akt i marrjes në dorëzim<br>Nuk është marr në dorëzim</td><td colspan="2"></td></tr>
</table>

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **163,750lekë pa Tvsh**.

Situacionimi i volumeve jo në përputhje me projekt-preventivin dhe faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me:

- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimi", i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12.
- Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" e konkretisht Kreu II, Pika 3.
- Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr.2343 prot., datë 06.04.2023.
- Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me 1394 prot., datë 023.03.2023
- Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve, sipas aktit me nr. 8191 prot., datë 22.12.2023.

Në mënyrë të përmbledhur nga auditimi i dosjes teknike dhe i zbatimit të punimeve për kontratën me objekt: **"Rikonstruksioni i rrugës Rukallarët, fshati Suk 2 200 ml, b = 4 m asfalt", u konstatua:**
Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se punimet, sipas njoftimeve përkatëse kanë nisur më nisur me datë 19.04.2023. dhe kanë përfunduar me datë 18.05.2023 brenda afatit të parashikuar në kontratë
Është bërë akti i dorëzimit të sheshit të ndërtimit në datën 19.04.2023, sipas të cilit "*...nga verifikimi në vend i sheshit, u konstatua se sheshi është i lire dhe sipërmarrësi i punimeve merr në dorëzim sheshin e punimeve për realizimin e kontratës...*".
Punimet kanë përfunduar më datë 18.05.2023 sipas afateve të parashikuar në amendamentin e kontratës. Garancia e punimeve është 12 muaj.
-Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume pune ndërtimi në vlerën **163,750 lekë pa Tvsh**.

**6.3.** Nën objekti i kontratës **"Rikonstruksioni i rrugicave së Cjepëve, fshati Suk 1, 485ml, b = 4m asfalt,bankina 2*0.5 m" .**

| 3/3. Zbatimi i Marrëveshjes së punimeve: "Asfaltimi i rrugëve të brendshme në lagjet e Bashkisë Roskovec", nënobjekti:"Rikonstruksioni i rrugicave së Cjepëve, fshati Suk 1, 485ml, b = 4m asfalt,bankina 2*0.5 m" | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **14.Lidhja e kontratës**<br>Nr.2333 prot., datë 06.04.2023 | **15.Vlera e kontratës (me tvsh)** 4 027 440<br>**OE fitues "**L.K." Shpk | | **16. Likuiduar lekë** | |
| **17- Situacioni Përfundimtar**<br>**-Vlera me tvsh 7,653,973.80 lekë**<br>**-Vlera pa tvsh 6,378,311.50 lekë** | **18.Afati i kontratës në dite**<br>Parashikuar (1 muaj) ,Zbatuar 1 muaj.<br>Fillimi punimeve: 19.04.2023<br>Përfundimi punimeve : 18.05.2023 | | **19. Zgjatja e kontratës** | |
| 20. **Mbikëqyrësi i punimeve**<br>OE "A." Shpk | Licenca Nr:<br>MK 1997/4 | Kontrata nr 1394prot., datë 03.03.2023. | Vlera e Kontratës (me Tvsh)38,880 lekë | Likujduar (me Tvsh)<br>0.0 leke |
| 21. **Kolaudatori i punimeve**<br>Ing. V. A.<br>OE "S." Shpk | Licenca Nr:<br>MK 0994/4 | Kontrata nr. prot., 8191 datë 22.12.2023 | Vlera e Kontratës (me Tvsh)<br>38,880 lekë | Likujduar (me Tvsh)<br>0.0 lekë |
| **22.Akt Kolaudimi**<br>Datë 29.01.2024 | **23.Akt i marrjes në dorëzim**<br>Nuk është marr në dorëzim | | | |

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **985,000 lekë pa Tvsh**.

Situacionimi i volumeve jo në përputhje me projekt-preventivin dhe faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me:

- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimi", i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12.
- Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" e konkretisht Kreu II, Pika 3.
- Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr.2343 prot., datë 06.04.2023.
- Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me 1394 prot., datë 023.03.2023
- Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve, sipas aktit me nr. 8191 prot., datë 22.12.2023.

Në mënyrë të përmbledhur nga auditimi i dosjes teknike dhe i zbatimit të punimeve për kontratën me objekt: **"Rikonstruksioni i rrugicave së Cjepëve, fshati Suk 1, 485ml, b = 4m asfalt, bankina 2*0.5 m", u konstatua:**
Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se punimet, sipas njoftimeve përkatëse kanë nisur më nisur me datë 19.04.2023. dhe kanë përfunduar me datë 18.05.2023 brenda afatit të parashikuar në kontratë
Është bërë akti i dorëzimit të sheshit të ndërtimit në datën 19.04.2023, sipas të cilit "*...nga verifikimi në vend i sheshit, u konstatua se sheshi është i lire dhe sipërmarrësi i punimeve merr në dorëzim sheshin e punimeve për realizimin e kontratës...*".
Punimet kanë përfunduar më datë 18.05.2023 sipas afateve të parashikuar në amendamentin e kontratës. Garancia e punimeve është 12 muaj.
-Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume pune ndërtimi në vlerën **985,000lekë pa Tvsh**.

**6.4.**Nën objekti i kontratës: **"Rikonstruksioni i rrugës Spahiu, fshati Strum, L = 300 ml , b = 4m asfalt", Bashkia Roskovec.**

| **b/4 Zbatimi i Marrëveshjes së punimeve:** "Asfaltimi i rrugëve të brendshme në lagjet e Bashkisë Roskovec", **nënobjekti:** "**Rikonstruksioni i rrugës Spahiu, fshati Strum, L = 300 ml , b = 4m asfalt**" | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **14.Lidhja e kontratës**<br>Nr.2332 prot., datë 06.04.2023 | **15.Vlera e kontratës (me tvsh)** 2 491 200<br>**OE fitues "**L. K." Shpk | | **16. Likuiduar lekë** | |
| **17- Situacioni Përfundimtar**<br>**-Vlera me tvsh 2,130,520.80lekë**<br>**-Vlera pa tvsh 1,775,434 lekë** | **18.Afati i kontratës në dite**<br>Parashikuar (1 muaj), Zbatuar 1 muaj.<br>Fillimi punimeve: 19.04.2023<br>Përfundimi punimeve : 18.05.2023 | | **19. Zgjatja e kontratës** | |
| 20. **Mbikëqyrësi i punimeve**<br>OE "A." Shpk | Licenca Nr:<br>MK 1997/4 | Kontrata nr 1394 prot., datë 03.03.2023. | Vlera e Kontratës (me Tvsh) lekë | Likujduar (me Tvsh) 0.0 leke |
| 21. **Kolaudatori i punimeve**<br>Ing. V. A.<br>OE "S." shpk | Licenca Nr:<br>MK 0994/4 | Kontrata nr. 8191 prot., datë 22.12.2023 | Vlera e Kontratës (me Tvsh)<br>38 880 lekë | Likujduar (me Tvsh)<br>Xxxx lekë |
| **22.Akt Kolaudimi**<br>Datë 29.01.2024 | **23.Akt i marrjes në dorëzim**<br>Nuk është marr në dorëzim | | | |

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **293,950 lekë pa Tvsh**.

Situacionimi i volumeve jo në përputhje me projektpreventivin dhe faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me:
- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimi", i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12.

- Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" e konkretisht Kreu II, Pika 3.
- Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr.2332 prot., datë 06.04.2023.
- Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me 1394 prot., datë 023.03.2023
- Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve, sipas aktit me nr. 8191 prot., datë 22.12.2023.

Në mënyrë të përmbledhur nga auditimi i dosjes teknike dhe i zbatimit të punimeve përkontratën me objekt: **"Rikonstruksioni i rrugës Spahiu, fshati Strum, L = 300 ml , b = 4m asfalt", u konstatua:**
Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se punimet, sipas njoftimeve përkatëse kanë nisur më nisur me datë 19.04.2023. dhe kanë përfunduar me datë 18.05.2023 brenda afatit të parashikuar në kontratë
Është bërë akti i dorëzimit të sheshit të ndërtimit në datën 19.04.2023, sipas të cilit "*...nga verifikimi në vend i sheshit, u konstatua se sheshi është i lire dhe sipërmarrësi i punimeve merr në dorëzim sheshin e punimeve për realizimin e kontratës...*".
Punimet kanë përfunduar më datë 18.05.2023 sipas afateve të parashikuar në amendamentin e kontratës. Garancia e punimeve është 12 muaj.
-Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume pune ndërtimi në vlerën **293,950 lekë pa Tvsh**.

**6.5.** Objekti i nënkontratës: "**Rikonstruksioni i rrugës Hazizaj, fshati Strum, L = 270 ml , b = 4m asfalt".**

<table>
<tr><td colspan="5">b/6. Zbatimi i Marrëveshjes së punimeve: "Asfaltimi i rrugëve të brendshme në lagjet e Bashkisë Roskovec", nënobjekti:"Rikonstruksioni i rrugës Spahiu, fshati Strum, L = 300 ml , b = 4m asfalt"</td></tr>
<tr><td>14.Lidhja e kontratës<br>Nr. 2332 prot., datë 06.04.2023</td><td colspan="2">15.Vlera e kontratës (me tvsh) 2,242,080<br>OE fitues "L. K." Shpk</td><td colspan="2">16. Likuiduar lekë<br>xxxxxxx lekë</td></tr>
<tr><td>17- Situacioni Përfundimtar<br>datë xxxx<br>-Vlera me tvsh 2,242,080 lekë<br>-Vlera pa tvsh 1,868,400 lekë</td><td colspan="2">18.Afati i kontratës në dite<br>Parashikuar (1 muaj) Zbatuar 1 muaj.<br>Fillimi punimeve: 19.04.2023<br>Përfundimi punimeve : 18.05.2023</td><td colspan="2">19. Zgjatja e kontratës</td></tr>
<tr><td>20. Mbikëqyrësi i punimeve<br>OE "A." Shpk</td><td>Licenca Nr:<br>MK 1997/4</td><td>Kontrata nr 1394prot., datë 03.03.2023.</td><td>Vlera e Kontratës (me Tvsh) lekë</td><td>Likuiduar (me Tvsh) 0.0 leke</td></tr>
<tr><td>21. Kolaudatori i punimeve<br>Ing. V. A.<br>OE "S." Shpk</td><td>Licenca Nr:<br>MK 0994/4</td><td>Kontrata nr. 8191 prot., datë 22.12.2023</td><td>Vlera e Kontratës (me Tvsh)<br>17,880 lekë</td><td>Likuiduar (me Tvsh) lekë</td></tr>
<tr><td>22.Akt Kolaudimi<br>Datë 29.01.2024</td><td colspan="2">23.Akt i marrjes në dorëzim<br>Nuk është marr në dorëzim</td><td colspan="2"></td></tr>
</table>

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **285,950 lekë pa Tvsh**.

Situacionimi i volumeve jo në përputhje me projekt-preventivin dhe faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me:
- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimi", i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12.

- Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" e konkretisht Kreu II, Pika 3.
- Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr.2342 prot., datë 06.04.2023.
- Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me 1394 prot., datë 023.03.2023
- Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve, sipas aktit me nr. 8191 prot., datë 22.12.2023.

**Në mënyrë të përmbledhur nga auditimi i dosjes teknike dhe i zbatimit të punimeve për kontratën me objekt: "<u>Rikonstruksioni i rrugës Hazizaj, fshati Strum, L = 270 ml , b = 4m asfalt</u>", u konstatua:**

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se punimet, sipas njoftimeve përkatëse kanë nisur më nisur me datë 19.04.2023. dhe kanë përfunduar me datë 18.05.2023 brenda afatit të parashikuar në kontratë

Është bërë akti i dorëzimit të sheshit të ndërtimit në datën 19.04.2023, sipas të cilit "*...nga verifikimi në vend i sheshit, u konstatua se sheshi është i lire dhe sipërmarrësi i punimeve merr në dorëzim sheshin e punimeve për realizimin e kontratës...*".

Punimet kanë përfunduar më datë 18.05.2023 sipas afateve të parashikuar në amendamentin e kontratës. Garancia e punimeve është 12 muaj.

-Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume pune ndërtimi në vlerën **285,950 lekë pa Tvsh**.

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **2,084,900 lekë pa Tvsh**.

Nga auditimi u konstatuan diferenca në volume për punime të deklaruara të kryera në objektin:"Asfaltimi i rrugëve të brendshme në lagjet e bashkisë Roskovec", Bashkia Roskovec, me nën objekte si më poshtë:

1. "Rikonstruksion i rrugës"Argjinaturës", Agacaj, 440ml, b=4m asfalt"; -
2. "Rikonstruksion i rrugës "Rukallarëve", fshati Suk 2,200 ml, b=4m asfalt";
3. "Rikonstruksion i rrugicave së Cjepëve, fshati Suk 1 ,485 ml , b=4 m asfalt , bankine-2x0.5m)"
4. "Rikonstruksion i rrugës "Spahiu" fshati Strum, L=300ml b=4m asfalt";
5. "Rikonstruksion i rrugës "Hazizajve" fshati Strum,270ml, b=4m asfalt", nga zbatuesi i punimeve OE "L. K." Shpk, për zërat e punimeve 6. 1- An 3.212/a; \

Konkretisht, janë konstatuardiferenca në volume dhe çmime në zërat e punës "Shtrese stabilizanti t=5cm";, për pasojë vlera e këtyre diferencave janë përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve. Situacionimi i volumeve jo në përputhje me projektpreventivin dhe faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimi", i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12., Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" e konkretisht Kreu II, Pika 3, Kontratën e sipërmarrjes së punimeve (Marrëveshje Kuadër) sipas aktit me nr. 1837 prot., datë 23.03.2023, Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. nr. 1394 prot., datë 03.03.2023, Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve, sipas aktit me nr. 8191 prot., datë 22.12.2023. me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **2,084,900 lekë pa Tvsh**.

***Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:***
1. Z. B. H. me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes;
2. Z. V. A. me detyrë kolaudator i kontratës së sipërmarrjes.

**7. Mbi auditimin e zbatimittë punimeve në objektin:"Ndërhyrje emergjente në fshatin Ngjeqar, Njësia Administrative Kurjan (Riparim i shkarjes në lagjen Stan, L=50L; Riparim i shkarjes në lagjen Gogallarët; Punime në rrugën Ngjeqan-Kurtaj; Punime për Përroin e Allambrezit )",** Bashkia Roskovec.

| **b. Zbatimi i Kontratës së Punimeve: "Ndërhyrje emergjente në fshatin Ngjeqar, Njësia Administrative Kurjan (Riparim i shkarjes në lagjen Stan, L=50L;Riparim i shkarjes në lagjen Gogallarët; Punime në rrugën Ngjeqan-Kurtaj; Punime për Përroin e Allambrezit )", Bashkia Roskovec** | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **14. Lidhja e kontratës**<br>Nr.. 9212 prot., datë 13.10.2022. | **15. Vlera e kontratës (me tvsh) 60,765,201** lekë<br>**BOE fitues** "2Z.K." & "A.&E." & "A.-Co" Shpk | | **16. Likuiduar lekë**<br>**Sipas aneksit të aktit** | |
| **17- Situacioni Përfundimtar datë**<br>**-Vlera lekë60,765,123** | **18. Afati i kontratës në dite**<br>Parashikuar 10 muaj, Zbatuar 10 muaj.<br>Fillim i punimeve: 29.09.2022<br>Përfundim i punimeve: 25.07.2023 | | **19. Zgjatja e kontratës** | |
| 20. **Mbikëqyrësi i punimeve**<br>Ekonomik "S." Shpk & "L.-I." Shpk | Licenca Nr:<br>MK. 0994/8,<br>MK 0985/7, | Kontrata nr. 9309 prot., datë 17.10.2022. | Vlera e Kontratës<br>1,594,182 lekë | Likujduar |
| 21. **Kolaudatori i punimeve** V. Dh. | Licenca Nr:<br>MK. 0096/3 | Kontrata nr. 7734/1 prot., datë 24.11.2023 | Vlera e Kontratës<br>40,500 lekë | Likujduar lekë |
| **22. Akt Kolaudimi**<br>Datë 30.11.2023 | 23. **Akt i marrjes në dorëzim**<br>datë12.12.2023 | | | |

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **993,329 lekë pa Tvsh**.

Nga audimi u konstatuan diferenca në volume për punime të deklaruara të kryera në objektin: **"Ndërhyrje emergjente në fshatin Ngjeqar, Njësia Administrative Kurjan (Riparim i shkarjes në lagjen Stan, L=50L; Riparim i shkarjes në lagjen Gogallarët; Punime në rrugën Ngjeqan-Kurtaj; Punime për Përroin e Allambrezit)", Bashkia Roskovec,** nga zbatuesi i punimeve BOE "2Z.K." Shpk & "A.&E." Shpk & "A.-Co" Shpk, për zërat e punimeve I. 10; I.11; I. 12; A. 6; A. 8; në volume dhe çmime në zërat e punës Ndërtim drenazhi me granil të larë (drenazhi kryesor)"; "F.V Gjeotekstil 280 gr/m2 për drenazhin kryesor", dhe "F.V Tub drenzh. i përforcuar Φ 200mm",për pasojë vlera e këtyre diferencave janë përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.Situacionimi i volumeve jo në përputhje me projektpreventivin dhe faktin, janë veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimi", i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" e konkretisht Kreu II, Pika 3, Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr. 9212 prot, datë 13.08.2023, Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. nr. 9309 prot, datë17.10.2023, Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve, sipas aktit me nr. 7734/1 prot., datë24.11.2024 me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **993,329 lekë pa Tvsh**.

**Në mënyrë të përmbledhur nga auditimi i dosjes teknike dhe i zbatimit të punimeve për kontratën me objekt: "Asfaltimi i rrugëve të brendshme në lagjet e bashkisë Roskovec", Bashkia Roskovec u konstatua:**

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se punimet, sipas njoftimeve përkatëse kanë nisur më nisur me datë 29.09.2023. dhe kanë përfunduar me datë25.07.2024 brenda afatit të parashikuar në kontratë
Është bërë akti i dorëzimit të sheshit të ndërtimit në datën 29.09.2023, sipas të cilit "*...nga verifikimi në vend i sheshit, u konstatua se sheshi është i lire dhe sipërmarrësi i punimeve merr në dorëzim sheshin e punimeve për realizimin e kontratës...*".
Punimet kanë përfunduar më datë 25.07.2024 sipas afateve të parashikuar në amendamentin e kontratës. Garancia e punimeve është 12 muaj.
-Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume pune ndërtimi në vlerën **993,329 lekë pa Tvsh**.
***Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:***
1. Z. B. H. dhe N. P., me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes;
2. Z. V. A., me detyrë kolaudator i kontratës së sipërmarrjes.

**2.5 Mbi organizimin dhe funksionimin e strukturave mbi administrimin e pronës**
Në zbatim të ligjit nr. 8744, datë 22.01.2011,"Pë transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore,VKM nr. 500,datë 14.08.2001, "Për inventarizimin e pronave të paluajtshmeshtetërore dhe transferimin e pronave të paluajtshmeshtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore "; VKM nr. 433, datë 8.6.2016 "Për transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe të Kullotave Publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/Bashkive"; pika 66 dhe UMF nr. 30 datë **27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", kap. III,** pika 30,35/a; VKM nr. 510, datë 10.06.2015 "Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të pa trupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo- territorial", Kreu III, pika 1 dhe UKM nr. 1, datë 18.7.2012 "Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara", kreu V, pika 4 dhe ligjit 139/2015 datë 17.12.2015 për qeverisjen vendore dhe ligjit 9936, date 26.06.2008, për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" në Bashkinë Roskovec rezulton si më poshtë:
Në Bashkinë Roskovec sipas VKM nr. 770 datë 24.09.2010, VKM me nr.1210 datë 11.12.2009, VKM me nr.108 datë 17.02.2010 rezultojnë se janë gjithsej **596 prona** prona të Bashkisë Roskovec, që kanë kaluar në administrim të Bashkisë Roskovec dhe të 4 njësive administrative me sipërfaqe totale 384,31 ha, e ndarë në Njësinë Administrative Roskovec, 211.33 ha, në Njësinë Administrative Kuman 107.34 ha, në Njësinë Administrative Krujan 14.26 ha, dhe në Njësinë Administrative Strum 51,28 ha.
Nga këto janë certifikuar nga ASHK- Fier 20 prona kryesisht shifër shumë e ulët për administrimin dhe manaxhimin e aseteve dhe pronave që disponon Bashkia Roskovec, pasqyra si me poshtë:
***Lista e pronave të Bashkisë Roskovec me certifikatë pronësie***

| Nr. | Numri i Pasurisë | Zona Kadastrale | Lloji i Pasurisë | Siperfaqja e Pasurisë /m2 | Siperfaqja e Pasurisë, Truall/m2 | Siperfaqja e Pasurisë, Ndertesë/m2 | Data e Lëshimit të Certifikatës |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 139 | 3196 | Kenete | 560000 | - | - | 30.07.2013 |
| 2 | 2/458 | 3196 | Shkolle 9-vjacare "Alush Grepcka" | 8438 | 8438 | 596 | 08.11.2021 |
| 3 | 3/298 | 3196 | Truall | 1500 | 1500 | - | 13.09.2021 |
| 4 | 2/457 | 3196 | Truall | 330 | 330 | - | 08.11.2021 |
|  | 2/457/ND-1 | 3196 | Ndertes | 240 | - | 240 | 10.12.2021 |
| 5 | 51/14 | 1992 | Fushe Sporti | 6820 | - | - | 23.11.2010 |
| 6 | 198/18 | 2599 | Kenete | 8000 | - | - | 20.07.2010 |
| 7 | 198/24 | 2599 | Kenete | 4380 | - | - | 18.05.2012 |
| 8 | 213/1 | 3805 | Truall | 8970 | - | - | 21.02.2023 |
| 9 | 82/75 | 3805 | Shkolla 9-vjecare "Jashar Muhameti" | 1000 | 1000 | 439 | 13.10.2017 |
| 10 | 144 | 2599 | Shkolla 9-vjecare "Naun Doko" | 5900 | 5900 | 500 | 07.07.2015 |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 11 | 131/11 | 3767 | Truall | 316 | 316 | - | 17.08.2010 |
| 12 | 131/12 | 3767 | Truall | 120 | 120 | - | 17.08.2010 |
| 13 | 175 | 2326 | Are | 6000 | - | - | 10.06.2010 |
| 14 | 299 | 2497 | Shkolla 9-vjecare "Jorgo Sopiku" | 12375 | 12375 | 487 | 24.04.2020 |
| 15 | 300 | 2497 | Terren Sportiv | 2437 | - | - | 24.04.2020 |
| 16 | 298/3 | 2497 | Pyll | 46440 | - | - | 28.06.2022 |
| 17 | 58/13 | 3537 | Qender Shendetesore Suk1 | 693 | 693 | 119 | 29.09.2021 |
| 18 | 58/60 | 2336 | Qender Shendetesore Kurjan | 200 | 200 | 125 | 06.11.2017 |
| 19 | 82/79 | 3805 | Qender Shendetesore Vlosh | 60 | 60 | 38 | 13.10.2017 |
| 20 | 44/19 | 2628 | Shkolla fshati Mbers | 400 | 400 | 236 | 17.02.2016 |
| | | | **TOTALI** | **674,619.00** | 31332 | 2780 | |

Për ndjekjen e procedurave sipas VKM nr.500, datë 14.8.2001 "Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore";
Kanë kaluar për pajisjen me certifikatë regjistrimi 20 prona në sipërfaqen totale 674,619 $m^2$ kryesisht Qendrat Shëndetësore,Shkollat, pyje, truall etj.
Pra nga sipërfaqja totale e 596 pronave është 3,843,100 $m^2$ nga këto janë pajisur me certifikatëpronësie 674,619 $m^2$ ose 17.5% e totalit janë të regjistruara me Certifikatë Regjistrimi të Pronësisë në ASHK- Fier.
Në Bashkinë Roskovec *"Nuk ka regjistër të pronave sipas komunave të specifikuara me sipërfaqet me kufizimet, me vlerat përkatëse secili objekt dhe të jenë kontabilizuar në bilancin përkatës të bashkisë, si dhe nuk pasqyrohen vijueshmëria dhe me të dhënat dhe modalitetet përkatëse deri në plotësimin e dosjeve të secilit objekt deri në pajisjen me Certifikatë Pronësie pranë ASHK-Fier".*
Pra nga 596 prona janë pa u certifikuar 576 prona për tu pajisur me Certifikate Pronësie nga ASHK-Roskovec. Sipas pasqyrës rezulton se në vitin 2023 është regjistruar dhe pajisur me certifikatëpronësie vetëm 1një objekt për sipërfaqen 8,970 $m^2$, në vitin 2022 është regjistruar dhe pajisur me certifikatëpronësie një objekt për sipërfaqen 46,440 $m^2$ pyll,në vitin 2021 është regjistruar dhe pajisur me certifikatë pronësie katër objekte për sipërfaqen 10387 $m^2$ dhe në vitin 2010 deri 2017 janë regjistruar dhe pajisur me certifikatë pronësie 16 objekte për sipërfaqen 608,822 $m^2$, pra shifër mjaft e ulet me mesatare një objekt "Në vit "pra duhen dekada me ketë ritem për tu paisur me certificatë pronsie Bashkia Roskovec.
-Nga të dhënat nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit nuk ka funksionuar gjatë vitit 2023 sektori i pronave pasi ka dhe mungesë specialistësh dhe vende vakante në këtë sektor, sipas organigramës me nr. 266 prot., datë 16.01.2023 në pikën 4.3 "Sektori i menaxhimit të pronave" janë planifikuar 3 punonjës sipas Vendimit nr. 11 datë 16.01.2023, të ndryshuar me Vendimin nr. 105, datë 31.08.2023 me nr 5124 prot., datë 31.08.2023 dhe faktikisht janë 2 specialist.
Gjatë vitit ushtrimor të vitit 2023 dhe formularëve të paraqitur për inventarizimin e pronave të paluajtshme ose aktive të qëndrueshmeshtetërore rezulton se në Bashkinë Roskovec janë gjithsej **596 prona** të paluajtshme si, shkolla, troje, sheshe, pemëtore, arra, spitale, zyra, rruge, kanale, lulishte, varreza, pyje, moçalishte, kodrina, pyje,kullota etj, në 4 NJA që janë në vartësi të Bashkisë Roskovec, Njësia Administrative Roskovec, Njësia Administrative Kuman, Njësia Administrative Krujan, Njësia Administrative Strum, **për p**ronat për të cilat Bashkia Roskovec nuk ka pajisura të pajisur me Certifikatë Regjistrimi Pronësie, mungojnë Hartë Treguese topografike, të secilës pronë, regjistër me të dhënat e secilës pronë dhe nuk ka të dhëna nëse, këto prona janë fizikisht apo janë zaptuar (Shif tabelën si më poshtë me VKM përkatëse të secilës njësi administrative).
Njësitë administrative të Bashkisë Roskovec me pronat në përdorim
Inventarët e pronave publike të miratuar me VKM dhe në Bashkisë Roskovec dhe Njësive Administrative në juridiksion të Bashkisë Roskovec

| Nr. | Bashkia Roskovec<br>Njesite Administrative | Vendimi iKëshillit të Ministrave | Faza e Kalimit | Nr rendore te pronave ne listen e inventarit |
|---|---|---|---|---|
| **1** | Nj. Administrative Roskovec | VKM nr. 770 date 24.09.2010<br>VKMnr.27 date 27.01.2023 | Liste perfundimtare<br>Liste perfundimtare | 161<br>1 |
| **2** | Nj. Administrative Kuman | VKM nr. 1210 date 11.12.2009 | Liste perfundimtare | 152 |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **3** | Nj. Administrative Kurjan | VKM nr. 108 date 17.02.2010 | Liste perfundimtare | 125 |
| **4** | Nj. Administrative Strum | VKM nr. 241 date 25.04.2007 | Liste paraprake | 157 |
| | **Totali** | | | **596** |

Pra konstatojmë se nuk mbajtur regjistër për ndjekje procedurave ligjore sipas rasteve, kohës së aplikimit, bashkëpunim me institucionet e tjera kryesisht ASHK-Fier me të dhënat me modalitetet përkatëse për sipërfaqet, kufizimet, matjet e kryera nga topografi, shkresat e nisura pranë Ashk, zaptimet e ndryshimet që mundet të kenë këto prona, pra sa me lart mbajnë përgjegjësi E. K. me detyrë Përgjegjës i Sektorit dhe Menaxhimit të Pronave dhe E. R. me detyrë Topograf për pronat si dhe punonjësit B. D. dhe E. F. dhe F. G.

Në administrim të Bashkisë Roskovec janë në administrim pyje dhe kullota 208.21 ha nga këto deri janë pajisur me Certifikatë Regjistrimi Pronësie 4.64 ha në vitin 2022 në ZK.2497 me nr. pasurie 298/3 pra një sipërfaqe e pa përfillshme për sipërfaqen që disponon Bashkia Roskovec. Në ndjekje të procedurave për regjistrimin e pyjeve dhe kullotave në vitin 2017 sipas shkresës me nr. 97 prot., data 12.01.2017 kanë dërguar dokumentacionin për regjistrimin pranë ZRPP-Fier listën e inventarit sipas VKM nr. 433, datë 08.06.2016, planvendosjet për 27 pasuri, plan rivelimin për 27 pasuri si dhe relacionin për këto pasuri.

Mbas këtij veprimi nuk është ndjekur procedura per bashkëpunim me ASHK- Fier për pajisje me certifikatë regjistrimi në pronësi nga Bashkia Roskovec nga viti 2016 deri në vitin 2023 "periudha që auditohet".

- Në strukturë e Sektori i Pyjeve përbëhet nga 6 punonjës "Përgjegjësi teknik për menaxhimin e pyjeve ,ujitjes, inxhinierteknik, punonjës administrative, punonjës për ujitjen dhe punonjës për stacionin e pompimit dhe kullimit.

Sipas dokumenteverezulton se:

-Nuk kanë as një sipërfaqe nga pyje e kullota të lëshuar me qira për aktivitete tregtare.

- Nuk kanë as një sipërfaqetë lëshuar me qira për kullota për bagëtitë të imta e të trasha.

- Nuk kanë as nje masë administrative për zjarre ose gjoba për dëmtimet që mundet të jenë kryer.

- Gjatë vitit 2023, janë mbajtur 31 procesverbale nga këto në 29 raste me përshkrimin "Nuk është konstatuar as një shkelje ose zjarrvënje", në dy raste përshkruhet se në datën 11.09.2023 ka rënje zjarri në sipërfaqen 2000$m^2$ , "Pa autor " dhe procesverbali i datës 14.10.2023 nga punonjsit B. D., E. F. dhe F. G. në prerjen e pyllit me nënshkrimin "Nuk dihet autori", proces verbalet janë me printim direkt nga kompjuteri, pa numër serial, pa ciklim dhe theksojmë se specialistët janë me arsimin e mesëm në 3 raste *"Pa arsimin përkatës"* pra ka vend për subjektivizëm nga specialistët e pyjeve.

***- Specialistët e rruajtjes së pyjeve "Nuk janë pajisur me proces verbale me numër serial dhe të cikluar nga titullari" .***

Pra menaxhim jo cilësor pa efektivitet , me performancë të ulet dhe pa as një "Kostatim" dhe me informacione formale, pa as një kostatim konkret dhe korrekt në detyrën e caktuar dhe në 2 raste kanë qenë vetëm kostatues, mbas ngjarjes, pra me veprime e mos veprime që bien në kundërshtim me ligjin nr 57/2020 "Per pyjet" ku shprehimisht thuhet per detyrat e specialistit: Profesionistët e pyjeve:

- Në kuptim të këtij ligji, profesionistë të pyjeve janë: a) punonjësit e institucioneve përgjegjëse për pyjet, në nivel qendror dhe vendor; b) specialistët e institucioneve të arsimit profesional dhe të arsimit të lartë në fushën e pyjeve; c) stafi teknik dhe profesional i institucioneve përgjegjëse për pyjet; ç) ekspertët në fushën e pyjeve.

*Neni 34 shprehimisht thuhet*: ç) ndëshkimin me gjobë në përputhje me kufijtë dhe parashikimet e këtij ligji, si dhe ekzekutimin e saj; d) vendimin për pagimin dhe rehabilitimin e dëmeve të shkaktuara në fondin pyjor, si dhe ekzekutimin e tyre; dh) kallëzimin penal sipas rastitsi dhe Ligj Nr. 48/2016 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9385, datë 4.5.2005, "Për pyjet dhe shërbimin pyjor", të ndryshuar si dhe neni 38 (Procedimi në fondin pyjor).

**-Auditim mbi procedurat e dhënies me qira të tyre dhe likuidimi i detyrimeve për kontratat e lidhura.**

Bashkia Roskovec ka dhënë me qira 19 prona kryesisht "Objekte" nga këto në vitin 2023 janë dhënë vetëm 2 objekte në vitin 2023 me afat qiraje një vjeçar, ndërsa në katër raste të dhënies me qira të objekteve janë dhënë në vitin 2021 me afat 30 vjeçar dhe një objekt në vitin 2020 me afat 30 vjeçar, konstatohet se kanë marrë informacion nga ASHK Fier," Vërtetim Hipotekor" + për pronën qe është e regjistruar si prone e Bashkisë Roskovec në vitin 2020 për sipërfaqen 70 $m^2$ për 30 vjet qytetarit F. K., në vitin 2021 janë marre nga ASHK Fier," Vërtetim Hipotekor"për pronën me sipërfaqe 84 $m^2$, 78$m^2$, 64$m^2$,dhe 84 $m^2$ (Shif tabelën si me poshtë) janë dhënë me qira për 30 vjet dhe në vitin 2022 dhe vitin 2023 kane dhënë 2 objekte me sipërfaqet 60 $m^2$ dhe 122 $m^2$ me afat një vjeçar.

Nga sa me sipërkonstatojmë se objektet e dhënë me qira nga viti 2020 deri ne viti 2023 janë gjithsej "***shtatë objektet*** *nuk janë të pajisura me Certifikatë Pronësie nga ASHK-Fier"* dhe nuk na u paraqit asnjëdokument për ndjekje procedurash sipas nenit 43 të ligjit nr. 20/2020 "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë" (si më poshtë pasqyra përkatëse, Aneksi 11).

Kontratat e lidhura nga Bashkia Roskovec për dhënien me qira të tokave bujqësore.

| Nr. | Subjekti | Kontrata | Data | Afati në vite | Sipërfaqja në ha/m² |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | E. B. B. | Qera toke bujqesore | 18.08.2021 | 99 vjet | 4 ha |
| 2 | B. K. C. | Qera toke bujqesore | 09.09.2021 | 99 vjet | 1 ha |
| 3 | S. I. | Qera toke bujqesore | 05.10.2010 | 33 vjet | 1.14 ha |
| 4 | L. G. | Qera toke bujqesore | 23.05.2012 | 33 vjet | 0.438 ha |
| 5 | B. S. | Qera toke bujqesore | 02.01.2012 | 33 vjet | 0.5615 ha |
| 6 | Dh. K. | Qera toke bujqesore | 19.11.2013 | 10 vjet | 0.85 ha |
| 7 | A. S. | Qera toke bujqesore | 05.11.2010 | 99 vjet | 0.1725 ha |
| 8 | M. Sh. | Qera toke bujqesore | 30.08.2010 | 99 vjet | 2.5 ha |
| 9 | L. S. | Qera toke bujqesore | 23.03.2012 | 30 vjet | 20 ha |
| 10 | B. P. LTD | Qera toke | 08.01.2021 | 3 vjet | 1.3153 ha |
| 11 | B. P. LTD | Qera toke | 08.01.2021 | 3 vjet | 0.9142 ha |
| 12 | A. L. Shpk | Qera toke bujqesore | 04.03.2022 | 35 | 3 ha |
| | **Total** | | | | |

**Burimi:** Bashkia Roskovec, përpunoi grupi i auditimit

Në **Pasqyrën Aneksi nr.11:** Kontratat për dhënien me qira të ndërtesave/objekteve apo enfiteozë

| Nr. | Subjekti | Nipti | Afati | Viti i lidhjes së kontratës | Sipërfaqe në $m^2$ |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | A. B. | | 1 vjecare | 01.09.2022 | 60 $m^2$ |
| 2 | Zyra Arsimore | | 1 vjecare | 28.03.2023 | 122$m^2$ |
| 3 | F. K. | familje | 30 vjet | 19.11.2020 | 70$m^2$ |
| 4 | S. L. | familje | 30 vjet | 23.03.2021 | 84$m^2$ |
| 5 | G. H. | familje | 30 vjet | 24.03.2021 | 78$m^2$ |
| 6 | M. B. | familje | 30 vjet | 08.03.2021 | 65$m^2$ |
| 7 | T. L. | familje | 30 vjet | 23.03.2021 | 84$m^2$ |
| **Totali** | | | | | |

Pra me veprime e mos veprime si dhe mos marrja e masave në kohë me ndryshimet e fundit ligjore që favorizojnë dhe lehtësojnë tarifat sipas ligjit nr. 20/2020 "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë" sipas nenit 43 ku citohet: *"Tarifat e regjistrimit për institucionet shtetërore dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore"*

a- *Për regjistrimin fillestar të pronave të institucioneve shtetërore dhe të njësive të vetëqeverisjes vendore aplikohen tarifa shërbimi "**të reduktuara**", sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për kadastrën.*

Nga auditimi i pasqyrave dhe ndjekja e procedurave të inventarizimit dhe vlerësimit të aseteve, u konstatua se Bashkia Roskovec nuk ka arritur të certifikojë dhe regjistrojnë pronat që ka në administrim në 4 njësitë në varësi të saj. Nga 596 asete në përdorim, rezulton se vetëm 20 objekte janë pajisur ne certifikatë pronësie dhe 576 asete nuk janë pajisur me certifikatë pronësie ose në 97% të tyre nuk janë ndjekur procedurat për ti regjistruar në ASHK- Fier. Lidhur me këtë konstatim, rezulton se në Drejtorinë e Urbanistikës në Bashkinë Roskovec, e cila aktualisht administron edhe çështjet e pronësisë dhe aseteve në këtë Bashki, ka mungesë

personeli, ku rrezulton se janë vakante 6 vende me pasojë mos funksionim përkatësisht të Sektorit të Administrimit dhe Menaxhimit te Aseteve, Planifikimit të Territorit, Emergjencave Civile, Hartimit të Projekteve, Integrimit Evropian dhe Marrëdhënieve me Publikun, veprime këto në kundërshtim me nenin 4, neni 5 dhe neni 43 i Ligjit nr. 20/2020 "Për kadastrën".
Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi për mos administrim të pronave dhe aseteve si dhe ne drejtim të menaxhimit, organizimit dhe funksionimit të strukturave mbi regjistrimin administrimin e pronës publike (asetet dhe pyjet kullotave) të transferuara sipas VKM nr. 241 datë 25.04.2007, VKM nr. 1210, datë 11.12.2009, VKM nr. 770, datë 24.09.2010,VKM nr. 108, datë 17.02.2010 dhe VKM nr. 27, datë 27.01.2023, për mos ndjekjen e procedurave dhe regjistrimit e tyre në ASHK sipas nenit 43 ligjit nr. 20/2020 "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në RSH", pra me veprime e mos veprime janë në kundërshtim nenet 34 e 38 të ligjin nr. 57/2020 "Për pyjet", në kundërshtim me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 "Për disa ndryshime në VKM nr. 391 datë 21.06.2006 "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave" pika 2 lidhja 11, nga Kryetaria zj. M. B., z. E. K. me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Menaxhimit të Pronave, z. V. K. me detyrë Përgjegjës Teknik për Menaxhimin e Pyjeve, Ujitjes dhe Kullimit, z. B. D. me detyrë Punonjës në Mirëmbajtjen e Pyjeve, z. A. G. Punonjës Administrativ, për Pyjet, Ujitjen dhe Kullimin, z. E. R. me detyrë Topograf, z. E. F. Specialist.

**2.6 Të ndryshme të dala gjatë auditimit.**
Nga audituesit e KLSH-së u auditua procedura e prokurimit me objekt: "Mbikëqyrje punimesh për objektin: "Rivitalizimi i Liqenit të Kurjanit", Bashkia Roskovec, si rezultat i ankesës administruar në KLSH me nr. 450 prot., datë 02.04.2024 dërguar nga z. H. L. e z. A. Zh. ku shprehen: *"Në datën 25.03.2024, Bashkia Roskovec shpalli procedurën e prokurimit sipas Ftesës për Ofertë. Siç duket dhe në ftesën për ofertë nuk jepet asnjë e dhënëmbi të cilat të 1llogarisim -vlerën që duhet të ofertojmë,duke marrë parasysh që vlerat për mbikëqyrjen dhekolaudimin e punimeve të ndërtimit llogariten duke ubazuar tek VKM nr. 354, datë 11.05.2016, duke njohur vlerën e objektit kryesor, i kemi kërkuar informacion në sistem,dhe nuk na është kthyer asnjë përgjigje. Kjo na bën të mendojmë që fituesi ishte paracaktuar.*
*Gjithashtu, duam të theksojmë se pjesa më e madhe e institucioneve abuzojnë me mënyrën e llogaritjes sëkëtyre vlerave, duke luajtur me shifrat pas presjevedhjetore, me kriteret teknike si tu dojë qejfi, pasi nëpjesën më të madhe të procedurave fituesit paracaktohen.*
*Për një procedurë 300 mijë lekë të reja kërkohet që mbikëqyrësi i punimeve të ketë 10 të punësuar, të ketë GPS, të ketë shofer etj, etj. Ka ngelur të kërkohen goma rezervë apo marka telefonash, çizme, mekanikun me vete mos na çahet goma rrugës.*
*Kërkojmë që procedura e mësipërme të anullohet dhe të rihidhet me të dhënat e plota, dhe gjithashtu tu kujtohet institucioneve të zbatojnë ligjin, duke marrë masa.*

**Për auditimin e kësaj procedure u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:**
1. Regjistri i prokurimeve për periudhën objekt auditimi 01.01.2023-31.12.2023.
2. Dosja e procedurës së prokurimit sipërcituar.
3. Dokumentacioni i prokurimit në sistemin elektronik të APP-së.
4. Përllogaritja e fondit limit.

Nga Nënkryetari i Bashkisë Roskovec z. M. G. me Vendimin nr. 65, nr. 2044 prot., datë 19.03.2024, në mbështetje të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, të ligjit 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjen vendore", Udhëzimi nr. 9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", VKB nr. 109, datë 21.12,2023 "Për miratimin në buxhetit dhe numrin maksimal të punonjësve të Bashkisë Roskovec për vitin 2024", është vendosur që:
1. Rishpërndarjen e fondeve buxhetore në planin e shpenzimeve për investime, si më poshtë vijon:

*Pakësohet:* Zëri "Mbikëqyrje dhe kolaudim punimesh". (Gr.00 Tit. 04520 Kap.05, Art.23 1) kodi i institucionit 2113001: 700,000 lekë. Shuma: 700,000 lekë
*Shtohet*: Zëri "Mbikëqyrje punimesh për objektin: "Rivitalizim i Liqenit të Kurjanit", (Gr.00 Tit. 04520 Kap.05, Art.231), kodi i institucionit 21 13001: 700,000 lekë.
Shuma: 700,000 lekë.
2. Për të gjitha këto rishpërndarje fondesh behën ndryshimet përkatëse në Regjistrin e Parashikimeve të prokurimeve publike të vitit 2024.
3. Ngarkohet Drejtoria Ekonomike dhe Sektori i Prokurimeve për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë. (nënshkruar nga, në mungesë dhe me urdhër) z. A. D. me shkresën nr. 1964 prot., datë 13.03.2024 i është drejtuar Sektorit të Prokurimeve Publike (për dijeni: Kryetares së Bashkisë) ku citohet: *"Referuar VKB nr. 109, datë 21.12.2023 "Për miratimin e buxhetitnumrin maksimal të punonjësve të bashkisë dhe ndërmarrjeve vartëse të bashkisë për vitin 2024".*
*Kërkojmë nga ana juaj të bëhet procedura e prokurimit publik për mbikëqyrje punimesh përobjektin; "Rivitalizimi i Liqenit të Kurjanit".*

Me nr. 2053 prot., datë 19.03.2024 Urdhri "Për ngritjen e KLLFLST" me përbërje: 1. S. Ç. (Drejtor Ekonomik), 2. F. Xh. (Specialist për Emergjencat Civile), 3. Xh. D. (Specialist për Strehim Social dhe Çështje Ligjore).
Në dosje gjendet procesverbali me nr. 2053/1 prot., datë 20.03.2024 i KLLFLST për miratimin e fondit limit me vlerën 573,434 lekë pa Tvsh.
KLLFLST me nr. 2053/2 prot., datë 20.03.2024 ka hartuar/nënshkruar Relacionin mbi për llogaritjen e fondit limit ku perifrazohet:
Në mbështetje të VKM nr. 354 datë 11.05.2016, Seksioni IV "Strukturat e transportit dhe qarkullimit": nenet 40-45. grupi tarifor në të cilën përfshihet ky objekte është "Grupi i IV tarifor", nga përllogaritjet ebëra nga KLLFLST rezultoi që për këtë objekt, fondi limit minimal i pranuar është 508,540 lekë pa Tvsh.
Në dosje gjenden Formularët e Deklarimit të mospasjes të konfliktit të interesit me nr. 2053/3 prot., datë 29.03.2024.
Komisioni i Blerjeve të vogla (M. G., N. Y. e V. Z.) me nr. 2143/2 prot., datë 29.03.2024 ka hartuar/nënshkruar "Procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim".
Në dosje gjenden Formularët e Deklarimit të mospasjes të konfliktit të interesit nga Komisioni i Blerjeve të Vogla me nr. 2143/3 prot., datë 29.03.2024.
Në procesverbal janë përcaktuar Specifikimet Teknike për procedurën e sipërcituar:

| |
|---|
| **I. Kriteret e veçanta të kualifikimit:** OE i renditur i pari, përpara se të shpallet fitues, duhet të dorëzojë pranë autoritetit kontraktor , dokumentet si më poshtë:<br>1.Ekstratin e QKB-së sipas objektit të kësaj procedure prokurimi,<br>2.Vërtetim banke ku të jenë të shprehura dhe të veçuara nga njëra-tjetra<br>1) NIPT<br>2) IBAN<br>**3)** NR.LLOGARIE<br>3.Çdo dokument i dorëzuar nga operatori ekonomik duhet të jetë kopje e noterizuar ose origjinalë.<br>4.Formularin e ofertës të detajuar me çmime sipas tabelës së mësipërme<br>5. Ky shërbim do të realizohet për: **Bashkinë Roskovec me NIPT- K52905407N**<br>6.Licenca:<br>• NP-4 Rrugë autostrada, ura, mbikalime, hekurudha;<br>• NP-1 Punime gërmimi në tokë;<br>• NS-8C Struktura druri<br>7. Në zbatim të ligjit nr.87/2019 "Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit", i ndryshuar, si dhe njoftimeve të APP-së, OE duhet të ketë kopje të Certifikatës elektronike për Fiskalizimin, për tatimpaguesit që përdorin Platformën Qendrore të Faturave. |

| |
|---|
| Operatori ekonomik duhet të ketë Kopje të Certifikatës elektronike për Fiskalizimin dhe Kopje të vlefshme të Kontratës së lidhur me Shoqërinë e Certifikuar për zgjidhjen softëere-ike në përdorim, për tatimpaguesit që lëshojnë faturat nëpërmjet zgjidhjes softëere-ike.<br>8. OE i renditur i pari, duhet të paraqesë pranë autoritetit kontraktor deri 1(**një) ditë pune dokumentacionin pas njoftimit të klasifikimit nëpërmjet sistemit elektronik.**<br>9. Afati i realizimit të shërbimit do te jete sipas periudhës se përcaktuar në kontratë. |

Urdhri i prokurimit me nr. 30, nr. 2143 prot., datë 25.03.2024 bashkangjitur "Ftesa për ofertë" me nr. 2143/1 prot., datë 25.03.2024, nënshkruar nga i Titullarit të AK.
**Në dosje gjendet:** Relacion Shpjegues mbi projektin: "Rivitalizimi i Liqenit të Kurjanit" ku shpjegohet që: Bashkia Roskovec ka realizuar projektin për objektin: "Rivitalizimi lidhja e tij me dhe pyllin e Luarit" "Kishën e Kurjanit" në vitin 2021. Projekti për këtë objektështë realizuar nga OE "A." Shpk. Preventivi i këtij objekti është vlerësuar me çmimet e VKM nr. 629, datë 15.07.2015 dhe për zërat e paparashikuar janë hartuar analiza teknike.
Liqenit të Kurjanit dhenë bazë të thirrjes të FSHZH "Thirrje për aplikim: Mbështetje me materialdhe lënde të parë pune" në gusht 2023, Bashkia Roskovec i është përgjigjur kësaj thirrje përlëndë të parë dhe jemi përfitues nga kjo thirrje.
Në bazë të marrëveshjes të lidhur me datë 05.12.2023 midis "Fondit Shqiptar të Zhvillimit" për Bashkinë Roskovec me objekt: "Mbështetje për realizimin e projekteve bashkiak e infrastrukturore nëpërmjet formave të bashkëpunimit të përbashkët- material dhe lëndë të parë pune, për realizimin e punimeve për projektin "Rivitalizimi i Liqenit të Kurjanit dhe lidhja e tijme pyllin e Luarit" "Kishën e Kurjanit", Bashkia Roskovec.
Në nenin 3 detyrimet e FSHZH "Në bazë të përzgjedhjes të projektit të aplikuar nga bashkia pasprocesit të vlerësimit, të sigurojë kontributin me furnizimin me material ndërtimit me lëndë tëparë, sipas listës bashkëlidhur kësaj marrëveshje dhe gjendjes së stokut, sipas kontratës së nënshkruar midis FSHZH dhe OE/BOE.
Në SPE kanë paraqitur interes për procedurën e sipërcituar 21 OE/PF:
1. OE "B. P." Shpk, (me Nipt: L....S) me ofertë ekonomike 508,540 lekë pa Tvsh.
2. OE "N. S." Shpk, (me Nipt: L.....C) me ofertë ekonomike 508,540 lekë pa Tvsh.
3. OE "2.&P H. S." Shpk, (me Nipt: M....P) me ofertë ekonomike 508,540 lekë pa Tvsh.
4. PF B. Y. (me Nipt: L.......S), me ofertë ekonomike 508,540 lekë pa Tvsh.
5. PF D. Ll. (me Nipt: M......F) me ofertë ekonomike 508,540 lekë pa Tvsh.
6. OE "O. C." Shpk (me Nipt: M......D) me ofertë ekonomike 508,540 lekë pa Tvsh.
7. OE "S.-A." Shpk, (me Nipt: M.......E) me ofertë ekonomike 508,540
8. OE "P. D. 20.." Shpk, (me Nipt: L......B) me ofertë ekonomike 508,541 lekë pa Tvsh.
9. OE "G. E. C." Shpk (me ofertë ekonomike 560,000 lekë pa Tvsh.
10. OE "A.-A." Shpk, (me Nipt: M......S) me ofertë ekonomike 561,000 lekë pa Tvsh.
11. OE "G & L C." Shpk, (me Nipt:L....N)
12. OE "M. C." Shpk, (me Nipt: K.....K)
13. OE "U. - S." Shpk, (me Nipt: K....C)
14. OE "F. A." Shpk, (me Nipt: L....J)
15. PF "V. Dh.", (me Nipt: K....E)
16. OE "I.-1." Shpk, (me Nipt: L....H)
17. OE "R. 9." Shpk, (me Nipt: J....V)
18. OE "S." Shpk, (me Nipt: J.....F)
19. OE "A. 2." Shpk, (me Nipt: M.....N)
20. OE "K. 20. C." Shpk, (me Nipt: M......I)
21. OE "V. E." Shpk, (me Nipt: M......)
Është konstatuar që 7 (shtatë) OE/PF pjesëmarrës kanë ofertë ekonomike me vlerë të njëjtë 508,540 lekë pa Tvsh.
Me procesverbalin e datë 03.04 2024 është formuluar/nënshkruar nga znj. A. Xh (Përgjegjësi i Prokurimit) dhe KBV është hedhur shorti në sallën e mbledhjeve kati dytë në bashki.

Në prani të pjesëmarrësve në konkurrim është realizuar shorti dhe gjithë konkurruesit kanë nënshkruar procesverbalin duke konfirmuar renditjen.
1. OE "N. S." Shpk; 2. OE "2.&P H. S." Shpk; 3. OE "S.-A." Shpk; 4. OE "B. P." Shpk; 5. OE "O. C." Shpk; 6. PF D. Ll.; 7. PF B. Y.
*Konstatohet që në short ka marrë pjesë edhe OE "2.&P H. S." Shpk, po ashtu edhe PF D. Ll. që nga auditimi konstatohet që nuk është në listën e personave që administron licencë për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit.*
Kontrata e sipërmarrjes për punë publike me nr. 2856 prot., datë 18.04.2024, është lidhur mes Autoritetit Kontraktor, Bashkia Roskovec, të përfaqësuar nga Titullari i Autoriteti Kontraktor znj. M. B. dhe OE "N. S." Shpk me administrator z. E. N. me vlerë të kontratës është **18,000,000** *(tetëmbëdhjetë milion)* **lekë pa Tvsh** (21,600,000 lekë me Tvsh).
Me urdhrin nr. 2850/1 prot., datë 18.04.2024 "Për caktimin e personave përgjegjës për zbatimin e kontratës" janë caktuar:
1. Drejtues kantieri z. A. D. me detyrë "Përgjegjës i Sektorit të Zbatueshmërisë së Investimeve".
2. Përfaqësuesi i Bashkisë për zbatimin e kësaj kontrate në terren do të jetë z. E. H. me detyrë Drejtor në Ndërmarrjen e Shërbimeve Komunale".

Formulari i njoftimit të publikimit të kontratës së nënshkruar fituesit me nr. 6176/2 prot., datë 16.10.2023, botuar në Buletinin nr. 89 datë 30 tetor 2023 në faqen 447/639.
Me Urdhrin nr. 62 e nr. 2850/1 prot., datë 18.04.2024 "Për caktimin e personave përgjegjës për zbatimin e kontratës" janë caktuar: 1. z. A. D. dhe z. E. H.
Në dosjen e procedurës së prokurimit gjendet me nr. 6176/3 prot., datë 18.10.2023 "Plani i zbatimit të kontratës".
**Si konkluzion:** Në lidhje me me përllogaritjen e fondit limit nga dokumentacion i dosjes së procedurës së prokurimit ankesa nuk qëndron pasi: KLLFLST me nr. 2053/2 prot., datë 20.03.2024 ka hartuar/nënshkruar relacionin mbi për llogaritjen e fondit limit.
Mendimi i ankimuesit që: "fituesi ishte paracaktuar" nuk është real pasi OE "2.&P H. S." Shpk dhe PF D. Ll. (që deklarohet si administratore e OE ankimues) kanë marrë pjesë në shortin për shpalljen e fituesit të procedurës, dhe kanë nënshkruar procesverbalin e hedhjes së shortit. Narrativa në vazhdim në ankesës nuk gjen bazueshmëri me procesin e auditimit të përcaktuar sipas drejtimeve të programit të auditimit.

## IV. GJETJE DHE REKOMANDIME

**Për përmirësimin e gjendjes, rekomandojmë marrjen e masave si më poshtë:**

### A. MASA ORGANIZATIVE

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion u konstatua se, nga Njësia e Auditimit të Brendshëm nuk janë marrë masa që në planet vjetore të auditimit, të programohet auditimi i fushave kryesore të veprimtarisë së institucionit, të cilat vlerësohen si fusha me risk të lart sipas nenin nr. 5 dhe nr. 6 të ligjit nr. 114/2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", nga Përgjegjësi i Njësisë së Auditimit të Brendshëm nuk është vepruar konform me Manualin e Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016, Kapitullin III, pika 3.2 "Plani vjetor i Auditimit", që kryhet nga vetë nga kjo njësi. Në disa dosje nuk ka gjurmë, nuk dokumentohet dhe nuk administrohet në shkresa përcjellëse e kthimit të Projekt Raportit nga pala e audituar (e konfirmuar dhe e nënshkruar nga titullari i subjektit të audituar dhe personat e përfshirë në auditim. Rekrutimi i punonjësve është kryer në kundërshtim me Ligjin nr. 114/2015 datë 22.10.2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", neni 11, pika 2, shkronjat "b" dhe

“c”. Struktura e NJAB funksionon me 3 punonjës konkretisht, nga të cilët një punonjës me detyrë specialiste e NJAB nuk është e certifikuar, në kundërshtim me Ligjin nr. 114/2015 datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, neni 11, pika 2, shkronja “c”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 14-26, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
**1.1 Rekomandimi:** Nga NJAB Bashkia Roskovec të realizohen të gjitha proceset në të gjitha fazat e auditimit në përputhje me MAB. Në raportet e auditimit të kryhen teste substanciale dhe analitike, në mënyrë që auditimet në fushatt me risk të lartë të jenë të thelluara, duke evidentuar mangësitë e sistemeve të kontrollit nëpërmjet formulimit të qartë të gjetjeve. Veprimtaria e AB të funksionojë si veprimtari që mbështet menaxhimin e kësaj njësie vendore për arritjen objektivave, duke ofruar siguri objektive dhe këshillim për të shtuar vlerën, duke garantuar certifikimin e të gjithë stafit të auditit të brendshëm.
**1.2 Rekomandimi:** Nga Njësia e Auditimit të Brendshëm të merren masa që në planet vjetore të auditimit, të programohet auditimi i Fushavekryesore të veprimtarisë së institucionit, të cilat vlerësohen si fushat me risk të lartë, si ngritja dhe implementimi i sistemit të kontrollit të brendshëm, prokurimet publike, në mënyrë që nëpërmjet rekomandimeve përkatëse ti jepet mbështetje titullarit të njësisë publike në arritjen e objektivave.
**1.3 Rekomandimi:** Nga Njësia e Auditimit të Brendshëm të merren masa që në rekrutimin e punonjësve te veprohet konform ligjit dhe të pajisur me certifikate te Auditimit të brendshëm.

***Në vijimësi***

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua që Bashkia Roskovec nuk ka parashikuar në strukturën e saj, Komitetin e Auditimit të Brendshëm. Struktura e projekt-raporteve dhe raporteve përfundimtare pjesë e dosjeve të auditimit të zhvilluar në vitin 2023, nuk është hartuar plotësisht në përputhje me urdhrin nr. 4 datë, 10.10.2020 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Në dosjet e auditimit të realizuar përgjatë vitit 2023, nuk janë bërë pjesë e Raportit Përfundimtar të Angazhimit, rubrikat e parashikuara si pjesë e Përmbledhjes Ekzekutive:
1) Rezultatet e auditimit;
2) Opinioni mbi vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm.
Nga verifikimi i Raporteve Përfundimtare të Angazhimit pjesë e dosjeve të auditimit u konstatua mungesa e rubrikës “Opinion i Përgjithshëm”. Dosjet e auditimit të brendshëm të njësive publike nuk arkivohen në arkivin e njësisë vendore. Njësia e Auditit të Brendshëm nuk ka çelur manualisht dhe elektronikisht dosjet e përhershme mbi njësitë e menaxhimit. Nuk është bërë pjesë e dosjes së auditimit njoftimi që duhet të kryejë grupi i auditimit për titullarin e njësisë publike, në rastet kur subjekti i audituar nuk njofton për planin e masave. Në dosjet e auditimit të realizuar nga Njësia e Auditimit nuk është dokumentuar plani i veprimit, i cili duhet të realizohet nga subjekti i audituar në vazhdën e rekomandimeve të lëna nga grupi i auditimit. Edhe pse vërtetohet se grupi i auditimit të brendshëm ka lënë për detyrë hartimin e një plani veprimi për zbatimin e rekomandimeve, nga verifikimi fizik i disa prej dosjeve të përzgjedhura u konstatua mungesa e planeve të veprimit nga ana e subjekteve të audituara. Në dosjet e auditimit nuk janë konstatuar shkresa rikujtuese nga ana e përgjegjësit të njësisë së auditimit drejtuar njësive të menaxhimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna.
Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me Ligjin nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, neni 13, Urdhri nr. 4 dt. 10.10.2020 i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Normave Tekniko Profesionale të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë, neni 19 pika 1, Manuali i Auditimit të Brendshëm, paragrafi 4.1.12, Kreu 6, paragrafin 6.3, Kreun IV, paragrafi 4.1.13.1. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 14-26, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
**2.1 Rekomandimi**: Titullari i institucionit të miratojë ngritjen e Komitetit të Auditimit të Brendshëm në përputhje me Ligjin. Dosjet e auditimit të arkivohen sipas përcaktimeve të

legjislacionit në fuqi. Përgjegjësi i Sektorit të Auditimit të Brendshëm të marrë masa për çeljen manualisht dhe eletronikisht të dosjeve të përhershme të auditimit të sektorëve dhe drejtorive të institucionit. Përgjegjësi i Sektorit të Auditimit të Brendshëm të marrë masat për hartimin e raporteve dhe projekt-raporteve të dosjeve të auditimit në përputhje më kërkesat dhe standardet e përcaktuara në Manualin e Auditimit të Brendshëm.

***Menjëherë dhe në vijimësi***

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se në Bashkinë Roskovec nuk ka funksionuar specialisti i riskut për menaxhimin e buxhetit sipas strukturës dhe sipas Ligjit 68/2017 neni 32,34 pika 1, neni 40 pika 3 dhe Udhëzimi nr. 5, datë 27.02.2014, i ndryshuar me Udhëzimin nr. 5/1 datë 21.05.2014, Udhëzimi i MFE nr. 2, datë 06.02.2012 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit".
Nga auditimi u konstatua se në pikën 11 të Rregullores, ku përshkruhet përbërja e strukturës së Drejtorisë së Planifikimit të Territorit, Kontrollit të Projekteve, Shërbimeve Publike, Transportit, Administrimit të Ujërave, Diasporës, Migracionit dhe Integrimit Evropian, si dhe përgjegjësitë dhe detyrat e kësaj drejtorie së bashku me punonjësit e saj, vihet re një mbi ngarkesë e detyrave dhe kompetencave të kësaj drejtorie, duke qenë se pjesë e saj janë dhe specialistë të integrimit evropian dhe specialistë për çështjet e diasporës, migracionit dhe integrimit evropian. Në Drejtorinë e Asistencës ndaj Fermerit, Mjedisit, Shërbimit Pyjor, Mbrojtjes Konsumatore dhe Shërbimit Veterinar, Sektori për Bujqësinë, Asistencën e Fermerit dhe Administrimin e Ujërave, është parashikuar specialisti Administrimit të Ujërave, i cili konkretisht mbikëqyr dhe kontrollon punën e Specialistit për Ujitjen, pjesë e strukturës së Drejtorisë së Planifikimit të Territorit. Për të mos ngarkuar strukturën e Drejtorisë së Planifikimit të Territorit, si dhe për të lehtësuar e thjeshtëzuar punën në shërbimin ndaj qytetarëve, do të duhej që pozicioni i Specialistit të Ujitjes të vendosej në Sektorin e Administrimit të Ujërave në Drejtorinë e Asistencës së Fermerit Mjedisit, Shërbimit Pyjor, Mbrojtjes Konsumatore dhe Shërbimit Veterinar. Këto dy drejtori mbajnë në emërtesën e tyre funksionin e Administrimit të Ujërave, duke ndërlikuar ushtrimin e detyrave dhe përgjegjësive të përcaktuar në Rregulloren e institucionit. Bashkia Roskovec nuk ka një plan strategjik për veprimtarinë vjetore ose të viteve në vijim. Nuk është hartuar dhe miratuar në dokument të veçantë deklarata e misionit. Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Bashkia Roskovec, ka hartuar një plan të brendshëm trajnimesh për punonjësit e këtij institucioni, por nuk dokumenton pjesëmarrjen e tyre dhe urdhrat përkatës. Bashkia Roskovec ka miratuar plan pune vjetor lidhur me funksionimin e Grupit për Menaxhimin Strategjik". Procesverbalet e mbledhjeve të GMS përgjatë vitit 2023 janë të pa protokolluara, si dhe u konstatua mungesa e firmave të disa anëtarëve të GMS. Bashkia Roskovec nuk ka hartuar planin e përgjithshëm strategjik të zhvillimit afatmesëm për institucionin. Në Bashkinë Roskovec nuk është hartuar dhe miratuar strategjia e menaxhimit të riskut. Bashkia Roskovec ka hartuar "Planin e Veprimit për Kontrollin e Brendshëm". Bashkia  nuk ka procedura të përshtatshme për të siguruar IT të ndryshme në sektorë të ndryshëm si dhe nuk ka plan investimesh për programet e IT. Jo çdo sistem ka procedurën e vet të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara, si dhe nuk ka një sistem elektronik back-up për të dhënat e institucionit. Në rregulloren e brendshme përcaktohen detyrat e specialistit të IT. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 14-26, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
**3.1 Rekomandimi:** Bashkia Roskovec, të marrë masa dhe të kërkojë funksionimin e specialistit për menaxhimin e riskut sipas strukturës së saj në sektorët me risk të lartë.
**3.2 Rekomandimi:** Titullari i Bashkisë Roskovec, të shtyrojë problematikat e konstatuara në lidhje me funksionimin e komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, duke garantuar marrjen e masave për përmirësimin e situatës në funksion të mirëadministrimit të bashkisë.

***Menjëherë***

**4. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi konstatohet se realizimi i shpenzimeve buxhetore me të ardhurat e veta të Bashkisë Roskovec së bashku me transfertat e pa kushtëzuara dhe specifike, për vitin 2023 kanë diferenca të dukshme me vlerën e planifikuar. Për vitin 2023 planifikimi i buxhetit fillestar për zërin e shpenzimeve me të ardhurat e veta vendore, transfertën e pa kushtëzuar dhe specifiken ka vlerën 612,497 mijë lekë buxheti i rishikuar ka vlerën 656,675 mijë lekë, ndërsa realizimi është në vlerën 451,001 mijë lekë ose në masën 69%. Zëri shpenzime page dhe sigurime shoqërore është planifikuar në vlerën 241,660 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 234,244 mijë lekë ose në masën 97%.
Zëri shpenzime operative (602) është planifikuar në vlerën 96,886 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 70,573 mijë lekë ose në masën 72%.
Zëri transferta buxhete familjare është planifikuar në vlerën 11,825 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 300 mijë lekë ose në masën 3%.
Zëri shpenzime kapitale është planifikuar në vlerën 301,704 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 145,883 mijë lekë ose në masën 48%.
Niveli i realizmit të investimeve të planifikuara, i cili është zëri më kryesor i buxhetit në lidhje me ndikimin që ka në ofrimin e të mirave publike ndaj komunitetit, për vitin 2023 investimet janë planifikuar në vlerën 301,704 mijë lekë dhe realizuar 145,883 mijë lekë ose në masën 48%.Mosrealizimi i angazhimeve buxhetore ndikohet nga realizimi i të ardhurave nga taksa dhe tarifa vendore, për të cilat nuk janë kryer analiza dhe planifikime realiste. Planifikimi i të ardhurave duhet të korrigjohet gjatë vitit duke u përshtatur me angazhime buxhetore të miratuara. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, , UMFE nr. 9, datë 20.03.2018, "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit" i ndryshuar, nenet 79, 80 dhe 81, Udhëzimit MFE nr. 22, datë 30.07.2018, "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore*". (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 26-44, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
**4.1 Rekomandimi:** Titullari i Institucionit, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në bashkëpunim me drejtoritë e tjera të Bashkisë Roskovec, të marrë masa për një planifikim të studiuar të të ardhurave të veta, duke u mbështetur mbi parashikime realiste. Mbi bazën e këtyre të ardhurave të parashikohet edhe plani i investimeve publike, me qëllim që investimet e planifikuara në buxhet të kenë burime financimi të sigurta për t'u realizuar. Për mosrealizimin gjatë vitit buxhetor të të ardhurave të planifikuara, të korrigjohet plani i shpenzimeve, brenda afateve që përcakton kuadri rregullator në fuqi.

***Menjëherë dhe në vijimësi***

**5. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi rezulton se në datë 01.01.2023, Bashkia Roskovec ka pasur detyrime të prapambetura progresive në vlerën 65,119,199 lekë me burim financimi të ardhurat e veta. Gjatë vitit 2023 është likuiduar vlera 64,108,584 lekë për detyrimet e prapambetura dhe janë krijuar detyrime të reja në vlerën 80,691,728 lekë. Totali progresiv i detyrimeve është në vlerën 81,702,343 lekë. Bashkia Roskovec nuk ka prioritarizuar likuidimin e detyrimeve të prapambetura dhe ka marrë angazhime të reja buxhetore pavarësisht se detyrimet janë në vlerën 65,119,199 lekë dhe gjatë vitit janë shtuar me vlerën 81,702,343 lekë. Bashkia Roskovec ka marrë angazhime buxhetore pa pasur fonde në dispozicion duke krijuar detyrimeve të prapambetura në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të MFE nr. 9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", pika 153-162, Rubrika - Marrja e angazhimit dhe kryerja e shpenzimeve publike, detyrimet kontraktuale midis palëve, nenin 52 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, UMF nr. 5, datë 27.12.2014 "Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura", pikat 82-91. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 26-44, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
**5.1 Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Roskovec dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, të

marrë masa që me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve, prioritet të kenë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës, pasi mos shlyerja në kohë e detyrimeve ndaj të tretëve paraqet risk për buxhetin e vitit në vazhdim të njësisë vendore, pasi një pjesë e buxhetit të kësaj njësie do të përdoret jo për të financuar nevojat reale të vitit buxhetor, por për të likuiduar detyrimet e prapambetura, duke zvogëluar fondet në dispozicion për investime dhe shpenzime të tjera në interes të komunitetit.

***Menjëherë dhe në vijimësi***

**6. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi, u konstatua se për vitin 2023 planifikimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore është në vlerën **414,712,133 lekë** dhe realizimi në vlerën **251,491,288 lekë** ose në masën **60%** me një diferencë mosrealizimi ndërmjet planifikimit dhe realizimit në vlerën **163,220,845 lekë.**
Referuar vlerës **163,220,845 lekë** të mosrealizimit disa prej zërave fiskal të cilët nuk janë realizuar në krahasim me planin e përgjithshëm të të ardhurave si më poshtë:
1-"Tarifë pastrimi" është planifikuar në vlerën 20,080,850 lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 15,675,707 lekë ose realizuar në masën 78%.
2-"Taksë ndikimi në infrastrukturë" është planifikuar në vlerën 5,500,000 lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 3,662,094 lekë ose realizuar në masën 67%.
Referuar të dhënave të sipërpërmendura me tejkalim paraqiten zërat fiskal si më poshtë:
1-"Regjistrimi i automjeti të përdorura" është planifikuar në vlerën 9,000,000 lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 10,595,649 lekë ose realizuar në masën 117%.
2-"Taksa mbi të ardhurat personale 2%" është planifikuar në vlerën 5,000,000 lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 8,645,042 lekë ose realizuar në masën 173%.
Referuar planifikimit dhe realizimit të të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore, konstatohet se për disa zëra realizimi paraqitet në vlera të ulta dhe për disa zëra realizimi paraqitet me tejkalim mbi planin, gjë e cila tregon se planifikimi i të ardhurave nuk është real, si dhe nuk ka një ndarje për efekt planifikimi, të të ardhurave të vitit aktual buxhetor, me të ardhurat që sigurohen nga detyrimet e prapambetura, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore", neni 64, Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore" i ndryshuar, neni 5, neni 42, pikat 1-2 dhe pika 4, neni 54, nënpika "c", Udhëzimin e MFE nr. 9, datë 20.03.2018, "Procedurat standarde për menaxhimin e të ardhurave" Kreu IV, pika 200. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 26-44, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
**6.1 Rekomandimi:** Sektori i Tatim-Taksave të marrë masa që:
- Gjatë hartimit të planit për realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore, të eliminojë planifikimet formale dhe të kryejë parashikime të besueshme bazuar në analiza të hollësishme për secilin zë, duke marrë në konsideratë realizimin e të ardhurave të vitit të mëparshëm por edhe arkëtimet nga detyrimet e prapambetura nga taksat dhe tarifat vendore nga vitet paraardhëse me qëllim pasqyrimin real të situatës të të ardhurave vjetore të bashkisë.
- Për secilin vit buxhetor, të mbajë të ndara për efekt planifikimi, të ardhurat e përfituara nga detyrimet e prapambetura, nga të ardhurat e përfituara nga taksat dhe tarifat vendore të vitit buxhetor aktual.

***Menjëherë dhe në vijimësi***

**7. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion konstatohet se në territorin e Bashkisë Roskovec për vitin ushtrimor 2023 kanë ushtruar aktivitetin 10 subjekte të cilat tregtojnë me pakicë hidrokarbure dhe nënprodukte të tyre. Nga auditimi u konstatua se 3 (tre) subjekte janë të pajisur me autorizim për tregtimin e hidrokarbureve, 1 (një) subjekt ka pezulluar aktivitetin dhe 7 (shtatë) subjekte nuk janë të pajisur me autorizim për tregtimin e hidrokarbureve.
Sa më sipër rezulton së Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore ka vepruar në kundërshtim

me Kreun II pika 11 e VKB nr. 90 datë 02.12.2022 "Mbi miratimin e paketës fiskale për vitin 2023" si dhe VKM nr. 970, datë 02.12.2015 "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj" i ndryshuar kapitulli II, pika 1; germa "b", dhe pika 9, ndryshuar me VKM nr. 344, datë 19.04.2017, kapitulli II, pika 1; germa "b" dhe pika 9 dhe 15. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 26-44, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**7.1 Rekomandimi:** Bashkia Roskovec, Drejtoria e të Ardhurave Vendore në bashkëpunim me Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial të marrë masa të menjëhershme për pezullimin e subjekteve, që ushtrojnë aktivitet për tregtimin karburanti pa u pajisur me autorizim/licencë.

***Deri më datë 31.12.2024***

**8. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi verifikimin e marrjes së dokumentacioneve financiarë dhe regjistrimet kontabël të kryera nga Bashkia Roskovec si dhe në njësitë vartëse, rezulton se, Drejtoria Ekonomike në Bashkia Roskovec dhe sektorët e financës në njësitë vartëse, regjistrimet e veprimeve kontabël, kryhen me program exel dhe jo me "Bartës informatik", të cilët janë programe informatike të pamanipulueshme dhe të printueshme në çdo kohë. Veprimet e kryera nuk paraqesin besueshmëri duke bartur risk në vetvete pasi janë të ndryshueshme në çdo kohë, gjithashtu ndikojnë në pasaktësi të veprimeve kontabël e rrjedhimisht në rezultate jo korrekt. Kjo gjë çon dhe në mos kuadrim të drejtë dhe të saktë si dhe vonesa në kohë për gjetjen, korrektimin dhe sistemimin e gabimeve matematikore. Mungesa e programimit kompjuterik në hedhjen e të dhënave në shërbimin kontabël, ndikon në ngadalësimin e marrjes dhe përpunimit të informacioneve financiare, besueshmërinë e të dhënave, cilësinë dhe saktësinë e evidencave kontabël dhe të pasqyrave financiare. *Veprime këto jo në përputhje me ligjin nr. 25/2018, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", nenin 3 pikat 14 e 15 dhe nenin 11.(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 44-53, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**8.1 Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Roskovec të marrë masa për pajisjen e Drejtorisë Ekonomike dhe Njësive Vartëse, me programe kompjuterike financiare për mbajtjen e kontabilitetit me qëllim shmangien e risqeve të mundshme të informacionit kontabël.

***Brenda 31.12.2024***

**9. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i pasqyrave financiare të periudhës ushtrimore raportuese 2023 u konstatua se; në disa llogari nuk paraqesin në mënyrë të drejtë në pozicionin financiar gjendjen reale në datën 31.12.2023 konkretisht llog.(210); llog.(212); llog (213); llog (520), si më poshtë vijon:

**1. Llog.(210)** "*Toka, troje, terrene*" nuk paraqet gjendjen reale sepse nga ana e Drejtorisë Ekonomike nuk janë hedh në kartelat e kontabilitetit asnjë prej vlerave të; a) trojeve nën objekt të objekteve si godina e re e Bashkisë dhe trualli përreth saj, ndërtesat e shkollave që ka në administrim, ndërtesat e shkollave dhe të zyrave në NjA, etj, sipas regjistrit të aktiveve të pasqyruar në llogarinë 212 "*Ndërtime e konstruksione*".

b) truallit të godinave të regjistruar në ASHK në pronësi të Bashkisë,

c) trojeve të cilat me VKM kanë kaluar në pronësi të Bashkisë Roskovec, si dhe nuk është kryer inventarizimi dhe vlerësimi i tyre, për të cilën duhej bërë sistemimi dhe kalimi në administrim në llogarinë përkatëse. Nga Bashkia Roskovec nuk janë reflektuar gjithashtu ndryshimet në këtë llogari sipas VKM nr. 19, datës 16.01.2019, në të cilin detyrohet si njësi të cilës i kalon prona me vlerë 30,755,412 lekë e përbërë nga ndërtesë dhe truall.

Nuk janë kryer ndryshimet përkatëse pasi nuk rezulton të jetë pasqyruar VKM datë 29.09.2021, për *Sipërfaqen tokë bujqësore (arë) në korridorin me gjerësi përgjithësisht 38 (tridhjetë e tetë) metra, në total 27,570 (njëzet e shtatë mijë e peseqind e shtatëdhjetë) m2 dhe servitutit me gjerësi përgjithësisht 8 (tetë) metra, në total 8,669 (tetë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e nëntë) m$^2$, me vlerë të përgjithshme kompensimi prej 6,242,275.63 (gjashtë milionë e dyqind e*

*dyzet e dy mijë e dyqind e shtatëdhjetë e pesë pikë gjashtëdhjetë e tre) lekësh;* e cila i ka kaluar Projektit të gazsjellësit TAP.

**3. Llog. (212)** "*Ndërtime e konstruksione*" nuk paraqet gjendjen reale sepse nuk disponohet asnjë lloj dokument pronësie për *30 objekte* me sipërfaqe trualli nën objekt të objekteve prej *23,303 $m^2$* të trashëguara nga nga ish Komunat një numër të konsiderueshëm objektesh të cilat janë në verifikim për regjistrimin e tyre. Kjo vjen për arsye se një pjesë e objekteve janë të trashëguara dhe të mbartura nga njësitë që u shkrinë (*ish/komunat*) në periudhat raportuese para vitit 2015 të pa shoqëruar me kartela objekti. Në këto kushte duke qënë se ka mospërputhje në administrimin për çdo objekt të "*Ndërtesave e konstruksioneve*" nga Bashkia Roskovec nga Sektori i Regjistrimit të Pronave, duhet që të bëhet hedhja në kontabilitet e objekteve dhe sipërfaqeve të regjistruara saktësimi objekteve, dokumentimi me kartelë objekti, inventarizim fizik i objektit, si dhe rivlerësim me normat për secilin objekt. Për sa më sipër *Llog. 212 "Ndërtime e konstruksione"* nuk paraqet një pamje reale për pasqyrat financiare të vitit 2023.

**4. Llog.(213)** "*Rrugë, rrjete, vepra ujore*" nuk paraqet pamjen reale pasi në këtë llogari nuk janë kryer ndryshimet përkatëse sipas VKM datë 29.09.2021, "Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 802, datë 30.9.2015, "Për vënien në dispozicion të shoqërisë trans Adriatik pipeline ag (tap ag), nëpërmjet marrjes në përdorim dhe krijimit të servitutit të përhershëm në sipërfaqet e tokave shtetërore që preken nga ndërtimi i korridorit të ndërtimit dhe korridori i sistemit të gazsjellësit, të projektit të Gazsjellësit Trans Adriatik (projekti TAP)", për ndryshimet përkatëse në llogarinë 213, për kalimin e *38 metra lineare, në total 14,457 m2 dhe servitutit me gjerësi përgjithësisht 8 (tetë) metra, në total 2,838 m2 pa kompensim; si dhe sipërfaqen rrugë automobilistike në korridorin me gjerësi përgjithësisht 38 metra linear, në total 5,755 m2 dhe servitutit me gjerësi përgjithësisht 8 metra, në total 1,304 m2.*

**5. Llog.(520) "**Disponibilitete në thesar" paraqitet në pasqyrat financiare në fund të vitit 2022 në shumën 82,851,685 lekë ndërsa në fund të vitit 2023 në shumën 121,091,695 lekë, shumë e cila ka kundërparti llog. 466 *(kreditorë në ruajtje)* e cila paraqitet në shumën 62,536,544 dhe llog. 85 *(teprica e periudhës)* e cila paraqitet në shumën 58,555,151 lekë. Në ekstraktin e sistemit të Thesari llog. 520 paraqitet me vlerën 0 lekë edhe pse llog. 466 dhe llog. 85 paraqiten po në vlerë të njëjtë me të dhënat e paraqitura nga Bashkia Roskovec, pra ka një mosrakordim të llog. 520, në të dhënat e PF të Bashkia Roskovec me të dhënat e sistemit të thesarit, veprim i cili nuk është në respektim të kërkesave të UMF nr. 8, datë 9.03.2018 "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme",* Kap. III, pikat 30, 50.

*Veprimet e mësipërme janë jo në përputhje me Ligji nr.68/2017"Për financate qeverisjesvendore", neni 34, pika 1, VKM nr. 510, datë 10.06.2015 "Për inventarizimi dhe hipotekimin e të gjitha pronave të paluajtshme dhe të luajtshme", Kreu (VI) "Transferimi pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme", pika (1); (2), VKM Nr 433 dt 08.06.2016 "Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/Bashkive", pika 35, shtojca me nr.33, Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", Kreu II pika 5 dhe Kreu III pika 30,* 50, *Udhëzimin e MFE nr. 2, datë 06.02.2012 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", pika 101.(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 44-53, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**9.1 Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Roskovec të marrë masa për vlerësimin e trojeve nën godina, që ka në inventar, si dhe të kryhet inventarizimi dhe vlerësimi i trojeve, të kaluara me VKM në pronësi të Bashkisë Roskovec. Po kështu për pyjet, kullotat, rrugë, vepra ujore, etj në pronësi të Bashkisë Roskovec, të transferuara me VKM, të bëhen inventarët me përditësimet përkatëse, saktësimi i hartave dhe kufijve të tyre, si dhe të bëhet vlerësimi i tyre. Pas procesit të regjistrimit në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës Fier dhe procesit të vlerësimit të kryhen

veprimet kontabël për përfshirjen e të gjitha këtyre Aktiveve Afatgjata Materiale në gjendjen e llogarive përkatëse në PF.
**9.2 Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Roskovec, të marrë masat e duhura që;
**a-**Të ngrejë grup pune i cili të verifikojë, vlerësojë, dhe saktësojë të gjitha aktivet e llogarive të klasës 2 dhe të dokumentoj këto aktive sipas kuadrit ligjor për regjistrimin e pasurisë.
**b-**Të ngrejë një grup pune me specialistë të fushës për kryerjen e inventarizimit dhe vlerësimin e aktiveve të llog. *212"Ndërtesa Konstruksione"* për NJA dhe nëpërmjet Drejtorisë Ekonomike të kryejë zbërthimin e dokumentacionit të trashëguar nga ish-Komunat për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra e veprimet me to në vite për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në bilancin e vitit 2015 e në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.
**9.3 Rekomandimi:** Drejtoria Ekonomike, në bashkëpunim me Degën e Thesarit Fier, për të bërë sistemimin e llogarisë 520 me qëllim pasqyrimin e vlerës së saktë në aktrakordimin e radhës.

***Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2024***

**10. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i pasqyrave financiare në lidhje me llogaritë 468 dhe 401-408, rezulton se; Llogaria 468 në fund të vitit 2022 paraqitet në shumën 176,090,570 lekë, ndërsa për vitin 2023 në shumën prej 188,006,444 lekë. Gjatë vitit 2023 shtesa prej 11,915,874 lekë vjen si rezultat i rritjes së debitorëve për taksa e tarifa vendore të Bashkisë Roskovec dhe Njësive vartëse. Nga ana e drejtimit të Bashkisë Roskovec rezulton se nuk janë marrë masat e duhura për uljen e detyrimeve debitore dhe rritjen e performancës në arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore. *sipas llogaritjeve të bëra nga grupi i auditimit shuma e debitorëve është në vlerën 209,296,575 lekë, pra rezulton me një diferencë të pa reflektuar në raportimin financiar të njësisë në vlerën 21,290,131 lekë.*
Nga analiza e llog. 468 "Debitorë të ndryshëm" rezulton se nuk janë përfshirë debitorët e tjerë që rrjedhin nga taksa e ndikimit në infrastrukturë në vlerën **6,393,168** lekë për 219 persona, dhe në total progresive shuma prej 26,028,331 lekë. Gjithashtu nuk janë përfshirë gjobat e vendosura nga IMT–ja dhe Policia Bashkiake në vlerën 650,000 lekë për 4 subjekte të konstatuara gjatë vitit 2023 ndërkohë që shuma progresive deri në fund të vitit paraqitet në vlerën 1,857,000 lekë së bashku me gjobat e viteve para periudhës ushtrimore e cila nuk është paasqyryar në llogarinë përkatëse. **Nga sa më sipër rezulton se llogaria 468 (debitorë të ndryshëm) nuk paraqet pamjen reale në raportimin financiar të Njësisë Roskovec.** *Veprime të cilat nuk janë në përputhje me Udhëzimi e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" kreu III pika 32, Kreu II pika 2/a, b, pika 22, me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, kreu II, neni 12, pika 3/g/gj, Rregullore e brendshme e funksionimit të Bashkia Roskovec, miratuar me vendimin pa nr. prot, datë 25.02.2019, Kreu VI, neni 36, pika 2.3. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 44-53, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
**10.1 Rekomandimi:** Bashkia Roskovec, Drejtoria Ekonomike, të marrë masat e duhura që:
**a.** Të kryejë një analizë të thelluar të rritjes së debitorëve dhe detyrimeve ndaj furnitorëve, me qëllim nxjerrjen e shkaqeve dhe përgjegjësive të rritjes së tyre.
**b.** Të hartojë plane konkrete të vjeljes në kohë të detyrimeve dhe likuidimeve ndaj furnitorëve me qëllim menaxhimin sa më efektiv të financave të Njësisë.
**c.** Të evidentojë të gjithë debitorët sipas listës analitike të shumës 6,393,168 lekë për debitorët e gjobave të IMT-së dhe taksës së ndikimit në infrastrukturë.

***Menjëherë dhe në vijim***

**11. Gjetje nga auditimi:** Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për kryerjen e procedurave të inventarizimit për vitin 2023 rezulton se nga Bashkia Roskovec nëpunësi

zbatues i njësisë publike, i caktuar nga titullari i njësisë publike, nuk ka hartuar regjistër kontabël të përditësuar të aktiveve që zotëron apo ka në administrim Bashkia Roskovec dhe njësitë në varësi, i cili në varësi të llojit të përmbajë kërkesat minimale si datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia etj. *Veprime jo në përputhje me Ligjin nr. 25/2018, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", pikat 26-33. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 44-53, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
**11.1 Rekomandimi:** Drejtoria Ekonomike, të marrë masa për plotësimin e regjistrit të aktiveve që ka në pronësi, duke plotësuar të gjitha kërkesat e formatit të aprovuar për të ulur riskun e shpërdorimeve materiale të pasurisë së Njësisë dhe për një menaxhimin sa më të mirë të tyre.

***Deri në datë 31.12.2024***

**12. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i pasqyrave financiare dhe procedurave të inventarizimit të aktiveve për vitin 2023 në lidhje me zërin (Tokë, truall, pyje, kullota etj) të cilat paraqiten në kontabilitetin e Bashkia Roskovec, rezulton se; Nga Nëpunësi i Autorizuar në cilësinë e titullarit të njësisë publike dhe nga Drejtori Ekonomik në cilësinë e Nëpunësit Zbatues nuk janë marrë masat e duhura për ngritjen e komisioneve përkatës për verifikimin dhe vlerësimin e zërit troje, pyje e kullota për Bashkia Roskovec dhe njësitë në varësi. Për këto aktive nuk është kryer asnjëherë inventar fizik në lidhje me to, për të cilat nuk mund të gjykohet nëse vlera e pasqyruar në kontabilitet, është fizikisht apo jo e disponueshme dhe e përdorshme nga institucioni çka do të thotë se nuk mund të verifikohet dhe vlerësohet dokumentacioni mbështetës i tyre. E njëjta situatë konstatohet edhe në Njësitë Administrative në varësi të Bashkia Roskovec pasi nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezultoi se nuk është kryer inventarizim për zërat e mësipërm të bilancit. *Këto veprime nuk janë në përputhje me ligjin nr. 25/2018, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", neni 11 dhe nenin 15, me ligjin nr.10296, datë 08/07/2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, neni 9 dhe 12, Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, kreu IV, pika 74. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 44-53, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
**12.1 Rekomandimi**: Nga Bashkia Roskovec, Drejtoria Ekonomike, të kryhet analiza e situatës së aktiveve të Njësisë, të vlerësohen këto asete, të plotësohen me dokumentacion pronësor, si dhe të kryhen reflektimet përkatëse në pasqyrat financiare, me qëllim vlerësimin e pronës dhe identifikimin e saj.

***Deri në datë 31.12.2024***

**13. Gjetje nga auditimi:** Për periudhën e auditimit nga data 01.01.2023 deri më 31.12.2023 Autoriteti Kontraktor Bashkia Roskovec ka realizuar gjithësej 42 procedura prokurimi blerje me vlera të vogla, me fond limit në shumën 20,082,147 lekë pa TVSH, me vlerë kontrate në shumën 16,611,980 lekë pa TVSH. Nga verifikimi i regjistrit të realizimeve dhe dosjeve të marra për shqyrtim, u audituan me zgjedhje 17 procedura me fond limit në shumën 9,725,076 lekë dhe vlerë kontrate në shumën 7,828,092 lekë, ose 48%, ku nga auditimi i dokumentacionit dhe të dhënave të vëna në dispozicion u konstatua se:
- Në 2 procedura në shumën totale të fondit limit në vlerën 1,416,666 lekë pa Tvsh, dhe vlerë kontrate në shumën 1,088,318 lekë, procedura të cilat duhet të kryheshin tenderim pasi kanë të njëjtën objekt prokurimi konkretisht; 1. Procedura me objekt: "Blerje materiale për prodhim tubo betoni, për Ndërmarrjen e Shërbimeve të Mirëmbajtëse" zhvilluar në 29.12.2024 me fond

limit 583,333 lekë pa Tvsh dhe vlerë kontrate 298,818 lekë pa Tvsh dhe 2. procedura me objekt "Blerje materiale për rrugë e trotuare gjate vitit, për Ndërmarrjen e Shërbimeve të Mirëmbajtëse" zhvilluar në muajin tetor me fond limit 833,333 lekë pa Tvsh dhe vlerë kontrate 789,500 lekë pa Tvsh.

- Në 2 procedura në shumën totale të fondit limit në vlerën 1,475,841 lekë pa Tvsh, dhe vlerë kontrate në shumën 1,215,000 lekë, procedura të cilat duhet të kryheshin tenderim pasi kanë të njëjtën objekt prokurimi konkretisht:

1. Procedura me objekt "Rikonstruksion i çezmave publike fshati Luar, Ngjeqar, Mbers" zhvilluar në 29.12.2024 me fond limit 663,824 lekë pa Tvsh dhe vlerë kontrate 465,000 lekë pa Tvsh dhe 2. procedura me objekt "Riparim i shkarjes, fshati Vlosh ml 25" zhvilluar në muajin tetor me fond limit 812,017ekë pa Tvsh dhe vlerë kontrate 750,000 lekë pa Tvsh.

-Pra rezulton se të dhënat e regjistrit të parashikimeve të hartuara nga personat përgjegjës dhe miratuar nga Titullari i Autoritetit kontraktor, nuk janë siguruar në mënyrë të tillë që, të analizoheshin sipas nevojave të paraqitura, me qëllim shmangien e copëzimit të fondeve për grup mallrat e ngjashme dhe kryerjen e tyre me procedura të rregullta konkurruese sipas kufijve monetarë. Pra nëse do të përllogariteshin drejtë nga personat përgjegjës të prokurimeve të dhënat e administruara, procedurat e blerjeve me vlera të vogla ku natyra dhe sasia e planifikuar kanë të njëjtin funksion apo të ngjashëm këto procedura do të kryheshin me procedura normale tenderimi. *Veprime të cilat nuk janë në përputhje me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, nenin 11, pika 5, neni 12, "Metoda të zbatueshme në përllogaritjen e vlerës së kontratës, pika 3, nenin 56, pika 2 paragrafi i II-të, pika 11, Udhëzimin nr. 05, datë 25.06.2021 "Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike", pika 3, nenin 74 "Personi përgjegjës për prokurimin dhe njësia e prokurimit", pika 3. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 44-53, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**13.1 Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Roskovec, Përgjegjësi i Prokurimeve, të marrin masat që, në hartimin e regjistrave të prokurimit të analizojnë dhe grupojnë emërtimin e procedurave, me qëllim shmangien e copëzimit të fondeve.

***Menjëherë dhe në vijimësi***

**14. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i procedurave të inventarizimit dhe vlerësimit të aseteve, u konstatua se Bashkia Roskovec nuk ka arritur të certifikojë dhe regjistrojnë pronat që ka në administrim në 4 njësitë administrative. Janë gjithsej 596 asete në përdorim nga këto rezulton se janë paisur me certifikatë rregjistrimi nga ASHK-Fier 20 prona dhe për **576 prona**t e tjera nuk është bërë asnjë punë për verifikimin e tyre mbi gjendjen fizike në të cilën ato ndodhen, kush i administron, si dhe nuk jane marrë masa për rregjistrimin e tyre në ASHK - Fier në kundërshtim me pikën 7 të neni 4 dhe pikën 2 e nenit 5 dhe nenit 43 pika 1 të ligjit 20/20 "Për Kadastrën" *'tarifa shërbimi të reduktuara në regjistrimin e aseteve te pushtetit vendor'.(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 92-96, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**14.1 Rekomandimi:** Bashkia Roskovec të marrë masa dhe të ndjekë të gjitha procedurat ligjore të verifikojë dhe saktësojë pronat në administrim të saj sipas Vendime të Këshillit të Ministrave dhe të bashkëpunojë me institucionin e ASHK për të regjistruar dhe pajisur me certifikatë regjistrimi të gjitha asetet që ka në përdorim.

***Menjëherë dhe në vijimësi***

**15. Gjetje nga auditimi:** Bashkia Roskovec nuk ka menaxhuar dhe nuk ka lidhur asnjë kontratë qiraje për kullotat e livadhet për blegtorinë, e cila ka në juridiksionin e saj 208 ha kullota, për pasoje ka sjellë mos shtim të ardhurash për vitin 2023, në kundërshtim me nenin 101/ 1,14,15,17 të rregullores nr.7, datë 24.11.2016 si dhe me nenet 6/3, neni 7 dhe neni 12/ 3

“ të Bashkisë Roskovec” të Ligjin nr. 57/2020 “*Për pyjet*”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 92-96, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
**15.1 Rekomandimi:** Bashkia Roskovec të marrë masa dhe të ndjekë të gjitha procedurat ligjore, të menaxhojë dhe kontrollojë asetet e veta të kullotave për të rritur të ardhurat sipas planifikimit në paketën fiskale të vitit 2023.

***Menjëherë***

**16. Gjetje nga auditimi:** Nga Sektori i Administrimit dhe Menaxhimit të Pyjeve dhe Kullotave, në vitin 2023 janë mbajtur 31 raste nga dëmtimet nga zjarret në pyje dhe nga këto në 29 raste me përshkrimin “Nuk është konstatuar asnjë shkelje ose zjarrvënje”, në dy raste përshkruhet se në datën 11.09.2023 ka rënie zjarri në sipërfaqen 2000m$^2$ , “Pa autor “, inspektoret e rruajtjes se pyjeve kanë mbajtur vetëm evidence pa ndjekje deri në fund të dëmtimit të pyjeve dhe kullotave, në kundërshtim me nenin 10 “Dënim administrativ”, neni 46 “Shqyrtimi dhe marrja e vendimit përfundimtar”, neni 50 “Njoftimi i të tretëve” i ligjit nr.10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 92-96, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
**16.1 Rekomandimi:** Bashkia Roskovec dhe Drejtoria e Administrimit të Pyjeve, të marrë masa dhe të ndjekë të gjitha procedurat ligjore për ruajtjen, identifikimin e dëmtuesve dhe menaxhimin dhe kontrollin e pyjeve, dhe të mos funksionojë, si drejtori evidentuese, por të menaxhojë asetet sipas ligjit të inspektimit në Republikën e Shqipërisë.

***Menjëherë dhe në vijimësi***

**B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI**

Bazuar në Ligjin nr. 154, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 shkronja “b” dhe “c” -Të drejtat e KLSH, dhe mbështetur në nenet 98-102, të Ligjit nr. 44, datë 30/4/2015, “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”, nenet 21-33, të Ligjit nr. 139, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, dhe pikën 93 të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, nga ana e Titullarit të njësisë publike (Bashkia Roskovec), të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. Nëpunësi zbatues të ndjekë procesin dhe të kryejë regjistrimet e nevojshme kontabël përfundimtare, me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **4,739,122 lekë pa Tvsh**, si më poshtë:

**1. Gjetje nga auditimi**: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt: “*Rikonstruksioni i shkollës mesme “Didin Bishani Kurjan*”, Bashkia Roskovec, me vlerë të kontratës 23,244,666 lekë me Tvsh, realizuar nga OE “S.” Shpk, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 1,124,502lekë pa Tvsh. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve 1743 prot., datë 17.03.2023 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Roskovec dhe OE “S.” Shpk, Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “*Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit*”, i ndryshuar, neni 7, si dhe Udhëzimin e KM nr. 2, datë 13.05.2005 “*Për zbatimin e punimeve të ndërtimit*”, Kreu III, pika 4. *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.4.1, faqe 82-92, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
**1.1 Rekomandimi:** Nga Bashkia Roskovec të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **1,124,502 lekë pa TVsh** nga OE “S.” Shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1743 prot., datë 17.03.2022, me objekt: “*Rikonstruksioni i shkollës mesme “Didin Bishani*

*Kurjan*", Bashkia Roskovec, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

***Menjëherë***

**2. Gjetje nga auditimi**: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt: "*Ndërhyrje për sigurinë e rezervuarit të Ngjeqarit*", Bashkia Roskovec, me vlerë të kontratës 51,637,895lekë me Tvsh, realizuar nga BOE "B." Shpk & "Ll." Shpk, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën **536,391 lekë pa Tvsh**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 5112 prot., datë 30.08. 2023 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Roskovec dhe BOE "B." Shpk & "Ll." Shpk, Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "*Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit*", i ndryshuar, neni 7 si dhe Udhëzimin e KM nr. 2, datë 13.05.2005 "*Për zbatimin e punimeve të ndërtimit*", Kreu III, pika 4. *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.4.1, faqe 82-92, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**2.1 Rekomandimi:** Nga Bashkia Roskovec të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **536,391 lekë pa Tvsh** nga BOE "B." Shpk & "Ll." Shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 5112 prot., datë 30.08. 2023, me objekt: "*Ndërhyrje për sigurinë e rezervuarit të Ngjeqarit*", Bashkia Roskovec, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

***Menjëherë***

**3. Gjetje nga auditimi**: Nga auditimi i zbatimit të shërbimit të kontratës me objekt: "*Asfaltimi i rrugëve të brendshme në lagjet e Bashkisë Roskovec*", me vlerë të kontratës 27,865,260 lekë me Tvsh, realizuar nga OE "L. K." Shpk, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën **2,084,900lekë pa Tvsh**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve (marrëveshje kuadër) nr. 1837 prot., date 23.03.2023 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Roskovec dhe OE "L. K." Shpk, Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "*Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit*" i ndryshuar, neni 7, si dhe Udhëzimin e KM nr. 2, datë 13.05.2005 "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit", Kreu III, pika 4. *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.4.1, faqe 82-92, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**3.1 Rekomandimi:** Nga Bashkia Roskovec të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **2,084,900lekë pa Tvsh** nga OE "L. K." Shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën (marrëveshje kuadër) nr. 1837 prot., date 23.03.2023 me, me objekt: "*Asfaltimi i rrugëve të brendshme në lagjet e Bashkisë Roskovec*", vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

***Menjëherë***

**4. Gjetje nga auditimi**: Nga auditimi i zbatimit të shërbimit të kontratës me objekt: "*Ndërhyrje emergjente në fshatin Ngjeqar, Njësia Administrative Kurjan (Riparim i shkarjes në lagjen Stan, L=50L; Riparim i shkarjes në lagjen Gogallarët; Punime në rrugën Ngjeqan-Kurtaj; Punime për Përroin e Allambrezit*)", me vlerë të kontratës 40,401,971.90 lekë me Tvsh, realizuar nga BOE 2Z.K."  & "A.&E."  & "A.-Co" Shpk, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën **993,329 lekë pa Tvsh**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 9212 prot, datë 13.08.2023 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Roskovec dhe BOE "2Z.K."  & "A.&E."  & "A.-Co" Shpk, Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "*Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit*" i ndryshuar, neni 7, si dhe Udhëzimin e KM nr. 2, datë 13.05.2005 "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit", Kreu III, pika 4. *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.4.1, faqe 82-92, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**4.1 Rekomandimi:** Nga Bashkia Roskovec të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **993,329 lekë pa Tvsh** nga BOE "2Z.K." & "A.&E." & "A.-Co" Shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 9212 prot, datë 13.08.2023, me objekt: "*Ndërhyrje emergjente në fshatin Ngjeqar, Njësia Administrative Kurjan (Riparim i shkarjes në lagjen Stan, L=50L; Riparim i shkarjes në lagjen Gogallarët; Punime në rrugën Ngjeqan-Kurtaj; Punime për Përroin e Allambrezit)*", vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

***Menjëherë***

## C. MASA PËR ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TATIM TAKSAT VENDORE

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatuar se detyrimet progresive për taksa dhe tarifat vendore për abonentë familjarë/privatë në datën 01.01.2023 paraqiten në vlerën 168,975,702 lekë. Pagesa për detyrimet e prapambetura gjatë vitit 2023 janë në vlerën 28,856,471 lekë. Shtesat gjatë vitit 2023 janë në vlerën 40,040,181 lekë dhe detyrimet progresive në datë 31.12.2023 janë në vlerën **180,059,412 lekë**. Detyrimet progresive në datën 31.12.2023 janë të kontabilizuara. Borxhi tatimor përbehet nga:
-Detyrime nga abonentët familjarë në vlerën **158,982,417 lekë** i përket 12,126 abonentëve familjarë.
-Detyrime nga biznese në vlerën **21,076,995 lekë** i përket 202 bizneseve
Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Kreu XI "Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara", nenet 88-104, Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, neni 3, pikat 9-10, nenet 20-22. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 26-44, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
**1.1 Rekomandimi:** Drejtoria e të Ardhurave Vendore në bashkëpunim me drejtoritë e tjerë të Bashkisë Roskovec, si Drejtoria e Aseteve, Drejtoria e Planifikim Zhvillim Territorit, Drejtorinë Juridike, Policinë Bashkiake dhe Drejtorinë Financës, të marrin masat administrative e ligjore duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve në vlerën **180,059,412** lekë për të bërë të mundur rritjen e performancës dhe uljen e borxhit që mund të krijohet nga mos ndjekja e tyre.

**Brenda 6-mujorit të parë të vitit 2025**

**2. Gjetje nga auditimi** Nga auditimi i pagesave të kontratave të qirave për tokat bujqësore rezulton se 1 qiramarrës nuk ka paguar detyrimin sipas kontratës në vlerën 21,000 lekë për vitin 2023 e cila përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Roskovec.
Për kontratat e qirave për ndërtesa/objekte rezulton që janë lidhur gjithsej 7 kontrata dhe 3 subjekte nuk kanë paguar detyrimin ndaj Bashkisë Roskovec, për vlerën totale prej **193,620 lekë,** vlerë e cila përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Roskovec. Sa më sipër rezulton së Drejtoria e Taksave dhe tarifave Vendore ka vepruar në kundërshtim me Ligji nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 36, VKM nr. 54, datë 05.02.2014 "Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", e ndryshuar.VKM nr. 391 datë 21.06.2006, ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave". (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 26-44, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
**2.1 Rekomandimi:** Drejtoria e Tatim Taksave Vendore të marrë masat për arkëtimin e vlerave debitorë nga subjektet:
A.L. Sh.p.k në vlerën 21,000 lekë; S. L. në vlerën 89,640 lekë; T. L. në vlerën 83,184 lekë, M. B në vlerë 20,796 lekë si dhe të ndiqet me përpikmëri zbatimi i kushteve të kontratave të qirasë.

***Menjëherë dhe në vijimësi***

## D. MASA PËR ELEMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE NË MENAXHIMIN E TË ARDHURAVE NGA TAKSAT E TARIFAT VENDORE, ME EFEKT MUNGESË TË ARDHURASH

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit që disponon Drejtoria e të Ardhurave, Bashkia Roskovec në lidhje me legalizimet e ndërtimeve pa leje dhe listave që disponon për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, konstatohet se nga ASHK Fier janë dërguar zyrtarisht me shkresë lista e qytetarëve shoqëruar me leje legalizimi.
Nga auditimi konstatohet se detyrimi për taksën e infrastrukturës në datën 01.01.2023 është në vlerën 19,635,163 lekë dhe përbëhet nga 603 debitorë. Pagesa për detyrimet e prapambetura gjatë vitit 2023 janë në vlerën 7,568,890 lekë. Shtesat gjatë vitit 2023 janë në vlerën 6,393,168 lekë dhe detyrimet progresive në datë 31.12.2023 janë në vlerën 26,028,331 lekë.
Nga dokumentacioni i paraqitur konstatohet se Bashkia Roskovec për periudhën ushtrimore nuk ka njoftuar subjektet debitorë si dhe nuk u evidentuan raste që institucioni të jetë drejtuar ASHK-së Dega Fier, për bllokimin e pasurisë dhe mos kryerjen veprimeve hipotekore. Veprime këto në kundërshtim me, Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, neni 27, pika 2.1, dhe VKM nr. 860, datë 10.12.2014, "Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim" i ndryshuar, pika 5. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 26-44, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
**1.1 Rekomandimi:** Bashkia Roskovec, Drejtoria e Zhvillimit të Territorit, në bashkëpunim me Drejtorinë e të Ardhurave Vendore, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet pa leje në vlerën **26,028,331 lekë.**

***Menjëherë dhe në vijimësi***

## E. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE

**1-5. Gjetje nga auditimi:** Për periudhën objekt auditimit 01.01.2023 – 31.12.2023 nga Bashkia Roskovec janë realizuar në total 3 procedura të hapura, me fond limit në shumën 118,714,579 lekë pa TVSh (me diferencë 48,900,269 lekë) dhe me vlerë kontrate të lidhur në shumën 75,814,579 lekë pa TVSh, ose 64 % të fondit limit.
Nga auditimi i 5 procedurave me vlerë të fondit limit 156,312 mijë lekë, janë konstatuar me shkelje të akteve ligjore/nënligjore të LPP, të 5 procedurat me vlerë kontrate 124,319 mijë lekë ose 80 % e vlerës së Fondit Limit. Në 4 nga këto procedura ofertat ekonomike të OE/BOE të shpallur fitues, nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të DT, si dhe rezulton vendosje jo e drejtë e kritereve për kualifikim duke çuar në mungesë konkurrence me pasojë përdorimin të fondeve publike për vlerën 103,762,016 lekë pa TVSh, në kundërshtim me përcaktimet e kuadrit ligjor në fuqi, respektivisht:
**1.** Procedura me objekt: **"Blerje materiale për investimet e Ndërmarrjes së Shërbimeve të Mirëmbajtjes". Bashkia Roskovec**, Viti 2023, me fond limit **11,456 mijë lekë**, me fitues OE "G.1" Shpk, me vlerë të ofertës **11,219 mijë lekë**, ka rezultuar që:
Njësia e Prokurimit në kriteret e vendosura në DT në lidhje me financimin e kësaj kontratë, dhe AK Bashkia Roskovec nuk ka zbatuar parashikimet e pikës 1 të nenit 21 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "*Për prokurimin publik*" dhe pikës 2 të nenit 85,të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*".

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka kualifikuar dhe shpallur fitues e OE "G.1" Shpk, kur nuk është në kushtet e plotësimit të gjitha kritereve të DT. KVO duhet të shpallte fitues OE/BOE konkurrues, nëse plotësonte të gjitha kriteret e DT, nëse jo të anulonte procedurën dhe zhvillonte procedurë tjetër me kushte më favorizuese.*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 53-82, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**2.** Procedura me objekt: **"Asfaltimi i rrugëve të brendshme në lagjet e Bashkisë Roskovec",** Viti 2023, me fond limit **28,435mijë lekë**, me fitues OE "L. K." Shpk, me vlerë të ofertës **23,213 mijë lekë**, ka rezultuar që:

Njësia e Prokurimit në kriteret e vendosura në DT në lidhje me financimin e kësaj kontratë, dhe AK Bashkia Roskovec nuk ka zbatuar parashikimet e pikës 1 të nenit 21 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "*Për prokurimin publik*" dhe pikës 2 të nenit 85,të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*".

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka kualifikuar dhe shpallur fitues e OE "L." Shpk, kur nuk është në kushtet e plotësimit të gjitha kritereve të DT. KVO duhet të shpallte fitues OE/BOE konkurrues, nëse plotësonte të gjitha kriteret e DT, nëse jo të anulonte procedurën dhe zhvillonte procedurë tjetër me kushte më favorizuese. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 53-82, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**3.** Procedura me objekt: **"Ndërhyrje për sigurinë e rezervuarit të Ngjeqarit". Bashkia Roskovec**, Viti 2023, me fond limit **76,728 mijë lekë**, me fitues BOE "B." Shpk & "Ll." Shpk, me vlerë të ofertës **43,031 mijë lekë**, ka rezultuar që:

Njësia e Prokurimit në kriteret e vendosura në DT në lidhje me financimin e kësaj kontratë dhe rastet e detyrimeve të mëparshme kundrejt bashkisë dhe AK Bashkia Roskovec nuk ka zbatuar parashikimet e pikës 1 të nenit 21, pikës 1, të nenit 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "*Për prokurimin publik*" dhe pikës 2 të nenit 39 e nenit 85,të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*".*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 53-82, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**4.** Procedura me objekt: **"Rikonstruksioni i shkollës "Naun Doko" ambienteve sportive dhe atyre të jashtme, Marinëz". Bashkia Roskovec**, Viti 2023, me fond limit **19,359mijë lekë**, me fitues BOE "2Z.K." & "A. C." Shpk, me vlerë të ofertës **14,783mijë lekë**, ka rezultuar që:

Njësia e Prokurimit në kriteret e vendosura në DT në lidhje me financimin e kësaj kontratë dhe rastet e detyrimeve të mëparshme kundrejt bashkisë dhe AK Bashkia Roskovec nuk ka zbatuar parashikimet e pikës 1 të nenit 21, pikës 1, të nenit 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "*Për prokurimin publik*" dhe pikës 2 të nenit 39 e nenit 85,të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*".

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka kualifikuar dhe shpallur fitues e OE "L" Shpk, kur nuk është në kushtet e plotësimit të gjitha kritereve të DT. KVO duhet të shpallte fitues OE/BOE konkurrues, nëse plotësonte të gjitha kriteret e DT, nëse jo të anulonte procedurën dhe zhvillonte procedurë tjetër me kushte më favorizuese. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 53-82, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**5.** Procedura me objekt: **"Përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitete të varfra dhe të pa favorizuara", Bashkia Roskovec**, Viti 2023, me fond limit **23,038 mijë lekë**, me fitues BOE "S.", me vlerë të ofertës **18,000 mijë lekë**, ka rezultuar që:

Kriteret e vendosura nga Njësia e Prokurimit në DT për rastet e detyrimeve të mëparshme kundrejt Bashkisë Roskovec nuk janë në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës dhe në përputhje me përcaktimet e pikës 1, të nenit 77, të Ligjit nr. 162/2020, "*Për prokurimin publik*", dhe nenet 39 e 85 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar, që çdo kriter i veçantë duhet të jetë në përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka kualifikuar dhe shpallur fitues e OE "S." Shpk, kur nuk është në kushtet e plotësimit të gjitha kritereve të DT. KVO duhet të shpallte fitues OE/BOE konkurrues, nëse plotësonte të gjitha kriteret e DT, nëse jo të anulonte procedurën dhe

zhvillonte procedurë tjetër me kushte më favorizuese. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 53-82, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
**1.1-5. Rekomandim:** AK në hartimin e DT, të shmangë vendosjen e kritereve që nuk janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, nuk janë të mirë argumentuara dhe në përputhje me procedurën e zhvilluar, pasi këto veprime direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE në procedurë ose çojnë në skualifikimin e OE me ofertë më të leverdishme.
Gjithashtu, Titullari i Bashkisë Roskovec dhe KVO, të marrin masa për eliminimin e rasteve të kualifikimit të OE që nuk plotësojnë të gjitha kriteret e vendosura në DT, duke analizuar arsyet e skualifikimit të padrejtë të operatorëve ekonomikë, të cilët plotësojnë kriteret e DT, në mënyrë që në të ardhmen të mos përsëriten veprime të tilla, për të mirë përdorur fondet e Bashkisë.

***Menjëherë***

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua nga ana e Bashkisë Roskovec janë shpenzuar 592,613 lekë për vendime gjyqësore. Vlera 592,613 lekë e shpenzuar për periudhën 01.01.2023-31.12.2023 nga Bashkia Roskovec, për zbatimin e vendimeve gjyqësore, konsiderohet efekt financiar negativ në buxhet. Gjatë vitit 2023 nuk ka pasur vendime të reja gjyqësore. Vendimet gjyqësore nuk janë analizuar nga Kryetari i Bashkisë dhe nuk është kërkuar prej tij nxjerrja e përgjegjësive administrative për këto vendime. Analizimi i arsyeve të humbjeve të vendimeve gjyqësore dhe nxjerrja e përgjegjësive administrative për to, do të ndikonte pozitivisht në korrigjimin e praktikave të gabuara të ndjekura nga njësia vendore për çështje të tjera gjyqësore, evidentimin e procedurave të bëra gabim, në kundërshtim me kuadrin rregullator në fuqi, e si rezultat shmangien e tyre në të ardhmen dhe uljen e shpenzimeve financiare negative në buxhet. Veprime këto në kundërshtim me UMFE nr. 9, datë 20.03.2018, "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit" i ndryshuar, pika 60. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 26-44, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
**2.1 Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Roskovec të analizojë të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore që do të zbatojë, me qëllim përcaktimin e shkaqeve që kane sjellë humbjen e çështjes gjyqësore. Rezultatet e analizës të shërbejnë për shmangien në të ardhmen e çështjeve gjyqësore, me qëllim uljen e efekteve negative financiare në buxhet.

***Menjëherë dhe në vijimësi***

**3. Gjetje nga auditimi:** Për zbatimin e vendimeve gjyqësore për vitin 2023 është shpenzuar vlerën 592,613 lekë për 2 raste, e cila i përket vendimeve për çështje të tjera gjyqësore (dëmshpërblim për shpronësimet). Për sa trajtuar më sipër **vlera 592,613 lekë e shpenzuar për zbatimin e vendimeve gjyqësore konsiderohet efekt negativ financiar për Buxhetin e Bashkisë Roskovec.** Vendimet gjyqësore nuk janë analizuar nga Kryetari i Bashkisë dhe nuk është kërkuar prej tij nxjerrja e përgjegjësive administrative për këto vendime. Analizimi i arsyeve të humbjeve të vendimeve gjyqësore dhe nxjerrja e përgjegjësive administrative për to, do të ndikonte pozitivisht në korrigjimin e praktikave të gabuara të ndjekura nga njësia vendore në proceset e largimit të punonjësve nga puna dhe për çështje të tjera gjyqësore, evidentimin e procedurave të bëra gabim, në kundërshtim me kuadrin rregullator në fuqi, e si rezultat shmangien e tyre në të ardhmen dhe uljen e shpenzimeve financiare negative në buxhet. Veprime këto në kundërshtim me UMFE nr. 9, datë 20.03.2018, "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit" i ndryshuar, pika 60. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 26-44, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
**3.1 Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Roskovec të analizojë të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore që do të zbatojë, me qëllim përcaktimin e shkaqeve që kane sjellë humbjen e çështjes gjyqësore. Rezultatet e analizës të shërbejnë për shmangien në të ardhmen të procedurave të gabuara të ndjekura për çështjen e largimit të punonjësve nga puna dhe çështje të tjera, me qëllim uljen e efekteve negative financiare në buxhet. ***Menjëherë dhe në vijimësi***

## F. MASA DISIPLINORE

**G.1 Për punonjësit të cilët janë pjesë e Shërbimit Civil:**

Mbështetur në nenin 15 "*Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së*", shkronja (c), të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*", nenin 58 "*Llojet e masave disiplinore*", të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 "Për nëpunësin civil" i ndryshuar, në VKM-në nr. 115, datë 05.03.2014 "*Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil*", **i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Roskovec**, që për shkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit, bazuar në performancën dhe llojin e shkeljeve, të fillojë procedurat për dhënien e masave disiplinore **për 8 punonjës**, si më poshtë:

**a. "*Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet*", gërma "c" e nenit 58, për 8 punonjës.**

**1. Z. S. Ç.**, me detyrë Drejtor i Drejtorisë Ekonomike, në cilësinë e nëpunësit zbatues, për parregullsitë e konstatuara në hartimin, miratimin dhe zbatimin e buxhetit dhe mos ndjekjen për zbatimin në masë të plotë të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm në lidhje me mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimin e pasqyrave financiare të vitit 2023, për mos pajisjen me dokumentacion pronësor të aktiveve afatgjata, regjistruar në Pasqyrat financiare të Njësisë, mos ngritjen e komisioneve për verifikimin e disa zërave të aktiveve të PF, mos reflektimin e aktiveve të kaluara me VKM përkatëse në PF, mos mbajtjen me bartës informatikë të të dhënave kontabël. Veprime të cilat nuk janë në përputhje me VKM nr. 510, datë 14.08.2001 pika 1 dhe 2. me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 me ndryshime, Kapitulli III, pika 35, Kreu VI, me Ligjin nr. 25/2018, *"Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare",* neni 11 dhe nenin 15, me ligjin nr.10296, datë 08/07/2010, *"Për menaxhimin financiar dhe kontrollin",* i ndryshuar, neni 9 dhe 12, Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016, Kapitulli III, pika 3.1., Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 kreu IV, pika 74, me Udhëzimin e MFE nr. 5 datë 21.02.2022 "*Për një ndryshim në Udhëzimin e MFE nr. 8",* datë 9.3.2018 pika 2.1. *(Trajtuar më gjerësisht në pikën 2 dhe pikën 3, faqe 97-118 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.)*

**2. Z. E. K.,** me detyrë Përgjegjës i Sektorit dhe Menaxhimit të Pronave pasi, nga auditimi i procedurave të inventarizimit dhe vlerësimit të aseteve, u konstatua se nga Bashkia Roskovec nuk është bërë e mundur që të certifikojë dhe regjistrojnë pronat që ka në administrim në 4 njësitë administrative. Gjithashtu nuk është bërë asnjë punë për verifikimin e tyre mbi gjendjen fizike në të cilën ato ndodhen, kush i administron, si dhe nuk është ndjekur asnjë rrugë për regjistrimin e tyre në ASHK -Fier si dhe nuk janë marrë masat e duhura për një bashkëpunim me sektorët e tjerë për administrimin, menaxhimin dhe dhënien me qira tëtë kullotave dhe livadheve, duke sjellë për pasoje ka sjellë mungesë të ardhurash për vitin 2023. *Veprime të cilat nuk janë në përputhje me pikën 7 të neni 4 dhe pikën 2 e nenit 5 dhe nenit 43 pika 1 të ligjit 20/20 "Për Kadastrën" 'tarifa shërbimi të reduktuara në regjistrimin e aseteve te pushtetit vendor'., në kundërshtim me nenin 101/ 1,14,15,17 të rregullores nr.7, datë 24.11.2016 si dhe me nenet 6/3, neni 7 dhe neni 12/ 3 " të Bashkisë Roskovec" të Ligjin nr. 57/2020 "Për pyjet".(Më hollësisht trajtuar në pikën 3,4, faqe 98-103, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**3. Z. M. L.**, me detyrë Administrator i Njësisë Administrative Kurjan, në cilësinë e Kryetarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

Për moszbatim të nenit 21, pika 1 të Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, dhe pikës 2 të nenit 85,të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", në procedurat me objekt: "Blerje materiale për investimet e

Ndërmarrjes së Shërbimeve të Mirëmbajtjes"; "Asfaltimi i rrugëve të brendshme në lagjet e bashkisë Roskovec".

**4. Znj. E. T.**, me detyrë Përgjegjëse e Sektori i Financës, në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.
Për moszbatim të nenit 21, pika 1 të Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, dhe pikës 2 të nenit 85,të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", në procedurat me objekt: "Blerje materiale për investimet e Ndërmarrjes së Shërbimeve të Mirëmbajtjes"; "Asfaltimi i rrugëve të brendshme në lagjet e bashkisë Roskovec".

5. **Znj. Z. Ç.**, me detyrë Specialiste e Emergjencave Civile, në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.
Për moszbatim të nenit 21, pika 1 të Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, dhe pikës 2 të nenit 85,të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", në procedurat me objekt: "Blerje materiale për investimet e Ndërmarrjes së Shërbimeve të Mirëmbajtjes"; "Asfaltimi i rrugëve të brendshme në lagjet e bashkisë Roskovec".

**6. Znj. E. M.**, me detyrë Administratore e Njësisë Administrative Strum, në cilësinë e Kryetarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.
Për moszbatim të nenit 21, pika 1 të Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, dhe pikës 2 të nenit 85,të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", në procedurat me objekt: "Ndërhyrje për sigurinë e rezervuarit të Ngjeqarit"; "Rikonstruksioni i shkollës "Naun Doko" ambienteve sportive dhe atyre të jashtëme, Marinëz" dhe "Përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitete të varfra dhe të pafavorizuara", pasi KVO nuk duhet të kishte bërë propozimin tek titullari i AK për lidhjen e kontratës me atë OE të shpallur fitues.

**7. Znj. V. Z.**, me detyrë Drejtore Juridike dhe Burimet Njerëzore, në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.
Për moszbatim të nenit 21, pika 1 të Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, dhe pikës 2 të nenit 85,të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", në procedurat me objekt: "Ndërhyrje për sigurinë e rezervuarit të Ngjeqarit"; "Rikonstruksioni i shkollës "Naun Doko" ambienteve sportive dhe atyre të jashtëme, Marinëz" dhe "Përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitete të varfra dhe të pafavorizuara", pasi KVO nuk duhet të kishte bërë propozimin tek titullari i AK për lidhjen e kontratës me atë OE të shpallur fitues.

**8. Znj. O. G.,** me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Biznesit, në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.
Për moszbatim të nenit 21, pika 1 të Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, dhe pikës 2 të nenit 85,të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", në procedurat me objekt: "Ndërhyrje për sigurinë e rezervuarit të Ngjeqarit"; Rikonstruksioni i shkollës "Naun Doko" ambienteve sportive dhe atyre të jashtëme, Marinëz" dhe "Përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitete të varfra dhe të pafavorizuara", pasi KVO nuk duhet të kishte bërë propozimin tek titullari i AK për lidhjen e kontratës me atë OE të shpallur fitues.

**H. <u>PËR NJOFTIMIN E DEPARTAMENTIT TË ADMINISTARTËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË SHËRBIMIT CIVIL</u>**

Për punonjësit të cilët janë rekomanduar masat disiplinore në pikën "F" më sipër, Drejtoria e Burimeve Njerëzore e Institucionit, pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, **të ndërmarrë veprimet si më poshtë**:

**1.** Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit për punonjësit e listuar në pikën "E", në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", të ndryshuar.

**2**. Ti kërkojë Departamentit të Administratës Publike kryerjen e verifikimeve nëse punonjësit e listuar në pikën "F" janë pjesë e shërbimit civil dhe të marrë masat e nevojshme për ndjekjen e procedurës disiplinore, mbi bazën e fakteve të paraqitura në këtë Raport Përfundimtar Auditimi.

**3.** Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 1 Komisionari për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", të ndryshuar.

**Në vijimësi**

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**